- ✓ **Keep global supply chains open and functioning especially for essentials** – including medical supplies, food products and ICT products and services. Keeping the trade in essential medical supplies flowing, which means removing barriers such as tariffs on medical goods essential for combating COVID 19. Keeping food supply chains flowing is also very important, followed with additional challenges related to the food loss and waste and sudden collapse in demand from restaurants and hotels.
- ✓ **Avoid making things worse** – the most important is avoiding export restrictions on essential goods. Experiences have shown that export restrictions temporarily lower domestic prices and raise availability, but they also discourage domestic production so any benefit tends to be short-lived. Also, export restrictions undermine confidence in international markets and they can initiate panic buying, increased demand, rising prices and problems in import-dependent countries. For that reason, governments should commit not to impose new tariffs or trade restrictive measures.
- ✓ **Look beyond the immediate: Policy actions now could have a long life.** In this current state governments are providing huge amounts of support to prevent the COVID 19 crisis from destroying livelihoods, businesses and production capacity. But, it is very important how the government support is designed. The support should be transparent, non-discriminatory amongst similarly affected firms, time-bound, targeted at consumers rather than tied to consumption of specific input and final goods and services.
- ✓ **Doing more on trade and health to be ready for the next time.** The current crisis offers an opportunity to develop readiness for future pandemics. A possible agreement among countries could include elements such as: ensuring transparency regarding the trade-related measures

through sharing information with the WTO; cutting tariffs on essential medical products; disciplines on export restrictions; upfront investments in co-operative solutions and addressing the needs of the most vulnerable countries.

- **References:**

- Baldwin, R. and S. Evenett (2020), “COVID 19 and Trade Policy: Why Turning Inward won’t work”, CEPR Press – A VoxEU.org BOOK;
- Baschuk, B. (2020), “A Trade Collapse that’s Heading Into the History Books”, Bloomberg;
- CCSA (Committee for the Coordination of Statistical Activities), (2020), “How COVID 19 is changing the world: a statistical perspective”;
- Evenett, S. (2020), “Tackling COVID 19 Together”, Global Trade Alert, University of St. Gallen, Switzerland;
- OECD (2017), “Making Trade Work for All”, OECD, Paris
- OECD (2020), “COVID 19 and International Trade: Issues and Actions”, OECD
- WTO (2020), “Trade set to plunge as COVID 19 pandemic upends global economy”, press release, WTO.
- WTO (2020), Annual Report 2020.

ROLI I BANKAVE NË PËRKRAHJEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prof. Dr. Gëzim Selimi

g.selimi@eust.edu.mk, International Univesity of Struga

ABSTRAKTI

Sektori bankar ka një vend të rëndësishëm në ekonominë moderne për shkak të rolit të tij të ndërmjetësimit financiar, dmth kanalizimit të mjeteve nga kursimtarët tek investitorët. Një sektor bankar stabil, i shëndetshëm dhe efikas inkurajon akumulimin e kursimeve dhe mundëson investime produktive, duke stimuluar kështu inovacionin dhe rritjen ekonomike. Bankat janë ndërmjetësit kryesor financiar në të gjitha vendet e botës. Kreditë bankare financojnë nevojat e popullatës (familjeve), për të zgjidhur problemin e shpenzimeve të tyre apo për të lehtësuar investimet e tyre në pasuri të paluajtshme. Rritja e tepërt e kredive mund të destabilizojë seriozisht sektorin bankar por edhe ekonominë në tërësi andaj monitorimi i vazhdueshëm i sektorit bankar është një pjesë kryesore për të vlerësuar stabilitetin e sistemeve financiare kombëtare.

Kushtet e likuiditetit për sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbeten të favorshme. Stabiliteti i bankës mund të vlerësohet duke përdorur tregues të tillë si përqindja e kredive të këqija në totalin e kredive, nivelet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe normat mesatare të kthimit të kapitalit të vet.

Mikro ndërmarrjet si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol kyç në ekonominë kombëtare nëpër botë nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës, krijimit të vlerës së shtuar, duke dhënë kontribut në inovacione, me uljen e papunësisë, në krijimin e GDP-së, etj. Aktivitetet e NVM janë të kufizuara me mundësitë e financimit, veçanërisht në fazën e rritjes kur ata sigurojnë burime të reja të mjeteve kryesisht nga burimet bankare. Kreditimi bankar është burimi më i shpeshtë i financimit të jashtëm i NVM në aktivitetin investues të tyre. Por, NVM

ballafaqohen me norma më të larta të interesit për shkak të mungesës së pasurisë si kolateral për sigurimin e kredisë. Shpenzimet e larta të huamarrjes nga banka (kërkesat për sigurim, normat e larta të interesit, etj.) paraqesin njërin ndër problemet më të theksuara të NVM.

Fjalët kyçe: Norma e interesit, kredia, NVM.

HYRJE

Në tregun e ndjeshëm bashkëkohorë, çdo ndryshim në segmentet e filozofisë së biznesit të bankës lë pasoja për ndryshimin e çmimeve dhe kushteve nën të cilat u ofrohet shërbimi klientëve. Nëse ka ndryshime të shumta ose të njëkohshme, çmimi i produkteve bankare rritet dhe shërbimet bëhen më të paarrtshme për konsumatorët. Analistët theksojnë se konkurrenca midis bankave shpeshherë është e padrejtë, veçanërisht përmes politikave të normave të interesit, kushteve të depozitave, afateve të kredisë dhe jo efikasiteti në sektorin financiar. Bankat sot janë duke u bërë gjithnjë e më efikase, janë duke punuar për rikthimin e besimit të klientit ndaj bankës, i përshtatin çmimet e shërbimeve për të ruajtur dhe për të fituar besnikërinë e klientit, në garë për konkurrencë gjithnjë më të madhe nga institucionet jobankare që ofrojnë shërbime të ngjashme me kushte të ngjashme. Përmes sistemit financiar subjektet ekonomike marrin mjetet e nevojshme për financimin e nevojave operative, investimeve, rritjes dhe zhvillimit të tyre. Funksionimi i sistemit financiar bazohet në krijimin e parave dhe kredive, formimin dhe shpërndarjen e të ardhurave kombëtare, si dhe importin dhe eksportin e kapitalit. Sistemi bankar është një pjesë e rëndësishme e sistemit financiar ku bankat afariste (komerciale) janë ndër entitetet më të rëndësishme të tregut financiar dhe në sistemin e përgjithshëm të financimit të ekonomisë.

Puna bankare (bankingu) dhe kredia në ekonominë moderne kanë një ndikim të fortë në të gjitha transaksionet ekonomike dhe në sferën financiare në përgjithësi. Bankingu dhe kredia theksohen si shtylla kryesore të funksionimit dhe ristrukturimit të strukturës financiare dhe ekonomike. Në sistemin e financimit të ekonomisë dhe shtetit, bankat luajnë një rol mbizotërues, qoftë në huazimin e

drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve të ndryshme, e në veçanti NVM, qoftë ai financim indirekt përmes tregjeve financiare.

Që nga paraqitja e parave dhe kredisë, roli i bankave në thelb nuk ka ndryshuar. Por, rëndësia e saj është rritur në mënyrë të vazhdueshme përmes zhvillimit të forcave prodhuese dhe marrëdhënieve shoqërore, kështu që sot ndikimi i tyre në flukset e parave dhe e mallrave është bërë një nga lidhjet më të rëndësishme në shkëmbimin modern në botë.

1. Ndërmarrja dhe bankingu

Sipërmarrësia reflektohet më së miri në fushat që ofrojnë më shumë mundësi inovative. NVM kanë kontribuar në depërtimin dhe zgjerimin e sipërmarrësisë pothuajse në të gjithë sektorët e biznesit. Sipërmarrësia është e pranishme në të gjitha format e biznesit, kudo që ndikim mbizotërues kanë njerëzit, që kanë njohuri, që kanë aftësi dhe gatishmëri për të filluar një biznes. Pra, për të qenë sipërmarrës, duhet një ide e qëndrueshme e biznesit dhe kapitali për të investuar. Bankat përfaqësojnë institucionin më të madh dhe më të rëndësishëm për depozitim dhe të kredi dhenje, prej të cilave shumë varet edhe forca financiare e ekonomisë, ndërsa forca e bankave përcaktohet nga forca e ekonomisë kombëtare dhe popullsisë në secilin vend. Vendet më të pasura kanë edhe bankat më të forta. Bankat mbizotëruan në sistemin financiar kombëtar deri para disa dekadash, deri para fillimit të periudhës së tranzicionit e cila është një periudhë kalimtare drejt një shoqërie informacioni, respektivisht kah një shoqëri e dijes, ku sistemi bankar kërkon një transformim të thellë që përfshin rehabilitimin e tyre, hyrjen e bankave të huaja dhe zhvillimin e tregjeve financiare. Në ekonomitë e pazhvilluara, bankat janë bartësit kryesor për financimin e ekonomisë dhe janë të rëndësishme pasi nuk kanë një treg financiar të zhvilluar dhe mbizotërohen nga kreditë bankare si instrumenti themelor i financimit. Pra, në tregun e pazhvilluar të kapitalit dhe infrastrukturës financiare, kredia bankare dhe depozitat luajnë një rol themelor në financimin e ekonomisë.

2. Koncepti i tregjeve financiare

Secili treg, si ai global ashtu dhe ai i segmentuar, shpreh marrëdhëniet e dy agregatëve kryesorë ekonomik: ofertën dhe kërkesën. Raporti i marrëdhënies midis këtyre dy agregatëve ndikon në nivelin e çmimeve që formohen sipas raportit të shprehur të ofertës dhe kërkesës.

Specifikat e marrëdhënieve që shprehen për tregun në sektorin real të ekonomisë vlejné në mënyrë të barabartë edhe për segmentet e tregut që funksionojné në sferën financiare. Pra, duhet theksuar se tregu financiar ka karakteristikat e tij, të cilat manifestohen si në hapësirë, kohë dhe mënyrën e funksionimit, ashtu edhe në strukturën e tregut të materialeve të cilat paraqiten si objekt i transaksioneve të shit-blerjes në tregun financiar. Siç u theksua edhe më lart, tregu financiar është një vend i bashkimit të mjeteve monetare nga burime të ndryshme ku formohet potenciali i ofertës dhe kërkesës. Secila pjesë e këtij kapitali ka tendencë të ketë kontribut sa më të lartë, dhe me këtë kapitali alokohet atje ku mund të sjellë më shumë si për sipërmarrësit ashtu edhe për pronarët e kapitalit. Çdo transferim i mjeteve financiare, nga sipërmarrjet fitimprurëse tek subjektet e deficitare, sjell krijimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe paraqet transaksion financiar. Pra, tregjet financiare paraqesin shumën e të gjitha transaksioneve financiare.

3. Teoritë e ndërmjetësimit bankar

Teoria më e theksuar dhe më shpesh e përdorur është teoria e ndërmjetësimit bankar. Bankat dhe ndërmjetësuesit tjerë financiar jobankar, sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, mbedhin dhe huazojné depozita. Teoria bazohet në rolin e kapitalit të bankave të trajtuara si ndërmjetës financiarë. Teoria i sheh bankat si ndërmjetës financiarë të ngjashëm me institucionet e tjera financiare jobankare, të cilat japin hua dhe mbledhin depozita. Bankat krijojnë likuiditet duke huazuar nga depozituesit dhe duke dhënë hua huamarrësve afatshkurtër dhe afatgjatë.

Ekziston një numër i madh teoricienësh si përkrahës të kësaj teorie mbi bankat, ku përkrahësit e hershëm të kësaj teorie mendojnë se veprimtaria e bankave

është veprimtari negocimesh, sepse ata negociojnë midis huadhënësve dhe subjekteve kredimarrëse, ku kapitalistët janë ata që japin kapital e jo bankierët, bankat vetëm u japin hua të tjerëve. Për të investuar gjëja e parë që duhet bërë është mbledhja e kursimeve. Këto pikëpamje u bënë mbizotëruese në modelet kejnziane të rritjes në periudhën e ardhshme.

Vendet në zhvillim shpesh kanë mbështetur politikat e tyre ekonomike në këto pikëpamje në marrëdhëniet e tyre me bankat ndërkombëtare. Ata besonin se bankat mund të kompensojnë mungesën e kursimeve të brendshme përmes burimeve të tyre, duke gjetur në këtë teori justifikim për mos përfshirjen e modeleve ekonomike në operacionet e bankave. Rritja e konsiderueshme e huamarrjes nga jashtë vendit i vendeve në zhvillim që nga Lufta e Dytë Botërore ndjek logjikën e dy teoricienëve - Gurley & Shaw (1960), të cilët, merreshin me funksionin e ndërmjetësve financiarë, argumentonin se bankat nuk janë ndryshe nga ndërmjetësit tjerë financiarë, teori e cila u mbështet më vonë edhe nga Tobin (1963). Shumica e projekteve të investuara në ekonominë kapitaliste janë në pronësi dhe operohen nga sipërmarrës dhe firma private. Investitorët investojnë dhe financojnë projekte dhe më pas kërkojnë hua për të përfunduar financimin. Bankat i konsiderojnë vetëm si një lloj ndërmjetës financiar, si shumë ndërmjetësues tjerë financiar dhe bankat në asnjë mënyrë nuk kanë aftësi të krijojnë kredi. Sipas kësaj teorie, roli i bankave, si dhe i ndërmjetësve të tjerë financiarë, është thelbësor për zhvillimin e ekonomisë. Burimet financiare që krijohen nuk mbesin tek ato por, nën kushte të caktuara, u jepen institucioneve financiare. Bankat plotësojnë nevojat e ndryshme huadhënësve, por në të njëjtën kohë edhe të huamarrësve, përmes shndërrimit shumë likuid të depozitave dhe kredive të vogla por me rrezik më të madh. Bankat konsiderohen si ndërmjetës dhe gjenerojnë të ardhurat e tyre duke marrë depozita dhe fonde me interes të ulët dhe duke dhënë kredie me një normë më të lartë interesi, duke kanalizuar para nga mijëra depozitues dhe investitorë të tjerë për klientët e tyre, duke vepruar si ndërmjetës.

Teoria më e vjetër e rezervave të fraksioneve bankare thotë se secila bankë individuale është një ndërmjetës financiar e cila vetë nuk mund të krijojë para, por si

grup, kolektivisht, mund ta realizojë dhe të jetë multiplikator i shpejtë i parave. Sipas kësaj teorie, sistemi bankar gjeneron para përmes procesit të rritjes së depozitave dhe dhënies së tyre tek klientët.

Teoria e krijimit të kredive bankare konsideron që bankat, si ndërmjetës financiarë, mbledhin depozita, dhe secila bankë në mënyrë individuale krijon kreditë e veta dhe siguron para për dhënien e kredive të reja. Teoricienët kryesorë të kësaj qasje theksojnë rëndësinë e llogarisë, gjendjen ligjore dhe financiare në bankës. Schumpeteri (1912) thekson funksionin e bankierëve si prodhues dhe tregtarë të kredive (huave), të cilët sipërmarrësve u lejon të vënë në veprim planet e tyre. Kjo teori, e njohur gjerësisht si teori e krijimit të kredisë, njeh fakte për produktet e bankave, tregon për një mekanizëm të veçantë për kursimin dhe investimin në një nga institucionet kryesore të kapitalit, dhe tregon rolin e vërtetë të bankave në evolucionin kapitalist.

4. Hulumtimet e mëparshme bashkëkohore mbi ndikimin e funksionit financiar dhe bankar në zhvillimin ekonomik

Nxitësit e rritjes dhe zhvillimit ekonomik janë ndër çështjet më të rëndësishme të hulumtuara në teorinë ekonomike. Qëndrueshmëria dhe zhvillimi ekonomik më parë kanë qenë të lidhura me faktorë të ndryshëm në shkolla të ndryshme të mendimit ekonomik, siç janë burimet natyrore, fuqia punëtore, duke i përfshirë edhe aftësitë, produktivitetin dhe arsimin, sipërmarrsinë, teknologjinë dhe inovacionin. Kapitali u përfshi më vonë në teorinë klasike ekonomike si një element kryesor. Pa një akumulim të rëndësishëm të kapitalit, faktorët e tjerë të prodhimit kanë një rëndësi të vogël. Zhvillimi i sektorit bankar (bankingut) dhe sofistikimi i sektorit financiar gradualisht bëhen shumë të rëndësishëm për çdo komb dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Bankat konsiderohen si institucione financiare të cilat marrin depozita dhe akordojnë kredi. Njëherit bankat paraqesin rojet kryesore të masës monetare në ekonomi, të cilat së bashku me ndërmjetësuesit tjerë financiar, paraqesin burim i

rëndësishëm për ndërmarrjet. Bankat konsiderohen si institucione financiare me traditë të gjatë, ndërsa kredidhënia është njëra nga funksionet fillestare të bankës. Pra, banka është institucion i cili grumbullon mjetet e lira monetare (depozitat), aprovon kredi dhe siguron paratë transaksionale (pagesat). Një përkufizim më i saktë mund të jetë, banka është institucion e cila grumbullon mjete dhe ua afron ndërmarrjeve ekonomike.

Komponeta e parë e rëndësishme e bankës është transformimi i mjeteve, nga ku banka i transformon mjetet afatshkurtër (likuide) –depozitat pasive në mjete afatgjate (më pak likuide) –në aktive. Funksion i rëndësishëm i bankës është të paraqitet si vlerësues i riskut kreditues në emër të depozituesit mjetet e të cilit banka i plasoi. Pra, banka është ndërmjetësues financiar që vlerëson sigurinë dhe racionalitetin në formë të huadhënies. Potenciali depozitues i bankës paraqet mjetet të cilat formohen në bazë të depozitave të një numri të madh investitorësh.

Roli i bankave dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e NVM nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm se tani. Në epokën e globalizmit, ku në mes të tjerash, kemi lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, ku në treg dominon një konkurrencë tepër e madhe, roli i bankave është të ofron përkrahje dhe financim të NVM dhe njëkohësisht të mundëson një rritje të qëndrueshme ekonomike.

5. Koncepti dhe rëndësia e mekanizmit të interesit

Bankingu dhe kredia në kushtet bashkëkohore kanë një rol shumë të rëndësishëm në sferën e ekonomisë dhe financave në përgjithësi. Ekzistojnë lloje të ndryshme dhe norma të ndryshme interesit, por është e pashmangshme që nocioni interes të jetë gjithnjë i lidhur me bankën. Norma e interesit është çmimi i kredisë, ose edhe më gjerësisht, çmimi i konsumit aktual për konsumin e ardhshëm. Lulahshmëria e tepërt dhe lëvizjet e normave të interesit kanë një efekt të dëmshëm në solvencën e prodhuesve vendas dhe institucioneve financiare, në vendimet mbi të gjitha kursimet dhe investimet, mbi qëndrueshmërinë e bilancave dhe kursit valutor. Stabiliteti i

normës së interesit për një periudhë të caktuar supozohet, që është një nga kushtet e qëndrueshme në tregun financiar. Këto janë udhëzimet themelore që ndikojnë në funksionimin e sistemit financiar dhe bankar.

5.1. Koncepti i interesit - kostoja e përdorimit të parave të huazuara

Sipas konceptit të përgjithshëm teorik të interesit, interesi është çmimi i përdorimit të kredisë dhe burimeve monetare në tregun financiar. Baza për interesi gjindet në pabarazitë financiare të transakcioneve të tregut dhe preferencave të ndryshme kohore të tyre për kursimet dhe konsumin. Shkalla e dobisë së burimeve monetare është gjithmonë më e lartë në të tashmen sesa në të ardhmen, që është edhe kushti për të paguar interesin si çmimi i tregut për përdorimin e tyre në një periudhë të caktuar. Prandaj, kursimet përcaktohet si pjesë e të ardhurave rrjedhëse që transferohen për një normë të caktuar interesi në një periudhë të ardhshme për të rritur më pas mjetet (aktivet) e kursimtarëve. Duke pasur këtë parasysh, niveli i interesit duhet të jetë stimulues për të siguruar prosperitetin e shpenzimeve në të ardhmen në raport me shpenzimet e tanishme të pronarit të tepicës financiare. Në qoftë se nuk sigurohet një nivel interesi i duhur, do të mungojë motivi i pronarëve të kapitalit për të shtyrë konsumin e tanishëm. Norma e interesit është në nivelin që barazon kursimet ose akumulimet e dëshiruara me investimet e dëshiruara kur ekonomia është në gjendje ekuilibër. Në teorinë monetare, koncepti i interesit është një nga çështjet më të ndërlikuara dhe njëkohësisht më të diskutueshme. Interesi rregullon "kërkesën për para", veçanërisht të ashtuquajturat kërkesa spekulative për para.

Forma e parë e kapitalit që sjell interes ishte kapitali i gjelbër, ndërsa në kapitalizëm mbizotëron kapitali hua. Kapitali i hua është forma më parazitare e kapitalit pasi nuk kryen asnjë funksion në prodhim dhe tregti dhe përsëri gjeneron të ardhura - interes. Tri burimet themelore të kapitalit të huas janë: fondet e pronarëve të mjeteve të prodhimit, mjetet e popullsisë dhe fondet e shtetit. Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në vlerën e normës së interesit në tregun e kapitalit. Këto kryesisht janë faktorë të tregut, faktorë jo-tregut dhe faktorë specifik të ofertës dhe

kërkesës. Faktorët më të rëndësishëm që përcaktojnë interesin janë faktorët e tregut: shumta e normës së fitimit, oferta ose kërkesa e kapitalit hua, rreziku i kapitalit, kostoja e huadhënësimit në kreditë e angazhuara, politika ekonomike dhe politika më e ngushtë monetare dhe fiskale. Ndikim të madh në nivelin e normave të interesit kanë edhe faktorët jo treg, siç është ndikimi i shtetit. Përveç këtyre faktorëve, ekzistojnë edhe faktorë specifikë në anën e ofertës dhe kërkesës. Në anën e kërkesës janë: investimi, fitimi i pritshëm, raporti i kapitalit vetanak dhe atij të huazuar. Në anën e ofertës, faktorët specifikë janë: shkalla e rrezikut, afati për të cilin jepen mjetet, oferta e përgjithshme e kapitalit, etj.

5.2. Interesi si kosto oportune e investimit

Formimi i çmimit të kredisë bankare mund të shpjegohet duke theksuar ndryshimet kryesore midis tregut të mallrave dhe shërbimeve për kreditë bankare. Supozimi themelor në tregun e mallrave është se ka shumë aktorë në anën e ofertës dhe kërkesës që blejnë dhe shesin mallra homogjene, dhe supozimi i dytë është njëkohësia, që do të thotë se mallrat dorëzohen dhe paguhen në të njëjtën kohë. Në tregun e kredisë bankare, kredia si mall që e ofron një bankë po hasë në premtimin e huamarrësit për të shlyer kredinë plus koston e huazimit. Prandaj, në literaturë shprehet se bëhet fjalë për vlerësimin e huave, për shkak të rrezikut moral dhe përzgjedhjes së gabuar, që bëhet kur jepet kredi. Kështu, nëse supozohet ngjashmëri midis tregut të mallrave dhe shërbimeve dhe kredive bankare, atëherë norma e interesit si çmim i kredisë do të formohej në nivelin që barazon ofertën dhe kërkesën për kredisë.

Sidoqoftë, në tregun e kredisë, zakonisht ka një dukuri ku kërkesa është më e tepërt se sa oferta. Prandaj, një numër i huamarrësve mbeten gjithmonë pa e kënaqur kërkesën e tyre për hua. Teoria klasike ekonomike përcakton ekuilibrin e nivelit të interesit si normën e të ardhurave të kapitalit real. Norma e interesit të tregut formohet në tregjet financiare si rezultat i raportit të ofertës dhe kërkesës midis kredisë dhe burimeve monetare. Në nivelin makroekonomik, niveli i normës së interesit krijohet si çmimi i përdorimit të mjeteve të lira dhe i shtyn përdoruesit t'i

përdorin këto fonde në mënyrën sa më sa më racionale. Në nivelin mikroekonomik, secili biznes duhet të llogarisë me normën ekzistuese të interesit për të vlerësuar nëse është duke përdorur në mënyrë racionale burimet e veta të financimit. Prandaj, konstatohet se interesi ka efekte të ndryshme në: prodhim, dinamikë dhe vëllimin e investimeve, çmimet dhe inflacionin në vend, akumulimin dhe të ardhurat totale dhe fitimin e subjekteve ekonomike.

6. Interesi bankar tregtar

Në kushtet e çrregullimit të afarizmit bankar dhe ndryshimeve dinamike në mjedisin bankar, normat e interesit bankar shpesh ndryshojnë dhe përshtaten me kushtet e reja të afarizmit të bankës. Ndryshimi i normës së interesit është një tipar i rëndësishëm i politikës së biznesit të një banke dhe një faktor kryesor për biznes të suksesshëm.

Ekzistojnë disa lloje të normave të interesit bankar: normat e interesit aktiv dhe pasiv; norma nominale dhe reale e interesit; normat fikse dhe të ndryshueshme të interesit; normat e interesit efektiv dhe referencë; normat konform dhe relative të interesit; normat e interesit të dukshëm dhe bazë; normat e interesit të paracaktuar ligjor dhe zbritëse; normat e interesit afatshkurtër dhe afatgjatë. Normat aktive të interesit janë normat me të cilat bankat i japin kredi (hua) nga fondet e tyre për bizneset dhe popullatën. Të gjitha këto janë interesa që përbëjnë të ardhurat e bankës, pra interesin që llogarisin bankat dhe arkëtojnë për shërbime të caktuara, para së gjithash për kreditë. Normat pasive të interesit përfaqësojnë të gjitha pagesat që një bankë u bën klientëve të saj dhe në të vërtetë janë një rrjedhje e fondeve nga banka. Pra, është interesi që banka u paguan klientëve të saj për mjetet e investuara tek ajo, siç janë depozitat e kursimeve, depozitat bankare dhe të ngjashme. Diferenca në të ardhura midis normave totale të interesit aktiv dhe atyre totale të depozitave përfaqëson të ardhurat neto nga interesi i bankës. Të ardhurat neto nga interesi i bankës janë baza e të ardhurave totale të secilës bankë tregtare ose afariste. Në bankat afariste me ekonomi të tregut, të ardhurat nga interesi aktiv zënë 70% -80% të të ardhurave totale të bankave në të gjitha bazat.

Lartësia e normës së interesit të kredisë është njëra nga komponentët më të rëndësishme në përcaktimin e NVM për kredimarrje, pasi që norma e interesit njëherit paraqet shpenzim për NVM dhe është determinanti kryesor për kredimarrësin nëse do të vendoste të merrte kredi. Lartësia e normës së interesit përcakton edhe koston e NVM për sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare. Rënia në normën e interesit dhe kërkesa për kredi, qëndrojnë në proporcion të zhdrejtë me njëra tjetrën. Bankat komerciale të RMV janë të interesuara që të plasojnë sa më shumë kredi tek NVM, në mënyrë që të realizojnë objektivat e përcaktuara duke angazhuar individ si këshilltarë special për biznese, në mënyrë që të krijojnë bashkëpunim afatgjatë në mes bankës dhe klientit. Këta këshilltarë, përveç që japin informata për mundësitë e kreditimit, ata në një formë shërbejnë edhe si kontrollues dhe këshilltar financiar për kreditë e kërkuara, pra i rishqyrtojnë në mënyrë detale dhe profesionale biznes planet e përgatitura na ana e bizneseve dhe të pasqyrave financiare.

Bankat e nivelit të dytë në RMV vazhdimisht tentojnë të përvetësojnë bizneset në bashkëpunim gjithëpërfshirës, duke filluar që nga kredidhënia, pagesat dhe transferet me klientët brenda dhe jashtë vendit, hapja e akreditivave devizor, dhënia e garancive bankare, kalimi i pagave të punëtorëve nëpërmjet bankës konkrete, dhënies së konsulencës financiare, tregtare, investive, logjistike, etj. Ky bashkëpunim gjithëpërfshirës në mes bankës dhe biznesit të caktuar mundëson që biznesit t'i aprovohet një limit kreditor deri në një shumë të caktuar, varësisht nga potenciali kreditor i biznesit, dhe i lihet në dispozicion për një periudhë të caktuar kohore. I tërë ky bashkëpunim ndikon në normën e interesit të favorizuar, që nënkuptojnë nën çmimin e rregullt të ofruar nga banka.

Norma e interesit është një nga faktorët më të rëndësishëm të marrjes së një kredie biznesi, pasi që norma e ulët e interesit ndikon në rritjen e kredimarrjes dhe normat e larta të interesit mund të çojnë në rritje të borxhit. Prandaj, bizneset duhet analizuar të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në normat e interesit të kredisë për biznes përpara se të aplikojnë për kredi.

Shumica e bizneseve të anketuara kanë rezultuar të jenë NVM, me veprimtari bazë shërbyese. Norma e interesit ka pasur ndikim në vëllimin e kredimarrjes së bizneseve të anketuara, ku 3/4 e këtyre bizneseve të anketuara kanë shfrytëzuar kredi bankare. Sipas këtyre bizneseve normën e interesit për kredi e konsiderojnë si të lartë dhe njëherit i konsiderojnë si të larta edhe shpenzimet administrative për marrjen e një kredie. Njëherit, për këto biznese norma e interesit është element shumë i rëndësishëm në vendimmarrjen për kredi dhe se shumica do ta ndërronin bankën pikërisht për shkak të saj. Më e rëndësishmja është se bizneset e hulumtojnë tregun bankar para se të marrin një vendim për kredi dhe njëherit ndihen më përgjegjës për investimin e bërë nëpërmjet borxhit.

PERFUNDIMI:

Në ekonominë bashkëkohore roli i resurseve monetare është gjithnjë e më i madh në rregullimin e rrjedhave të përgjithshme afariste, veçanërisht në kushtet kur ka mungesë të mjeteve monetare. Nga “neutraliteti” i dikurshëm i parave në ekonomi, nuk ka ngelur thuajse kurrgjë pasi tani kapitali në mënyrë të theksuar e përcakton dhe e formatizon sasinë dhe intensitetin e investimeve. Në periudha të ndryshme kohore, veprimi i parasë gradualisht ka ndryshuar dhe sot ka një rol dominues dhe të rëndësishëm në ekonomi. Kur kjo vëzhgohet nga aspekti i sipërmarrësisë, veçanërisht në vendet në tranzicion, roli i kapitalit dhe idesë afariste është e njëjta. Për shkak sistemit financiar të pazhvilluar në RMV, burimi kryesor i mjeteve në ekonomi është sistemi bankar dhe banka për shërbimet e saja arkëton një shumë të caktuar kompensimi, respektivisht, çmimi i konsumit të tanishëm i shprehur në konsumin e ardhshëm. Pra, kur qartësohet ideja afariste, përcaktohet vlera dhe arsyeshmëria e investimit fillon gjurmimi i sigurimit të mjeteve të volitshme financiare. Mu në këtë moment pasqyrohet roli dhe funksioni i interesit, si pjesëmarrësi kryesor në procesin e sipërmarrësisë dhe investimit, që do të thotë se kapitali nuk mundet pa investimet dhe as investimet pa kapital.

Literatura e shfrytëzuar

- Abdylmenaf Bexheti, Financat publike, Tetovë, 2007
- Adrian Civici, Kriza financiare, Tiranë, 2010
- Ahmet Mançellari, Tregëtia ndërkombëtare, Tiranë, 2004
- Alqi Naqellari, Hyrje në mikroekonomi, Tiranë, 2004
- Alqi Naqellari, Politikat ekonomike dhe ambienti politik shqiptar, Strugë, 2010
- Anastas Angjeli, Ditari i tranzicionit ekonomik, Tiranë, 2013
- Edlira Luçi, Investimet, Tiranë, 2007
- Gazmend Luboteni, Menaxhmenti Bankar, Prishtinë, 2015
- Halit Xhafa, Beshir Ciceri, Drejtimi financiar 1 dhe2, Tiranë, 2003
- Isa Mustafa, Menaxhmenti financiar, Prishtinë, 2007
- Mihael R. Baye, Ekonomia menaxheriale dhe strategjia e biznesit, 2009
- Mishkin, Ekonomiksi i parasë, bankingut dhe tregjeve financiare, Prishtinë, 2016
- Nasir Selimi, Hyrje në ekonomiks dhe biznes, Tetovë, 2013
- Paul G. Farnham, Ekonomi për menaxherë, FARNHAM, 2009
- Sabahudin Komoni, Financat, Prishtinë, 2009
- Sabri Kadriu, Financat Publike, Prishtinë, 2012
- Seadin Xhaferi dhe Avdi Elezi, Terminologji financiare , Shkup, 2009
- Selman Selmanaj, Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë, 1996
- Spiro Brumbulli, Investimet, Tiranë, 2002
- Taki Fiti, Osnovi na mikroekonomijata, Shkup, 1999
- Xheladin Shatku, Paraja dhe aktiviteti ekonomik, Shkup, 2004

SOME POLICY RESPONSES TO POST-PANDEMIC ECONOMIC RECOVERY¹

Florian Miti*, Sibora Zahaj**

*Department of Economics, University “Ismail Qemali” of Vlora, Albania

florian.miti@univlora.edu.al

**Prefecture of Vlora, Albania

sibora.zahaj@gmail.com

Abstract:

As the new coronavirus, COVID-19, outbreak all over the globe in the first months of 2020, the prompt response of many governments was the general lockdown of economic and social activities. These extreme measures were taken almost simultaneously in every country, as soon as the virus was spreading out, as a desperate measure to stop massive population contagion and thus prevent the public health system collapse.

Now, as countries are cautiously opening up, policymakers have to cope with the economic aftermaths of this pandemic. Financial support to firms, families, and workers was a first emergency measure, but this is not enough for a steady economic recovery.

This article tries to find which policies might result in a better economic stimulus, especially regarding the emerging economies.

Abstrakti:

Ndërsa koronavirusi i ri, Covid 19, u përhap në të gjithë globin në muajt e parë të 2020, përgjigjja e shpejtë e shumë qeverive ishte bllokimi i përgjithshëm i veprimtarive ekonomike dhe sociale. Këto masa ekstreme u morën pothuajse njëkohësisht në çdo vend, menjëherë pas përhapjes së virusit, si një masë

¹ Alb: “Disa përgjigje të politikave për ringritjen ekonomike pas pandemisë”

dëshpëruese për të ndaluar infektimin masiv të popullatës dhe për të parandaluar kështu një kolaps të sistemit shëndetsor publik. Tashmë, ndërsa vendet hapen me kujdes, politikëbërësit duhet të përballen me pasojat ekonomike të kësaj pandemie. Ndihma financiare për firmat, familjet dhe punëtorët ishte një masë e parë urgjente, por kjo nuk është e mjaftueshme për një rimëkëmbje të qëndrueshme ekonomike. Ky artikull përpiket të analizojë politikat të cilat mund të rezultojnë në një stimulim më të mirë ekonomik, sidomos në lidhje me ekonominë në zhvillim.

1. Hyrje

Pandemia prej koronavirusit të ri e ka zhytur botën në një mega-krizë permast e të cilës nuk i kemi parë ndonjëherë në kohët moderne. Ndërsa epidemiologë, virologë e kërkues nëpër laboratore kanë nisur një garë globale në nxitim për të gjetur një vaksinë efektive kundër virusit të quajtur SARS-CoV-2 e të pagëzuar nga Organizata Botërore e Shëndetësië si COVID-19, janë duke bërë krahasime dhe shfrytëzuar eksperiencën e fituar me shfaqjen në fillim të vitit 2003, të një tjetër koronavirusi (SARS-CoV-1) dhe përhapjen e tij nga Kina Jugore në Azinë Juglindore; - po kështu, një numër i konsiderueshëm ekspertësh, ekonomistësh apo politikëbërësish të cilët janë dhe ata në kërkim të ethshëm të gjetjes të “vaksinës ekonomike” dhe recetave të shpëtimit nga kriza ekonomike e shkaktuar prej e Covid-19, po i referohen shpesh krahasimit të kësaj të fundit me krizën e “Depressionit të Madh” të viteve 1930 të shekullit të kaluar.

Qëllimi kryesor i ekonomistëve në këtë rast nuk është thjesht analiza e mekanizmit që shkaktoi krizën më të madhe ekonomike, financiare e sociale të shek. XX-të dhe pasojat e tëmerrshme të saj, por, mbi të gjitha, masat dhe politikat e përdorura për përballimin e krizës dhe daljen prej saj pasi shifrat e dëmeve ekonomiko-financiare dhe sociale janë mjaft të ngjashme mes tyre.

Megjithatë, kjo krizë nuk u shfaq si një krizë e ofertës, por si një krizë e kërkesës e provokuar nga pandemia botërore si pasojë e masave shtrënguese shëndetësore për pengimin e përhapjes së saj, që me izolimin pothuajse total të popullatës, frenuan rëndë edhe ekonominë duke ulur në minimum konsumin si pasojë e pa-mundësisë për të lëvizur dhe konsumuar, ndërkohë që ekonomia globale vinte nga një trend pozitiv i rritjes ekonomike.

Janë pikërisht diferencat në shkaqet e formimit të këtyre krizave që çojnë dhe në një analizë më të thellë dhe të kujdeshme në lidhje me zbatimin e recetave të vjetra antikrizë.

Duke analizuar krizën e “Depresionit të Madh”, nobelisti në ekonomi, Milton Friedman, evidentoi rolin e “ngjitjes së frikës” në gjithë ecurinë dhe pasojat e kësaj krize ekonomiko-financiare. Sipas tij, “kriza dhe paniku” ishin drejtuesit kryesorë të saj pasi nga frika se bankat nuk do të kishin likuiditetin e nevojshëm në raport me depozitat e tyre, njerëzit u dyndën përpara sporteleve të bankave për të tërhequr paratë e tyre duke çuar në përshpejtimin e falimentimit të sistemit bankar, kjo dhe për faj të politikës pasive të Bankës Qendrore (FED), duke mos injektuar likuiditet dhe duke mos funksionuar kështu si “huadhënësi i fundit”.

Prej asaj kohe, ashtu siç dhe u faktua nga rimëkëmbja prej krizës më të fundit bankare të viteve 2007-2009, politikat monetare janë bërë shumë aktive e relaksuese në emër të furnizimit të tregut me likuiditet dhe shpëtimin të bankave e tregjeve financiare, të shoqëruara këto me politika keynesianiste me ndërhyrjen shtetërore në investimet publike apo edhe me programet masive të ndihmës për ruajtjen e punësimit apo pagesat e papunësisë, blerjen e borxheve të ndryshme nga bankat qendrore etj.

Kështu, masat emergjente të marra nga Banka Qendrore Europiane (BQE) në përballimin e krizës të shkaktuar nga emergjenca e Kovid-19, konsistojnë në një sërë politikash monetare dhe masash të mbikëqyrjes bankare për të lehtësuar ndikimin e pandemisë së koronavirusit në ekonominë e euro zonës dhe për të mbështetur të gjithë qytetarët evropianë².

Së pari, janë masat e synuara për të siguruar në një shkallë masive që likuiditeti të hyjë atje ku ai duhet më shumë. Objektivi i huazimit të synuar siguron deri në rreth 3 trilion euro likuiditet për bankat me një normë negative, e cila mund të jetë aq e ulët sa -0.75%, niveli më i ulët që ka ofruar ndonjëherë. Nga përvojat e kaluara BQE e di se masa të tilla mund të jenë mjaft të fuqishme. Ajo ka prezantuar gjithashtu një paketë lehtësuese të kolateralit, me një fokus të veçantë në bizneset më të vogla, të vetëpunësuarit dhe individët privatë.

Së dyti, BQE është duke blerë bono të sektorit publik dhe privat në një vëllim të madh për të siguruar që të gjithë sektorët e ekonomisë të mund të përfitojnë nga kushte të lehta financimi. “Programi për blerjen e urgjencës pandemike”, së bashku me programet e blerjes së aseteve, e lejon BQE të blejë më shumë se 1 trilion € obligacione deri në fund të këtij viti. BQE gjithashtu ka shtrirë blerjet e aseteve në letërat tregtare, të cilat janë një burim i rëndësishëm i likuiditetit për firmat. Kjo u siguron atyre ndihmë shtesë për të menaxhuar flukset e tyre të përditshme të parave dhe për të shmangur pushimet të panevojshme nga puna.

Ndërkohë, në rrafshin qeverisës të Bashkimit European, vendet anëtare të BE-së nuk kanë rënë dakort për krijimin dhe aplikimin e instrumentit të

² Shkeputur nga: “How the ECB is helping firms and households” by Christine Lagarde, President of the ECB 9/4/ 2020

“Coronabond-it”, i cili do të ishte një mundësi më shumë, sidomos për vendet më të prekura nga kriza, për të financuar shpenzimet për mbështetjen sanitare e shëndetësore, aktivitetin ekonomik, mbështetjen e papunësisë, etj. Po kështu dhe “fondi i rimëkëmjes” i cili kërkon një dakortësi të 27 vendeve, hasi në debate të forta fillimisht nga që vende si Holanda, Austria, Danimarka, Suedia, Finlanda të cilat preferojnë sistemin e huasë së që duhet të shlyhet në vitet në vazhdim dhe jo formën e grantit, duket se është pranë aprovimit të tij³ (dhe pse pothuajse i përgjysmuar, sipas propozimit Franko-Gjerman prej 500 miliard Euro).

Kujtojmë që Bashkimi European u kritikua shumë nga autoritetet italiane për mbështetjen e pakët të Italisë në përballimin e krizës shëndetësore të Covid-19, sidomos gjatë muajit mars, gjë që vuri në provë funksionimin e këtij bashkimi dhe coi më pas në reagimin e presidetes së Komisionit, Ursula von der Leyen e cila deklaroi se Pakti i Stabiliteti do të pezullohej në mënyrë që bilanci italian të përballojë krizën. Kjo do të bënte mjaft interesante dhe specifike edhe masat e marra nga vende të veçanta anëtare të BE-së (sidomos për vendet më të goditura si Italia, Spanja, Gjermania dhe Franca) në kuadrin e mbështetjes së ekonomisë reale të tyre të goditur rëndë nga kriza e koronavirusit.

2. Çështjet e politikave

Ndërkohë që në shumë vende të zhvilluara politikat monetare konvencionale dhe jokonvencionale po zgjerohen çdo ditë e më tepër, bizneset po ndihmohen maksimalisht që të reduktojnë humbjet dhe të mos falimentojnë me paketa të ndryshme anti-krizë, mbështetja sociale ka marrë përmasa të jashtëzakonshme me rritjen eksponenciale të nivelit të papunësisë, ato gjithashtu po merren me strategjitë e rimëkëmbjes ekonomike për të bërë gjithçka që ky recesion i fortë të mos kthehet në depresion ekonomik.

³ Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, propozoi të Mërkurën (27 maj) një stimul të paparë me 750 miliardë euro, kryesisht përmes granteve të pakthyeshme (500 miliard), me qeveritë të cilat që kanë një rol vendimtar në vendosjen se si do të shpenzohen paratë.

Fondi i ri i rimëkëmbjes do të përfshijë gjithsej 500 miliardë euro grante, ndërsa pjesa tjetër (250) do t'u ofrohet qeverive përmes kredive me kushte të favorshme. Italia dhe Spanja do të jenë përfituesit më të medhenj të këtij granti. <https://www.euractiv.com/section/economy-jobs/news/von-der-leyen-proposes-e750-billion-stimulus-under-member-states-grip/>

Në këto kushte, asnjë vend nuk do të jetë në gjendje të shmangë nevojën për shpenzime masive stimuluese dhe, për pasojë, shpërthimit të borxhit që do të vijë me të. Ndërsa ekonomitë e përparuara kanë mundësi krijuese për administrimin e kësaj stuhie, tashmë është e qartë se vendet në zhvillim do të kenë nevojë për një zgjidhje më radikale. Edhe pasi virusi do të jetë më së shumti i zhdukur, familjet do të angazhohen në kursime paraprake dhe bizneset do të hezitojnë të angazhohen për shpenzime kapitale, duke shkaktuar një rënie të mëtejshme të kërkesës agregate. Stimulimi fiskal i financuar nga deficit, i përfituar dhe i përdorur aty ku është e mundur, me siguri do të jetë mjeti i vetëm i aftë për të mbyllur hendekun e prodhimit.

Vendet në zhvillim që edhe përpara pandemisë kishin një ekonomi të brishtë, tani janë edhe më të prekura nga rënia e kërkesës për eksport të produkteve të tyre, nga një rënie drastike e dërgesave nga emigrantët, me një industri të turizmit të gjunjëzuar dhe dalje masive të kapitalit të huaj, e kanë tashmë dukshëm të pamundur të paguajnë borxhet e tyre ndaj kreditorëve të huaj, gjë që do të vinte në diskutim rimëkëmbjen ekonomike të politikëbërësve të vendeve në zhvillim të cilët gjithnjë e më shumë kanë frikën e një recesioni të tejzgjatur.

Institucionet ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore njoftuan kohët e fundit lehtësimin e shërbimit të borxhit për vendet më të varfra në botë deri në fund të vitit 2020, dhe po disbursojnë me shpejtësi fondet shtesë - kryesisht në formën e më shumë kredive, por përtej kredive super të buta dhe moratoriumeve të pagesave kundrejt borxhit ndaj vendeve të zhvilluara, këto institucione duhet të marrin veprime më drastike, siç është dhe marrja në konsideratë e faljes së ndjeshme të borxhit - ndoshta përgjatë iniciativës së programi më i fundit multilateral për lehtësimin e borxhit (Iniciativa e vendeve të varfra tepër në borxhe -HIPC). Grantet janë mënyra e duhur për të transferuar burimet në vendet me të ardhura të ulëta. Pas Luftës së Dytë Botërore, Plani Marshall përfshinte vetëm grante; sot, çështja për "grante pandemie" për vendet me të ardhura të ulëta është po ashtu shumë e fortë.

Një tjetër alternativë e politikës monetare e propozuar nga Kenneth Rogoff dhe që ka nxitur mjaft kundërshtime është aplikimi i normave negative të interesit në rastet e një recesioni të thellë. Rogoff (2016), diskuton mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e monedhës, ku gjithashtu sqaron pse nuk duhet që të mendohet për instrumente monetare alternative si "lehtësimi sasior" dhe "paraja e hedhur me helicopter" si forma të politikës fiskale.

Ndërsa një përgjigje fiskale është e nevojshme, politika monetare është gjithashtu shumë e nevojshme pasi vetëm politika monetare adreson kredi në të gjithë ekonominë. Derisa inflacioni dhe normat reale të interesit të ngrihen nga humnera,

vijon autori, vetëm një politikë efektive me norma negative të thella mund të kryej efektivisht punën (Lilley dhe Rogoff, 2019).


Me marrjen e masave lehtësuese dhe rikthimit drejt normalitetit, skenari më i mirë do të ishte testimi dhe miratimi i ndonjë vaksine efektive brenda vitit, në të kundërt, aktiviteti ekonomik mund të mbetet në recesion të ashpër për një kohë të gjatë aq sa statusi i recesionit aktual, do të konfirmohej si më i keqi që nga “Depresioni i Madh” i viteve 1930.

Sërisht këtu politikëbërësit duhet të dëgjojnë nga mësimet e historisë: Një gabim i mësuar nga pandemia e “gripit spanjoll” të një shekulli më parë, ishte braktisja e parakohëshme e investimeve në shëndetin publik, që do të lejonte një vit më pas rikthimin në një valë të dytë e të tretë infeksionesh të cilat rezultuan edhe më vdekjeprurëse.

Analogjikisht, politikëbërësit gjithashtu mund të braktisin stimulimin ekonomik shumë më herët, një gabim ky që mund të çojë në një recesion në formë W, pra një rimëkëmbje e pasuar nga një rënie tjetër, të ngjajshëm me ngjarjet e viteve 1936-37 në SHBA kur, pas rikuperimit nga depresioni që kishte filluar më parë, administrata e Presidentit Roosevelt frenoi shpenzimet federale dhe rriti taksat e ndjekur nga një politikën monetare shtrënguese prej Rezervës Federale Amerikane, duke rikthyer një recesion të rëndë, i cili zgjati deri në vitin 1938.

3. Parashikimet mbi pasojat në ekonomi nga COVID-19

Oxford Economics përditëson parashikimet të rritjes së PBB-së globale për vitin 2020 për rreth 200 vende duke përdorur një Model Ekonomik Global, i cili duke reflektuar një vlerësim akoma më pesimist nga vijueshmëria e masave bllokuese, gjatë gjysmës së parë të vitit, do të thotë që PBB-ja botërore tani pritet të kontraktohet me 4.8% për vitin 2020 në tërësi, ndërsa ne ende presim një ringritje në pjesën e dytë të vitit (shiko grafikun).



Sipas këtij grafiku, PBB-ja globale parashikohet të rikthehet në nivelin e saj të tremujorit të IV të 2019, deri në fillim të vitit 2021, por që gjithësesi, do të ketë kosto më afatgjata nga shpërthimi i virusit. Sipas Oxford Economics, nuk pritet që niveli i PBB-së të konvergojë në rrugën e parashikimit të mëparshëm (d.m.th para shpërthimit të COVID-19), për shkak të ndryshimeve në sjellje të individëve, siç është rritja e kursimeve paraprake, duke parashikuar se për vitin 2023 niveli mesatar i PBB-së të jetë 1.7% nën nivelin e parashikimit para pandemisë.

Përsa i përket vendeve të rajonit dhe Shqipërisë varësia e lartë nga turizmi është një prej arsyeve kryesore që i bën pesimiste parashikimet e institucioneve ndërkombëtare si FMN-ja dhe BERZHI. *Visual Capitalist* nisur nga të dhënat nga Organizata Botërore e Turizmit, ka përpiluar një raport i cili evidenton shtetet me varësi më të lartë nga turizmi ku, Shqipëria, renditet në vendin e 30-të në botë, për peshën që turizmi zë në punësimin total, me 22 %. Ndërsa Kroacia dhe Mali i Zi e kanë këtë tregues në 25% dhe 33% respektivisht.

Pesha e lartë e turizmit në ekonomi vlerësohet si një nga arsyet e rënies së fortë të pritshme këtë vit. Sipas raportit të fundit të BERZH, “ekonomia e Shqipërisë ka të ngjarë që të goditet fort nga epidemia, për shkak të varësisë së saj të lartë nga turizmi dhe eksporteve me vlerë të ulët të mallrave ndërmjetëse me destinacion industrinë e modës në Itali. Një reduktim i mundshëm i remitancave do të ndikojë gjithashtu negativisht në rritje. Rimëkëmbja do të varet nga lehtësimi gradual i masave që janë marrë për të frenuar virusin dhe nga një kthim në normalitet në gjysmën e dytë të vitit”.

Është e qartë tashmë se një nga kostot më të mëdha sociale të prodhuara nga kjo pandemi është pikërisht papunësia e lartë dhe rreziku i rritjes së varfërisë, ndaj dhe masat riparuese të paketave ndihmëse të çdo qeverie duhet të përfshinë strategji të cilat vënë në plan të parë të papunët dhe shtresat sociale.

4. Përfundime

Edhe pse askush ende nuk e di se si dhe kur do të përfundojë kjo krizë, ne duhet të marrim parasysh kuptimin që ka kjo për gjendjen aktuale duke marrë hapat e duhur në mënyrë të jemi në gjendje të parandalojmë një krizë tjetër që mund të vijë në të ardhmen.

Ndërsa ekonomitë e përparuara kanë mundësi financiare -edhe pse një shpërthim i borxhit publik përben një rrezik shumë të madh në horizont- si dhe kapacitete për administrimin e kësaj krize, tashmë është e qartë se vendet në zhvillim dhe ato të varfra do të kenë nevojë për një zgjidhje më radikale. Grantet dhe anulimi i huave

janë ndoshta mënyra e duhur për të transferuar burimet në vendet me të ardhura të ulëta dhe për t'i ndihmuar ato të ringrihen nga kjo krizë.

Ajo çka historia shekullit të XX-të na ka mësuar, qoftë mbi pandeminë apo mbi depresionin ekonomik, është që masat e marra, si në planin e investimeve në shëndetin publik ashtu dhe ato për stimulimet ekonomike, duhet të kenë një vazhueshmëri afatgjatë.

Përsa i përket ekonomisë shqiptare, ajo ka të ngjarë që të goditet fort nga epidemia, për shkak të varësisë së saj të lartë nga turizmi dhe eksporteve të industrisë së lehtë. Ulja e remitancave do të ndikojë gjithashtu negativisht në rritjen ekonomike. Një nga kostot më të mëdha sociale që ka prodhuar kjo pandemi është pikërisht papunësia e lartë dhe rreziku i rritjes së varfërisë, ndaj dhe masat riparuese të paketave ndihmëse të çdo qeverie duhet të përfshinë strategji të cilat vënë në plan të parë të papunët dhe shtresat sociale. Rimëkëmbja do të varet edhe nga lehtësimi gradual i masave që janë marrë për të frenuar virusin dhe nga një kthim në normalitet në gjysmën e dytë të vitit.

Edhe pasi virusi do të jetë më së shumti i zhdukur, do të ketë kosto më afatgjata nga shpërthimi i virusit për shkak të ndryshimeve në sjellje të individëve, siç është rritja e kursimeve paraprake dhe hezitimi për shpenzime kapitale nga ana e firmave, duke shkaktuar një rënie të mëtejshme të kërkesës agregate, ndaj edhe masat e marra nga qeveritë dhe institucionet për përbalimin me sukses të kësaj situate, duhet që efektivisht të përkthehen në faktorë të rritjes së besimit dhe optimizimit.

Bibliografia

- ADRIAN CIVICI, “Krizë e Covid-19 vs “Depresioni i Madh” / Krahasim i gabuar apo mësim i fituar? 12/05/2020, Fjala.al
- ADRIAN CIVICI, “Instrumentet dhe politikat anti-krizë që po aplikojnë vendet e BE-së/ Po Shqipëria?!” 30/04/2020 Fjala.al
- BUITER H. WILLEM, “Time for a Selective Debt Jubilee” May 21, 2020 on Project-Syndicate.
European Bank for Reconstruction and Development (BERZH), “[Regional economic prospects](http://www.ebrd.com)” – [EBRD www.ebrd.com](http://www.ebrd.com) >
- FRIEDMAN, MILTON, AND ANNA J. SCHWARTZ (1963). A Monetary History of the United States, 1867–1960. Princeton: Princeton University Press
- Financial Times, “The EU recovery fund is a historic step, almost”, <https://www.ft.com/content/9fb00360-9a7f-11ea-871b-edeb99a20c6e>
- European Central Bank-“Our response to the coronavirus pandemic”, <https://www.ecb.europa.eu/home/search/coronavirus/html/index.en.html>
- INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

- JEFFREY FRANKEL “How to Avoid a W-Shaped Recession” May 1, 2020, on Project-Syndicate
- JOSH LIPSKY, JEREMY MARK, “We Must Expand Debt Relief for Developing Countries” May 20, 2020 on Project-Syndicate.
- LILLEY, ANDREW AND KENNETH ROGOFF (2019), “The Case for Implementing Effective Negative Interest Rate Policy”, essay presented at “Strategies For Monetary Policy: A Policy Conference”, The Hoover Institution, Stanford University, May 4, 2019.
- ROGOFF, KENNETH “The Case for Deeply Negative Interest Rates” May 4, 2020 on Project-Syndicate.
- ROGOFF, KENNETH “The Curse of Cash: How Large-Denomination Bills Aid Crime and Tax Evasion and Constrain Monetary Policy” Princeton University Press, 2017.
- Oxford Economics, Global Outlook: <https://www.oxfordeconomics.com/>
- Organizata Boterore e Shendetesise [https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-\(covid-2019\)-and-the-virus-that-causes-it](https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/technical-guidance/naming-the-coronavirus-disease-(covid-2019)-and-the-virus-that-causes-it)
- MAURICIO CÁRDENAS, “Emerging Economies Need New Finance, Not Moratoriums” May 13, 2020 on Project-Syndicate.
- Monitor :<https://www.monitor.al/shqiperia-nder-vendet-me-varesi-me-te-larte-nga-turizmi-ne-bote-pasoja-nga-covid-19/>
- Visual Capitalist <https://www.visualcapitalist.com/countries-reliant-tourism/>
- World Travel & Tourism Council: <https://wttc.org/Research/Economic-Impact>

“E-QEVERISJA, NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”

Dr.sc. Zenel SEJFIJAJ

International University of Struga , e-mail: zsejfiyaj@hotmail.com

Dr.sc. Gazmend MORINA

International University of Struga , e-mail: gazmend_morina@hotmail.com

Bsc. Gramoz SEJFIJAJ, Msc.(cand).

University of Liechtenstein , e-mail: gramoz.sejfiyaj@uni.li

Abstrakt

Qeverisja elektronike (ose E-Qeverisja) është aplikimi i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në funksionet dhe procedurat e qeverisë me qëllim të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Ky përkufizim tregon se si qeverisja elektronike përdor TIK-un si një mjet mbështetës në zhvillimin e qeverisjes së mirë. Zbatimi i duhur i qeverisjes elektronike lejon nivele më të larta të efektivitetit dhe efikasitetit në detyrat qeveritare, përmirësimin e proceseve dhe procedurave, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, gjithashtu përmirëson përdorimin e informacionit në proceset e vendimmarrjes dhe lejon komunikim më të mirë midis zyra të ndryshme qeveritare. Komunitat kanë një ndërveprim unik të drejtpërdrejtë me qytetarët. Marrëdhënia midis komunave dhe qytetarëve të tyre është e pashmangshme: regjistrimet e biznesit, regjistri i automjeteve, zhvillimi i gjendjes reale apo edhe pajtimi i një fëmije në një shkollë, për shembull - të gjitha kërkojnë që qytetarët të vijnë në kontakt me komunën. Qëllimi i qeverisjes elektronike është të krijojë një lidhje të re dinamike midis qeverive dhe qytetarëve: një cikël që do të bëhet më i thjeshtë dhe më pjesëmarrës për qytetarët. Për ta arritur këtë, nuk është e rëndësishme vetëm futja e teknologjisë në detyrat konvencionale të komunës por edhe në menaxhimin e sektorit publik, me qytetarët publik dhe nevojat e tyre që janë pika qendrore e kësaj risie. Specialisti i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Mauro D. Ríos, në punimin e tij "Në kërkim të një përkufizimi të Qeverisë Elektronike", thotë: "Qeveria Dixhitale është një mënyrë e re e organizimit dhe menaxhimit të punëve publike, duke prezantuar procese pozitive transformuese në menaxhim dhe vetë strukturën e

grafikut të organizatës, duke shtuar vlerë në procedurat dhe shërbimet e ofruara, përmes prezantimit dhe përvetësimit të vazhdueshëm të teknologjive të informacionit dhe komunikimit si një lehtësues i këtyre transformimeve”. Qeverisja elektronike ka qenë vazhdimisht insistim i Bashkimit Evropian për një transparencë të Qeverisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës ka filluar me aplikimin e e-Qeverisjes dhe në vazhdimësi është duke ndërtuar dhe zhvilluar kjo formë e qeverisjes. Në këtë punim do t’i trajtojmë disa fusha të aplikimit të e-Qeverisjes nga Qeveria e Kosovës si: e-Pasuria, e-Prokurimi, e-Shëndetësia, e-Komuna, e-Portali Qeveritar etj. Temë tjetër që lidhet me këtë e që do të trajtohet është edhe Hapja e të Dhënave (Open Data).

Fjalët kyçe: Qeverisja, Teknologjia, Shërbimet, Qytetarët, Siguria, Elektronike

Hyrje

Me një gjerësi të paparë në fushën e teknologjisë së informacionit, bota u zhvendos nga epoka industriale në epokën e informacionit. Manifestimet e këtij transformimi dhe shfaqja e termave dhe koncepteve të tranzicionit janë bërë pjesë e jetës sonë të përditshme, në fushën e ekonomisë dolën koncepte si E-commerce, E-biznes dhe para elektronike, Në fushën e kontaktit: E - posta, mësimi elektronik dhe në fushën e sektorit publik: Qeveria elektronike.

Kosova rangohet në mesin e 50 vendeve me normën më të lartë të depërtimit të internetit dhe aftësive digjitale, si dhe me shkallë të lartë të posedimit të telefonave të mençur. Këto shifra bëjnë që hapja e kanaleve të reja të komunikimit, transparencës, llogaridhënies, dhe ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët, përmes infrastrukturës së teknologjisë informative, të jetë e një rëndësie jetike.

Realizimi i qeverisjes elektronike do t’i mundësojë të gjitha kategorive shërbimin qeveritar, të shpejtë, në çdo kohë dhe nga çdo largësi, për t’i realizuar kërkesat e tyre të përditshme. Qeverisja elektronike do ta modernizoj administratën dhe do të krijoj një menaxhim efikas dhe me përgjegjësi në të gjitha nivelet e administratës.

E-Pasuria

E-Pasuria Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë në kuadër të E-Qeverisjes është një projekt i realizuar nga kompania private DataProgNet për Ministrinë e Administratës Publike. Projekti është implementuar në të gjitha Ministrinë, Komunitet dhe Agjencitë. Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë përbëhet prej ueb aplikacionit dhe bazës së të dhënave të vendosur në serverët e qeverisë, si dhe prej pajisjeve përcjellëse të cilat janë të shpërndara nëpër institucione. Në aplikacion mund të qasemi duke vizituar linkun:

<https://epasuria.rks-gov.net>

Deri më tani në Sistemin Elektronik për Menaxhimit të Pasurisë janë të regjistruar një numër i madh i përdoruesve prej institucioneve të ndryshme, me role të ndryshme dhe ky numër vazhdimisht rritet me përdorimin e aplikacionit. Përmes sistemi të menaxhimit të pasurisë menaxhohet me të gjitha hyrjet/daljet e aseteve dhe të materialit shpenzues në institucion, kryhet barkodimi i pajisjeve, përcillet zhvlerësimi/amortizimi i pajisjeve, gjendja e stokut, si dhe kërkesa online për pajisje dhe për material shpenzues prej secilit punëtor të institucionit përkatës.

Aplikacioni i E-Pasuria tani thuhet të jetë implementuar dhe është duke u zbatuar nga të gjitha njësitë e sektorit publik në Kosovë. Në vazhdimësi ka ndryshime për shkak të modifikimeve dhe zhvillimit të këtij aplikacioni. Aplikacioni ka mjaft vërejtje dhe sugjerime për t'i rregulluar në mënyrë që të jetë funksional në mënyrën e duhur.


Figura e mëposhtme paraqet dukjen e hyrjes në sistem:


?

e-Pasuria

SISTEMI ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E PASURISË

Kyçu në sistem

Username 

Password 

Kyçu

ASHI - Qendra Kontaktuese
Tel: 30 900
038 200 30 900

E-Prokurimi

Qëllimi kryesor i sistemit të prokurimit elektronik, është që ai të ndikojë pozitivisht dhe fuqimisht nën drejtime të tilla, si ⁴:

- Rritja e aftësive vendimmarrëse të zyrtarëve të prokurimit, duke siguruar informacion kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës të prokurimit;
- Përmirësimi i transparencës në procedurat dhe në praktikat e prokurimit;
- Përmirësimi i planifikimit financiar dhe buxhetimit;
- Efikasitet në të gjithë procesin e prokurimit dhe minimizimi i kohës së ciklit të prokurimit;
- Nxitja dhe inkurajimi i pjesëmarrjes dhe promovimi i konkurrencës ndërmjet furnizuesve;
- Shfrytëzimi i ekonomisë së shkallës nëpërmjet grumbullimit të kërkesës dhe maksimizimi i vlerës së parasë në prokurimin qeveritar;

⁴ Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, E-Prokurimi, Manuali i Përdoruesit, Prishtinë, 2016.

- Rritja e besimit të bizneseve dhe të qytetarëve në procesin e prokurimit qeveritar dhe në përdorimin e fondeve publike;
- Optimizimi i niveleve të inventarit përmes adoptimit të praktikave efikase të prokurimit;
- Sigurimi i konfidencialitetit, integritetit dhe vërtetësisë së të gjitha transaksioneve dhe të dhënave ndërmjet entiteteve të prokurimit dhe furnizuesve.

Kyqja në aplikacionin e prokurimit elektronik bëhet përmes linkut:

<https://e-prokurimi.rks-gov.net>

E-Prokurimi është në funksion edhe të qytetarëve (Operatorëve Ekonomik) si dhe Qeverisë (Autoriteteve Kontraktuese). Disa nga funksionet që kryhen nga ana e Autoriteteve Kontraktuese janë të paraqitura në figurën e mëposhtme.

Republika e Kosovës
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

Navigation: FILLIMI, RRETH NESH, LEGJISLACIONI, MANUALET, INFORMACIONE, TRAJNIMET, RAPORTET

MANUALET / MANUALET PËR AUTORITETE KONTRAKTUESE

- Regjistrimi CA
- Pergatitja dhe publikimi i tenderit
- Korigjimi i procedures
- Sqarimet e TD
- Fillimi i hapjes të ofertave
- Vlerësimi i tenderit
- Dhënia e kontratës
- Dhënia e kontratës - Korigjimi
- Anulimi procedures
- e - Prokurimi generic
- Udhëzues përdorimi për
- Identifikohu
- Ndryshimi i parullës - Ndryshimi i pyetjës sekrete dhe pergjegjja
- Ndryshimi i shpenzimeve (pa njoftim të publikimit)
- Përdoruesit e mi - Shënimet nër organizatën

Prokurimi Eelektronik në Kosovë në aspektin e teknologjisë informative, menaxhohet nga një softuer i cili është nën kompetencat e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë.

E-Shëndetësia

E-Shëndetësia, është e dedikuar në ndërtimin e komunitetit medicinal, në avancimin e metodologjisë së qasjes në shërbime shëndetësore, në lehtësimin e qasjes dhe komunikimit. Kjo platformë ka për qëllim dixhitalizimin e të gjitha shërbimeve mjekësore në Kosovë. Kjo platformë ka thjeshtësuar kërkimin e shërbimeve mjekësore në mënyrë që të evitohen vështirësitë e termeve shkencore, sepse pacienti nuk ka nevojë me i ditë ato, por me i gjetë ato. E-shëndetësia ofron mundësinë që secili biznes ta ketë profilin tij, t'i prezantojnë informacionet, shërbimet, adresën dhe lokacionin në hartën e dedikuar vetëm për shërbime shëndetësore, fotogaleri - personale, panoramë me pamje 360° në disa lokacione që pacienti ta lokalizoj shpejt dhe lehtë, Direct Call që ta kursejmë kohë e pacientit me ruajtjen e numrave kontaktues, Messenger – që të lehtësohet komunikimi në mes Doktorit dhe Pacientit, të kursehen nga shpërqëndrimet e bisedave me familjarë. Forumi i cili do ta lehtësojë komunikimin dhe bashëpunimin në mes komunitetit medicinal të së njejtit departament, ku dhomat do të jenë të m byllura që komunikimi të jet 100 % privat, mundësi që ta reklamojnë edhe webfaqen e tyre dhe rrjetet sociale, prezantimin e punimeve të tyre me video dhe animacione (brenda platformës). Shëndetësia përmes elektronikës është një synim tjetër, përmes së cilës do të krijohen ndërhyrje mjekësore edhe nga distanca. Pacientëve të Republikës së Kosovës do ti sigurohen kartela shëndetësore dhe do të krijohen regjistra të shumtë elektronikë shëndetësorë në mënyrë që të gjithë të kenë historikun elektronik shëndetësor. Përfundimisht do të krijohet një sistem elektronik shumë efektiv i menaxhimit të informatave në shëndetësi.

E-Mësimi

E-Mësimi nënkupton zhvillimin e aktiviteteve mësimore përmes teknologjisë informative apo në distance. Këto forma aplikohen në rrethana jo të zakonshme, e që aktuale është gjendja pandemike e krijuar nga Covid-19. Sipas hulumtimit tonë kjo formë mësimi nuk është duke dhënë efektin e duhur, por jo ndihmon nxënësit dhe

mësimëdhënësit që të jenë sado pak aktiv në procesin mësimor. Probleme të theksuara sidomos për shkak të teknologjisë kemi hasur tek provimet online, sidomos nga studentët. Ky portal menaxhohet nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Aktivitetet mësimore janë të ndara sipas fushave të kurrikulës dhe fushave të aktiviteteve. Gjithashtu, platforma ofron tema dhe njësi konkrete, materiale didaktike, këshilla, video, udhëzime audio-vizuale, fleta pune dhe fotografi për të gjithë fëmijët/nxënësit bazuar në nivelet dhe aftësitë individuale. Përveç aktiviteteve mësimore, platforma ofron informata dhe materiale ndihmëse lidhur me qasjen ndaj fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, metodat bazike, vlerësimin dhe informata tjera të rëndësishme për zhvillimin social, emocional dhe psikofizik të fëmijës/nxënësit.

E-Komuna

Portali i dedikohet personave fizik dhe juridik në teritorin e komunave përkatëse. Përmes këtij portali qytetarët mund të informohen se cilat dokumente ju nevojiten paraprakisht t'i përgatitin para se të aplikojnë për cilindo dokument që mund ta marrin në sportelet e Komunës së Prishtinës. Me këtë mënyrë të informimit të qytetarëve të komunave, tentohet që të krijohet qasje elektronike shumë e lehtë për qytetarët e komunave, dhe në të njëjtën kohë të formojmë sportelin elektronik. Qeverisja elektronike e komunave ka ndihmuar dhe lehtësuar shumë shërbimet e kërkuara nga qytetarët. Disa nga shërbimet që qytetarët mund t'i kryejnë me ndihmën e E-Komuna janë : nxjerrja e dokumenteve të gjendjes civile, pagesa e mbeturinave, tatimit në pron.

Hapja e të Dhënave (Open Data)

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies të administratës shtetërore është duke zbatuar Iniciativën për Hapjen e të Dhënave (Open Data), iniciativë kjo që udhëhiqet nga Ministria e Administratës Publike, filloi së zbatuari në Maj të vitit 2016, kur Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Kartën Ndërkombëtare për Hapjen e të Dhënave me vendimin nr. 07/87.

Bazuar në këtë vendim, Ministria e Administratës Publike është mandatuar të koordinoj zhvillimet dhe punët dhe të promovojë hapjen e të dhënave në Kosovë. Në këtë kuadër, u krijua Portali Kombëtar për të Dhëna të Hapura ku parashihet publikimi i të dhënave që prodhohen nga Qeveria e Kosovës. Hapja e të dhënave të qeverisë, parasheh ndryshime pozitive në mënyrën se si qeveria bashkëvepron me qytetarët. Ky proces u mundëson qytetarëve dhe bizneseve të marrin në mënyrë aktive në vendime të informuara në fusha të ndryshme të veprimit.

Portali Kombëtar për Hapjen e të Dhënave

Portali kombëtar për të dhëna të hapura, opendata.rks-gov.net është katalogu zyrtar i të dhënave dhe 'metadata'-ve të të dhënave të publikuara në një format të hapur nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këtu gjendet një numër i data-seteve me të dhëna që prodhohen nga ministrinë e linjës dhe agjencitë shtetërore. Të gjitha institucionet obligohen të hapin, njëherit, publikojnë të dhënat e tyre në këtë platformë.

Portali promovohet nga Qeveria e Kosovës, njëherit menaxhohet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) - Ministria e Administratës Publike. Ndër tjerash, ASHI angazhohet rreth implementimit të funksioneve të reja dhe përmirësimeve eventuale që përmirësojnë përvojën digjitale të përdoruesve.

E-Portali shtetëror

E-Portali është sporteli elektronik, nga ku çdo qytetar përmes internetit mund të marrë shërbimin elektronik nga qeveria, duke eliminuar distancën, rritur efikasitetin, rritur shpejtësinë dhe duke qenë në shërbim 24 orë në 7 ditë të javës. Përmes e-portalit mund të kryhen shërbime për nevoja të biznesit (G2B) dhe nevoja të qytetarëve (G2C). Ndërtimi i e-portaleve qeveritare bëhet në platforma të ndryshme teknologjike, ndërsa e-Portali shtetëror i Kosovës është i ndërtuar në platformën Microsoft. Zakonisht e-Portali shtetëror ka domenin e vet të mbështetur në kryedomenin shtetëror por në rastin tonë deri sa të kemi fituar kryedomenin e Republikës së Kosovës nga organizatat ndërkombëtare, e-Portali shtetëror ka një

domen të përkohshëm. Duke shfrytëzuar e-Portalin, qytetari apo kompania përzgjedh shërbimin elektronik tepër të sigurtë, që ka nevojë të marrë nga qeveria. Në e-Portal vazhdimisht vendosen shërbime të reja elektronike, sapo qeveria këto shërbime t'i bëjë elektronike. Editimi i e-Portal-it bëhet nga një grup i posaçëm koordinues ndërministror i menaxhuar nga institucioni kryesor qeveritar për shërbimet elektronike. Në e-Portal vendosen regjistrat e institucioneve publike, sistemi i pagesave, sistemi i regjistrat të popullsisë, sistemi i punësimit elektronik, sistemi i mbrojtur i mailbox-it për e-shërbim, regjistri i kompanive të kualifikuara për shërbimet e certifikatave, sistemi i menaxhimit të dokumenteve kryesore, bazat e të dhënave për ndodhitë e jetës etj. e-Portali krijon një mjedis të favorshëm për zhvillim ekonomik. Për të marrë një shërbim të sigurtë përmes e-Portalit shtetëror, shfrytëzuesi duhet të jetë i pajisur me kartelë elektronike të identifikimit (e-ID), përmes së cilës ai identifikohet si në rastin e nënshkrimit elektronik, pagesave elektronike, etj⁵.

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Me realizimin e strategjisë për qeverisjen elektronike ka pasur përfitime të mëdha për shoqërinë kosovare. Përfitimet janë të natyrës ekonomike dhe sociale duke përfshirë modernizimin e administratës, arsimin, shëndetësisë, drejtësisë, sigurisë, zhvillimin e biznesit, zhvillimin e tregtisë, zhvillimin e bujqësisë, rritjen e buxhetit, rritjen e demokracisë, zhvillimin e kulturës, hulumtime shkencore, statistika të ndryshme etj.

Aplikimi i qeverisjes elektronike në Republikën e Kosovës në shumicën e fushave ka dhënë rezultate shumë pozitive në shërbim të transparencës dhe efikasitetit të kryerjes së punëve. Progres dhe aplikim të plotë qeverisja elektronike ka shënuar në E-Pasuria (Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare) dhe E-Prokurimi (Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik).

⁵ Ministria e Shërbimeve Publike, Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, Prishtinë, 2008.

Sistemi e-Pasuria ka bërë një avancim të mirë pasi që ka aritur bashkëpunim dhe ndërlidhje edhe me sistemin e-Prokurimi dhe Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), në kuadër të sektorit publik në Kosovë, për marrjen e informatave të rëndësishme në lidhje me pasurinë.

Nga pjesa dytë e vitit 2019 dhe tani në vitin 2020, E-Prokurimi është implementuar në tërësi dhe ka eliminuar formën fizike të prokurimit.

Ndërsa probleme të mëdha në implementimin e plotë kem hasur tek shëndetësia elektronike, sidomos te Qendrat e Mjekësive Familjare, mirëpo vërehej një avancim gradual.

Problem apo barrierë tjetër që e kemi hasë gjatë hulumtimit tonë ishte edhe stafi/punëtorët të cilët direkt merreshin me zbatimin e platformave të caktuara të qeverisjes elektronike. Këto probleme lidheshin me moshën e vjetër të tyre dhe mungesën e trajnimeve të duhura.

Qytetarët janë shumë të kënaqur me platformat e qeverisjes elektronike e cila me theks të veçantë ka ndikuar në uljen e kostos së shpenzimeve të tyre dhe efikasitetin. Rekomandimet tona në lidhje me qeverisjen elektronike kanë të bëjnë në radhë të parë me legjislacionin. Pra institucionet relevante të Qeverisë së Kosovës duhet të hartojnë bazë ligjore të mjaftueshme që lidhen me platformat dixhitale të shërbimeve.

Duhet të rritet numri i punëtorëve të Teknologjisë Informative në vendet përkatëse që lidhen me aplikacionet e E-Qeverisjes.

Duhet të ketë trajnime të vazhdueshme të stafit që merren me zbatimin e platformave elektronike të qeverisjes.

Nuk duhet të bëhen shpesh avancime apo up grade të moduleve/aplikacioneve të qeverisjes elektronike sepse këto po shkaktojnë probleme të mëdha në zbatim.

Shoqëria e Informacionit duhet të zhvillohet në bazë të objektivave strategjike si në vijim:

- Zhvillimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre;

- Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Transformimi dixhital i qeverisë është një element kryesor për suksesin e Tregut të Vetëm, duke ndihmuar në heqjen e barrierave ekzistuese dixhitale, zvogëlimin e ngarkesave administrative dhe përmirësimin e cilësisë së ndërveprimeve me qeverinë.

Literatura

1. A.Jakupi, Metodologjia e Punës Shkencore dhe Kërkimore, Prishtinë, 2005;
2. Mauro D.Rios, Technological Neutrality and Conceptual Singularity, 2013, at:
SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2198887> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2198887>;
3. Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-241, Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2010;
4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2015-2020, Prishtinë, 2014;
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, E-Prokurimi, Manuali i Përdoruesit, Prishtinë, 2016;
6. Kuvendi i Kosovës (2008), Ligji Nr.03/L-048, Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Prishtinë;
7. Ministria e Administratës Publike & DataProgNet, Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë në kuadër të E-Qeverisjes, Manuali i përdorimit;
8. Qeveria e Kosovës, Rregullore (qrk) nr. 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

9. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020, Prishtinë, 2013;
10. Ministria e Administratës Publike, Vlerësimi për Gatishmërinë e Hapjes së të Dhënave, Prishtinë, 2018.

THE BRAND AS AN IMPORTANT FACTOR IN THE DEVELOPMENT OF ENTERPRISE MARKETING

Adem Qorrolli PhD Candidate

University of Tetova – Macedonia

Abstract

Purpose of the paper - The purpose of this paper is the empirical examination in the relationship between the role of marketing and local brands and international brands, the performance of brands in the development of businesses. All these variables should be studied in a macroeconomic environment of small and medium enterprises in Kosovo.

Research Methodology - the study contains 100 surveys with small and medium enterprises in Kosovo, which were conducted in order to analyze these variables. Adequate models were used, starting with statistical description, regression analysis in order to test the variables.

Findings - from the analysis we have achieved to a result which confirms the positive links between the variables, it means that there is a strong link between marketing development and local or international brands.

Limitations of research - from the analysis done, we have managed to find the results which have been positively proven in the researched market. The limitations of this paper are in the sample used during this research.

Keywords: *marketing, brand, local, international.*

Introduction

Brands have an important place in marketing and especially in international marketing, although it is not always sufficiently developed. To understand branding

we need to make comparisons between the local brand and the international brand. Most studies are mainly related to theoretical studies about brands, also when studying about brands, the approach focuses more on the brand - the brand in particular and not on marketing as a whole. These approaches often present limitations on the launch of the study, which requires a comprehensive and strategic approach to brand influence in local and international brand marketing. Through such a study we have the opportunity to measure the role of the brand in assessing the performance of marketing either locally or internationally. The development and recognition of new brands affects the strategic development of an effective marketing of the enterprise, through managerial development in the orientation of new brands which contributes to increased performance.

To see this development and brand role in marketing we have analyzed a sample of 100 small and medium enterprises in Kosovo, which have developed branding as a marketing concept for several years.

Literature review

The brand in general represents the strategic effect of all ongoing marketing efforts that manage to build a new brand-related image among customers, and contribute to increasing the performance of an enterprise by creating revenue growth and increasing the value of Yovovich shares (1988). The brand is set as the focal point of a firm's development, so higher priority should be given to issues related to brand development (Capon et al., 2001; Urde 1994, 1999). Small and medium-sized businesses need to work on developing a brand development strategy that is directly related to the overall business strategy (Rooney, 1995). This once again justifies the decision that one of the competitive advantages in the market is also a brand recognition strategy (Biel, 1992; Mosmans, 1996; Rubinsein, 1996). This approach to brand development at the enterprise level also strengthens the argument of many authors that brands need to be developed, maintained and protected because they have a growing impact on business performance. This way of brand development is

supported by several studies, which emphasize that the brand should be considered as an integrated business approach (Rubinstein, 1996).

Business integration helps shape business development by making a stronger connection between the enterprise and the external environment and serves the enterprise as a strategic point of reference (Mosmans and Der Vorst, 1998). Urde (1999) also supports the concept of brand development and serves as a starting point for formulating enterprise strategy. Brand development orients the enterprise in determining competitive avant-garde by providing ongoing benefits in its future. It is this approach that is supported by several studies, which say that firm performance and brand development are positively related to Wong and Merrilees (2005).

Development of international brands

The development of international brands that there should be proper treatment in the enterprise has already been proven and continues to be supported by numerous researchers. Supporters of this theory are also Shocker et al. (1994), how brand management remains important in the field of marketing. Also, in order to prove the role and strategic importance of the brand, the relationship between brand performance and financial performance at the national and international level should be well studied. Another important segment in the formulation of the firm's strategy is the cultural aspect. All this support for the development of international brands is done because precisely this development offers opportunities for the development of global markets, the pursuit of many market segments and the capitalization of economies of scale (Chernatony et al., 1995). Some companies have made this embrace of international brands without noticing much, but this is seen in terms of adapting to products or services and how to standardize them. The issue of adaptation and standardization is also observed in numerous studies such as (Still and Hill, 1984; Rosen et al., 1989) and cultural issues of brand development (Erdem et al., 2006) as well as their increasing impact on performance. . The main thing of these global markets is that companies need to put in their marketing strategies the characteristics of different environments, as well as brand repositioning which refers

to the adaptation of the desired brand in the minds of new customers (Czinkota et al., 2001), (Wong and Merrilees, 2006).

Research methodology

The study of the relationship between brands and the development of marketing, and the idea that this relationship of variables can improve overall marketing performance in general. In addition to consumer awareness, this marketing strategy can also improve the image of the enterprise in the country and the recognition of this enterprise internationally. All of these marketing actions have a direct impact on changing consumer behavior, a direct impact on improving performance (Eing et al., 2001). It can also increase brand confidence, and be used as a competitive marketplace, with lower marketing costs. According to Keller (2000), continued marketing support is essential for brands to be successful. All of this research and study suggests that marketing strategy has a direct impact on enterprise performance, a direct force in attracting new customers. Enterprise performance is argued to be one of the most important factors influencing enterprise performance (Herbig and Mileëicz, 1997). In general, the enterprise strategy that invests in brand expansion can provide the enterprise with a differential market advantage (Calderonet al., 1997). All of these factors can affect the performance of a foreign company in the market (Okoroafo, 1996).

The sample was randomly drawn by sending the questionnaires to small and medium enterprises in Kosovo, with special attention to answering these questionnaires the high management of the enterprise, or the marketing manager of the enterprise. The total number of surveys conducted during this research is 100, in the framework of sampling in the survey. The processed results show us a significant value of p , with a value of less than 0.001. Through this result we see that the data are suitable for factor analysis. The reliability level of the factors examined was tested with the Cronbach test, which provides us with a satisfactory reliability worth 0.7.

H1: Customer development and their impact on enterprise marketing

The relationship between brands and their impact on enterprise marketing is seen to be steadily increasing, with the fact that most companies have this approach in their planning. It is this planning that influences the ongoing efforts of the marketing strategy and is calculated as the basic tool in the enterprise. This can also be seen from the product characteristics which must be consistent with the projected image to achieve the intended objectives within the market. Most studies conducted continue efforts to develop a brand, due to its long duration and long-term benefits (Urde, 1994; Mosmans, 1996).

Discussion and recommendation

The results of the study confirm the important role that brand development plays in marketing, starting from the size of performance and brand performance, which shows the role and impact of performance on marketing development. All of this performance growth has a statistically significant impact of 0.39, on the financial performance of the enterprise, and this supports the formation of effective marketing strategies.

The current study has formulated a conceptual model which allows the brand to play an important role in the development of marketing and that such a model has general validity in building a statistical model. The results obtained provide a good explanation of the performance of the local and international brand. Brand performance was found to be an appropriate measure of final performance. Moreover, as a major role was found for the brand, as an influential factor in shaping the international marketing strategy. Companies that take steps in the development of international marketing are encouraged to consider in particular their approach to these two brand activities, if they require higher international participation and performance.

H1: Customer development and their impact on enterprise marketing

The result obtained from the analysis, confirms a significant and significant impact on the development of marketing with a coefficient of 0.39 and t-statistic 4.34 (p, 0.001). The mirror obtained from the model used, shows the significant safety of the brands. Such mechanisms for brand development include the role of managerial knowledge in relation to brands, ie the orientation of enterprises from the beginning in brand development. All this brand orientation refers to the influence of the brand that has on all marketing activities and operations of the company (Urde, 1994).

Model Hypothesis	Coefficient	Results
Zhvillimi i brendeve dhe ndikimi i tyre ne marketingun e ndërmarrjes	t – statistic Significant	0.39 4.34 (p<0.001) Significant

According to the results obtained, if invested in the development of new brands by the company, then this would improve marketing performance and brand development by 20 percent. The reason for brand integration in marketing is associated with the use of brand to integrate all aspects of operations and marketing, fostering greater sustainability that achieves positive effects in enterprise management. The development of the brand also affects the adaptation of the brand to the local market, it also refers not only to the adaptation of the marketing mix but also to the comprehensive representation of the brand.

From the study we learn that culture plays an important role in adapting to the foreign market, which suggests an omplex configuration of the brand in an international

context. According to this study it is required that the placement of the brand should be done in the main marketing phase.

Limitation

Although this study makes an important contribution to the study of brands, there are still some limitations that need to be emphasized. First, although a suitable sample has been taken for testing hypotheses, the degree of responsibility for the study cannot be generalized. Some trading companies during the survey did not respond and this may affect the evaluation of the parameters used.

Second, during the research the model used is cross-sectoral, which means that it is not possible to make reasonable and effective conclusions and recommendations without including a research in a longer period of time.

References

- Biel, A. L. (1992). Hoë brand image drives brand equity. *Journal of advertising research*, 32(6), 7-11.
- Calderon - Garciduenas, J. (1997). *U.S. Patent No. 5,672,151*. Washington, DC: U.S. Patent and Trademark Office.
- Capon, N., & Hulbert, J. M. (2001). *Marketing management in the 21st century*. Prentice Hall.
- De Chernatony, L., Halliburton, C., & Bernath, R. (1995). International branding: demand–or supply-driven opportunity? *International Marketing Review*.
- Erdem, A. T. (2006). *U.S. Patent No. 7,127,081*. Washington, DC: U.S. Patent and Trademark Office.
- Eëing, C. E., & Cleveland, A. J. (2001). *U.S. Patent No. 6,176,710*. Washington, DC: U.S. Patent and Trademark Office.
- Jackëerth, J. C., & Rubinstein, M. (1996). Recovering probability distributions from option prices. *The Journal of Finance*, 51(5), 1611-1621.
- Keller, E. (2000). Do trade patterns and technology floës affect productivity groëth?. *The Eëorld Bank Economic Review*, 14(1), 17-37.

- Herbig, P., & Milešić, J. (1997). The relationship of reputation and credibility to brand success. *Pricing Strategy and Practice*, 5(1), 25-27.
- Okoroafo, S. C. (1996). Differences in marketing activities and performance of foreign and domestic manufacturing firms in Nigeria. *Journal of Global Marketing*, 9(4), 109-116.
- Mosmans, A., & van der Vorst, R. (1998). Brand based strategic management. *Journal of Brand Management*, 6(2), 99-109.
- Rooney, J. A. (1995). Branding: a trend for today and tomorrow. *Journal of Product & Brand Management*.
- Öng, H. Y., & Merrilees, B. (2005). A brand orientation typology for SMEs: a case research approach. *Journal of Product & Brand Management*.
- Shocker, A. D., Srivastava, R. K., & Ruekert, R. E. (1994). Challenges and opportunities facing brand management: An introduction to the special issue. *Journal of Marketing Research*, 31(2), 149-157.
- Still, R. R., & Hill, J. S. (1984). Adapting consumer products to lesser-developed markets. *Journal of Business Research*, 12(1), 51-60.
- Shih, T. Y., & Eickramasekera, R. (2011). Export decisions within Taiwanese electrical and electronic SMEs: The role of management characteristics and attitudes. *Asia Pacific Journal of Management*, 28(2), 353-367.
- Yovovich, B. G. (1988). What is your brand really worth? *Adweek's Marketing Week*, 8, 18-22.
- Urde, M. (1999). Brand orientation: A mindset for building brands into strategic resources. *Journal of Marketing Management*, 15(1-3), 117-131.
- Wong, H. Y., & Merrilees, B. (2006). Determinants of SME brand adaptation in global marketing. *International Journal of Entrepreneurship and Small Business*, 3(3-4), 477-487.

“ROLI I QEVERISË SË KOSOVËS GJATË KRIZËS EKONOMIKE DHE FINANCIARE, TË SHKAKTUAR NGA COVID- 19”

Dr.sc. Gazmend MORINA¹, Dr.sc. Zenel SEJFIJAJ², Mr.sc. Ajete Ukshini MORINA³, Bsc. Gramoz SEJFIJAJ, Msc.(cand)⁴

¹*International University of Struga , e-mail: gazmend_morina@hotmail.com*

²*International University of Struga , e-mail: zsejfiyaj@hotmail.com*

³*Ministry of Finance and Transfers, Treasury of Kosovo, e-mail: ajete_ukshini@hotmail.com*

⁴*University of Liechtenstein , e-mail: gramoz.sejfiyaj@uni.li*

Abstrakt

Shpallja e gjendjes pandemike nga ana e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në nivel global, për shkak virusit Covid-19, rezultoi me izolimin e pothuajse të gjitha shteteve të botës, e kjo barti me vete edhe shumë pasoja si ato të natyrës ekonomike, financiare, shëndetësore etj.

Tani të gjithë sytë dhe shpresat e qytetarëve ishin kah qeveritë e shteteve të tyre. Madje shumë shtete shpallën edhe gjendje të jashtëzakonshme për shkak të përhapjes së madhe të virusit dhe viktimave të shumta në njerëz.

Një gjendje e tillë e preku edhe Republikën e Kosovës. Andaj tema të cilën do ta trajtojmë në këtë punim ka të bëjë me rolin e Qeverisë së Kosovës në menaxhimin e krizës ekonomike dhe financiare të shkaktuar nga pandemia për shkak të virusit Covid-19.

Pandemia e COVID-19 ka prishur në mënyrë gjithëpërfshirëse jetën e zakonshme. Bota e biznesit është duke ri-menduar angazhimin e saj për shpërndarjen vetëm në kohë dhe përpunimin e zinxhirëve të furnizimit dhe duke menduar ‘riorganizimin’ - domethënë, ri-atdhesimin e prodhimit. Sektori publik është i detyruar të ri-orientojë gatishmërinë dhe rezistencën dhe rolin e qeverisë në nxitjen e të dyjave, ndërsa politikëbërësit dhe politikanët angazhohen në llogaritjet e kota por rutinore për vlerën e valutës të jetës njerëzore, pasi ata konsiderojnë ri-aktivizimin e pjesëve të

ekonomisë. Sektori financiar duhet të manovrojë në koordinim me bankat rezervë për të shmangur futjen e ekonomisë në një depresion që mund të jetë e vështirë të rikthehet, veçanërisht nëse, siç parashikojnë tani ekspertët, lindin valë shtesë të COVID-19 dhe shfaqen pandemi të tjera.

Fjalët kyqe: Pandemia, Qytetarët, Ekonomia, Virusi, Qeveria, Kriza

Hyrje

Kërcënimi për shëndetin si pasojë e koronavirusit u bë aq i ashpër sa rezistimi ndaj virusit u bë një përparësi thelbësore, pavarësisht nga kostoja ekonomike. Virulenca dhe vdekshmëria e saj nënkuptonin se efektet e saj ishin të një rendi të ndryshëm sesa gripi normal sezonal, me të cilin shpesh është krahasuar në mënyrë jo të duhur. Shumë shpejtë sistemet shëndetësore në zonat më të prekura filluan të zvarriten nën tendosje ndërsa infeksionet akute u rritën në mënyrë eksponenciale. Qeveritë kërkuar masa, fizike dhe jo fizike, këshilluese dhe të detyrueshme, për të marrë kontrollin e koronavirusit. Rreptësia e masave të kërkuara duhej vendosur kundër dëmtimit të ekonomisë dhe strukturës më të gjerë sociale, madje dhe rrezikut të mundshëm të pakënaqësisë së qytetarëve. Meqenëse kjo ishte një krizë ndërkombëtare, ajo gjithashtu varej nga bashkëpunimi midis shteteve. Kishte një bashkëpunim shkencor dhe klinik në teste, trajtime dhe vaksina, dhe ndarje të rastit të furnizimeve të pakta dhe ndihmë me vendet e varfëra që nuk kanë burime për të përballuar. Ministrat e ekonomisë duhej të punonin së bashku për të mbajtur ekonominë botërore në mbështetjen e jetës.

Qeveria e Kosovës duke e parë situatën e krijuar nga koronavirusi, mori masa të menjëhershme.

Masat parandaluese për përhapjen e virusit COVID-19 në Kosovë filluan të merren para konfirmimit të rasteve të para. Më 11 mars u vendos: të mbyllen institucionet arsimore, të suspendohet trafiku ajror dhe tokësor nga vendet me rrezik, të bëhet kontrolli i obliguar i udhëtarëve nga vendet e prekura nga epidemia dhe të bëhet vetizolimi i obliguar për personat që vijnë nga vendet e prekura.

Më 15 mars Ministria e Shëndetësisë kërkoi shpalljen e gjendjes së emergjencës shëndetësore dhe më 18 mars u caktua Qendra e Studentëve si hapësirë karantine për

personat që vijnë nga jashtë. Më 15 prill hynë në fuqi masa rigorozë të kufizimit të lëvizjes, duke filluar me 90 minuta në ditë të lejuara dhe gradualisht duke u shtuar sipas vlerësimit të situatës me pandeminë.

Menjëherë qeveria filloi punën për përgatitjen e një pakoje ndihmë financiare për bizneset dhe qytetarët, pasi që dihej se situata emergjente e shëndetit publik do të barte edhe pasoja ekonomike, financiare e sociale.

Menaxhimi i pandemisë / historik i shkurtë

Pandemitë ndodhin kur shfaqet një infeksion viral i ri dhe shumë ngjites, për të cilin nuk ka imunitet të popullatës, një vaksinë ende nuk është krijuar dhe trajtimet nuk janë të disponueshme. Një pandemi që kujtohet rregullisht nga epoka e para-vaksinimit është gripi 'Spanjoll' që zgjati nga viti 1918-20, duke infektuar deri në një miliard njerëz në të gjithë botën dhe duke vrarë midis 50 dhe 100 milion. Kohët e fundit, gripi 'aziatik' i 1957–58, e cila filloi në Kinën jugore, dhe gripi i Hong Kongut nga 1968–1969 mendohet se kanë infektuar deri në 500 milion njerëz globalisht dhe çuan në vdekje 1- 4 milion njerëz. Në vitin 2009, i ashtuquajtur i gripi i derrave nga i cili infektuan rreth një miliardë njerëz me vdekje të vlerësuar të paktën 150,000 por ka më shumë të ngjarë të kenë qenë afër 500,000. Sindroma e frymëmarrjes e Lindjes së Mesme (MERS), e raportuar për herë të parë në Arabinë Saudite në vitin 2012 dhe e lidhur me deve, ishte vdekjeprurëse për rreth një të tretën e të infektuarve, por prodhoi vetëm rreth 2,000 raste.

SARS, me të cilin lidhet më së shumti virusi aktual, filloi, gjithashtu në Kinë, në nëntor 2002 dhe deri në korrik 2003 kishte rezultuar në 8,437 raste dhe vdekje 813 në 32 vende. Pothuajse 95 % e rasteve ishin në rajonin e Paqësorit Perëndimor. Përhapja filloi me disa raste të pneumonisë atipike në provincën jugore kineze të Guangdong midis njerëzve që merrshin me ushqim ose shisnin kafshë të egra. Kishte vonesa në raportimin e saj, në fillim në nivel kombëtar dhe pastaj ndërkombëtar. Brenda Kinës, pengesat administrative dhe mos-ndërhyrjet politike parandaluan marrjen e lajmeve të këqija në kryeqytet. Vetëm më 11 shkurt 2003 autoriteti lokal raportoi shpërthimin. Pekini u rezistoi kërkesave të OBSH për lejen

për të dërguar një ekip hetues. Shpejt arriti në Vietnam, Hong Kong, Kanada, Singapor dhe Tajvan. Një mjek kinez, i cili mendoi se ishte mbi sëmundjen, qëndroi në një hotel ndërkombëtar në Hong Kong dhe u bë 'pacienti zero' për rreth 4,000 raste. Ankthi për përhapjen e sëmundjes çoi në kufizime në fluturimet nga vendet e prekura, të cilat goditën rëndë ekonominë e tyre. Kina dhe të tjerët u mërzitën nga shpejtësia me të cilën vendet vendosën ndalime për fluturime nga zonat e infektuara, duke argumentuar se ajo kishte një ndikim të madh ekonomik pa bërë domosdoshmërisht shumë ndryshime. Gro Harlem Brundtland, asokohe drejtor i përgjithshëm i OBSH-së, mbështeti ndalimet e udhëtimit nga zonat e prekura dhe gjithashtu u ankua për vonesat në raportimin e shpërthimit. Ndërsa qeveria kineze pranoi se duhet të bëjë më mirë nëse diçka e ngjashme ndodh në të ardhmen, episodi gjithashtu e nxiti atë të inkurajojë OBSH-në të jetë më e ndjeshme ndaj interesave të Kinës. Për ato vende më të prekura, përvoja formoi përgatitjet për pandemitë e ardhshme. Pandemia e COVID-19 filloi me një infeksion të ri që shfaqet midis stallarëve në një treg ushqimi deti në Wuhan, ku kafshët e egra (marmota, zogj, lepuj, lakuriq dhe gjarpërinjtë) tregtoheshin në mënyrë të paligjshme. Më 10 Dhjetor 2019 erdhi çështja e parë e regjistruar, një shitës i karkalecave në treg i cili ndoshta ishte infektuar në Nëntor. Edhe pse ka pasur spekulime në lidhje me burime të ndryshme, origjinale duket se kanë qenë lakuriqet. Së shpejti klinikët vendas kinezë ishin duke komentuar ngjashmëritë me SARS-in, megjithëse u tha që të heshtnin dhe të shmangnin përhapjen e thashethemeve të rrezikshme. Tajvani e hetoi këtë çështje dhe më 31 dhjetor 2019, paralajmëroi Organizatën Botërore të Shëndetësisë për rrezikun. Sepse, me insistimin kinez, Tajvani nuk ishte anëtar i OBSH-së, ky raport kaloi pa përgjigje dhe nuk u kalua në vendet e tjera. Sidoqoftë, Kina e informoi OBSH-në në të njëjtën ditë për dhjetëra raste të pneumonisë së një shkakut të panjohur. Fataliteti i parë i raportuar ka ndodhur në 11 Janar 2020. Së shpejti rastet po shfaqeshin në një numër vendesh.

Përgjigja e ngadaltë e OBSH-së ndaj krizës në zhvillim u kritikua më vonë. Në fund të marsit, Zëvendëskryeministri japonez Taro Aso, i inatosur që Lojërat Olimpike të Tokios në vitin 2020 duhej të shtyheshin deri në vitin 2021, u ankua për gatishmërinë e tij për të luajtur me krizën dhe pyeti veten nëse ajo duhet të riemërohej " Organizata

Kineze e Shëndetit '. Në Prill , Presidenti amerikan Donald Trump i përforcoi këto ankesa dhe shkoi aq larg sa të pezullojë kontributin financiar të Amerikës në pritje të një rishikimi për OBSH-në. Megjithatë, dy muaj më parë Trump dukej se e konsideronte ndalimin e udhëtimit si një përgjigje të mjaftueshme, dhe shprehu besim deri në shkurt se Presidenti kinez Xi Jinping e kishte çështjen nën kontroll. Përveç kësaj, përveç lëshimit të ndalimeve të udhëtimit, SH.B.A. bëri shumë pak për t'u përgatitur për një pandemi gjatë javëve pasuese. Pjesë e problemit ishte se testet fillestare të zhvilluara për Qendrat e Kontrollit dhe Parandalimin e Sëmundjeve të Shteteve të Bashkuara (CDC), një agjenci federale, nuk funksionuan, që do të thoshte se nuk ishte në gjendje të gjurmonte përhapjen e hershme të virusit në SH.B.A. Kështu që ndërsa shumë ekspertë panë rreziqet që vijnë nga një pandemi e madhe, mesazhet kryesisht sigurose erdhën nga vendi në të cilin kishte ndodhur shpërthimi, udhëheqësi i vendit që kishte udhëhequr historikisht përgjigjet ndërkombëtare dhe organizata përgjegjëse për mbajtjen e botës të informuar për rreziqet dhe mjetet juridike ⁶.

Pako Fiskale Emergjente nga Qeveria e Kosovës, si ndihmë për situatën nga Covid-19

Qeveria e Republikës së Kosovës, si ndihmë për bizneset dhe qytetarët e Kosovës, për shkak të situatës së shkaktuar nga virusi Covid-19, me datë 03.04.2020, aprovoi Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente në vlerë prej 190,000,000.00 €, si në vijim:

- **Masa 1:** Pagesa e dyfishtë e skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për muajin Prill dhe Maj 2020, deri në vlerën 7,650,000.00 €, përfshirë këtu edhe pagesën për muajin Mars 2020.
- **Masa 2:** Pagesa shtesë në vlerë prej 30.00 €, në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të

⁶ Lawrence Freedman, Strategy for a Pandemic: The UK and Covid-19, Published online: 14 may 2020.

ulët se 100.00 €, për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2020, me kusht që janë përfitues të vetëm një skeme, si dhe rikthim në listat e përfituesve për përfituesit që për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën Janar-Mars 2020, nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre. Kjo masë do të zbatohet deri në vlerën 13,000,000.00 €.

- **Masa 3:** Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare, si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre, për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik, si në vijim ⁷:
 - a) Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170.00 €, për muajin Prill dhe Maj 2020, deri në vlerën 41,000,000.00 €.
 - b) Subvencionimi i qirasë deri në 50 %, të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për muajin Prill dhe Maj 2020, masë kjo deri në vlerën 12,000,000.00 €.
 - c) Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin Prill dhe Maj, deri në vlerën 8,000,000.00 €.
- **Masa 4:** Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike, që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020, masë kjo deri në vlerën 20,000,000.00 €.
- **Masa 5:** Sigurimi i mbështetjes shtesë financiare për Komunitetet e Republikës së Kosovës, që janë ndikuar në përballje me pandeminë, në rast nevojë për shkak të zgjatjes eventuale të pandemisë, masë kjo deri në vlerën 10,000,000.00 €.
- **Masa 6:** Sigurimi i shtesës mbi pagë, në vlerë prej 300.00 €, për punëtorët në teren dhe që janë të ekspozuar direkt nga rreziku i infektimit në punën e tyre (jo tërë stafi i institucionit) siq janë: Stafit mjekësor (mjekët dhe infermierët), policët e Policisë së Kosovës, zyrtarët (gardianët) e Shërbimit

⁷ Ministria e Financave dhe Transfereve, Vendimi Nr. 31/2020, datë 03.04.2020, Prishtinë.

Korrektues, zyrtarët (zjarrëfikësit) e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, personeli (ushtarët) i FSK-së, punëtorët që punojnë në Karantina, zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Punës, zyrtarët (inspektorët) e Administratës Tatimore të Kosovës, zyrtarët (doganierët) e Doganave të Kosovës, zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Tregut, zyrtarët (inspektorët) e inspektorateve përkatëse komunale, zyrtarët e Inspektoratit të Mjekësisë së Punës, për muajin Prill dhe Maj 2020, masë kjo deri në vlerën 15,000,000.00 €.

- **Masa 7:** Pagesë shtesë në vlerë prej 100.00 €, për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatoreve, për muajin Prill dhe Maj 2020, masë kjo deri në vlerën totale 3,000,000.00 €.
- **Masa 8:** Pagesa e asistencës mujore, në vlerë prej 130.00 €, për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2020, deri në vlerën totale të masës prej 4,000,000.00 €.
- **Masa 9:** Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata pandemike, në vlerë deri në 2,000,000.00 €.
- **Masa 10:** Sigurimi i likuiditetit financiar për:
 - a) Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit përmes programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në shumën deri në 10,000.00 €, për periudhën 24 mujore, masë kjo deri në vlerën 15,000,000.00 €.
 - b) Shoqëritë tregtare / Kompanitë e autorizuara, që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike), me kthim deri më 31.12.2020, në kuadër të vlerës së përcaktuar.
- **Masa 11:** Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione, për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për rritje të prodhimit bujqësor, deri në vlerën totale 5,000,000.00 €.

- **Masa 12:** Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione, për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për evitim të situatës së krijuar nga Covid-19, në aktivitetet sportive dhe kulturore, deri në vlerën 5,000,000.00 €.
- **Masa 13:** Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës, pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik, masë kjo deri në vlerën 10,000,000.00 €.
- **Masa 14:** Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorë me kontratë pune, së paku 1 vjeçqare gjatë periudhës së pandemisë, nga 130.00 €, për 2 muajt pasues pas regjistrimit, masë kjo deri në vlerën 6,000,000.00 €.
- **Masa 15:** Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130.00 €, për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të pa punë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga Buxheti i Kosovës, për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2020, masë kjo deri në vlerën 3,000,000.00 €.

Pas një kohe të shkurtë Qeveria e Kosovës respektivisht Ministria e Financave dhe Transfere ka filluar me ekzekutimin e pagesave që lidhen me Pakon Fiskale Emergjente.

Deri në afatin e paraparë për aplikim (15 maj 2020), Administrata Tatimore e Kosovës ka pranuar 45,294 kërkesa për kompenzim të pagave të punëtorëve, 10,724 kërkesa për kompenzim të qirasë dhe 3,278 kërkesa për kompenzim për punëtorët e rrezikuar⁸.

Kjo pako fiskale emergjente është dizajnuar për të arritur disa qëllime si:

- Të ofrojë ndihmë financiare shtesë për shtresat më të varfëra të shoqërisë gjatë pandemisë Covid-19;
- Të ndihmojë bizneset në mbulimin e shpenzimeve operative në mënyrë që:
 - a) Të sigurohet një pagë minimale për të gjithë punëtorët gjatë situatës emergjente;

⁸ www.atk-ks.org

- b) Të sigurohet se bizneset kanë mundësi të vazhdojnë veprimtarinë gjatë dhe pas tejkalimit të situatës emergjente.
- Të sigurojmë likuiditet shtesë për bizneset në mënyrë që të stimulohet rritja e aktivitetit ekonomik;
- Të stimulohen punonjësit e sektorëve esencial gjatë gjendjes së emergjencës të cilët janë të ekspozuar më së shumti ndaj rrezikut të infektimit;
- Të stimulohet punësimin dhe formalizimi në sektorit privat.

Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike

Ky hap ka të bëjë me fazën e dytë të ndihmës financiare nga ana e Qeverisë së Kosovës, si rezultat i gjendjes pandemike të shkaktuar nga virusi Covid-19, në vlerën e 1.26 miliardë €, me periudhë plasimi në ekonomi prej 24 muajsh kurse me shtrirje të kostos në pesë vitet në vijim.

Masat e propozuara në pakon e rimëkëmbjes në shumë raste mund të kontribuojnë në arritjen e disa objektivave njëherësh, por megjithatë të njëjtat mund të grupohen në 4 synime të agreguara:

- a) Rritje e balancuar dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, që nënkupton mbështetjen e rritjes ekonomike në nivel makroekonomik, por duke u përkujdesur që e njëjta të shoqërohet edhe me përmirësim të indikatorëve kyç të mirëqenies, si për shembull, ulje të varfërisë, e sidomos asaj ekstreme.
- b) Përmirësim i strukturës së përbërjes së PBB përmes favorizimit të sektorëve të caktuar ekonomik, sidomos në sferën e prodhimit dhe përmirësimit të bilancit tregtar të vendit.
- c) Punësimi dhe formalizimi i ekonomisë, me fokus parësor në fuqizimin e rolit të gruas dhe të të rinjve në ekonomi, dhe
- d) Ruajtja e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe minimizimin e rreziqeve fiskale të vendit.

Disa nga masat e përfshira në këtë pako janë ⁹:

⁹ Ministria e Financave dhe Transfereve, Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike, Prishtinë, 2020

- a) Kreditimi i ekonomisë me synim rritjen e ofertës agregate. Qeveria e Kosovës do të ofrojë garanci shtetërore për kreditë që bizneset private dhe qytetaret do të marrin nga bankat komerciale në vend, ku kreditë përmes FKGK- Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive do të garantohen në masën 80 %, ndërsa mbulimi i normës së interesit për kreditë e garantuara do të jetë 50 % e në disa raste deri në 100 %. Mundësia për shfrytëzimin e kësaj skeme do të jetë 2 vite, dhe maturiteti maksimal deri në 5 vite. Shuma maksimale e portfolios kreditore që Qeveria e ka planifikuar të mbulojë përmes kësaj mase arrin në 1,1 miliardë €, ndërsa nevoja për ndërhyrje fiskale është 300 milionë euro (195 milionë € për garancion bankar dhe 105 milionë € për mbulim të kostos së interesit)
- b) Qeveria konstaton se rinia e vendit përbën resursin dhe potencialin më të vlefshëm të vendit, por njëkohësisht edhe më së paku të shfrytëzuar. Kjo kategori edhe ka qenë mbiproporcionalisht e goditur nga periudha e pandemisë dhe rrjedhimisht ka nevojë për mbështetje të fuqishme të qeverisë në mënyrë që të mund të avancohet në kontribuues 12 me rëndësi në tejkalimin më të shpejtë të pasojave të pandemisë dhe përsheptimin e rritjes ekonomike.
- c) Qeveria e Kosovës konstaton se rritja e punësimit krahas uljes së shkallës së informalitetit të ekonomisë përbëjnë hapa esencial si për avancimin e standardit të jetesës në vend, ashtu edhe për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Njëkohësisht kjo përkthehet edhe në avancim të statusit të punëmarrësve si në ekonomi ashtu edhe në shoqëri.
- d) Qeveria e Kosovës konstaton se sektori i hotelërisë, restoranteve dhe kafeve, ka qenë mbiproporcionalisht i dëmtuar në periudhën e pandemisë dhe pritet që ta ketë më të vështirë rimëkëmbjen në muajt në vijim. Rrjedhimisht, Qeveria ndan 12 milionë euro për subvencionim të pagave të punëmarrësve në sektorin e HORECA-s për një periudhë prej 6 muajsh.
- e) Qeveria e Kosovës konstaton se parakusht për rritjen e punësimit në sektorin privat që do të lehtësonte tejkalimin e vështirësive të rezultuara nga masat kufizuese në përballje me pandeminë COVID-19, është edhe përmirësimi i

sistemit arsimor në vend, dhe zbutja e hendekut mes shkathtësive të akumuluar në sistemin e edukimit dhe nevojave në tregun e punës.

- f) Qeveria e Kosovës e sheh me shumë brengosje problemin e varfërisë në vend (rreth 18 % e qytetarëve të vendit) e sidomos incidencën e varfërisë ekstreme (rreth 5% e qytetarëve). Momentalisht nga buxheti i shtetit alokohen rreth 30 milionë euro për afërsisht 25,000 familje apo 100,000 qytetarë në kuadër të skemës së ndihmave sociale. Kjo nënkupton që në mesatare këta qytetarë përfitojnë më pak se 83 centë në ditë edhe atë vetëm nëse nuk gëzojnë asnjë të ardhur shtesë etj.

KONKLUZIONE

Ndërsa COVID-19 vazhdon të ndikojë në çdo aspekt të jetës njerëzore, qeveria ka marrë një rol kryesor në luftën kundër pandemisë. Qeveritë federale, shtetërore dhe lokale janë duke zbatuar direktivat që synojnë të imponojnë distancimin shoqëror, stimulojnë ekonominë dhe adresojnë mungesat mjekësore, midis masave të tjera.

Në bazë të hulumtimit tonë, roli i Qeverisë së Kosovës në menaxhimin e krizës ekonomike dhe financiare të krijuar nga situata emergjente e shëndetit publik, ka qenë i një niveli mesatar. Edhe mendimi ynë përafrohet me atë të disa ekspertëve ndërkombëtarë, që Qeveria e Kosovës mori vendim të hershëm për izolim të shtetit dhe bizneseve e qytetarëve në veçanti. Kjo shkaktoi një monotoni dhe mërztije për shkak të kohës së gjatë në izolim.

Edhe pse situatë emergjente e shëndetit publik, nuk munguan rastet e keqpërdorimeve apo korrupsionit në lidhje me paranë publike.

Bazuar në Pakon Fiskale Emergjente, pati disa kritika dhe akuza nga sindikatatat e punëtorëve dhe shoqëria civile për keqpërdorim nga ana e bizneseve, në lidhje me përfitimet e pagesave nga kjo pako. Shumë biznese ishin paguar nga kontraktorët, konkretisht nga institucionet publike dhe nuk kishin pasë ndërprerje të veprimtarisë gjatë pandemisë dhe të njëjtit kishin aplikuar për përfitim nga kjo pako, ku kjo rezultoi edhe me një ndërprerje të pagesave deri në identifikimin e këtij problemi.

Disa biznese, me theks të veçantë farmacitë dhe disa dyqane ushqimore, bënë rritje të çmimeve dhe parregullsi tatimore, ku për këtë, Administrata Tatimore e Kosovës, për periudhën 12 mars deri 22 maj 2020, pranoi 4,096 denoncime.

Sipas hulumtimit tonë, të gjithë qytetarët dhe bizneset që i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara nga Qeveria, kanë përfituar nga pagesat e Pakos Fiskale Emergjente. Qytetarët janë shprehur të kënaqur dhe falenderues ndaj Qeverisë, edhe pse lartësia e pagesave nuk ishte në nivel të kënaqshëm, duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve të produkteve ushqimore.

Roli i Qeverisë së Kosovës, në vëzhgimin e procedurave të shtyerjes së pagesës së kredive nga bankat komerciale për ata që kanë kredi, nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi që bankat komerciale kanë bërë shtyerjen e afatit të pagesës së kredive sipas kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve, por e kanë llogaritur interesin (kamatën) për periudhën e shtyerjes.

Humbjet e ekonomisë nga izolimi vlerësohen të jenë të mëdha, por “lehtësimi” të kësaj i shtohet fakti u numrit të vogël të infektuar në nivel vendi dhe numri i vogël i vdekjeve nga virusi Covid-19.

REKOMANDIME

Për më tepër, shoqëria civile duhet të thithë implikimet e qasjes së pabarabartë në kujdesin shëndetësor dhe strehë të sigurt. Industria e kujdesit shëndetësor duhet të përfshihet me një reagim të pritshëm kundër një modeli të ofrimit të shërbimit të padenjë për krizat e shëndetit publik.

Qeveria e Kosovës duhet t'i ndihmojë sa më shumë dhe pa vonuar sektorit privat, i cili ka pësuar goditje të madhe si pasojë e izolimit/ndërprerjes së veprimtarisë.

Institucionet relevante të Qeverisë së Kosovës duhet të verifikojnë (ex post) rastet e keqpërdorimeve (nëse ka pasur) pas përfundimit të pandemisë.

Qeveria e Kosovës, respektivisht Banka Qendrore e Kosovës, duhet që menjëherë të fillojë me hetimin e rasteve të llogaritjes së kamatës për ata që kanë aplikuar për shtyerje të afatit të pagesës së kredisë, për shkak të situatës së emergjenvës së shëndetit publik dhe të kompensohen.

Si fund të rekomandimeve tona apo të këtij punimi në përgjithësi e mbyllim me pyetjen:

A duhet të peshojë qeveria, jetën e disa qytetarëve kundër të tjerëve kur merr vendime se si të trajtohet pandemia?

Literatura

1. Prof.Dr. Ali Jakupi (2005), *Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore*, Prishtinë;
2. Kuvendi i Kosovës (2008), *Ligji Nr.03/L-048, Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*, Prishtinë;
3. Lawrence Freedman (2020), *Strategy for a Pandemic: The UK and Covid-19*, Published online;
4. Steven Simon (2020), *Pandemic and the Authoritarian Impulse*, Published online;
5. Ministria e Financave dhe Transfereve (2020), *Vendimi Nr. 31/2020*, datë 03.04.2020, Prishtinë;
6. Ministria e Financave dhe Transfereve (2020), *Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike*, Prishtinë;

ZBATIMI JURIDIK I BIZNESEVE DHE MENAXHIMI ME FOKUS NË KOSOVË

Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

E-mail: besnik.hajdari@umib.net

&

MSc. Besim TAHIRI

Master i Shkencave Juridike

Llojet e ndërmarrjeve në Kosovë dhe Menaxhimi

Llojet e ndërmarrjeve në Kosovë sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë janë: Biznesi individual, Ortakëri e përgjithshme, Shoqëria komandite, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K.), Shoqëritë aksionare (SH.A), Kompani e huaj, Ndërmarrjet shoqërore, Ndërmarrjet publike, dhe Kooperativat bujqësore.

Biznesi individual

Në biznesin individual, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet e shoqërisë. Shoqëria ka një emërtim zyrtar ose përfshin mbiemrin e ligjshëm të pronarit dhe të përfshij shkurtesën “B.I.”.

Ortakëri e përgjithshme

Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e solidarisht për borxhet e shoqërisë. Shoqëria kolektive ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij shkurtesën "O.P."

Shoqëria komandite

Në shoqëritë komandite, përveç ortakëve "të pakufizuar" (ortakët që përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e kompanisë) marrin pjesë edhe ortakët "e kufizuar" ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre. Shoqëria komandite ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij, shkurtesën "SH.K.M."

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K.)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara janë ato shoqëri që janë themeluar nga një ose disa themelues, të cilët përgjigjen për të gjitha borxhet e tyre dhe detyrimet tjera me tërë asetet. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ka një emërtim, menjëherë pas tij, shkurtesa "SH.P.K.". ARBK mund të regjistrojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, pa pasur nevojë të siguroj dëshmi mbi pagimin e kapitalit.

Shoqëritë aksionare (Sh.A.)

Shoqëri aksionare janë ato shoqëri, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe që aksionaret përgjigjen për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj. Shoqëria mund të themelohet e të ketë një ose disa aksionar. Ajo ka një emërtim, prapa të cilit vihet shkurtesa "SH.A.". Shuma e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie është më së paku 10.000Euro.

Kompani e huaj

Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm. Pas emërimit shkruhet “DEGA NË KOSOVË”.

Ndërmarrjet shoqërore

Ndërmarrje shoqërore do të thotë një person juridik që shumica e aseteve dhe kapitali janë në pronësi shoqërore . Këto ndërmarrje deri në privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit sipas Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Ndërmarrjet publike

Ndërmarrja Publike është ndërmarrje e cila kryen veprimtarinë e interesit të përgjithshëm, që është e themeluar nga shteti.

Ndërmarrja publike monitorohet nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndërmarrje publike do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.

Kooperativat bujqësore

Kooperativa bujqësore është një shoqëri tregtare e krijuar nga personat fizikë apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar. Kooperativa e Bujqve themelohet nga së paku pesë (5) bujq, që janë nënshkrues të detyrimeve. Kooperativa nuk do të themelohet pa kapital e as nuk do të ekzistojë pa kapital. Kapitali ndahet në aksione të vlerës së barabartë me vlerë minimale prej 10 €. Drejtori nuk mund të jetë anëtar i kooperativës. *Të gjitha këto*

mund ti shifni në Ligjin Nr.2003/9 për Kooperativat e Bujqëve si dhe Ligjin Nr,03/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kooperativat e Bujqëve Nr-2003/9¹⁰.

Organizimi dhe Zinxhiri i Menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike në Kosovë

Organizimi

¹¹Në Kosovë ekzistojnë 17 NP qendrore dhe 43 NP lokale. Gjashtë nga NP-të qendrore janë kompani rajonale në fushën e ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërmarrjet tjera qendrore veprojnë në fushat energjisë, telekomit, postës, transportit hekurudhor, mbeturinave dhe ujërave. Prej 43 ndërmarrjeve lokale sa janë gjithsej, 23 janë stacione të autobusëve⁷, tetë ndërmarrje veprojnë në fushën mbledhjes së mbeturinave, tri ndërmarrje janë kompani të ujësjellësit dhe mbeturinave (njëra vetëm ujësjellës), dy ngrohtore, tri ndërmarrje për banim dhe nga një ndërmarrje në fushat si gjelbërim, treg, rekreacion, trafik urban.

NP-të në Kosovë funksionojnë në bazë të parimeve të qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH). Këto parime nuk janë të detyrueshme, mirëpo shërbejnë si bazë e mirë për zbatimin e praktikave të mira nga përvojat e vendeve të ndryshme lidhur me çështjet e menaxhimit të NP-ve. Shkurtimisht, këto parime ndahen në gjashtë grupe dhe përfshijnë:

- 1) Sigurimi i një kornize efektive ligjore dhe rregullative - kërkon ndarjen e funksionit të shtetit si pronar dhe funksioneve tjera të shtetit veçanërisht sa i përket rregullimit të tregut. Në vazhdim, theksohet se marrëdhënia në mes NP-ve dhe institucioneve financiare dhe jo financiare shtetërore duhet të bazohet në baza komerciale.

¹⁰<http://www.arbk.org/sq/Llojet-e-bizneseve>

¹¹http://www.institutigap.org/documents/51878_MNP%20final.pdf faqe 8-12, menaxhimi i ndërmarrjeve publike. NJPMNP Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

- 2) Shteti si pronar - duhet të sigurojë që NP-të:
 - a) të qeverisen në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente;
 - b) të sigurojnë pavarësinë e bordit në mënyrë që të arrihen objektivat e caktuara; dhe
 - c) njësia apo trupa e cila koordinon menaxhimin e NP-ve (rregullatori) duhet t'i përgjigjet organit përfaqësues - Parlamentit.

- 3) Trajtimi i barabartë i aksionarëve - kërkon që të gjithë aksionarët e ndërmarrjes të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë qasje të barabartë në informacionin e ndërmarrjes.

- 4) Marrëdhëniet me palët e interesit (stakeholders) - legjislacioni duhet të njohë përgjegjësitë e NP-ve ndaj palëve të interesit dhe bordet gjithashtu duhet sigurojnë implementimin e kodeve të brendshme të etikës.

- 5) Transparenca dhe hapja (disclosure) - NP-të duhet të auditohen nga auditorë të brendshëm dhe të jashtëm. Gjithashtu, NP-të duhet të bëjnë transparente informacione financiare dhe jo-financiare për aksionarin dhe publikun.

- 6) Përgjegjësitë e bordeve - Bordet duhet të kenë autoritetin e nevojshëm, kompetencat dhe objektivitetin për funksionin e tyre në drejtimin strategjik dhe monitorimin e menaxhmentit.

Zinxhiri i Menaxhimit të NP-ve

Në nivel komunal, të drejtën e aksionarit të NP-së e ushtron Komisioni Komunal i Aksionareve, i cili përbëhet nga:

- a) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës; dhe
- b) dy anëtarë tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal.

Komisioni bën përzgjedhjen e bordeve të NP-ve lokale dhe i raporton Kuvendit Komunal në baza vjetore mbi performancën e NP-vë lokale. Në rastet, kur një ose

më shume së një komunë ka aksione në një ndërmarrje lokale, atëherë secili Komision Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të zgjedhë një drejtor. Përfaqësimi i secilës komunë në borde të drejtorëve rregullohet me udhëzim administrativ të lëshuar nga Qeveria e Kosovës.

Në nivel qendror, të drejtën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në NP-të qendrore e ka Qeveria e Kosovës. Mbi çështjet e ndërmarrjeve publike Qeveria vendosë me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa vendimet zbatohen nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik. Përveç zbatimit të vendimeve, Neni 8.1 i Ligjit për NP obligon Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik

dhe NJPMNP t'i raportojnë dhe japin përgjegjësi Kuvendit në baza vjetore lidhur me performancën e NP-ve qendrore.

Të drejtat e veta si aksionar në një NP, Qeveria i ushtron përmes zgjedhjes së Bordit të Drejtorëve. Bordet e NP-ve në Kosovë përbëhen prej 5 ose 7 personave dhe sipas Nenet 15.12 të Ligjit për NP-të, asnjë anëtar i bordit, përveç Kryeshefit Ekzekutiv (KE), nuk ka kompetenca ekzekutive.

Njëkohësisht, ligji në përputhje me praktikat e mira të sugjeruara nga OBEZH, përcakton se KE nuk mund të jetë Kryesues i Bordit. Përveç vetëvlerësimit nga ana e bordit, puna e bordeve të NP-ve qendrore vlerësohet edhe nga NJPMNP. Në rast se NP-ja dështon të realizojë caqet e përcaktuara në planin e biznesit për dy vite radhazi, aksionari merr parasysh shkarkimin e bordit të një ndërmarrje. Sa i përket kompetencave të bordit mbi KE, Neni 18 i Ligjit për NP specifikon se bordi mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme performancën e zyrtarëve të NP-së (duke përfshirë KE). Sipas Nenet 21.4, ndër kompetencat e bordit të drejtorëve është edhe emërimi i zyrtarëve të NP-së.

Hallka e fundit e zinxhirit të menaxhimit të ndërmarrjeve janë zyrtarët e ndërmarrjes. Zyrtarët e ndërmarrjeve publike janë përgjegjës për menaxhimin dhe arritjen e caqeve vjetore të caktuara në plan të biznesit nga vetë ata e të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Plani i biznesit ndër tjera duhet të përmbajë:

- synimet afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP-ja dhe orarin e realizimit;
- mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- përcaktimin e shpenzimeve dhe mënyrën e financimit;
- veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve;
- detyrimet e NP-ve ndaj konsumatorëve, etj.

KE-të dhe zyrtarët e saj kanë edhe këto kompetenca detyrime:

- dorëzimin e raporteve tremujore dhe vjetore tek
- Bordi i Drejtorëve;
- testimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve;
- rekrutimi i stafit;
- caktimi i nivelit të pagës për stafin etj.

Kuptimi dhe Definimi i Menaxhmentit

Gjeneza dhe zhvillimi i menaxhmentit

Menaxhmenti si disiplinë shkencore është relativisht e re në krahasim me praktikimin dhe përvojën e saj. Që nga kohërat e egjiptianëve të vjetër të cilët njihni disa nga aktivitete të menaxhmentit të sotmes, si: ndarja e punëve midis punëtorëve, veshja e ndryshme e punëtorëve të llojeve dhe pozitive të ndryshme.

Shembull tjetër i historisë së lindjes dhe zhvillimit të menaxhmentit është edhe ai nga mbreti i Babilonisë Hamurabi, prej të cilit janë të njohura normat e kodeksit i përbërë prej 282 ligjeve, gjenerali kinez Tzu kishte parapare ndarjen e ushtrisë në

divizione, ndarjen dhe shkallëzimin e gradave ushtarake, shfrytëzimin e mjeteve të ndryshme për komunikim dhe udhëheqje¹².

(Ketu shto dicka nga Islami)

Nga koha e industrializimit ekzistonin dy lloje të teorisë, shkolla klasike dhe neoklasike, lidhur me qeverisjen dhe organizimin e ndërmarrjeve.

Shkolla Klasike

Qeverisja dhe organizimi i ndërmarrjeve e cila ishte e drejtuar kryesisht kah njohja e organizimit formal, qasja analitike e harmonizimit dhe shpjegimit të koncepteve të ndarjes së punës, proceseve funksionale, strukturës organizative dhe kontrollit e cila është e njohur me teorinë klasike – qeverisja shkencore. Vlerat të qëndrueshme të teorisë klasike janë dhanë nga Frederick W. Taylor (SHBA) dhe Henry Fayol (Fra).

Esenca e menaxhmentit shkencor të Fredrick Taylor është në efektin e vërtet të ditës. Kjo paraqet punën që e kryen një punëtor në mënyrë të ndershme, me shpejtësi maksimale por pa e dëmtuar shëndetin. Ku kufijtë e saja ishin shumë të larta me qëllim që efikasitetin ta arrij vetëm me një numër të vogël punëtorësh. Në bazë të kësaj linden tri parime kryesore:

- Parimi i parë: normimi i efekteve ditore të punëtorit,
- Parimi i dytë: “Shop Management”, bartja e punës mendore nga ofiçina prodhuese në njësinë e veçantë për plan,
- Parimi i tret: kontrolli i punës dhe kryerja e detyrave të punës.

Sipas këtyre parimeve Taylor ka punuar në mënyrë të hollësishme në metodologjinë e realizimit të konceptit të qeverisjes shkencore në këto mënyra:

- a) zgjedhja e punëtorëve të kualifikuar,

¹² Prof. Dr. Berim Ramosaj, Management – Bazat e Menaxhimit, Prishtinë 2005

- b) studim i lëvizjeve të punëtorëve gjatë kryerjes së punëve,
- c) eliminim i ngadalësisë dhe lëvizjet e panevojshme,
- d) pas eliminimit të lëvizjeve të tepërta, të përcaktohen lëvizjet e duhura.

Interesi kryesor i Teylorit ishte shtimi (rritja) e efikasitetit në prodhim, jo vetëm duke zvogëluar shpenzimet dhe rritur fitimet por të mundësohet edhe paga më të larta. Duke u mbështetur në tërë përvojën e cila ka ardhur nga metalurgjia e çelikut (Midvale steel company) në Filadelfi del se edhe sot e kësaj dite me disa modifikime ka mjaft rendësi dhe mbetet në teorinë dhe praktikën e menaxhmentit si bazë mjaft e shëndosh për zhvillimin e menaxhmentit bashkëkohor¹³.

Henry Fayol e definon Menaxhmentin si parashikim, planifikim, komandim, koordinim dhe kontroll në procesin e arritjes së qëllimeve të kompanisë. Ai përcakton gjashte aktivitete themelore:

- 1) Aktivitete teknike,
- 2) Aktivitete komerciale,
- 3) Aktivitete financiare,
- 4) Aktivitete të sigurimit,
- 5) Aktivitete të njohjes së evidencës,
- 6) Aktivitete menaxherike,

Sipas Fayoli pesë aktivitetet e para janë të ndërlidhura dhe kanë karakter ekzekutiv derisa ajo menaxherike duhet të jetë e pavarur nga pesë aktivitetet e para¹⁴.

Këto parime të dalura nga Fayoli i ka mbështetur në përvojën e arritur ne kompaninë ku ka punuar tërë jetën e tij e cila është e përmbledhur në librin Administration Industrielle et generale (menaxhmenti i përgjithshëm dhe industrial).

Teoritë organizative të njohura si teori të shkollës klasike apo shkollës së qeverisjes shkencore me të gjitha përcaktimet e rëndësishme konceptuale kanë pasur aspirata

¹³ Po aty, faqe 24, 25

¹⁴ Po aty, faqe 26

që të gjitha problemet e qeverisjes të zgjidhen me anën e analizës racionale dhe shkencore.

Shkolla Neoklasike

Ndërsa në anën tjetër, shumë karakteristika të shkollës klasike të qeverisjes shkencore lan nën hije elementet dhe mënyrën e organizimit joformal, këto qiten në pah nevojën për një qasje të re shkencore, qasjen bihevoristike.

Lënde studimi e shkencave bihevorale është struktura dhe proceset e ndërtimit të shoqërisë dhe sjelljet e njerëzve në të si përvojë e përditshme e tërë njerëzimit.

Paraqitja e drejtimit të quajtur marrëdhëniet humane – ndërnjerëzore në teorinë e organizimit paraqet në të vërtetë reaksion të dimensionit psikologjik – sociologjik ndaj atij teknik të menaxhmentit si tërësi komplekse.

Kuptuar në këtë mënyrë menaxhmenti neoklasik bihevoristik fitoj një dimension të ri sociologjik - psikologjik. Teoricienit më i dalluar i kësaj shkolle është Elton Mayo i cili beri eksperimentin e tij në Western Electric në Illinois lidhur me raportin e vendit të punës me sjelljen e punëtorit i cili quhet ndryshe edhe Efekti Hatorn. Ku dy grupeve ju është ofruar puna ne kushte të ndryshëm mirëpo dy grupet kanë treguar sukses dhe kjo për arsye se marrëdhëniet ndërnjerëzore kanë qenë relativisht të mira dhe së dyti ekzistim i shkallës së lartë të harmonizimit të interesave të punëtorëve dhe menaxhmentit.

Shikuar nga aspekti i përgjithshëm dhe efekti i orientimit progresiv, teoria e marrëdhënieve ndërnjerëzore as për afërsisht nuk ka arritur publicitetin e qeverisjes shkencore, arsyet për këtë mund të gjinden në kohën kur është paraqitur kjo teori, për në kohën e krizës së madhe ekonomike të viteve të tridhjeta¹⁵.

Definimi i Menaxhmentit

¹⁵ Po aty, faqe 28, 29

Fjala menaxhment rrjedh nga fjala angleze “to manage”. Në disa gjuhë , siç janë p.sh. franceze, suedeze, shqipe, etj., nuk ka kuptim adekuat unik, i cili në tërësi do t’i përgjigjet kuptimit të fjalës “manage”. Në të shumtën e rasteve në këtë kontekst përdoren termat “qeverisje”, “udhëheqje”, “drejtim” e të ngjashme.

Menaxhmenti në kuptimin e përgjithshëm të fjalës ka këto sinonime: vendosje, rregullim, planifikim, kontrollim, organizim, drejtim, arritje e qëllimeve, realizim etj¹⁶.

Autorë të ndryshëm kanë dhënë definicione të ndryshme lidhur me menaxhmentin:

- Qeverisja e ka kuptimin e parashikimit, planifikimit, komandimit, koordinimit dhe kontrollit (Fayol)¹⁷.

- Koordinim i resurseve të ndryshme në procesin e planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit të orientuar sipas qëllimeve të përgjithshme të përcaktuara qysh më parë (Kuntc dhe O’ Donel)¹⁸.

- Menaxhmenti paraqet procesin e orientimit të vetëdijshëm të aktiviteteve njerëzore kah realizimi i qëllimit - qëllimeve të caktuara, përkatësisht tërësinë e ndërlidhur të pesë funksioneve: planifikimit, organizimit, kuadrit (personelit), udhëheqjes dhe kontrollit (B. Ramosaj)¹⁹.

- Menaxhmenti si proces mund të definohet si tërësi aktiviteteve me të cilin kryhen funksionet e caktuara me qëllim që në mënyrë efikase të sigurohen, renditen

¹⁶ B. Ramosaj, Management, Udhëheqja dhe menaxhimi financiar i ndërmarrjes ekonomike, botimi I dytë, Prishtinë 2003

¹⁷ Fayol, H., General and Industrial Management, Pitman, v. 1949

¹⁸ Massic, J. L. and Douglas, J, Managing: Acontemporary Introduction, Englewood Cliffs, N. J., Prentace Hall, v. 1973, fq. 24

¹⁹ B. Ramosaj, Ndërmarrja dhe menaxhmenti ndërmarrës, Rilindja, Prishtinë, v. 1991, fq. 24

dhe shfrytëzohen përpjekjet njerëzore dhe resurset fizike ashtu që të arrihet ndonjë qëllim²⁰.




Fig. 1 Procesi i menaxhmentit

Funksionet kryesore që përbejnë esencën e menaxhmentit si proces në organizmat bashkëkohorë janë: Planifikimi, Organizimi, Personeli, Udhëheqja dhe Kontrolli.

Planifikimi

Planifikimi përfshin zgjidhjen e detyrave dhe qëllimeve, të aksioneve me ndihmën e të cilave mund të arrihen ato. Përfshin marrjen e vendimeve përkatësisht zgjedhjen e drejtimeve të ardhme të aksioneve midis alternativave të mundshme. Procesi para marrjes së vendimeve quhet studim planor, analize po propozim.

Organizimi

Organizimi si funksion kryen shpërndarjen e punës dhe të detyrave dhe vendos marrëdhënie midis të punësuarve në organizate. Me qëllim që të realizohet ndonjë cak, organizata kërkon që puna të ndahet në disa bartës. Rezultat i funksionit të organizimit është struktura organizative e cila tregon mundësitë dhe shkallen e përpjekjeve të organizatës për tu integruar si tërësi. Organizimi është pjesë e menaxhmentit që përfshin përcaktimin e strukturës së roleve të njerëzve brenda organizatës. Qëllimi i strukturës organizative është krijimi i ambientit në të cilën do të realizohet veprimtaria njerëzore. Ekzistojnë shume problem gjatë përshtatjes së

²⁰ B. Ramosaj, Management – Bazat e menaxhimit, Prishtinë, v. 2005, fq. 39

strukturës në situatë të caktuara duke marrë parasysh definimin e llojeve të punëve që duhet të kryhen si dhe njerëzit që duhet të kryejnë ato.

Personeli


Personeli duhet të rekrutohet, ushtrohet dhe të zgjidhet ashtu që të kryejë punë të caktuara në organizatë. Sigurimi i mënyrës së vlerësimit të punëve, kundërvlerës, shpërblimit për punën e bërë, mbrojtja në punë si dhe kujdesi ndaj shëndetit të personelit paraqesin disa nga aktivitetet që kryhen në kuadrin të funksionimit të politikës së kuadrove. Politika e kuadrove përfshin plotësimin e vendeve të punës në strukturën organizative, si dhe mbajtjen e këtyre vendeve të plotësuara.

Udhëheqja

Udhëheqja si funksion apo pjesë e procesit të menaxhmentit realizohet me njerëzit dhe midis njerëzve ashtu që të arrihen rezultate të dëshiruara. Udhëheqja përfshin kryesisht aktivitete rreth aspekteve ndërnjerëzore të menaxhmentit. Udhëheqja si funksion i menaxhmentit përfshin motivimin, stilet e udhëheqjes, qasjet e mundshme si dhe komunikimin.

Kontrolli

Kontrolli si funksion ka për qëllim krahasimin përkatësisht korrigjimin e rezultateve të arritura me të dhënat e planifikuara. Pasi që plani të aprovohet u jepet anëtarëve të organizatës me qëllim që të sigurohet puna e dëshiruar. Kontrolli në këtë mënyrë mbyllet rreth e ciklit dhe jep informata mbi atë se me çfarë suksesi firma po ecën kah qëllimet e përcaktuara²¹.



²¹ Po aty, faqe 46, 47, 48

Fig. 2 Qasja sistemore e manaxhmentit

Heinz Weirich & Harold Koontz, Manegement, v. 1993




Fig. 3 Funkzionet menaxherike

Heinz Weirich & Harold Koontz, Manegement, v. 1993

Bibliografia dhe Literatura e Zgjedhur

1. Dr. Sc. Qemal Y. BUÇINCA, Menaxhimi i Sistemeve Organizative, Prishtinë 2006
2. Dr. Sc. Qemal Y. BUÇINCA, Menaxhimi i Prodhimtarisë, Prishtinë 2008
3. Prof. Dr. Berim RAMOSAJ, Management – Bazat e Menaxhimit, Prishtinë 2005
4. Prof. Dr. Berim RAMOSAJ & Doc. Dr. Izet ZEQRIRI, Management – Udhëheqja dhe Menaxhimi Financiar i Ndërmarrjes Ekonomike, Botimi i dytë, Prishtinë 2003
5. Dr. Emeric SOLYMOSSY & Dr. Safet MEROVCI, Ndërmarrësia, Prishtinë 2006
6. Dr. Sc. Mujë GJONBALAJ, Lënda: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore, Prishtinë 2011
7. Dr. Mujë GJONBALAJ, Rëndësia e Tregut të Punës dhe Politikat e Punësimit në Kosovë
8. World Bank Document, Kosovo Labor Market Study: Policy Challenges of Formal and Informal Employment, Qershor 2003

9. Riinvest, Tregu i Punës dhe Papunësia në Kosovë – Raport Hulumtues, Prishtinë 2003
10. OECD ‘Organization for Economic Co-operation and Development’, Education at a Glance, 2010 - OECD Indicators
11. The International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, Tazeen FASIH, Linking Education Policy to Labor Market Outcomes, 2008
12. Shiv Singh, Ray Velez and the Enterprise Solutions Practice at Razorfish, Corporate Best Practices Report, A User-Driven Web 2.0 Perspective
13. Internet Intelligence, Implementing an Intranet – A Management Overview, 2006

REVIEW FOR THE IMPLEMENTATION OF MACROPRUDENTIAL INSTRUMENTS FROM SOME OF THE AUTHORITIES OF CENTRAL AND EASTERN EUROPEAN COUNTRIES

1. Dr. Orkida ILOLLARI

orkida.ilollari@gmail.com

2. Prof. Assoc. Dr. Artur RIBAJ

artur.ribaj@outlook.com

3. Academic Prof. Dr. Anastas ANGJELI

anastas.angjeli@umsh.edu.al

4. Prof. Dr. Adrian CIVICI

adriancivici@gmail.com

Abstract

The last financial crisis pointed out that there is the need to use well-defined macro-prudential policies and instruments to overcome it. One of the most important regulatory tools used is the macro-prudential regulation consists in narrowing this gap, imposing the banks to take on higher risks during difficult periods to ensure the credit support during crisis. These instruments include the inherited requests and the accumulated capital on the provisions prospective of liquidity indicators and appropriate collateral evaluations (IMF, May 2010). As most of the countries around the world, Europe and Balkan it became necessary to implement the policy and macro-prudential instruments. The measures adopted by the authorities varied and they consisted in controlling the banks' loans issued in the foreign currency. These instruments are implemented by supervisory authorities in specific countries. According to (IMF, 2011), the number of countries adopting macro-prudential instruments is small because of such policies' use in recent years only, thus restricting the margin of safety in statistical analyses. The choice to implement

macro-prudential instruments in some way would solely favor high-risk countries that implement such policies as a response to economic and market developments. It is obvious that macro-prudential instruments and policies varied among countries. This is due to the fact that each country has different problems of the macroeconomic nature and in the financial system. According to the report of IMF (2011) when applying macro-prudential instruments should be noted that the same measures are not equally effective in all countries where they are applied.

Key words: Macro-prudential regulation, Financial Crisis, Systemic Risk, Monetary Policies.

Introduction

The financial crises can be defined as major disorders of the financial market, which are followed by companies' bankruptcy and a substantial decrease of assets prices. The financial crisis occurs when there is an increment of the non-symmetric information due to the financial market disorder causing severe problems of opposing selection and moral hazards, causing the financial markets to be incapable of channeling funds efficiently from savers to individuals and businesses with opportunities for productive investments. In these cases, the financial markets cannot function well and as a result, there is a considerable shrink in the economic activity. The main purpose of trying to prevent the crisis is related to the increasing costs to the society. To overcome these crises there are needed tools and instruments, well defined regulations in place implemented by the policymakers.

Experiences from various countries show that using instruments to achieve planned targets has proved successful. Some countries use them individually, whereas others combine or coordinate their instruments with other policies (IMF, 2013).

The relation between Central Bank and Financial stability

Parties involved in the monetary policies have various definitions of the "macro prudential" term. According to the IMF (2011), this term means a policy that aims to maintain the financial stability. Public references to macro prudential policies have started in the mid-1980s and it was developed in the 2000s. This term is used today as a continuous approach to financial regulation and supervision. It started to be used

with the exact term "macro-prudential policy" only after the recent global crisis (Galati & Moessner, 2011).

1. Macro prudential instruments implemented from the Bank of Albania(BoA)

Albania as part of the Central and Eastern European countries has many features in common with these countries in regard to their economic and financial structures; they have the same

development pattern and share similar problems. The same crisis affected these countries at the same time. As in these other countries, even in Albania, there were many benefits from large inflows of capital, merely in the form of foreign direct investment and external financing. The

entrance of the Western countries banks in Albania facilitated the capital inflows. As a result, there was a credit and economic growth based on consumer-oriented model. Regardless of the

inflation being kept stable, there were financial imbalances and weaknesses that affected the real estate prices. The last crisis of 2007 - 2008 found Albania with a lack of liquidity because of the deposits being withdrawn. There were also lower levels of remittances and foreign direct investment. There was a lack of liquidity and exchange rate depreciation reflected on the balance sheets, which affected the consumption and investments. As a result of the economic situation, there were taken countercyclical measures in the form of expansionary monetary and fiscal policies.

The economic slowdown was seen by Bank of Albania as the main risk faced by the Albanian economy and financial system. Appreciating the role that bank loans have in the economic activity, the Bank of Albania adopted a package of macro prudential measures oriented towards promoting loans and reducing risk in the banking system.

1 In March 2013 the Bank of Albania adopted another set of macro prudential instruments, aiming to promote credit, provide liquidity in the country and reduce risk in the banking system.

These instruments consist:

- Facilitating capital requirements for credit growth;
- relieve liquidity requirements;
- to increase the capital requirements for assets abroad based on rates required by the BoA;
- encouraging the domestic loans in the foreign currency;
- reduce the restructured loan provisioning;
- higher risk weight: *risk weights are prudential indicators set by the regulatory authority.*

For certain instruments this provides a better coverage of risk capital, as well as incentives for conservative management of exposure levels to entities / certain sectors.

One of the key instruments launched by Bank of Albania, was restructuring loans. This is an important process that affects the proactive administration of risk of further deterioration of NPLs. All this effort comes to enable repayment of obligations in terms of the specific difficulties the borrower faces. One of the key instruments launched BoA was restructuring loans.

2. Macro prudential instruments implemented from the Bank of France

According to the Central Bank of France (Banque de France February 2013), the key function of the financial system is to ensure efficient resource transfers from the lender to the borrower. Funding such activities is essential to economic development since they are the key promoters of economic growth.

Funding can be provided in two way²²:

1. directly from equity or bond issuance in stock markets;
2. or bank loans.

Unlike other countries with better developed disintermediation, such as in the UK or USA, French banks play a major role in lending to the economy. Bank loans are also

¹
Banque de France • Focus • No. 9 • 19 February 2013

the main source of financing for households and small- or medium-sized enterprises. A healthy financial system is requisite for a proper intermediation process, because it can correctly assess the financial risks and is able to mitigate any shocks, thereby easing the more serious consequences to the economy. The Central Bank of France has developed numerous financial risk benchmarks based on market data by using analyses, modern methodology, and complex systems to identify the interrelatedness between financial institutions and discover the probable spread channels (Banque de France February 2013).

One of the first macro prudential instruments that France used in 2010 was the imposition of a reported monthly liquidity of 100% and exposure to customers or a limited group of customers no larger than 25% of the bank's capital.

Macro prudential instruments in France were arranged in two categories, based on decisions of the supervisory authorities (Banque de France 2013):

1. Objective to mitigate procyclicality
2. Raise the stability of the financial system to shocks.

3. Macro prudential instruments implemented from the Bank of Italy

The Bank of Italy is the authority that maintains the stability of the national financial system by

macro prudential overseeing of the banks and through implementation of policies that govern the entire financial system.

The Bank of Italy adopts measures to address systemic risks resulting from other financial mediators as well as the financial markets (Banca D' Italia, Numero 76 – Giugno 2014).

Just like any other central bank, the Bank of Italy performs its duties, e.x. maintains financial stability by analyzing in detail all the components of the financial system, for the purpose of identifying weaknesses and risks to financial stability. During the recent global crisis, lending in Italy accelerated by reason of the corporations“

increased demand for funding and improved activities. Lending for households increased as well, the number of loans for immovable properties got bigger, and some steps helped reduce lending cyclicality.

The macro prudential instruments below were used by Italy in the recent crisis:

– Caps on LTVs were introduced, along with advices against borrowing a housing loan with an LTV 80% higher than the amount requested.

Demands for required capital in such cases were stricter (Source: IMF, 2011b).

4. Macro prudential instruments implemented from the Bank of Hungary

Hungary joined the European Union in 2004.

In 2010 it introduced the policies on LTV and DTI differentiated by currency, before the mortgage loans in foreign currency were stopped (IMF, 2011b).

Weaknesses in its economy were in the form of high external debt, as well as changes in foreign currency. A Large part of the house mortgages were issued in foreign currency by causing borrowers in this category to be vulnerable towards the variations in the exchange rate. The measures were related to the treatment of foreign exchange changes on mortgages. The macro-prudential instruments that Hungary used are:

2010 - The introduction of LTV and DTI limit for housing loans in foreign currency, also were detained housing loans in foreign currency.

5. Macro prudential instruments implemented from the Bank of Serbia

The country met the inflation target by exceeding it with more than 5% in 2011. In Serbia, in 2006, they were introduced the higher risk weights such as that of foreign currency loans over a certain amount. In 2008 there was differentiated the classification of loans and provisioning rules as per the currency. Serbia's National Bank increased its policy rate by 200pbs during the period June-December 2008

(IMF, 2012). Also, it in the same way as Croatia, adopted measures to curb foreign currency lending. Serbia had a rapid credit growth, which was followed by the obligations and responsibilities towards external debt. Systemic risk was increased as a result of the bank loans in foreign currency which did not have strong standards. The risk of these loans specifically affected vulnerable borrowers. The measures taken intended to limit currency risk, as well as limit the high credit growth.

The Macro-prudential instruments that Serbia used were as follows:

2004 - DTI for families: introduction of the ceiling (cap) in DTI and its recalibration several times since 2004.

2005 – There were introduced differentiated reserve requirements for foreign currency and the reduction of foreign currency loans.

2006 - The capital ceiling was introduced to 200% in the proportion of mortgage portfolio. This ceiling was reduced to 150% a year later.

2007 – 2008 - Ceiling on foreign currency lending by introducing a minimum deposit of 20% for loans (non-mortgage) for families. A year later it was reduced to 0%.

2008 - Restrictions on the distribution of profits, dividends and bonus payments were forbidden, if the bank was under provisioning. This rule is in effect today.

Capitalization and liquidity indicators are high and NPLs are well provisioned. NPLs are at the level of 15.58%. Credit growth is low despite abundant liquidity in the banking system due to perceived lending risks, and high NPLs (Hafizi & Bushi, 2014).

6. Macro prudential instruments implemented from the Bank of Croatia

Croatia joined EU in 2013. These measures main purpose was to minimize the foreign borrowing and contain the credit growth. The banks had to fulfill the requirement of sublimit on credit growth of 1%. The marginal reserve requirement applied aided the foreign borrowing of the banks. During 2001-2003 in Croatia bank lending to the private sector was increased by 20-30% per year. During this period

of time there was a rapid economic growth that was followed by a "boom" as a result of capital inflows and domestic consumption (Hafizi & Bushi, 2014).

In 2007 the mortgages increased rapidly at an annual rate of 31%. Also the housing prices increased with a 30% rate for the same period. Systemic risk increased bank loans in the foreign currency, particularly for vulnerable borrowers from the weak standards of the banks. The latter were subject to liquidity risks and unforeseen change of investors in the region. They took measures to slow the immediate credit growth, to reduce pro-cyclicality, to slow down foreign borrowing and encouraged banks to apply prudential policies in such cases (IMF 2011b). The macro-prudential instruments that Croatia used:

In 2003 - As a result of the additional liquidity requirement ratio increased by liquid foreign assets in foreign borrowing them at 24%.

During 2004 -2006 banks found it necessary to impose additional provisioning for excessive credit growth; the liquidity was raised to 32% and the LTV started to be applied for mortgages in the sum of 75%. Also, new loans were not approved if the average monthly income of a borrower did not cover his own total expenses.

2006 –it was introduced a special reserve requirement at 55% on increases in liabilities created by debt securities which was followed by 20% drop in capital inflows. As a result of the credit growth slowing down, the external borrowing of the banks dropped.

2008- The general reserve requirement was at the level of 17% until the end of the year (Hafizi & Bushi, 2014).

The macro-prudential measures implemented in Croatia seem to have been effective. The prudential and macro-prudential measures reduced capital inflows for one quarter and they contributed to increasing for one year the monetary independence. The level of NPLs is 10.78% for the period of 2009-2014, but regardless of these levels it can be said that the foreign-owned banking system is robust.

Conclusions

The recent financial crisis has stressed the position of effective systemic risk measurement, which remains a key factor in macro-prudential and regulatory policies. This enables the measures of systemic risk to touch the identification and evaluation of threats to financial stability. Since the time it was created in 1970, it still defines the concerns in regards to the financial stability and its relation to macro-economy. Also, the focus of these concerns has changed over time. They have been unified to excessive lending to developing countries, the impact of financial innovation and the development of capital markets, the effect of the regulation on "pro-cyclicality" of the financial system, as well as the consequences of the failure of key systemic institutions.

The authorities in Europe adopted various measures to control bank loans given in the foreign currency. The instruments seem to have had the effect of slowing down the credit growth and the formation of capital or liquidity coverage.

Macro-prudential instruments include the integral requirements and capital accumulation in a liquidity indicators provisions perspective and careful appraisal of the collateral. Macro-prudential surveillance policies are strategic instruments to ensure financial stability, in fact they can reduce the repetition of systemic risks and structural weaknesses.

Regarding macro-prudential policies, the need for the development of specific anchors was argued, which would make the objective of financial stability more reliable, more transparent and therefore more accessible. Measurement of financial stability or instability can be a hard process, but this should not discourage us trying to accomplish it.

Emerging economies that have fixed exchange rate and interest rate limited tend to be the most widely used macro-prudential instruments. The same tools are equally effective when used in developed countries with flexible exchange regimes rate. The implementation of macro-prudential instruments cost must be taken into account when calculating the benefits from these instruments (IMF,2011a). The basis for a successful implementation of the macro-prudential instruments is a good structure and strong surveillance. The experience of Albania as a country with a developing economy shows that price stability and financial stability are prerequisites for each

other. According to the IMF (2011b) when applying macro-prudential instruments should be noted that the same measures are not equally effective in all countries where they are applied.

Instruments used needed to address systemic risks as listed below:

- For liquidity risks of the system there can be used limitations in the mismatch of liquidity restrictions on the net position in foreign currency (if liquidity risk derived from financing in foreign currencies) (IMF, 2011b).
- For systemic risks caused by inflation or increased credit the appropriate instruments that can be used are those related to the loans, such as the limit of DTI and LTV (IMF, 2011b).
- For risks arising from the effect of financial leverage, the instruments related to capital can be used. The latter creates a countercyclical situation through changes in capital requirements and risk weight assets. In this way it is possible to limit the excessive financial leverage. If this increase is due to the demand of banks to expand lending, these measures may be supplemented by instruments related to credit (IMF, 2011b).
- If the above mentioned risks are created as a result of capital flows, then the listed instruments can be used. Instruments used for liquidity are effective in limiting the financing in foreign currency. In this context, the instruments related to capital may be helpful for limiting the credit growth (IMF, 2011b).

The following points need to be taken into consideration (Gerlach, 2013).

- An instrument versus many instruments
- Broad-based versus targeted
- Rules versus discretions
- Coordination with other policies

Different countries have adopted the design and calibration of instruments based on their particular circumstances such as: resource and risk type, the ability of their system to avoid regulations, the quality of surveillance, implementation, management and agreements related to the macro-prudential politics.

Reference

1. Acharya, V. V., Pedersen, L. H., Philippon, T., & Richardson, M. (2017). Measuring systemic risk. *The Review of Financial Studies*, 30(1), 2-47.
2. Alessandri, P., Bologna, P., Fiori, R., & Sette, E. (2015). A note on the implementation of the countercyclical capital buffer in Italy. *Bank of Italy Occasional Paper*, (278).
3. Allen, W. A., & Wood, G. (2006). Defining and achieving financial stability. *Journal of Financial Stability*, 2(2), 152-172.
4. Amorello, L. (2016). Europe goes ‘countercyclical’: a legal assessment of the new countercyclical dimension of the CRR/CRD IV package. *European Business Organization Law Review*, 17(1-2), 137-171.
5. Antonucci, A. (2016). I poteri di removal degli esponenti aziendali nell'ambito del Single Supervisory Mechanism. *Banca Impresa Società*, 35(1), 21-38.
6. Arregui, N., Beneš, J., Krznar, I., & Mitra, S. (2013). Evaluating the net benefits of macroprudential policy: A cookbook.
7. Banque de France (September 2009) “The Future of Financial Regulation?” *Financial Stability Banque de France* (January 2010) “Financial Crisis, Economic Crisis”, Documents and Debates, No. 3
8. Basto, R. B. (2013). A Macro-prudential Policy for Financial Stability.
9. Benati, L., & Surico, P. (2008). Evolving US monetary policy and the decline of inflation predictability. *Journal of the European Economic Association*, 6(2-3), 634-646.
10. Benati, L., Mumtaz, H. 2007. “U.S. Evolving Macroeconomic Dynamics: A Structural
11. Bernanke, B. S. (2010). The economic outlook and monetary policy: a speech at the Federal Reserve Bank of Kansas City Economic Symposium, Jackson Hole, Wyoming, August 27, 2010 (No. 539).

12. Borio, C., Furfine, C., & Lowe, P. (2001). Procyclicality of the financial system and financial stability: issues and policy options. *BIS papers*, 1(3), 1-57.
13. Cincotti, S., Raberto, M., & Tegli, A. (2012). Macroprudential policies in an agent-based artificial economy. *Revue de l'OFCE*, (5), 205-234.
14. Civici, A.(2015). The role of macro-prudential policies in the financial stability. *Bankieri* No.15, April 2015
15. Claudio, B., & Claudio, B. O. R. I. O. (2012). The financial cycle and macroeconomics: What have we learnt?. *BIS Working Papers*.
16. De Nicoló, M. G., Favara, G., & Ratnovski, L. (2012). Externalities and macroprudential policy. *International Monetary Fund*.
17. Gerlach, S. (2013). Monetary policy after the crisis. *The Manchester School*, 81, 16-34.
18. Hafizi, D., & Bushi, I. (2014). Global Crisis Impact in Banking System for Western Balkan countries. *Economics Questions, Issues and Problems*.
19. Ilollari, O. (2015). Macro-prudential Instruments in Eastern European and Balkan Countries. *Review of Applied Socio-Economic Research*, 10(2), 58-64.
20. Ilollari, O. (2016). The Policies of Bank of Albania for Providing Financial Stability. *European Journal of Sustainable Development*, 5(3), 409-409.
21. PORTERI, A. (2010). La crisi, le banche ei mercati finanziari. Paper numero, 102.
22. Schinasi, M. G. J. (2003). Responsibility of central banks for stability in financial markets (No. 3-121). *International Monetary Fund*.
23. Smaghi, B. (2009). Three question on monetary-policy easing. *Lecture at the University of Ancona*, 6.

MARKETINGU DIGJITAL – SFIDAT DHE MUNDËSITË NË KOSOVË

PhD. Afrore Bërdyna Mazreku²³

Abstrakt

Përgjatë epokës së sotme, marketing në internet është një fenomen në rritje. Në marketing, vetëm përbërja e dy fjalëve është on-line, që do të thotë internet dhe marketing, që do të thotë blerje dhe shitje e mallrave dhe shërbimeve. Prandaj, lidhjet e marketingut në internet mund të përdoren për të blerë dhe shitur produkte dhe shërbime me ndihmën e Internetit. Që nga qershori 2011, Kosova ka një popullsi prej rreth 169,318 mijë përdorues të Internetit, e cila parashikohet të arrijë në 296.535 mijë deri në vitin 2020. Në Kosovë, metoda më e preferuar e pagesës është shpërndarja e produkteve, duke grumbulluar 75 përqind të aktiviteteve me pakicë. Kërkesa për produktet e huaja të konsumit po rritet edhe më shpejt se furnizimi i brendshëm nga shitësit me pakicë të aprovuar dhe ofertat e tregtisë elektronike. Marketingu në internet dhe shërbimet elektronike konsiderohen fushat më të reja të kërkimit që kanë rëndësi strategjike për kompanitë që kanë përqendruar përpjekjet e tyre në tregun elektronik. Studimet kanë treguar që sjellja e konsumatorit në internet ndryshon (në disa aspekte të rëndësishme) nga sjellja e konsumatorit në vendin e tregut. Cilësia e shërbimeve elektronike është një koncept për të cilin është debatuar shumë, veçanërisht viteve të fundit. Përkufizohet si: "Shkalla në të cilën uebfaqja lehtëson ose ndihmon procesin e blerjes (duke e bërë atë sa më efikas dhe eficientë sa të jetë e mundur) dhe shpërndarjen e produkteve ose shërbimeve". Cilësia e shërbimeve elektronike është një tregues i nivelit të lartë të kënaqësisë së klientit në faqen e internetit. Është pikërisht kjo që bën një ndryshim midis një faqe internet cilësor edhe një faqe interneti me cilësi të ulët (nga këndvështrimi i konsumatorit)

²³Autori përgjegjës: PhD, Universiteti Sv.Klement Orhidski-Bitola, fakultet Ekonomik ,departamenti Marketing –Prilep Maqedoni , afrore.039@hotmail.com, Pejë

që lehtëson procesin e afrimit të klientëve me bizneset dhe ndikon në krijimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve afatgjata.

Fjalëtkyçe: Marketingunë internet, E-marketing, MarketinguDixhital, Marketingu Virtual

Hyrje

Blerja dhe shitja e produkteve zakonisht realizohet kryesisht përmes dyqaneve fizike, dyqane me shumicë dhe pakicë dhe madje edhe nëpër qendra të mëdha tregtare ku të dy blerësit dhe shitësit takohen fizikisht. Konsumatori viziton një dyqan duke përzgjedhur produktin që i përshtatet më së miri dhe duke i paguar shitësit ose në para ose me karta krediti .Por kohët e fundit, një koncept i ri i blerjes dhe shitjes ka evoluar i cili ka ndryshuar skenarin e tërë të marketingut. Cila është e ardhmja tregtisë elektronike, ku transaksionet tregtare tani po kryhen në mënyrë elektronike. E-tregtia ka hapur një derë tjetër e cila ka ndryshuar mënyrën e përdorimit të një shitësi për të shitur mallrat dhe shërbimet e tij.

Sot, një konsumator ka një mundësi për të blerë mallrat dhe shërbimet e tij pa vizituar dyqanin. Kjo ishte bërë e mundur përmes marketingut on-line. Marketingu në internet i referohet blerjes dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve me ndihmën e uebit. Për të blerë mallra dhe shërbime përmes marketingut on-line, një konsumator duhet të ndjekë këto hapa të thjeshtë:

- Hapni website të marketingut on-line në kompjuter ose telefon celular. Për shembull www.flikart.com, www.ebay.com, www.amazon.co.in etj.
- Zgjidhni produktin e dëshiruar nga një numër i alternativave të disponueshme në faqen on-line.
- Siguroni adresën për të eliminuar ndonjë mashtrim të mundshëm me të dhënat e tuaja,

- Bëni pagesa qoftë përmes llogarisë on-line, qoftë përmes kartave të debitit ose kredisë. Konsumatorët përdorin portale, metoda dhe mjete të ndryshme për të krahasuar dhe zgjedhur produktet e tyre nga tregu online.

2.Skenari i marketingut online

2.1 Skenari global

"Amazon" është dyqani më i madh në botë i marketingut on-line i formuar në 1994 me selinë e tij në Seattle, Washigton është një kompani publike amerikane e themeluar nga JeffBezos me shërbime të marketingut on-line në të gjithë botën me ndihmën e 183.100 punonjësve të saj. Produktet kryesore të shitura nga Amazon përfshijnë filma, muzikë, lojëra kompjuterike, kompjuterë, telefona celularë, veshje, këpucë, bizhuteri, libra, mobilje, lodra për bebe dhe lloje.tableta, pjesë automobilistike, kamera, kufje, spekers etj. Një tjetër, dyqan online popullor i marketingut "eBay" u themelua nga PierreOmidyar në 1995 me selinë e tij në San Jose, California.

Është gjithashtu një korporatë Amerikane shumëkombëshe që punëson më shumë se 34.600 të punësuar dhe shet mallra dhe shërbime on-line në pjesë të mëdha të globit. Produktet kryesore të ofruara nga eBay përbëhen nga libra, kamera, telefona celularë dhe telefona të mençur, orë, veshje për burra, gra, fëmijë dhe madje edhe bebe, televizion, printer, skaner, laptop, desktop, bizhuteri, sport dhe lojëra, video lojëra mobilje dhe madje edhe makina, motoçikleta dhe kamionë.

2.2 Skenari në Kosovë

Gjirafa, Inc., është kompani e avancuar e teknologjisë, produkt kryesor i së cilës është makina kërkimore Gjirafa.com. Gjirafa, Inc., është kompani e avancuar e teknologjisë dhe inovacionit, që ka për qëllim lehtësimin e jetës tonë në epokën digjitale, duke ofruar shërbime të bazuara në Internet si: makina kërkimore në gjuhën Shqipe Gjirafa.com, platforma e reklamimit në Internet Gjirafa AdNetwork, shërbimi i shitjes online Gjirafa50.com dhe GjirafaMall.com, Video platforma me

përmbajtje ekskluzive GjirafaVideo, platforma e pikave të interesit dhe bizneseve Gjirafa.biz, dhe shumë të tjera. Gjirafa është kompani Amerikane, e themeluar në SHBA nga MergimCahani, njëherit edhe CEO, ndërsa bashkëthemelues janë ErcanCanhasi dhe DiogjenElshani. Gjirafa me degët e saj në Kosovë dhe Shqipëri numëron rreth 80 të punësuar të cilët kryesisht punojnë në dy zyret e saj, Prishtinë dhe Tiranë.

3.Përfitimet për klientët

Marketingu në internet ofron një numër avantazhesh për konsumatorët nga të cilët avantazhet kryesore mund të paraqiten si më poshtë:

3.1 Ulja e çmimit

Marketingu në internet nuk kërkohet të mirëmbajë dyqanet me pakicë dhe shumicë, si rezultat i të cilave investimi i tyre në asete fikse bie, gjë që nga ana tjetër ul kostot. Kjo ulje e kostos ndihmon për të ulur çmimet e mallrave dhe shërbimeve për shkak të së cilave një konsumator mund të marrë produktin e tij të dëshiruar me një çmim më të ulët përmes marketingut on-line.

3.2 Kursen kohë dhe punë

Një konsumator nuk është i detyruar të vizitojë dyqane të ndryshme për të blerë produktin e tij të dëshiruar nëse ai është duke përdorur shërbimin e marketingut on-line, i cili kursen kohën e çmuar të një konsumatori. E tëra që një konsumator duhet të bëjë është që të zgjedh produktin e tij të preferuar në internet, të sigurojë adresën e dorëzimit në faqen on-line dhe ta bëjë pagesën qoftë përmes llogarisë on-line, qoftë përmes debitit ose kartës së kreditit.

3.3 Arritja e gjerë

Marketingu në internet është i aftë të mbulojë hapësira të gjera gjeografike, të cilat nuk janë të mundshme përmes marketingut tradicional. Një konsumator mund të

shijojë shërbimet e marketingut on-line në të gjitha fushat ku shfrytëzimi i internetit është i disponueshëm.

3.5 24x7 marketing

Përkundër dyqaneve tradicionale të cilat bëhen të pashfrytëzuar gjatë natës dhe gjatë pushimeve, një konsumator mund të porosis për produktin e tij të dëshiruar edhe gjatë natës dhe në pushime përmes marketingut on-line.

4. Problemet e marketingut online

Një monedhë ka dy fytyra, dhe marketingu on-line nuk bën përjashtim nga kjo. Përkundër një numri të avantazheve të cilat janë vërtetuar nga marketingu on-line për konsumatorët, ekzistojnë disavantazheme të cilat përballen një konsumator përmes marketingut on-line. Disavantazhet kryesore me të cilat përballen konsumatorët përmes marketingut on-line mund të paraqiten si në vijim:

4.1 Jo i përshtatshëm për konsumatorët e pa-arsimuar

Marketingu on-line mund të përdoret vetëm nga konsumatorë të arsimuar dhe po ashtu nga konsumatorët që posedojnë njohuri për kompjuterët.

4.2 Nuk është i përshtatshëm për konsumatorët që banojnë në zona që nuk kanë lidhje në internet

Marketingu në internet është i përshtatshëm vetëm për konsumatorët që banojnë në rajone që kanë lidhje interneti. Interneti është qendra kryesore për të gjitha transaksionet on-line. Në mungesë të lidhjes në internet, një konsumator nuk do të jetë në gjendje të blejë në internet.

4.3 Jo i përshtatshëm për Produkte që prishen

Marketingu në internet nuk merret me produkte që prishen si qumështi, buka, vezët dhe sendet e tjera të ngrënshme.

4.4 Asnjë mundësi e provës përpara blerjes

Ndërsa kundër sistemit tradicional të marketingut, marketingu on-line nuk ofron një mundësi për të provuar dhe prekur produktin përpara blerjes. Për shembull, një konsumator që blen një këmishë nga një dyqan on-line mund të mos jetë në gjendje ta prekë atë dhe ta provojë në mënyrë që të provojë cilësinë dhe përshtatjen e tij.

5. Rritja e marketingut në internet në Kosovë

Në vitin 2011, baza e përdoruesve të Kosovës në internet vlerësohej të ishte 169.318 mijë. Në vitin 2010 tregu i e-tregtisë në Kosovë me vlerë rreth 572.3 mijë \$. Në vitin 2013, vlera e tregut të e-tregtisë në Kosovë u ngrit deri në 630.6 mijë \$. Linja online e blerësve në Kosovë u vlerësua të ishte 820.5 milion në 2014 dhe parashikohet të tejkalojë 14 milion deri në fund të vitit 2016. Aspektet kryesore të njohjes për-shkallëzuese të marketingut on-line në Kosovë përfshijnë:

- Rritja e popullsisë me një ritëm më të shpejtë.
- Një numër shumë i madh i përdoruesve të internetit në Kosovë
- Rritje e vazhdueshme e standardit të jetesës në shoqërinë kosovare.
- Përmirësim i vazhdueshëm i shpejtësisë së internetit me ardhjen e broadband për laptopë dhe desktop.
- Rritje e vazhdueshme dhe e jashtëzakonshme e numrit të përdoruesve të smartphone.
- Shpejtësi në internet për telefonat inteligjentë me ndihmën e shërbimeve 3G dhe 4G.
- Disponueshmëria e një game të gjerë të mallrave dhe shërbimeve në krahasim me dyqanet tradicionale.

6. Barrierat e marketingut online në Kosovë

Kosova aktualisht renditet në vendin e 32-të në Europë (në vend të 95-të në rang botëror) për nivel përdoruesish të shërbimeve të Internetit. Ndërsa, në rajonin e Ballkanit renditet në vendin e 4-të, pas Greqisë (anëtare e BE-së), Turqisë dhe

Kroacisë (vende kandidatë përantarësim në BE), dhe atë para Shqipërisë dhe Maqedonisë. Kosova për momentin llogaritet të ketë më shumë se 120.000 mijë abonentë Interneti dhe kjo shifra po rritet ditë-ditë. Pengesa kryesore e rritjes së duhur të marketingut on-line në Kosovë mund të na përmbledhet nën:

6.1 Shkalla e lartë e aftësisë

Një nga faktorët kryesorë që është përgjegjës për rritjen e ngadaltë të marketingut on-line në Kosovë është shkalla e lartë e analfabetizimit. Ende sot një popullsi që jeton në Kosovë respektivisht në zona rurale ose të largëta, midis këtyre zonave ka rajone të caktuara ku qasja në arsim është e ulët dhe më pak e papërfillshme.

6.2 Qasje më e ulët në edukimin e përdorimit të kompjuterëve

Për të kryer transaksione në internet marketing duhet të keni njohuri të duhura për kompjuterin. Në Kosovë qasja ndaj njohurive kompjuterike veçanërisht e ulët në zonat rurale dhe të largëta.

6.3 Jo i përshtatshëm në Rajone të ngadalta të Internetit

Marketingu në internet është i përshtatshëm vetëm për rajone me shpejtësi më të lartë të internetit. Shkarkimet që zgjasin në internet për shkak të lidhjeve të ngadalta mund të çojë në humbjen e interesit të konsumatorit për të blerë produkte në internet. Në Kosovë ka akoma shumë zona ku nuk ofrohet shpejtësi e lartë e internetit.

6.4 Mungesa e besimit

Mungesa e besimit për mënyrën e pagesës në internet është një faktor tjetër përgjegjës për rritjen e ngadaltë të marketingut on-line në Kosovë. Shumë konsumatorë në Kosovë ende nuk i besojnë mënyrës elektronike të pagesës për shkak të së cilës ata detyrohen të anulojnë blerjen në internet.

6.5 Kërcënimi i harkimit

Hakerat kompjuterikë përbejnë një kërcënim të madh për marketing në internet. Këta hakerë mund të vjedhin të dhëna të çmuara nga sistemet e dyqaneve on-line.

7. Përfundimi

Ky punim përpiqet të bëjë një analizë të thellë të aspekteve të ndryshme që lidhen me marketingun në internet. Një monedhë ka dy fytyra dhe marketingu on-line nuk bën përjashtim nga kjo fjalë e urtë dhe e vjetër. Një aspekt i këtij punimi është të studiojë avantazhet dhe disavantazhet e marketingut on-line për konsumatorët. Nga njëra anë ajo heq avantazhe të caktuara nga konsumatorët siç është i përshtatshëm vetëm për konsumatorët që posedojnë njohuri kompjuterike dhe për më tepër, ai nuk ofron një mundësi për konsumatorin p.sh. një ulje të çmimit, duke kursyer kohën dhe punën e konsumatorit, disponueshmërinë e shumëllojshmërisë gjigande të produkteve nën një çati etj. Diskutimi i mësipërm sqaron se marketingu on-line është një përfitim për konsumatorët pasi që me ndihmën e marketingut on-line "konsumatorët tani mund të shijojnë blerjet edhe kur nuk janë në dyqan"

Aspekti tjetër i këtij punimi është të shqyrtojë portat dhe kurthet e marketingut on-line në Kosovë. Ekzistojnë disa faktorë që janë përgjegjës për rritjen e kohës së lirë të marketingut on-line në Kosovë, siç janë niveli i lartë i analfabetizmit, qasja më e ulët në arsimimin për përdorimin e kompjuterëve, mungesa e shpejtësisë së duhur të internetit në rajone të caktuara etj. Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë, të cilët po rritin sasinë e konsumatorëve të marketingut on-line në Kosovë, siç është rritja e rregullt e numrit të personave që përdorin kompjuterë, smartphone dhe internet, vazhdimi i rritjes së standardit të jetesës, përmirësimi i shpejtësisë së internetit me ardhja e shërbimeve me shpejtësi të lartë dhe 4G etj. Për shkak të këtyre avantazheve, marketingu në internet po fiton popullaritet të pandërprerë në Kosovë sot dhe gjithashtu do të përdoret gjerësisht në të ardhmen. Investimi zero në dyqanet fizike në mbarë globin është një përfitim kryesor që ofrohet nga marketingu on-line i cili tndon ndërmarrësit e rinj në Kosovë për të filluar dyqanet e tyre on-line të marketingut.

Bibliography

- Beqiri, D. (2020). *Interneti-Komunikimet kompjuterike*. Pejë: Kolegji Dukagjini.
- Berisha, M. (2004). *Informatika e biznesit* . Pejë: Dukagjini.
- Berisha, M. (2005). *Biznesi elektronik*. Pejë: Dukagjini.
- Charak, K. (2017). Online Marketing - The challenges and Perspective in Indian Market . *AJANTA* , 131-138.
- Mustafa, M. (2004). *Informatika e Biznesit*. Prishtinë.
- Sylqa, D. (2015). *Shërbimet dhe rëndësia e biznesit elektronik*. Pejë: Kolegji Dukagjini.

KRIZA GLOBALE FINANCIARE. SHKAQET , PASOJAT DHE REAGIMET

Msc. Semra Bujari

s.bujari@eust.edu.mk, International University of Struga

Rezarta Mamudi

r.mamudi@eust.edu.mk, International University of Struga

Abstrakt

Krizat financiare kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha në ekonominë botërore si dhe kanë lënë pasojat të rënda ekonomike dhe sociale. Pas çdo krize financiare janë shfaqur dobësitë e sistemit financiar dhe reformat e kërkuara për të menaxhuar sa më mirë krizat e ardhshme. Qëllimi i këtij punim shkencor është analiza e e efekteve të krizës financiare në ekonominë globale, me fokus në krizën e fundit globale financiare. Në përfundim ky punim konkludon se kriza e fundit globale financiare ka frenuar rritjen ekonomike në ekonominë globale, ka rritur nivelin e papunesisë, dhe ka zvogluar qarkullimin neto në investimet e huaja direkte, si dhe shtjellon dobësitë e sistemit global financiar që është shfaqur si rezultat i krizës dhe nevojës për një arkitekturë të re për t'iu përgjigjur sfidave të ardhshme në menyrën më të duhur.

Historikisht, pasojat dhe efektet e krizës financiare kanë qenë të përmasave shumë të mëdha dhe disa herë të pa-menaxhueshme dhe si rrjedhojë, kanë lënë pasojat tepër të rënda në aspektin social dhe ekonomik. Pas të gjitha krizave financiare është vërejtur se kthimi në normalitet dhe balancë është jo i lehtë për vendet, qeveritë, si dhe regjionet që janë goditur, si pasojë e krizës financiare. Përvojat e hidhura të krizave financiare përkundër avancimeve të shkencës financiare, forcimit të vazhdueshëm të mbikqyrjes së sistemit financiar, pagave të majeve të bankierëve, ekspertëve financiar dhe ekonomistëve, kanë reflektuar, se e gjithë kjo gamë e njerëzve me një ekspertizë të pakontestueshme ka dështuar vazhdimisht në parashikimin dhe ndalimin e krizave.

Fjalë kyçe: kriza globale, ekonomia, papunsia, tregjet, aktiviteti ekonomik.

Hyrje

Gjatë historisë ka pasur shumë lloje të goditjeve që kanë ulur prodhimin në një ekonomi në afat të shkurtër, apo shembujt që përfshijnë rritjen e taksave, uljen e besimit të konsumatorit, rritja e çmimit të naftës, etj. Megjithatë, një lloj shoku është veçanërisht shkatërrues për një ekonomi siç është kriza financiare.

Krizat nuk janë fenomen i ri që prekin botën financiare nëse i shikojmë prej një perspektive historike. Krizat financiare kanë ndodhur ndër shekuj me radhë, kanë reflektuar dobësitë në sistemin financiar në kuptimin e legjislacionit, menaxhimit, spekulimeve si dhe kufizimet që lejon 'kreativiteti financiar'.

Kriza financiare është një situatë në të cilën vlera e institucioneve financiare ose pasurive bie shumë shpejt. Kriza financiare është e lidhur shpesh me panik ose një situatë në bankat, në të cilën investitorët shesin pasuritë ose të tërheqin paratë nga llogaritë e kursimeve duke pritur që vlera e këtyre pasurive do të bjerë nëse ato do të vazhdojnë të qëndrojnë në atë institucion financiar.

Kriza ekonomike është një situatë në të cilën ekonomia e një vendi përjeton një rënie të papritur e shkaktuar nga kriza financiare. Një ekonomi që përballë me krizë ekonomike më shumë gjasa do të sjellë një rënie të PBB (eng. GDP), një tkurrje të likuiditetit dhe rritje/rënie të çmimeve për shkak të inflacionit/deflacionit. Kriza ekonomike mund të marrë formën e një recesioni apo depresioni. Kriza ekonomike ndryshe quhet krizë e ekonomisë reale.

I. Krizat globale financiare

Krizat globale financiare definoohen si recesion global "një rënie e PBB-së reale vjetore për kokë banori (pesha e barazisë së fuqisë blerëse) e mbështetur nga një rënie ose përkeqësim të një ose më shumë nga shtatë treguesit e tjerë makroekonomikë globalë: Prodhimi industrial, tregtia, flukset e kapitalit, konsumi i naftës, shkalla e papunësisë, investimi për kokë banori dhe konsumi për kokë banori. Sipas këtij përkufizimi, që nga Lufta e Dytë Botërore ka pasur vetëm katër recesione globale (në 1975, 1982, 1991 dhe 2009), të gjitha këto zgjasin për afërsisht një vit.

Krizat financiare globale lënë pasojë të rënda edhe në tregun e punës. Me fillimet e krizave por edhe disa vite apo dekada pas tyre, rritja e papunësisë në nivelin global është vazhdimisht në rënie. Në periudhën e krizës së vitit 2012, numri total i të papunëve në botë kapi shifrën prej 197 milion njerëzve. Gjithashtu, diku rreth 39 milion të tjerë kanë dalë nga vendet e punës për arsye se ato perceptoheshin të paqëndrueshëm. Që nga fillimi i krizës globale deri në ditët e sotme diku 69 milion vende të punës janë shuar. Është projektuar që në vitin 2013 edhe 5.1 milion njerëz do të humbin vendet e punës si dhe në vitin 2014 edhe 3 milion të tjerë.

Nga ky numer i lart i humbjes së vendeve të punës, përqindja me e madhe e tyre ishte nga vendet me ekonomi të zhvilluar ndërsa pjesa tjetër nga një pjesë e Azisë dhe Afrikës. Mirëpo këto të fundit kanë arritur të frenojnë humbjen e mëtutjeshme të vendeve të punës, por si pasojë ato u përballën me përkeqësimin e kushteve të punës, kualitetit të punës si dhe numërit në rritje të njerëzve të punësuar që jetojnë nën apo afër nivelit të varferisë. Recesioni i vazhdueshëm në Evropë si dhe rënia e nivelit të aktivitetit ekonomik ka patur efekte në pjesët tjera të botës për shkak të zvoglimit të tregtisë ndërkombëtare që ka ardhë si rezultat i rënies së fuqisë blerëse në Evropë dhe tendencës së uljeve të shpenzimeve si përgjigjje ndaj krizës. Për më shumë, inkoherenca e adaptimit të politikave fiskale dhe politikave monetare brenda Eurozonës, problemet me borgjin sovran kanë stopuar dhe shtyer investimet e planifikuara nga Korporatat jo vetëm në Evropë, por gjithashtu në SHBA, Kinë, dhe Japoni.

Si rezultat i kësaj gjendje, Korporatat në vend se të investojnë në kapacitete të reja dhe të punsojnë punëtorë të rinj, ato kanë vendosur të rrisin mbajtjen e parasë së gatshme apo pagesat në dividenda për aksionarët e tyre.

Ndër industritë më të prekura nga Kriza janë ato të orientuara në eksporte. Vendet e reja të punës që janë krijuar kanë kërkuar aftësi dhe kompetencë që të papunët nuk qenë në gjendje që të zotrojnë (ILO, 2013). Grafikoni i ilustruar më poshtë tregon se kriza financiare ka patur efekt negativ në PBB në nivelin global sipas statistikave të Bankës Botërore. Nga 4 % sa ka qenë rritja e PBB-së në vitin 2007, në vitin 2008 ka qenë negative 2 %. Rritja e PBB-së edhe pse ka patur tendencë pozitive ende nuk ka arritur balancën e kohës së para krizës.

Vlenë të analizojmë edhe kriza e vitit 1973 - 1974, kjo për shkak të përmasave të mëdha globale që ka pasur kjo krizë dhe ndikimin e saj në rritjen e çmimit deri në 4herë më shumë. Kjo rritje enorme e çmimit të naftës që shkaktoj drejtë për drejtë krizë globale ishte si rezultati i ndryshimeve politike në botën arabe, ku vlen të theksohet lufta ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, embargoja e Arabisë Saudite ndaj vendeve që përkrahin ushtarakisht shtetin e Izraelit dhe vendosja e diktaturave në disa vende arabe (si p.sh në Libi, etj), (Ilie, L., 2006). Këto ndryshime politike dhe ushtarake patën efektin e saj të menjëhershëm në ndryshimin e çmimit botëror të naftës dhe kjo sigurisht prodhoj një krizë financiare dhe ekonomik në nivel botëror. Me rrënimin e murit të Berlin-it dhe të shpërbërjes së ish-BRSS në fund të viteve të 80-ta, u rrënuar pothuajse i tërë sistemi i ekonomisë totalitare apo centraliste që ka ekzistuar në botë deri në atë kohë dhe në shumë vend filloi procesi i transformimit drejt ekonomisë së tregut të lirë (sistemit kapitalistë). Ky ndryshim i ekonomisë globale u prit me shpresën të madhe se ekonomia globale po shkon drejtë një konsolidimi të një sistemi ekonomik kapitalistë (si modeli ekonomik më i

arsyeshëmi kohës moderne) por edhe drejtë një stabilitetit dhe rritje të vazhdueshme ekonomike.

Mirëpo njëkohësisht janë shfaqur edhe shenjat e para të një krize ekonomike dhefinanciare, që ishte paralajmëroj nga Paul Krugman qysh në vitin 1989, (më vonë në vitin 2008 ky ishte fitues i çmimit nobel, pikërisht për meritat e tij ndaj kësajkrize) por paralajmërimi i Krugman-it “se një krizë e madhe financiare globale sikurse ajo e viteve 1929 - 1933 mund të na godet përsëri” në atë kohe nuk tërhoqi vëmendje e opinionit botëror dhe që më vonë do jetë krizë e pashmangshme.

Përgjatë historisë së krizave financiare, secila krizë ka ofruar një leksion të dobishëm për t’ju përgjigjur krizat në të ardhmen. Duke marrë parasysh se 75 % e vendeve anëtare të FMN-së nga vitit 1980 janë ballafaquar me probleme të mëdha në sistemin bankar por që kanë arritur të dalim nga ato kriza dhe prej tyre të nxjerrin rekomandime të domosdoshme andaj duke u mbështetur në këto leksione dhe përvojat e tyre nga kriza, këto vende vazhdimisht janë përgatiten për t’i sfiduar krizat emundshme financiare.

Andaj jo rastësisht Louis Pasteur në (Skreb, M. & Kraft, S.,2002) ka thënë se: “*Fati i favorizon të përgatiturit*”, pra nga këto kuptojmë se ato vendetë cilat kanë kaluar nëpër kriza të ndryshme financiare vazhdimisht përpigjen që të stabilizojnë sistemin e tyre financiar dhe të përgatiten për krizat e mundshme financiare. Por në anën tjetër, siç argumenton (ILO Report, 2011) masat kundërkrizës të ndërmarr nga qeveritë e vendeve të zhvilluara nuk kishte për qëllim vetëmbështetje në rimëkëmbjen e ekonomisë por edhe shmangien enorme të rritjes së papunësisë dhe ky efekt në papunësi pati efektin e vet në mes të vitit 2010.

II. Shkaqet e krijimit të krizave globale financiare

Kriza financiare e vitit 2008-2010 ka patur efekt negativ në investimet e huaja direkte në botë. Sipas të dhënave të Bankës Botërore të cilat reflektohen në grafikonin e paraqitur më poshtë, nga shpërthimi i krizës ka patur rënie drastike të IHD-ve në nivelin global duke arritur pikën më të ulët në vitin 2009. Rënia me e theksuar ka qenë në vendet të cilat kanë qenë më të prekura dhe me të ekspozuara nga kriza. Në SHBA në vitin 2008 kishte total IHD-de prej \$ 332 miliard, ndërsa në vitin 2009 totali i IHD-ve ka zbritur në \$ 152 miliard apo për rreth 50% me pakë. Të njëjtën rënie të investimeve ka patur edhe Japonia, dhe Greqia si vendi me i goditur i Eurozonës gjatë krizës financiare. Pothuajse të gjitha shtetet Evropës të cilat janë pjesë të Eurozonës kanë patur rënie në IHD, duke përfshirë edhe Indinë, Pakistanin, Federatën Ruse dhe Kinën. Gjithashtu, edhe Kosova nuk ishte immune nga kriza në

kuptimin e IHD-ve ku nga \$ 536 milion në vitin 2008, ne vitin 2009 totali i IHD-ve u zvoglua në \$ 408 milion.

Tabela 1 Historiku i krizave financiare nëpër vendet e ndryshme (1870 - 2008)

Australia	1893	1989							
Kanada	1873	1907	1923						
Zvicra	1870	1910	1931	2008					
Gjermania	1873	1891	1901	1907	1931	2008			
Danimarka	1877	1885	1902	1907	1921	1931	1987		
Spanja	1883	1890	1813	1920	1924	1931	1978	2008	
Franca	1882	1889	1907	1930	2008				
UK	1873	1890	1974	1984	1991	2007			
Italia	1873	1887	1891	1907	1921	1930	1935	1990	2008
Japonia	1882	1900	1904	1907	1913	1927	1992		
Holanda	1893	1907	1921	1939	2008				
Norvegjia	1899	1922	1931	1988					
Suedia	1878	1907	1922	1931	1991	2008			
SHBA	1873	1884	1893	1807	1929	1984	2007		

Tri (3) krizat financiare që kishin një shtrirje më të vogël si në dëmeekonomike ashtu edhe pasoja financiare janë si vijon:

1) Kriza e vitit 1966 - e njohur si kriza e parë financiare në kohën moderne. Kjongdodhi gjatë përpjekjes së FED për një politikë monetare restriktive, ku panikui krizës ishte i madhe. Kriza u përhapë shumë shpejt mbi kredit e dhëna tëbizneset pastaj në gjithë tregun e kredive.

2) Kriza e vitit 1969 – u shkaktua kur bizneset filluan të ofronin letra afatshkurtame vlerë dhe kriza u përhapë shpejtë kur kompania hekurudhore Penn Centraldeklaroi falimentimin pastaj tek të gjithë mbajtësit e letrave komerciale u përhappaniku financiar që u reflektua me krizë;

3) Kriza e viteve (1986 - 1992) - krijimi i një mjedisi jo të mjaftueshëm të mbikëqyrjesbankare, vështirësitë e përgjithshme ekonomike dhe mungesa e një koordinimiperfekt të politikës monetare dhe fiskale, ka bërë që 118 institucione të depozitavetë kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje financiare me vlerë 3.8 miliard \$;

Ndër (3) kriza të mëdha që janë identifikuar me një shtrirje të gjerë gjeografike dheme pasoja të mëdha si në tregjet financiare, kapitale por edhe të konsumit janë si vijon:

1) Kriza e viteve (1929 - 1933) – ishte si pasoj e rritjes marramendëse të vlerës së kredive për konsum të lirë brenda një dite (29 Tetori i vitit 1929), kjo ka shkaktuar rritjen e panikut tek pronarët e letrave me vlerë pastaj zhvlerësimi i këtyre letrave me vlera ka qenë shumë i shpejtë (Milana, V. & Vasile, C., 2010), Andaj faktorët kryesor të përhapjes së kësaj krize janë:

a) Ekspansioni i kredive duke ndikuar me rritjen e kërkesës për kapitale;

b) Rritja e proteksionizmit ndikoj në rënien ekonomik dhe të papunësisë deri në 25 %;

c) Rënia e industrisë së ndërtimit në 1926 - 1929 (u përcaktua si faktorkryesor i krizës);

d) Ulja e çmimeve për prodhimet primar dhe ato industriale, etj.

2) Kriza e naftës në vitin 1974 - kjo krizë pasqyron një rën nga tri (3) krizat që janë goditur nga nafta në tregun global (e dyta është më 1979, si rezultat i revolucionit Iranian; e treta në fillim të viteve të 90-ta, si rezultat i ndërhyrjes së SHBA-ve në luftë ndaj Irak-ut). Krizë e vitit 1974 kishte përmasa mjaft të mëdha dhe ndryshe ka qenë e njohur për shkak të mungesës së naftës në tregun global andaj sipas disa përlllogaritjeve nga OPEC-ut (kryesisht nga vendet arabe) zvogëlimi i sasisë së gjithëmbarshme ka arritur deri në 20 %, (Verleger, P. K., 2000).

3) Kriza financiare globale (2007 - 2008) - kjo krizë ka filluar në SHBA, ku bankat I thellonin borxhet të këqija “të pakthyeshme” në tregjet e kapitale apo patundshmërisë” dhe kjo është vlerësuar me dëme dhe pasoja shumë të mëdha dhe i detyruar drejtë çrregullimit të tregjeve financiare deri tek recesioniekonmik global dhe në falimentimit e shume banka të fuqishme që kishin ndikim mjaft të madhe në tregun financiar global.

Konkluzione

Duke u bazuar në analizën teorike të këtij hulumtim, kuptojnë se efekti i krizave financiare nëpër ekonominë e vendeve të ndryshme ka qenë i pranishëm por që pasojat e krizave në të kaluarën kanë qenë më të vogla nëse e krahasojmë me krizën fundit financiare të vitit 2008. Marr në tërësi, krizat financiare kanë ardhur si pasojë e rritjes së çmimeve të vazhdueshme nëpër tregje të ndryshme (si në tregjet e naftës, tregjet hipotekare, tregjet e letrave me vlerë, etj) deri tek ngopja e këtyre tregjeve dhe de-

rregullim total i sistemit ekonomik si në nivel vendesh, rajonesh deri tek niveli global.

Nga ky hulumtim i këtyre krizave përgjatë këtyre shekujve të fundit, kemi marr një leksion të dobishëm se të gjitha vendet e zhvilluar si edhe ato që janë në zhvillim duhet të mobilizohen bashkërisht potencialet e tyre ekonomikedhe politike (si në nivel shtetesh, rajonesh dhe në nivel global) për t'i tejkaluar sfidat, vështirësitë dhe pasojat që po sjellim krizat. Sa do e vogël të jetë një krizë(nivel shteti) pasoja do të janë përtej parashikimeve dhe kjo krizë po rrezikonmirëqenien me përmasa mjaft të mëdha (p.sh kriza aziatike kishte efektin e saj edhe në ekonominë evropiane). Pra, është momenti i unifikimit të politikës globale dhe qytetërimit moderne përballë sfidave globale siç janë krizat ekonomike dhe financiare.

Literatura e shfrytëzuar :

- Campello, M. and Graham, J. and Harvey, C. (2010). " The real effects of financial constraints: Evidence from a financial crisis " Vol 97. pp. 470-487.
- Civici, A. (2011). " Iluzionet Monetare: Mashtrimet e Medha. " Obra GVG.
- Collyns C (2008). " The crisis through the lens of history". Finance and Development, Vol 45, pp. 18– 20.
- Dominguez, K. and Hashimoto, Y. and Ito, T. (2012). " International reserves and the global financial crisis" Jurnal of International Economics Vol 88 Nr 62.
- Giannone, D., M. Lenza and L. Reichlin (2010). " Market freedom and the global recession. " London Business School.
- International Monetary Fund (2009). " Lessons of the Global Crisis for Macroeconomic Policy. " IMF Research Department, Washington, DC.
- ILO (2013). Global Employment Trends 2013. International Labour Organization. Yearly Report.

NDIKIMI I EKSPORT-IMPORTEVE NE RRITJEN EKONOMIKE GJATË DHE PAS KRIZËS EKONOMIKE 2008-2011.

Phd. Cand. Jorida Koçibelli

Fakulteti i Ekonomisë

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

E-mail: agollijorida@gmail.com

ABSTRAKTI:

Ky punim prezanton në mënyrë sintetike ecurinë e importeve dhe eksporteve gjatë dhe pas krizës financiare. Gjithashtu për periudhen e marrë në shqyrtim eksporti dhe importi kanë pasur ndikim negativ dhe të parëndesishëm në rritjen ekonomike. Qëllimi i këtij studimi është analiza dhe roli që ka luajtur bilanci tregtar gjatë krizës financiare, në drejtim të përmirësimit të rritjes ekonomike. Analiza e detajuar e bilancit në situatë recensionare ndihmon studiuesit dhe vendimarrësit që të ndërmarrin politika të duhura dhe efëçente për të stabilizuar ekonominë në një kohë relativisht të shkurtër.

Rritja e eksporteve çon në një përmirësim të standardit të jetesës. Kjo në tërësi shkakton një sërë efektesh zinxhir si: rritje të aksesit në monedha, gjë që rrit të ardhurat kombëtare, rrit qarkullimin dhe tepricat e shtetit; përmirëson teknologjinë dhe rrit në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e produkteve; rrit kërkesen agregate për këtë kategori mallrash si dhe indirekt rrit edhe punësimin. Importet, ndryshe nga eksportet, çojnë në daljen e monedhës vendase dhe dobësojnë bilancin tregtar, duke dobësuar kështu rritjen ekonomike.

Në këtë punim janë përdorur të dhënat sasiore të eksporteve, importeve në përqindje të PBB-së si dhe të dhëna të detajuara të bilancit tregtar sipas grupmallrave.

Fjalët kyçe: Eksport; Import; Rritje Ekonomike; Kriza Financiare.

HYRJE

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve shihen si një promotor i zhvillimit ekonomik dhe social. Eksportet u kërkojnë kompanive të përtërijnë dhe të përmirësohen për të ruajtur pjesën e tregut. Nga ana tjetër, eksportet sigurojnë rritje të shitjeve dhe fitimeve. Ato minimizojnë ndikimin e paqëndrueshmërisë së tregut, duke punuar në tregjet globale, kompanitë bëhen më të vëmendshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, ndryshimit të kërkesave të klientëve dhe luhatjeve sezonale në ekonominë lokale.

Pas periudhës së krizës, Shqipëria ka pasur një bilanc negativ tregtar edhe me vendet e Rajonit. Open Data Albania²⁴ ka realizuar një hulumtim mbi eksportet dhe importet, sipas shteteve duke evidentuar bilancin tregtar të Shqipërisë me këto vende. Eksportet shqiptare drejt shteteve fqinje jo anëtare të BE-së 2013, kanë ardhur vazhdimisht në rritje, por kjo nuk ka çuar në një bilanc pozitiv.

Në fund të vitit 2013, bilanci tregtar me fqinjët arriti në -25.7 miliardë lekë, duke shënuar rënie kundrejt vitit 2012 si pasojë e zgjerimit të eksporteve dhe njëkohësisht tkurrjes së importeve. Në total, eksportet e Shqipërisë drejt vendeve të Rajonit në fund të vitit 2013 arritën në rreth 29.5 miliardë lekë, duke përbërë rreth 12% të totalit të eksporteve të vendit, çka thekson një shkëmbim të limituar tregtar me 'fqinjët'. Eksportet kanë shënuar rritje kundrejt vitit 2012, duke u zgjeruar me 3%. Importet, nga ana tjetër kanë shënuar rënie në vitin 2013 pasi arritën nivelin maksimal një vit më parë. Në

²⁴ OPEN DATA ALBANIA, *Eksportet, importet dhe bilanci tregtar sipas grupmallrave, 2016*

total, në fund të vitit 2013, u importuan 55.2 miliardë lekë mallra e shërbime nga shtetet fqinje, me një rënie vjetore prej 10%.

Sipas të dhënave të analizuara, peshën më të lartë të eksporteve të vendit tonë e zë kategoria “Tekstile dhe këpucë”, e cila zë rreth 44% të totalit të eksporteve. Nga 243.5 miliardë lekë që shënojnë eksportet totale në vitin 2016, 106.6 miliardë lekë janë eksporte të kategorisë “Tekstile dhe këpucë”. Eksportet e kësaj kategorie shtatë vitet e fundit janë rritur mesatarisht me 12% çdo vit.

Një tjetër grupmallrash me vlerë të konsiderueshme eksporti është kategoria “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”. Vlera e eksportit të kësaj kategorie është rritur mesatarisht 30% çdo vit në vitet 2010-2013, për të pësuar rënie me 22% mesatarisht çdo vit në vitet 2014-2016. Në vitin 2016 Shqipëria ka eksportuar 46.6 miliardë lekë minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike.

1. Hulumtimet e mëparshme bashkëkohore mbi impaktin e bilancit tregtar në rritjen ekonomike

Një larmi studimesh tregojnë rezultate të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet e këtyre tre variablave. Kohët e fundit, shumica e studimeve kanë marrë pjesë për t'u përqëndruar në modelet VAR dhe VEC dhe qasjen e kointegrimit. Rishikimi i literaturës është i kufizuar në studime që përqëndrohen në ndikimin e përbashkët të eksportit dhe importit në rritjen ekonomike.

Kështu, çdo përkeqësim i termave të tregtisë (pra, çdo ulje e vlerës së eksporteve ndaj asaj të importeve) nënkupton më shumë dalje parash nga vendi dhe rrjedhimisht edhe rënie në kursime e të gjitha këto bashkë mund të godasin bilancin e llogarisë rrjedhëse (Calderon et al, 2000 & Aristovnik, 2006b).

Rodrigue Tremblay (1990) ne studimin e vet propozoi që përmirësimet e veçanta të produktivitetit dhe rritjes janë rezultat i rritjes së eksporteve dhe importeve, veçanërisht në sektorin e prodhimit, por që rritjet e qëndrueshme të rritjes mund të shfaqen vetëm përmes diversifikimit industrial.

Ramos, F. F. R. (2002) hetoi rastin e shkakësisë midis eksporteve, importeve dhe rritjes ekonomike në Portugali gjatë periudhës 1865-1998. Rezultatet empirike nuk konfirmojnë një kauzalitet nje- drejtimesh midis variablave të konsideruar. Ekziston një efekt kthyes midis rritjes së eksporteve-prodhimeve dhe rritjeve të importeve- prodhimeve. Më interesant, nuk ka asnjë lloj shkakësie të konsiderueshme midis rritjes së import-eksportit. Të dy rezultatet duket se mbështesin përfundimin se rritja e prodhimit për ekonominë portugeze gjatë asaj periudhe zbuloi një formë të shoqëruar me një ekonomi të vogël të dyfishtë në të cilën transaksionet brenda-industrisë ishin shumë të kufizuara.

Dilawar Khan and al. (2012) rezultatet e bazuara në modelin Enor-Conection tregojnë ekzistencën e korrelacionit afatgjatë midis eksporteve, importeve dhe rritjes ekonomike. Të dy, eksportet dhe importet konsiderohen si një pjesë thelbësore për rritjen ekonomike të Pakistanit. Për më tepër, rritja ekonomike ka një ndikim të rëndësishëm në eksportet dhe importet. Një rritje e suksesshme dhe e qëndrueshme ekonomike kërkon rritje të eksporteve dhe importeve.

Taghavi, M., Goudarzi, M., Masoudi, E., & Gashti, H. P. (2012) rezultatet empirike konfirmuan një lidhje afatgjatë midis variablave të konsideruar. Bazuar në rezultatet, eksporti kishte lidhje direkte dhe pozitive me rritjen ekonomike në planin afatgjatë. Gjithashtu importi kishte një lidhje të konsiderueshme dhe negative me rritjen ekonomike, atëherë importi kishte efekt negativ në rritjen ekonomike në planin afatgjatë. Gjithashtu konkluduan

se një goditje në eksport ka pasur një efekt pozitiv në rritjen ekonomike; nga ana tjetër një goditje në termin e gabimit të importit nuk kishte shumë efekt në rritjen ekonomike, kështu që një goditje në import nuk mund të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike

Sayef Bakari, Mabrouki Mohamed (2017) - hetoi marrëdhëniet midis eksporteve, importeve dhe rritjes ekonomike në Panama. Për të arritur këtë qëllim, të dhënat vjetore për periudhat midis 1980 dhe 2015 u testuan duke përdorur analizën e bashkë-integritit të Johansen të Modelit të Regresimit Automatik Vektor dhe testet Granger-Causality. Sipas rezultatit të analizës, u përcaktua se nuk ka asnjë lidhje midis eksporteve, importeve dhe rritjes ekonomike në Panama. Nga ana tjetër, u zbulua se ekziston një dëshmi e fortë e kauzalitetit dydrejtimësh nga importet në rritjen ekonomike dhe nga eksportet në rritje ekonomike. Këto rezultate japin prova se eksportet dhe importet, shihen si burimi i rritjes ekonomike në Panama.

Mitra Lal Devkota (2019) testoi marrëdhënien midis eksporteve, importeve dhe rritjes ekonomike dhe konkludoi se rezultatet nga VECM tregojnë se ekziston një lidhje kauzale një-drejtimore që kalon nga rritja ekonomike në import në Indi. Kjo nënkupton që me një rritje në të ardhurat e kombit, shpenzimet e kombit do të rriten dhe një pjesë e shpenzimeve do të jetë në import.

2. Ecuria e Ekport- Importeve në Shqipëri

Në vitin 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 310 mld lekë, duke u rritur me 13,7 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 641 mld lekë, duke u rritur me 2,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 331 mld lekë, duke u ulur me 6,3 %, krahasuar me 2017. Eksportet, gjatë këtij viti janë rritur me 13,7 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +4,9 pikë përqindje,

“Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Në mënyrë të përmblodhur Bilanci tregtar sipas grup mallrave jepet në tabela më poshtë:


Tabela 1: Bilanci tregtar sipas grupmallrave, 2010- 2016 (në mln lekë)

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Ushqime Pije, Duhan	-77.635	-80.776	-80.358	-78.773	-77.224	-75.830	-75.018
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	-28.673	-43.493	-34.330	6.761	-4.341	4.341	-3.279
Produkte kimike; plastike	-54.557	-58.160	-63.999	-65.370	-69.525	-70.965	-75.650
Lëkurë, artikuj prej lëkure	-5.817	-6.497	-6.951	-8.200	-11.243	-13.400	-15.593
Prodhime druri dhe letre	-15.636	-15.861	-12.748	-12.300	-13.741	-13.400	-15.593
Tekstile dhe këpucë	9.913	13.607	13.772	15.237	22.939	20.791	26.637
Materiale ndërtimi dhe metale	-44.086	-40.798	-27.846	-27.133	-33.697	-32.261	-44.111
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-85.943	-101.957	-90.271	-90.271	-96.455	-106.491	-119.681
Të tjera	-13.786	-13.171	-12.873	-10.938	-13.217	-14.589	-14.275
BILANCI TREGTAR (Eksport-Import)	-316.220	-347.107	-315.460	-270.987	-296.505	-301.423	-335.751

Burimi: Përpunimi i autorit, të dhënat INSTAT.

Pas një paraqitje të detajuar të bilancit sipas grupmallrave, analizova një paraqitje grafike të importit, eksportit dhe variablave të rritjes ekonomike reale dhe bilancit tregtar në përqindje të variablit të varur që është rritja ekonomike reale.

Grafiku 1: Treguesit e eksportit, importit në % të PBB-së, si dhe rritja reale e PBB-së.



Burimi: Përpunimi i autorit, të dhënat nga INSTAT.

Nga analiza grafike gjatë një dekade rezulton se eksportet, importet dhe rritja reale e PBB-së ndjekin të njëjtin trend. Në fillim të periudhes së krizës financiare pothuajse të gjithë variablat makroekonomike pësuan rënie. Më tepër kjo lëvizje negative u ndje edhe tek marrëdhëniet tregtare të vendit tonë me shtetet që u preken më shumë nga kjo krizë, vende të cilat Shqipëria realizonte volumin më të madh tregtar. Bilanci tregtar i shprehur në përqindje të PBB-së pas viteve të rimëkëmbjes nga kriza ka pësuar rënie nga vlerat negative të raportuara por që historikisht kemi pasur një bilanc ku importet kanë tejkaluar eksportet.

Bazuar në parimet e OBT²⁵-së, Shqipëria ka punuar gjithmonë për liberalizimin dhe lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, duke ndjekur rrugën e integritit rajonal dhe më gjerë, me anë të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, si me grupime vendesh dhe me vende të veçanta. Nga 1 Dhjetori i vitit 2006, në kuadër të MSA-së, ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është në zbatim marrëveshja e tregtisë së

²⁵ *Organizata Botërore e Tregtisë*

lirë. Kjo marrëveshje synoi në integrimin gjithnjë e më të plotë të Shqipërisë me BE-në, ndërkohë që ky grupim është partneri kryesor tregtar dhe ekonomik i vendit tonë.

3. Impakti i fillimit të Krizës Financiare në Ekport- Import

Kriza financiare botërore la efekte në treguesit kryesore makroekonomike edhe në vendin tonë dhe kjo lidhej së tepërmi me ekzistencën e një tregu financiar jo të zhvilluar. Por, duke qenë se ekonomia shqiptare ndodhet ende në stadin e ekonomive në zhvillim dhe ristrukturim, del si domosdoshmëri shfrytëzimi i burimeve dhe avantazheve krahasuese, që ajo ka në raport me ekonomitë e rajonit dhe në nivel më të gjerë. Sipas të dhënave të (ITC)²⁶ në Gjenevë, e cila studion edhe nivelin e tregtisë në shkallë botërore dhe rajonale, Shqipëria u renditit në pozicionin e 138-të për sa u përket eksporteve dhe në pozicionin e 114-të për sa u përket importeve, ndaj 194 vendeve dhe territoreve të studiuara dhe vlerësuara në vitin 2008. Krahasuar me disa vende të tjera, ekonomia e të cilave për nga madhësia dhe stadi i zhvillimit është e përafërt me ekonominë tonë, këto klasifikime tregojnë se ekonomia shqiptare ka ende rezerva dhe potenciale ekonomike të pashfrytëzuara.

Referuar treguesve të shkëmbimeve tregtare për vitin 2009, rezulton se shkalla e hapjes ekonomike, referuar vetëm tregtisë së mallrave me jashtë, është në masën 46.8%, me një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2008 që u arrit raporti më i madh në këto vite, në shifrën 51%. Përbërja dhe struktura e treguesve të tregtisë së jashtme kanë një rëndësi të madhe në bilancin e

²⁶ *Qendra Tregtare Ndërkombëtare në Gjenevë*

pagesave dhe impakteve të tjera ekonomiko- sociale etj, kërkojnë vëmendje më të madhe, si nga ana e qeverisë dhe e të gjithë aktorëve të tjerë.

Metodologjia

Për të parë impaktin që pasur bilanci tregtar gjatë dhe pas krizës botërore, fillimisht kam përdorur programin e SPSS 20, duke testuar rritjen ekonomike për të parë nëse ka shpërndarje normale variabli i supozuar i varur ndaj variablave të pavarur si eksporti dhe importi.

Tests of Normality						
	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Rritja reale PBB	.184	11	.200 [*]	.910	11	.245

*. This is a lower bound of the true significance.

a. Lilliefors Significance Correction

Sipas analizës së testit të normalitetit rezulton se rritja reale ka shpërndarje normale pasi $\text{Sig} > 0.05$. Më pas analizova me anë të modelit të regresionit linear të shumëfishtë për të parë impaktin e variablave në rritjen ekonomike. Për më shumë të dhëna të modelit gjenden në fund të materialit në anekse. Koeficienti $R = 0.575$ tregon që modeli ka fuqi shpjeguese mesatare por lidhja është statistikisht e parëndësishme për periudhën e marrë në studim. Ndikimi i variablave është negativ dhe i parëndësishëm. Në mënyrë ekuacionale paraqitet:

$$\text{PBB} = -19.194 - 0.231\text{Eksport} - 0.706\text{Import}$$

Tabela e rezultateve të përmbledhura të regresionit të shumëfishtë linear:

Variablat në % te GDP	Koeficienti β	Lidhja
Eksportet	-0.231	0.133
Importet	-0.706	0.117

Në këtë periudhe rezultati nuk është i kënaqshëm dhe të dyja variablat ndikojnë negativisht tek variabli i varur që është rritja ekonomike reale.

Shqipëria si një vend me një ekonomi të hapur ka pasur historikisht një deficit tregtar negativ, e cila ka pasur dhe ndikim e vet edhe tek bilanci i pagesave i cili përsëri paraqitet negativ.

Pavarësisht këtij rezultati duhen të bëhen përpjekje për të përmirësuar llogarinë korrente, veçanërisht bilancin tregtar, kryesisht eksportet pasi ekporti është rritje e të ardhurave kombëtare dhe e produktit të përgjithshëm.

Konkluzione dhe Rekomandime

Duhet thënë se defiçiti i llogarisë rrjedhëse është një sinjal i dobishëm për hartuesit e politikave ekonomike, por zgjedhja e politikave të përshtatshme do të varet nga një ekzaminim më i ngushtë i burimeve të defiçiteve të llogarisë rrjedhëse.

Gjatë periudhës së krizës ekonomike dhe pas saj eksport- importi ka pasur impakt negativ, por të parëndësishëm në rritjen ekonomike, për faktin se bilanci tregtar është negativ.

Për ta përmirësuar dhe rregulluar sa më shpejt situatat e luhatjeve ekonomike rekomandoj:

- ✓ Të mbahet një qëndrim strategjik ndaj nxitjes së eksporteve i cili të ketë për qëllim përfshirjen dhe bashkëpunimin e ngushtë midis të gjithë aktorëve, me qëllim përfitimin nga qëndrimet plotësuese dhe nga efektet e sinergjisë. Kështu, lidhjet funksionale midis organizatave publike dhe private, komunitetit të biznesit dhe

organizatave donatore si dhe kontributi i qeverisë do të jenë vendimtare për suksesin e nxitjes së eksporteve shqiptare.

- ✓ Nxitja e industrisë shqiptare për një qëndrim të integruar, duke filluar nga përmirësimi i aftësisë konkurruese ndërkombëtare deri në nxitjen e eksporteve.
- ✓ Investimi më i përqëndruar në mallra kapitale dhe sektorë të ekonomisë ku vendi ka avantazh absolut. Qëllimi është që të ulet konsumi i mallrave të importit dhe të stimulohet prodhimi vendas për të kaluar nga një ekonomi konsumeriste në një ekonomi të orientuar në prodhimin e mallrave kapitale.
- ✓ Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë shqiptare të orientuar për eksport, do të varet nga ngritja e suksesshme e kapaciteteve respektive politike, institucionale, teknike dhe administruese për të administruar situatat e lëkundjeve ekonomike.

Referenca

Aleksander Aristovnik & Stanka Setnikar-Cankar, 2006. "How Excessive are External Imbalances in Selected Transition Countries?," Prague Economic Papers, Prague University of Economics and Business, vol. 2006(3), pages 243-267.

Calderon, C., Chong A. and Loayza, N. (2000): "Determinants of Current Account Deficits in Developing Countries", Contributions to Macroeconomics, 2: 1-35

Dilawar Khan and al. (2012). "Exports, imports and economic growth nexus: Time series evidence from Pakistan". World Applied Sciences Journal.18 (4): 538-542, 2012.

Mabrouki Mohamed (2017) , “Impact of exports and imports on economic growth: new evidence from Panama”; JOURNAL OF SMART ECONOMIC GROWTH, Volume 1, Number 2, Year 2017, p. 67-79.

Ramos, F. F. R. (2002). “Exports, imports, and economic growth in Portugal: evidence from causality and cointegration analysis”. Economic Modeling.18. (2001). 613-623.

Rodrigue Tremblay (1990), The “export-import” effect and economic growthNorth American Review of Economics and Finance, Volume 1, Issue 2, Autumn 1990, Pages 241-252, Available online 1 November 2002.

Mitra Lal Devkota (2019), “Impact of Export and Import on Economic Growth: Time Series Evidence from India”, Dynamic Econometric Models, Volume 19 (2019), ISSN (print) 1234-3862, ISSN (online) 2450-706.

Taghavi, M., Goudarzi, M., Masoudi, E., & Gashti, H. P. (2012). Study on the Impact of Export and Import on Economic Growth in Iran. Journal of Basic and Applied Scientific Research, 2(12), 12787–12794.


ANEKSE

Tests of Normality

	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Rritja_reale_PBB	.184	11	.200*	.910	11	.245

*. This is a lower bound of the true significance.

a. Lilliefors Significance Correction



Model Summary

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.575 ^a	.330	.163	1.57220

a. Predictors: (Constant), Eksporti_perqindje_PBB,

ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	9.747	2	4.874	1.972	.201 ^b
	Residual	19.775	8	2.472		
	Total	29.522	10			

a. Dependent Variable: Rritja_reale_PBB

b. Predictors: (Constant), Eksporti_perqindje_PBB, Importi_perqindje_PBB

Coefficients^a

Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
(Constant)	-19.194	14.061		-1.365	.209
1 Importi_perqindje_PBB	-.706	.401	-.586	-1.759	.117
Eksporti_perqindje_PBB	-.231	.138	-.558	-1.674	.133

a. Dependent Variable: Rritja_reale_PBB

FINANCIMI I PROJEKTEVE TË KOMUNAVE TË KOSOVËS PËRMES BORXHIT PUBLIK

Dr. Betim Spahiu

Kolegji i Menaxhmentit International "Globus" , e-mail:
betim_spahiu@hotmail.com

Dr. Muhamet Spahiu

Kolegji i Menaxhmentit International "Globus" , e-mail: spahiu.m@gmail.com,
muhamet.spahiu@m-holding.al

MA. Lorik Muçaj

Evulucion Academy, lecturer and academic director , e-mail:
lorik@m-holding.al

ABSTRAKT

Ky punim shkencor prezanton nivelin apo shkallën e borxhit në financimin e projekteve apo të buxhetit të komunave të Kosovës. Në përgjithësi borxhi publik në Kosovë është duke shënuar rritje nga viti në vit, mirëpo komunat e Kosovës nga paslufta e deri më tani kanë shkallë shumë të vogël të borxhit publik, dhe atë kryesisht në formë të garancisë nga Qeveria e Kosovës. Në aspektin makroekonomik për politikën publike, qeveritë duhet të përpiqen të sigurojnë që niveli dhe ritmi i rritjes së borxhit të tyre publik është në thelb i qëndrueshëm dhe mund të shërbehet në një gamë të gjerë rrethanash, duke përmbushur objektivat e koston dhe rrezikut. Menaxherët e borxhit duhet të sigurojnë që autoritetet fiskale janë të vetëdijshme për ndikimin e kërkesave të financimit të qeverive komunale dhe nivelet e borxhit në koston e huamarrjes.

I tërë Borxhi Shtetëror do të ketë paritet dhe barazi të statusit, do të jetë "bazë e barabartë", pa marrë parasysh se kur është shkaktuar, dhe pa marrë parasysh nëse është në formë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, të Kontratave të Financimit, apo huamarrjeve tjera kontraktuale.

Borxhi Komunal apo Borxhi, është obligim ose detyrim monetar i krijuar me marrëveshje financimi, dëftesë thesari, instrument borxhi i pagarrantuar, obligacion, mbitërheqje ose emetim i letrave me vlerë dhe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, përfshinë garanci.

Në këtë punim do të trajtohet koncepti dhe llojet e borxhit publik, borxhi komunal në veçanti, pastaj kufizimet e borxhit publik sipas legjislacionit në Kosovë, garancitë shtetërore, kriteret për marrjen e borxhit publik nga ana e komunave në Kosovë dhe

në fund do të prezantohen konstatimet dhe rekomandimet e dhëna si rezultat i hulumtimit të bërë.

Fjalët kyçe: Borxhi publik, Financim, Menaxhim, Qeveria, Komunal

1. HYRJJE

Borxhi si instrument të cilin e përdor shteti për plotësimin e nevojave të veta të jashtëzakonshme dhe financimin e projekteve investuese të ndryshme, e zënë një vend të rëndësishëm pothuajse në të gjitha vendet në zhvillim dhe vendet e pazhvilluara, sidomos pas daljes nga lufta, në raste të katastrofave natyrore, krizave financiare etj. Borxhet publike mund të merren nga subjektet juridike apo fizike brenda shtetit si dhe nga ato jashtë shtetit. Në Republikën e Kosovës, Qeveria e bën menaxhimin e borxheve shtetërore, ku për këtë e ka nxjerrë edhe bazën ligjore, si në nivel primar ashtu edhe në atë sekondar, të cilat hartohen varësisht prej politikave të Qeverisë.

Institucionet financiare apo kreditorët e mundshëm, në të cilat Kosova ka qasje për financim, të ndara sipas llojit të financimit, janë si në vijim:

➤ **Financim i Buxhetit**

- Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN),
- Banka Botërore (instrument i kushtëzuar me arritjen e reformave të caktuara)

➤ **Financim i Projekteve**

- Banka Botërore – Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH),
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH),
- Banka Evropiane Investuese (BEI),
- Agjencia Gjermane për Rindërtim (KfW),
- Republika Federale e Austrisë,
- Banka Islamike për Zhvillim (ISDB),
- Fondi Saudit për Zhvillim (SFD),
- Fondi i OPEC për Zhvillim (OFID),
- Agjencioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)
- Këshilli i Bankës Zhvillimore Evropiane (CEB)
- Kreditues të tjerë me të cilët mund të krijohet bashkëpunim në të ardhmen.

2. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij punimi shkencor janë përdorur disa metoda të kërkimit dhe hulumtimit shkencorë. Ndër metodat, e para është metoda empirike sipas të cilës është studiuar gjeneza e borxhit publike nga klasikët dhe borxhezët të cilët ndër të parët i kishin dhënë idetë e tyre mbi huanë publike. Pastaj metoda e analizës dhe sintezës duke bërë analizën e borxhit komunal në veçanti dhe borxhit public në përgjithësi ²⁷. Metodë tjetër e cila është përdorur është metoda e specializimit pasi që punimi trajton në specifika borxhin komunal. Mirëpo për t'i dhënë karakter në kuptim të plotë këtij punimi shkencor janë zhvilluar takime dhe intervista me akterët kryesore të kësaj lëmie në Kosovë, në radhë të parë me Njësinë Për Menaxhimin e Borxheve në kuadër të Thesarit, Ministria e Financave të Kosovës, pastaj me zyrtarë të ndryshëm financiar në disa komuna të Kosovës.

3. DEFINICIONI I BORXHIT PUBLIK

Definicioni i borxhit publike sipas Ligjit për Borxhet Publike të Kosovës Nr.03/L – 175, borxhi është çdo obligim financiar për tu paguar, apo përndryshe për të paguar para që dalin nga Kontratat për Financim, dëftesat e thesarit, obligacionet, mbitërheqjet apo nga letrat tjera me vlerë të transmetuara si këmbim për derdhjen e fondeve, si dhe obligimin për të paguar kryegjënë, interesin, zbritjen, provizionet, komisione apo gjobat të cilës do natyrë.

Borxhi shtetëror nënkupton çfarë do detyrimi financiar në të cilin ka hyrë Qeveria që përfshin borxhet e brendshme, borxhet e jashtme qofshin ato të emetuara në formë fizike apo elektronike ²⁸. Pra, borxhi shtetëror është para të cilën shteti e merr nga subjektet, entitetet apo shtetet e huaja dhe të cilën duhet ta kthejë në kohën e caktuar me marrëveshje së bashku me interesin apo kamatën.

Borxhi shtetëror merret për arsye të ndryshme, e ndër to janë :

- mbulimi i shpenzimeve të jashtëzakonshme
- mos-mbledhja me kohë e të hyrave publike në raport me shpenzimet publike
- financimi i projekteve investuese të ndryshme
- financimi i deficitit buxhetor

Varësisht nga kohëzgjatja e kthimit të borxhit, borxhi shtetëror ndahet në:

Borxh afatshkurtër, i cili duhet të kthehet apo paguhet në një periudhë kohore brenda një viti, dhe

²⁷ Prof.Dr. Ali Jakupi, Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore, Prishtinë, 2005.

²⁸ MEF, Udhëzimi Administrativ Nr.10/2010, Për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore dhe Garancive Shtetërore, Neni 2, Kosovë.

Borxh afatgjatë, i cili borxh duhet të paguhet në një periudhë më të gjatë se një vit. Ndërsa, varësisht prej subjekteve apo entiteteve brenda territorit të shtetit apo nga organizatat, institucionet apo qeveritë e huaja, borxhi publik ndahet në:

- Borxh të brendshëm dhe
- Borxh të jashtëm (ndërkombëtar)

4. BORXHI PUBLIK I NËN-HUAZUAR

Borxhi i nën-huazuar karakterizohet nga 2 procese si në vijim ²⁹:

- Procesi i parë është kur Qeveria huazon borxh nga kreditorët e jashtëm;
- Procesi i dytë është kur Qeveria i nën-huazon fondet e marra të borxhit tek organizatat e sektorit publik.

Në këto raste së pari e nënshkruan marrëveshjen e financimit me kreditorin, dhe së dyti hyn në marrëveshje nën-huazuese me organizatën e sektorit publik. Shlyerja e borxhit nga organizata buxhetore i bëhet Qeverisë, pastaj Qeveria ia transferon shumën e borxhit kreditorit të jashtëm apo të brendshëm.

Tabela 1. Niveli i borxhit të nën-huazuar 2014- TM4 2018

	2014	2015	2016	2017	TM1 2018	TM2 2018	TM3 2018	TM4 2018
Borxhi Ndërkombëtar	326.35	371.17	373.77	422.15	415.98	418.37	416.59	416.15
Qeveria Qendrore	316.54	339.87	323.93	365.18	358.55	364.03	361.85	364.53
Borxhi i Nën-huazuar	9.81	31.30	49.83	56.97	57.43	54.34	54.74	51.62
<i>Borxhi Ndërkombëtar (% e BPV-së) R</i>	5.86%	6.39%	6.25%	6.58%	6.26%	6.30%	6.27%	6.27%

5. BORXHI KOMUNAL

Komunat si organizata të sektorit publik, mund të hyjnë në borxh për plotësimin e nevojave financiare të tyre.

Sipas Ligjit për Borxhet Publike, në Kosovë, komunat mund të hyjnë në marrëveshje për borxhe afatshkurta dhe afatgjata, mirëpo duhet plotësuar disa kritere. Njëri ndër këto kritere është opinioni pa rezervë apo i pa kualifikuar ³⁰, nga auditori i përgjithshëm si pjesë e auditimeve vjetore ligjore të obliguara, për dy vitet e fundit radhazi.

²⁹ Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, Strategjia Vjetore e Borxhit 2013,

³⁰ Opinioni i pakualifikuar, është kur Auditori i Jashtëm është i kënaqur në të gjitha aspektet material që kanë të bëjnë me pasqyrat financiare.

Komuna e cila ka dështuar të kryejë pagesën e borxhit nuk mund të hyjë në ndonjë borxh shtesë për një periudhë prej dy viteve pasi te ketë bërë pagesën e atij borxhi të papaguar në mënyrë që të mos ketë mbetur asnjë pjesë e pa përmbushur.

Komuna nuk mund të hyjë në ndonjë borxh afatgjatë për një periudhë prej gjashtë muajve para zgjedhjeve komunale.

Shlyerja e borxhit komunal, në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara, është përgjegjësi vetëm e komunës, përveç kur garantohet shprehimisht nga një person tjetër juridik. Borxhi komunal nuk përbën asnjë obligim të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë të Republikës së Kosovës, përveç kur Ministria e Financave, shprehimisht lëshon me shkrim garanci lidhur me borxhin. Borxhi komunal nuk mund të merret përsipër nga shteti pa dy të tretat e votave të Kuvendit.

Borxhi komunal mund të merret vetëm në valutën zyrtare të Republikës së Kosovës.

5.1. Kufizimi i borxhit

Në Kosovë, sipas Ligjit Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind (40 %) të Bruto Prodhimit Vendor (BPV). Në rast se Borxhi i Përgjithshëm e tejkalon dyzet për qind (40 %) të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), Qeveria duhet t'i paraqesë Kuvendit strategjinë për të kthyer borxhin e përgjithshëm nën pragun dyzet për qind (40 %) brenda një viti.

Ndërsa sipas këtij ligji, kufizimet e borxhit komunal janë:

- Stoku i përgjithshëm i borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë duke përfshirë garancitë, në asnjë moment nuk guxon ta tejkalojë dyzet për qindëshin (40 %) e të hyrave vetanake të grumbulluara dhe granteve të përgjithshme (me përjashtim të atyre të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që menjëherë i paraprinë marrjes së borxhit.
- Te borxhi afatshkurtër në asnjë rast nuk mund të tejkalojë më shumë se pesë për qind (5 %) e të hyrave të përgjithshme të grumbulluara (me përjashtim të atyre të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që i paraprinë menjëherë marrjes së borxhit afatshkurtër.
- Te borxhi afatgjatë shuma e shërbimit të borxhit që duhet paguar në cilin do vit të një borxhi afatgjatë nuk duhet të tejkalojë dhjetë për qind (10 %) të të hyrave të përgjithshme të grumbulluara (me përjashtim të të hyrave që nuk janë rrjedhëse) për vitin fiskal që menjëherë i paraprinë marrjes së borxhit afatgjatë.

5.2. Financimi i projekteve të komunave të Kosovës, përmes borxhit publik

Janë borxhe në të cilat hynë shteti për financimin e projekteve të ndryshme kapitale investuese. Ministria e Financave duhet t'i analizojë mirë secilin propozim për financim të ndonjë projekti. Për këtë duhet themeluar një grup punues, i cili do t'i shqyrtojë të gjitha projektet për marrjen e borxhit

Të gjitha organizatat buxhetore të sektorit publik, kanë të drejtë të kërkojnë borxhe për financimin e ndonjë projekti investues. Andaj çdo propozim për projekte investuese, duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Financave, e cila pastaj e formon një grup punues, ku në mesin e këtij grupi duhet të jetë edhe një përfaqësues i organizatës përkatëse e cila ka kërkuar financim për ndonjë projekt, si dhe një përfaqësues i huadhënësit. Pas vlerësimit të propozimit të projektit të caktuar, grupi punues e rekomandon Ministrinë e Financave, për aprovimin apo jo, të borxhit shtetëror.

Me rastin e aprovimit të borxhit ndaj organizatave tjera, Ministria e Financave kërkon nga organizatat e sektorit publik që të garantojnë se:

- Fondet e kërkuara duhet të shfrytëzohen vetëm për projektin e kërkuar,
- Ministria e Financave ka qasje në regjistrat apo shënimet që kanë të bëjnë me borxhin shtetëror.

6. GARANCIA SHETËRORE

Garancia është një detyrim i mundshëm për të paguar borxhin që fillimisht del si detyrim i një pale të tretë dhe që varet prej dështimit të kësaj pale të tretë për të bërë pagesën në afatin e caktuar apo që t'i bindet kushteve të instrumentit me të cilin rregullohet një borxh i tillë burimor³¹. Të gjitha Garancitë në të cilat futet shteti apo komuna, duhet të ceken në mënyrë eksplicite me shkrim.

Garancia shtetërore është një detyrim i mundshëm i Republikës së Kosovës i cili varet nga obligimet financiare të një personi tjetër juridik dhe bëhet pjesë e Borxhit Shtetëror kur pala e cila ka përgjegjësinë për pagesën e obligimeve të tilla financiare, dështon në kryerjen e pagesës në kohën e duhur. Pastaj, Qeveria e obligon Ministrinë e Financave si përgjegjëse të autorizuar për menaxhimin e borxheve shtetërore që ta merr përgjegjësinë për pagesën e borxhit të obliguesit kryesor / primar.

Garancitë shtetërore duhet të planifikohen në Ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.

Garancitë shtetërore që i lëshohen entiteteve publike apo private do të përfshijnë kushtin që huamarrësi t'ia paguaj Qeverisë një tarifë të garancisë. Niveli i tarifës do të llogaritet në bazë të një analize të secilit aksion të garancisë nga pjesa e përgjithshme e humbjeve të supozuara nga portofoli e garancive. Tarifat e paguara nën skemën e tarifave të garancisë do të përfshihen në buxhet dhe do të llogariten si rezervë e garancisë. Vetëm shpenzimet që lidhen me humbjet e ndërlydhura me garancitë shtetërore mund të mbulohen nga kjo kategori e zotimeve. Çdo shumë e tejkualuar në zotimet e garancive në fund të vitit fiskal do të bartet në buxhetin e viteve të ardhshme nën të njëjtin titull të buxhetit të zotuar.

Huamarrësit të cilët mund të kenë të drejtë në garancinë shtetërore janë³²:

- organizatat e sektorit publik; ose
- entitetet private të cilat janë duke financuar projekte të infrastrukturës publike apo projekte të cilat janë të lidhura me sektorin ekonomik të rëndësisë strategjike apo sociale për shtetin.

³¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 2, Prishtinë, 2010

³² Dr.Nexhmije Berisha Vokshi, Kontabiliteti i Sektorit Publike, Prishtinë, 2013

Garancia shtetërore do të përfundojë atëherë kur ³³:

- Huaja për të cilën është dhënë garancia është paguar e plotë nga huamarrësi;
- Afatet e Garancisë kanë skaduar; apo
- Pagesa është kryer në përputhshmëri të plotë me kushtet e garancisë.

Deri në fund të vitit 2017 portofoli i garancive shtetërore të Republikës e Kosovës përbëhej nga tri garanci shtetërore të emetuara.

Në vitin 2014, Ministria e Financave ka emetuar garancinë e parë shtetërore në shumën prej 10 milion €, me të cilën garanton FSDK-në (Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës) për linjën kreditore të ofruar nga BERZh. Kjo linjë kreditore ka shërbyer që FSDK të rrisë vlerën e depozitave të siguruar nga 2,000 në 3,000 € për depositor ³⁴.

Ndërsa, garancinë e dytë ndërkombëtare Republika e Kosovës e ka emetuar gjatë vitit 2016, përmes së cilës e garanton ndërmartjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e ofruar nga BERZh në vlerën 10 milion €.

Vlen të theksohet që kjo kredi është e garantuar në kuadër të institucioneve të Kosovës fillimisht, nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Me këtë kredi është paraparë avancimi i Trafikut Urban të Prishtinës.

Në fund të vitit 2016 Republika e Kosovës ka emetuar garancinë e tretë shtetërore në shumën 24 milion €, e cila i është vënë në dispozicion FSDKsë për linjën e dytë kreditore të ofruar nga BERZh. Kjo linjë kreditore përbën vazhdimësi të linjës së parë kreditore që është vënë në dispozicion në vitin 2013, për mbulimin adekuat të depozituesve të siguruar në mënyrë proporcionale me rritjen graduale të përcaktuar me ligj të limitit të mbulesës për çdo depozitues.

³³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 24

³⁴ Thesari i Kosovës, Divizioni për Menaxhimin e Borxheve, Buletini Ekonomik, 2017, Prishtinë, 2018

Tabela 2. Struktura e borxhit të përgjithshëm dhe garancive shtetërore 2009-2017

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi Ndërkombëtar	249.01	260.08	253.71	336.60	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	249.01	260.08	253.71	409.92	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42
Garancitë Shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	10.00	10.00	20.00	44.00
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)*	6.12	5.91	5.27	8.10	8.94	10.65	13.07	14.58	16.63
BPV	4,070	4,402	4,815	5,059	5,327	5,567	5,807	5,985	6,257

Tabela 3. Paraqitja detale e garancive shtetërore

	2014	2015	2016	2017
Garancitë Shtetërore	10.00	10.00	20.00	44.00
Garancia për Linjën Kreditore të FSDK	10.00	10.00	10.00	10.00
Garancia për Trafikun Urban Prishtinë	0	0	10.00	10.00
Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	0	0	0	24.00
Garancitë Shtetërore (% e BPV-së)	0.18%	0.17%	0.33%	0.70%

7. PROGRAMI I BORXHEVE

Programi i borxhit nënkupton planifikimin dhe politikat kombëtare për borxhin duke u bazuar në kornizën makroekonomike dhe fiskale. Qeveria është e obliguar që çdo vit, jo më vonë se data 31 dhjetor, apo deri në datën e fundit të vitit fiskal aty ku viti fiskal nuk përputhet me vitin kalendarik, ta përgatitë programin për borxhin shtetëror.

Në Republikën e Kosovës, përgjegjës për përgatitjen dhe ofrimin e programit të borxhit shtetëror është Ministria e Financave. Kjo ministri ka për detyrë ta përgatisë programin dhe strategjinë për menaxhimin e borxhit shtetëror. Pas përgatitjes së programit për borxhin shtetëror, ministria ia dërgon Qeverisë për aprovim pastaj Qeveria ia dërgon Kuvendit për informim.

Programi për Borxhin Shtetëror do të sigurojë që të mbulohen nevojat e huamartjes me shpenzimet më të vogla të mundshme, me një nivel të arsyeshëm të rrezikut.

Programi për borxhin shtetëror, përfshinë por nuk kufizohet në informatat në vijim³⁵:

- Deklaratën e qëllimeve të politikave të Qeverisë për borxhet;
- Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit lidhur me atë se si Qeveria synon t'i arrijë qëllimet e saja me politikat për borxhin;
- Standardet dhe caqet duke përfshirë kufizimet specifike vjetore për borxhet për secilën kategori të Borxhit Ndërkombëtar dhe atij të Brendshëm;
- Borxhin Shtetëror historik dhe pjesën aktuale të papaguar dhe Garancitë Shtetërore;
- Pagesat e pritura mbi Garancitë;
- Shërbimin historik dhe aktual të borxhit për të gjithë Borxhin Shtetëror;
- Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të propozuara, duke përfshirë edhe qëllimet e borxheve të këtilla;
- Parashikimet e Shërbimit të Borxhit duke përfshirë edhe borxhet e propozuara për të ardhmen;
- Treguesit historik për qëndrueshmërinë e borxhit dhe analizat e qëndrueshmërisë së borxhit të parashikuar; dhe
- Rishikimi i ecurisë së viteve të mëparshme dhe çfarëdo ndryshimesh të propozuara në Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit.

Strategjia vjetore e borxhit ka për qëllim të përcaktojë një orientim në mënyrë që Qeveria t'i plotësojë nevojat e saj buxhetore, të menaxhojë borxhin dhe të zhvillojë tregun e brendshëm të letrave me vlerë. Objektivat e strategjisë vjetore të borxhit janë³⁶:

- Përcaktimi i objektivave qeveritare të huazimit;
- Prezantimi i strukturës aktuale të borxhit;
- Vlerësimi i rrezikut;
- Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit;
- Plani i huazimit për vitin e ardhshëm;

Strategjia vjetore e borxhit ka për obligim të përcaktojë planin për borxhin i cili shkaktohet në emër të institucioneve të Qeverisë. Po ashtu duhet të përfshijë borxhin total, i cili përbëhet nga borxhi shtetëror dhe komunal si dhe garancitë nëse e ka lëshuar ndonjë Qeveria³⁷.

8. KONSTATIME

Borxhi i Përgjithshëm Shtetëror i Kosovës deri në fund të vitit 2017 përbëhej nga borxhi i brendshëm dhe borxhi ndërkombëtar shtetëror, si dhe tri garanci shtetërore. Deri më tani, Kosova nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

³⁵Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Neni 15, Prishtinë, 2010

³⁶ Strategjia Vjetore e Borxhit 2013, Miistria e Financave, Thesari

³⁷ Dr. Nexhmije Berisha Vokshi, Kontabiliteti i Sektorit Publik, Prishtinë, 2013

Gjatë vitit 2017 borxhi ndërkombëtar në Kosovë ka pasur zhvillime të theksuara në krahasim me vitet paraprake, si rezultat i disbursimeve në kuadër të programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe disbursimeve nga kreditë për financimin e projekteve.

Në fund të vitit 2017 borxhi ndërkombëtar arriti shumën 422.15 milion €, që paraqet rreth 42.3 % të totalit të borxhit shtetëror, apo 6.75 % të Bruto Produktit Vendor. Pjesa më e madhe apo 76 % e portofolit të borxhit ndërkombëtar është ndaj Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Komunat e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi mund të marrin borxhe afatshkurta dhe borxhe afatgjata.

Qeveria e Kosovës kontraktin borxhin ndërkombëtar nga kreditorët multilateralë dhe bilateralë. Burimi kryesor i financimit multilateral janë institucionet financiare ndërkombëtare siç janë BNRZH, AZHN dhe FMN në të cilat Kosova është e anëtarësuar. Kreditë e AZHN kontraktohen në kushte tejet të favorshme me norma të ulëta të interesit fiks dhe maturitet afatgjatë. Kreditë nga programet e FMN- së kontraktohen me periudha më të shkurtra maturiteti, kanë norma variable të interesit dhe janë të denominuara në valutën SDR. Ndërkaq kreditorët bilateralë përfshijnë Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) të Gjermanisë, UniCredit Bank të Austrisë, Exim Bank në emër të Qeverisë së Hungarisë, dhe NATIXIS në emër të Qeverisë Franceze. Edhe këta kreditorë financojnë me norma të ulëta të interesave fikse me periudha të gjata maturimi prej 18 deri në 30 vjet. Disa kredi bilaterale janë ofruar përmes një pakoje kombinimi mes granteve dhe kredive. Varësisht nga politikat e aprovuara dhe të detyrueshme për huamarrësit, shumica e kreditorëve financojnë vetëm projekte specifike në sektorë të caktuar. Huamarrja nga borxhi i brendshëm bëhet përmes emetimit të letrave me vlerë të cilat dallojnë për nga afati i maturimit. Bonot e Thesarit emetohen me maturitet deri në 12 muaj, ndërsa Obligacionet Qeveritare, me maturitet më të gjatë se 1 vit.

I tërë emetimi bëhet në valutën EUR, gjë që eliminon riskun valutor, dhe mjetet e pranuar shërbejnë për financimin e drejtpërdrejt të buxhetit. Emetimi i letrave me vlerë karakterizohet me kosto të ulëta të transaksionit në njërin anë, kurse në anën tjetër ndihmon në zhvillimin e tregut vendor duke ndikuar në rritjen e eficiencës së menaxhimit të likuiditetit, si për Qeverinë ashtu edhe për sistemin e përgjithshëm financiar.

9. REKOMANDIME

Inkurajojmë të gjitha komunat e Kosovës që të bëjnë analiza detale të projekteve të ndryshme investive dhe të aplikojnë për kredi (borxh publik) qoftë në nivel ndërkombëtar si dhe në atë kontraktual nga Qeveria e Kosovës.

Duke pasur parasysh mungesën e analizave të mirëfillta për projekte apo investime nga ana e komunave të Kosovës, të cilat do të ndikojnë në zhvillim lokal, rekomandimi ynë është që komunat e Kosovës mos të fillojnë të marrin borxh publik në mënyrë direkte, por të vazhdohet me garanci shtetërore nga ana e Qeverisë siç është gjendja për momentin si dhe me borxhe të nën-huazuara.

Po ashtu Qeveria do të duhej të ndërmerre masa sa më të shpejta për investime në zhvillimin lokal përmes borxhit publik të brendshëm me anë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe përmes Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Pra, fondet nga FKPK-ja të investohen në Kosovë, e jo në tregjet ndërkombëtare siç ka vazhduar deri tani.

LITERATURA

- [1] Ali J. (2005) “Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore”, Prishtinë, Kosovë ;
- [2] Ministria e Financave – Thesari (2011), “MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI”, botim në bashkëpunim me Komisionin Evropian;
- [3] Kuvendi i Kosovës (2008), “LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE DHE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, NR. 03/L-048”, Prishtinë, Kosovë;
- [4] Kuvendi i Kosovës (2010), Ligji Nr.03/L-175 “Për Borxhet Publike” Prishtinë;
- [5] Nexhmije B.V. (2013) “Kontabiliteti i Sektorit Publik”, Prishtinë;
- [6] Thesari i Kosovës (2018), Divizioni për Menaxhimin e Borxheve “Buletini Ekonomik, 2017”, Prishtinë;
- [7] International Monetary Fund (2014) “Government Finance Statistics Manual 2014”;
- [8] Thesari i Kosovës (2018) “Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021”, Prishtinë.

IMPAKTI I TIK NË VLERËN E BIZNESIT NË NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME NË REPUBLIKËN E MAQEDONSË SË VERIUT

Armen Kadriu, Prof.Dr

International University of Struga - Struga, Republic of North Macedonia
a.kadriu@eust.edu.mk

Lirinda Vako Abedini, MSc

International University of Struga - Struga, Republic of North Macedonia
l.vako@eust.edu.mk

Abstrakt

Procesi i globalizimit dhe dixhitalizimit, ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën e bërjes së biznesit dhe konkurrencës në treg. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është gurthemeli i këtij ndryshimi drastik, duke sjellë ndryshime revolucionare në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë përfitimet, sfidat dhe strategjitë për minimizimin e barrierave të adoptimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe të ofrojë një pasqyrë të TIK në RMV, duke studiuar besimet dhe qëndrimet e NVM-ve në lidhje me këtë çështje. Përveç informacionit për situatën aktuale, do të identifikohen dhe analizohen nevojat dhe vështirësitë e NVM-ve në identifikimin dhe përdorimin e TIK.

Në këtë punim do të përdorim hulumtime sasiore, pyetësor online për mbledhjen e të dhënave, dhe do të arrihet një konkluzion për ndikimin e TIK në rritjen dhe konkurrueshmërinë e NVM-ve në RMV.

Fjalë kyçe: *NMV, TIK, biznes procese, vlera biznesit*

1. Hyrje

Avancimi i madh teknologjik dhe zhvillimi i TIK, kanë ndikuar ndjeshëm dhe në ekonominë e vendeve në zhvillim, si Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV), duke prekur veçanërisht sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pasi një numër i konsiderueshëm i NVM-ve kanë implementuar TIK në procesin e tyre të gjenerimit të vlerës, jo vetëm në rritjen e produktivitetit, por edhe në ndryshime në stile të komunikimit, konkurrencës dhe koordinimit.

Duke qenë se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë faktor kyç në shpirtin sipërmarrës dhe novacione, ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal, në rritjen e konkurrencës dhe janë burim thelbësor i vendeve të punës. Zhvillimi i sektorit të NVM-ve është instrumenti më eficient për ekonomitë në tranzicion, që gjeneron qëndrueshmëri në rritjen ekonomike, punësim, si dhe reduktim të varfërisë. Zhvillimi i këtij sektori privat është i një rëndësie shumë të madhe dhe konsiderohet si faktor kryesor i rritjes ekonomike dhe trend i zhvillimit industrial dhe prodhimit.

Duke qenë se mjediset e biznesit bëhen gjithnjë e më komplekse, ekziston nevoja për SME-të që të miratojnë mjete që do të ndihmojnë në përballimin e këtij kompleksiteti dhe që ende të qëndrojnë konkurruese në treg. Prandaj, ekziston një nevojë në rritje për NVM-të për të implementuar sisteme të TIK-ut të bazuar në operacionet e përditshme të biznesit të tyre, për ti ndihmuar të prodhojnë dhe të tregtojnë shërbimet dhe produktet e tyre. Përdorimi i TIK potencialisht mund të përmirësojë komunikimin midis individëve dhe grupeve në organizata. Për NVM-të në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që të bëhen më të avancuara, është e domosdoshme që ata të implementojnë sistemet bazë të TIK për të lehtësuar komunikimin global me furnizuesit, distributorët dhe klientët e tyre.

2. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Mbase është e vështirë të jepet një përkufizim i saktë lidhur me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nisur nga fakti që studiues dhe vende të ndryshme, kanë pikpamje të ndryshme, por Komisioni European ka një përkufizim të njohur ligjor. Sipas këtij

përkufizimi, një SME duhet të ketë më pak se 250 të punësuar, një qarkullim prej më pak se 50 milionë euro, dhe një bilanc me më pak se 43 milionë euro.

Një përkufizim të ngjashëm me Komisionin Europian, jep edhe Banka Botërore, e cila e bën klasifikimin si më poshtë:

- 1-5 të punësuar – Mikrondërmarrje
- 6-25 të punësuar – Ndërmarrje të vogla
- 26-250 të punësuar – Ndërmarrje të mesme

Përkufizimi i Institutit për kërkime për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Bon, Gjermani e bën klasifikimin si në vijim:

- 9 të punësuar dhe qarkullim nën 500000 euro – ndërmarrje të vogla
- Deri në 499 të punësuar dhe qarkullim nën 50 milion euro – ndërmarrje të mesme

Megjithëse përkufizimet mund të rezultojnë deri diku me ndryshime nga njëri tjetri, përsëri si pikë referimi mbetet numri i të punësuarve dhe xhiroja vjetore.

3. Roli dhe rëndësia e NVM në RMV

E vetmja mënyrë për të reduktuar varfërinë në mënyrë të qëndrueshme është promovimi i rritjes ekonomike, përmes pasurisë dhe krijimit të punësimit. Në vendet në zhvillim si RMV, NVM-të janë burimi kryesor i të ardhurave, një terren ushqyes për sipërmarrësit dhe një ofrues i rëndësishëm i punësimit.

Bazuar në përkufizimin e Unionit Europian dhe “Ligjit mbi shoqërit tregtare” sipas kritereve të përcaktuara në nenin 469 paragrafi 4 dhe nenit 470, në RMV, NVM-të i kategorizojmë në tre grupe, duke u fokusuar në numrin e punëtorëve dhe qarkullimin vjetor:

1. **Mikro ndërmarrje** – prej 1 deri në 9 të punësuar, qarkullim vjetor < 50.000,00 Euro, mbi 80% nga bruto të ardhurat të realizohen vetëm nga një klient

2. **Ndërmarrje të vogla** – nga 10 deri në 50 të punësuar, qarkullim vjetor ≤ 2 milion Euro, gjendja e bilancit ≤ 2 milion Euro
3. **Të mesme** – prej 51 deri në 249 të punësuar, qarkullimi vjetor ≤ 10 milion Euro, gjendja e bilancit ≤ 11 milion Euro.
4. **Të mëdha** – mbi 250 të punësuar, gjegjësisht të gjitha subjektet tjera që nuk bëjnë pjesë në klasifikimet e më sipërme.

Sipas të dhënave të fundit të lëshuara nga Zyra Statistike Shtetërore dhe SBA, 99.7% të numrit të përgjithshëm të kompanive në territorin e RMV e përbëjnë segmenti i bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme duke lënë kompanitë e mëdha me vetëm 0.3%. Nga ana tjetër, 74.4% e të punësuarve në RMV i përkasin pikërisht sektorit NVM. Bazuar në këto të dhëna, është e dukshme rëndësia tepër e lartë dhe fuqia e NVM në zhvillimin ekonomik dhe nivelin e punësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4. Impakti dhe përdorimi i TIK nga NVM në RMV

Evolucioni i teknologjisë ndikon në mënyrë të konsiderueshme në bizneset e vogla dhe të mesme duke ndryshuar infrastrukturën e industrisë dhe operacionet e biznesit dhe duke krijuar hapësirat për shfaqjen e avantazheve konkurruese për ato organizata që janë duke adoptuar TIK në proceset e tyre të biznesit. Miratimi i TIK-ut nga NVM-të siguron aftësinë e qasjes së shpejtë në të dhënat, vlerësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e vëllimeve të mëdha të të dhënave. Rrjedhimisht, ato NVM që përdorin TIK, kanë mundësinë të hyjnë në tregun ndërkombëtar dhe të mbeten konkurruese pavarësisht sfidave të globalizimit, liberalizimi dhe progresi shkencor dhe teknik.

Si teknologji ndër-sektoriale, TIK është një nxitës i inovacionit të produktit dhe procesit. Për më tepër, TIK luan një rol kyç në ekonominë e bazuar në njohuri, ku rëndësia e saj strategjike do të rritet ndjeshëm për shkak të mega-tendencave siç është interneti i gjërave. TIK është sigurisht një ndikim i fuqishëm në ecurinë ekonomike

dhe mund të karakterizohet me një shkallë të lartë të progresit teknologjik dhe produktivitetit. Duke kuptuar rëndësinë e NVM-ve për ekonominë dhe ndikimin e TIK-ut në përmirësimin e performancës së këtyre ndërmarrjeve, është realizuar një pyetësor drejtuar 50 bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në RMV, me anë të cilit do të jepet një pasqyrë më e qartë lidhur me impaktin dhe përdorimin e TIK nga NMV në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë sondazhit tonë, bazuar në të dhënat e mbledhura, kemi vërejtur se një numër i konsiderueshëm mikro ndërmarrjesh nuk përdorin asnjë formë të TIK-ut. Arsyeja duket të jetë brezi më i vjetër i pronarit/menaxherit, të cilët nuk janë përdorues të TIK dhe/ose forca punëtore me nivel të ulët arsimit, mungesa e njohurive teknologjike apo buxheti i ulët. Softuere si paketa Microsoft Office (Microsoft Word, Excel, PowerPoint dhe Access) janë përdorur nga 87% e firmave të anketuara. Rreth 62% e firmave përdorin aplikacione të tilla si E-Commerce, Menaxhimi i Inventarit ose ERP. Rrjetat e zgjidhjeve të tilla si serverat, routers dhe fireëall u shfrytëzuan në 45% të NVM-ve. Sistemet e ruajtjes së të dhënave dhe sigurisë u përdorën nga 31% e firmave të anketuara dhe teknologjitë e rrjeteve pa tela dhe zgjidhjeve të sigurisë në rrjet me vetëm 27% të NVM-ve të anketuara.

Sipas të dhënave të mbledhura nga pyetësori, 75% e NVM-ve caktojnë më pak se 10% të buxhetit të tyre vjetor për investimet në TIK, 4% e firmave investojnë ndërmjet 10% dhe 20%, 18% e firmave investojnë ndërmjet 20% dhe 40% dhe vetëm 6% e firmave të anketuara caktojnë më shumë se 40% të buxheteve të tyre në TIK.

Nga ana tjetër, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kanë të impementuar ndonjë formë të TIK, shprehen se janë relativisht të kënaqura dhe kanë rezultate në firmat e tyre në një mënyrë apo tjetër. 57% nga të anketuarit, mendojnë se përdorimi i mjeteve të TIK në kompanitë e tyre ka sjellë një përfitim në kohë, duke e ulur kështu pra kohën e operacioneve të biznesit në mënyrë të ndjeshme. 39% e të anketuarve kanë vërejtur një reduktim të kostos pasi implementimit të TIK, dhe një kosto më e ulët do të thotë më tepër të ardhura, çmime më konkurruese dhe kënaqje më të madhe konsumatore.

Konkurrenca është një faktor kyç në çdo biznes, dhe pikërisht implementimi i mjeteve të TIK në NVM-të e anketuara, ka ndikuar tek afro 35% e të anketuarve, duke e rritur ndjeshëm konkurrencën. Në 55% të të anketuarve, implementimi i TIK ka sjellë një rritje të shitjeve dhe rrjedhimisht të fitimit. 31% vërejnë rritje të produktivitetit, krahasur me më parë, kur nuk kishin të implementuar asnjë formë të TIK. Rreth 78% mendojnë se është rritur ndjeshëm kënaqja konsumatore, gjë e cila pas përdorimit të formave të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si psh: Facebook, Insagram, Twitter, web dhe portaleve të ndryshme apo mediave sociale, kanë çuar në përmirësim të marrëdhënieve me klientët. Nga ana tjetër klientëve u është dhënë mundësia për të fituar në kohë, kosto dhe cilësi. 65 % e të gjithë të anketuarve besojnë se vlera më e madhe që TIK ka shtuar në biznesin e tyre ishte aftësia për të depërtuar në tregje të reja dhe për t'iu përgjigjur menjëherë ndryshimeve të tregut

Nga këto të dhëna vërejmë se TIK ka një ndikim tepër pozitiv tek ndërmarrjet mikro, te vogla dhe të mesme në shumë aspekte, veçanërisht në reduktimin e kostos, rritjen e produktivitetit dhe kënaqjen konsumatore, përmirësimin e aktiviteteve biznesore dhe rritjen e vlerës së biznesit.

5. Barrierat e implementimit të TIK nga NVM

Megjithëse disa nga NVM-të në RMV janë qartësisht të vetëdijshëm për përfitimet e TIK, ekzistojnë disa kufizime dhe pengesa për investimet në TIK. Ne argumentojmë se kjo mund të shpjegohet me praninë e barrierave ndaj investimeve të TIK si niveli i ulët i kapitalit njerëzor dhe mungesa e riorganizimit të firmës.

Bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë investigimit, 72% e firmave mendojnë se mungesa e aftësive të nevojshme të brendshme është një pengesë e madhe. 66% mendojnë se kostot monetare të implementimit dhe zbatimit të TIK janë tepër të larta. Gati 43% mendojnë se nuk ka informacion të mjaftueshëm në dispozicion për TIK dhe ndikimin e tij në vlerën e biznesit. Nga të anketuarit, rreth 49% e firmave janë të

pasigurtë rreth mirmbajtjes së investimeve të tyre në TIK dhe 28% e menaxherëve mendojnë se nuk ka mbështetje të mjaftueshme për implementimin e TIK në biznese nga ana e qeverisë, ndërsa rreth 19% e shohin problematikë dhe shfaqen disi skeptik lidhur me aspektin e sigurisë që ofron bota e teknologjisë.




Figura 1: Barrierat e implementimit të TIK në RMV

6. Konkluzioni

Në këtë punim ne tregojmë rëndësinë, ndikimin dhe përdorimin e TIK-ut mbi SME-të në Shqipëri. Analiza dhe hulumtimet e kryera tregojnë një korrelacion të fortë pozitiv midis TIK-ut, efikasitetit ekonomik dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve. Ky material ofron dëshmi teorike të efekteve direkte dhe indirekte të TIK-ut mbi performancën e NVM-ve. Nga studimi, ne konkludojmë se TIK mund të përmirësojë performancën e përgjithshme, performancën financiare dhe operacionale të NVM-ve nëse përdoret siç duhet. Fushat ku ndikimi i TIK është më i madh janë: marketingu, komunikimi, rrjetet dhe burimet. TIK ka një ndikim në përmirësimin e komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm luan një rol të madh në performancën e inovacionit të NVM-ve.

Koncepti i TIK-ut në përgjithësi është ende jo në nivelin e duhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe si i tillë vazhdon të përballet me një sërë sfidash, duke përfshirë infrastrukturën e dobët të telekomunikacionit, mungesën e stafit të kualifikuar dhe besimin, barrierat psikologjike, ndarjen dixhitale dhe strategjitë dhe planifikimin e dobët në adoptimin e TIK-ut etj. Duket se përkundër të gjitha këtyre sfidave, NVM-të kuptojnë qartë potencialin e vërtetë të TIK-ut.

Në përfundim, TIK nuk është më koncept në planin e dytë, por një arsye e vërtetë dhe forcë shtytëse që u ofron ndërmarrjeve rrugët për të konkurruar në shkallë globale në mënyrë efikase dhe krijon marrëdhënie më të ngushta ndërmjet klientëve dhe furnizuesve. Zhvillimi i sektorit të TIK do të kishte ndikim direkt në rritjen ekonomike duke krijuar vende të punës dhe gjenerimin e të ardhurave, prandaj adoptimi i TIK duhet të shihet shpesh si një mënyrë normale e të bërit biznes.

7. Referenca:

- (Henry Ongori, Stephen O. Migiro, 2010)
- (M. Kapurubandara, R. Lawson , 2006)
- (Tam A.S.M, Chu L.K, SculliD, 2001)
- (Parker, C.M., Castelman, T, 2007)
- (P.Schubert, U.Leimstoll, 2007)
- (P. Schubert, J.Fisher, U.Leimstoll, 2007)
- (2017 SBA Fact Sheet — The former Yugoslav Republic of Macedonia, 2017)
- <http://www.stat.gov.mk>
- (What is an SME? - European Commission, n.d.)
- (D.Jamali, P.Lund-Thomsen, S.Jeppesen, 2015)

PERFORMANCE EVALUATION OF MOBILE AD-HOC NETWORK (MANET) ROUTING PROTOCOLS USING NS3 SIMULATOR

MSc. Eng. Albina TOÇILLA

Lecturer of Computer Networks Polis University – Tirana, Albania

Abstract

Ad-hoc network as a decentralized type of wireless networks, means that users form a temporary network, in order to communicate with each other, without any form of centralized administration. Each node that is part of the network behaves both as a host and as a router and consequently must forward packets to other nodes. A routing protocol is required for this purpose. An ad-hoc network has special features that impose new requirements on routing protocols. The most important feature is the dynamic topology, which is a consequence of the mobility of the joints. Nodes can often change position, which means they can consist of laptops or digital personal assistants, and are often limited to resources such as CPU capacity, storage capacity, battery power, and bandwidth.

A considerable number of routing protocols for MANET have been developed by network researchers and designers to enable the improvement of MANET performance. Examples of the most common routing protocols used for MANET include the Ad-hoc On-demand Distance Vector (AODV), the very dynamic Destination-Sequenced Distance Vector (DSDV) routing protocol, and the Optimized Link State Routing protocol (OLSR) protocol. Understanding the effects of each of these routing protocols on a typical IEEE 802.11 network would help in efficient design and development of appropriate MANETs.

In this paper, we will study the performance of evolution and the comparison between the three routing protocols of these networks: AODV, OLSR and DSDV,

simulating in NS3 the dependence of their characteristics on different network changes.

Keywords: *MANET networks, routing protocol, performance evaluation, nodes.*

1. Introduction

The field of wireless and mobile communications has been developed a lot in the last decade. The devices are becoming smaller, cheaper, friendlier and more powerful. This evolution is leading to an alternative way for mobile communications, where devices create a self-organized and self-administered wireless network, called ad hoc. The lack of infrastructure and the dynamic nature of these networks requires a set of strategies to be implemented in order to ensure end-to-end communication. These networks, MANETs have been studied by many organizations and institutes. Routing on these networks is a major issue that has attracted the attention of many researchers. This has led to the development of several routing protocols. It is not possible to determine exactly which of them performs better and which is worse, as this depends on the characteristics of the network, as well as the conditions, where we can identify the density of the joints and traffic, or the speed of their movement.

2. Motivation

The extension and application of MANET networks in various human activities makes these networks the object of study and interest in many cases. The challenge facing these studies consists on finding the right path. This is "worthy" of specific protocols, three of which will be the focus of our study on this task, as will be addressed in the following sections.

The first section is dedicated to a general overview of MANET networks, their advantages and disadvantages, as well as the areas where they find application the most. In the following, the second section is devoted to the presentation of routing protocols and familiarity with the logic of operation of each of them. Further, we will

get acquainted with the NS3 simulator, through which it has become possible to perform the simulations of this task. The subsequent section includes the performance analysis of AODV, DSDV and OLSR protocols, analyzing the impact of network changes on them, as well as the relevant explanations for each case.

At the end of this task, the key points drawn as a result of the work as a whole, which should remain in our minds regarding the MANET networks, are summarized.

3. MANET characteristics and applications

Ad hoc networks are a very good alternative compared to fixed (connected) networks in some operational situations, but an analysis regarding the advantages and disadvantages it offers will serve us to understand the application and situations in which it is better to used.

a) *Among the advantages of MANETs are:*

- **Easy and fast installation:** the level of flexibility for creating MANETs is high, as it does not require any previous installation or infrastructure and in this case, it can be created and broken down in a very short time.
- **Dynamic Topology:** nodes can move arbitrarily (randomly) across the network and may temporarily disappear from the MANET so the network topology graph can be constantly changing at an indefinite rate.
- **Fault tolerance:** due to limitations of radio interfaces and Dynamic topology, MANETs support connection failures because routing and transmission control protocols are designed to manage these situations.
- **Connectivity:** the use of centralized points is not necessary for communication within MANET, due to cooperation between nodes for transmitting packets.
- **Mobility:** wireless mobile nodes can move in different directions at the same time. Although routing algorithms deal with this issue, performance simulations show that there is a threshold level of joint mobility where protocol operation begins to fail.
- **Cost:** MANETs can be more economical in some cases as they eliminate fixed infrastructure costs and reduce energy consumption in mobile nodes.

- **Possibility of reusing the Spectrum:** due to short communication connections (node to nodes instead of nodes in a central base station), radio emission levels can be kept low. This increases the chance of reusing the spectrum or the possibility of using unlicensed bands.

b) *Some of the problems that MANETs have:*

- **Bandwidth Restrictions:** the capacity of wireless connections is always much lower than in Wired ones. In fact, some Gbps are available for Wired LAN, while nowadays, commercial applications for wireless LANs typically work around 2 Mbps.
- **Processing Ability:** the majority of nodes are tools without a powerful CPU. Moreover, network tasks such as routing and data transmission cannot consume the power resources of the devices, intended to play any other role, such as sensing functions.
кои ги остваруваат заради купо-продажба на дрога најчесто се користат со сленгови. Познавањето на сленговите може да биде од големо значење за откривање на голем број кривични дела поврзани со злоупотреба на дрога. За хероин уживателите го користат зборот жуто, црвено, хорс. За цената или количината користат шифрирани изрази како што се: за 500 денари - 5 минути, една паковка, петстотка без да наведат за кој вид на дрога станува збор, единица, двојка, петка, десетка (за грам). Понекогаш во продажбата се инволвирани и такси возила за транспорт на дрогата. Притоа, многу често таксистите и не знаат дека пренесуваат дрога, бидејќи дрогата најчесто ја кријат во предмети кои секојдневно се употребуваат и кои не би привлечеле посебно внимание. Најчесто дрогата кога се пренесува преку такси возила се сокрива во следниве предмети: цд дискови, мали книжни пакувања од прехранбени продукти, лименки, чаеви, пластични кутивчиња и други непрозирни предмети.

Во нашето законодавство карактеристични се две кривични дела кои се инкриминации во сферата на наркоманијата и тоа: чл. 215 Неовластено производство и пуштање во промет на наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори и чл. 216 Овозможување на употреба на наркотични дроги.⁵⁸

Со чл. 215 Неовластено производство и пуштање во промет на наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори законодавецот го инкриминира неовластеното произведување, преработување, продавање или нудење на продажба или заради продажба купување, држење или пренесување или посредување во продажба или купување или на друг начин неовластено пуштање во промет наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори. Сторител на основниот облик на ова дело може да биде секое физичко лице. Првичната кривична санкција предвидена за сторителот доколку е исполнето законското битие на делото беше казна затвор од 1 до 10 години. Меѓутоа законодавецот сфаќајќи ја тежината на ова кривично дело со измените од

⁵⁸ Чл.215 и чл.216 од Кривичен Законик на РМ-пречистен текст, 2016

септември 2009 година казната затвор од 1 до 10 години ја заменува со казна затвор во траење од 3 до 10 години, подигнувајќи ја минималната граница во изрекувањето на оваа казна. Оваа инкриминација опфаќа дејствија со кои се овозможува ширење на наркоманијата: неовластеното производство и неовластената трговија, што значи дека се појавува во два облици. Првиот облик за свој материјален супстрат го има неовластеното произведување или преработување на супстанции или препарати што се прогласени за наркотични дроги, психотропни супстанции или прекурзори. Од самата суштина на делото, произлегува дека производството и преработувањето треба да се вршат заради продажба, односно пуштање во промет, а не и заради задоволување на сопствените потреби. Вториот облик на дејствието на извршување е неовластеното пуштање во промет наркотични дроги, психотропни супстанции или прекурзори по пат на: продавање, нудење на продажба или заради продажба купување, држење или пренесување, или посредување во продажбата или купувањето, или на друг начин. За да постои делото не е важно времето поминато помеѓу производството и пуштањето во промет на дрогата. Притоа, тука не се казнува купувањето, држењето и сл. без намера за продажба, посредување во трговијата, односно пуштање во промет, туку за свои сопствени потреби. Од друга страна, карактеристично е што како сторител на ова дело, покрај физичко, може да се појави и правно лице, па така предвидената кривична санкција е парична казна. Законодавецот предвидел и затвор во траење од 1 до 5 години за оној кој што неовластено прави, набавува, посредува или дава на употреба опрема, материјал или супстанции за кои знае дека се наменети за производство на наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори. Всушност, станува збор за помошни дејствија и активности со кои се потпомага исполнувањето на законското битие на основниот вид на ова дело. Потешок облик постои во случај на организираност, односно соучесништво и соизвршителство, поточно ако делото е извршено од страна на повеќе лица или сторителот на ова дело организирал мрежа на препродавачи или посредници, при што сторителот ќе се казни со затвор најмалку 5 години. Значи, притоа, потешко се казнува организаторот на мрежа

на препродавачи или посредници (злосторничко здружение што се одликува со посебно разработена стратегија на постапување на одделните членови на здружението).

Законското битие во чл. 216-Овозможување на употреба на наркотични дроги се состои од повеќе дејствија на извршување: наведување друг на уживање наркотични дроги и прекурзори или давање наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори за уживање или ставање на располагање простории заради уживање на наркотични дроги, психотропни супстанции или на друг начин овозможување на друг да ужива наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори. Како сторител на основниот облик на ова кривично дело може да биде секое физичко лице, што се потврдува и од терминот „тој што“ употребен на почетокот во овој член. За овој облик на кривичното дело е предвидена кривична санкција казна затвор во траење од 1 до 5 години. Наведувањето кое е едно од дејствијата со кое може да се исполни законското битие на ова кривично дело значи поттикнување на едно или повеќе лица. Со оглед на тоа што законодавецот го предвидел терминот „наведува“, а не „ќе наведе“ или „наведе“, значи дека инкриминирано е и неуспешното поттикнување. За постоење на делото е доволно сторителот да презел дејствија со кои кај друг сака да создаде или зацврсти одлука за уживање на дрога (со наговарање, опишување на ефектите и сл.), при што не е нужно другото лице да започнало да ужива опојна дрога или психотропна супстанција (Богданова-Смилевска, 2017, 57). Давањето на друг опојна дрога или психотропна супстанција значи дејствие на овозможување на друг за нивно уживање. За разлика од претходното дело на пуштање во промет, тука се работи не за трговска операција, туку за непосредно продавање заради уживање на дрогата на друго лице (давањето на друг „да проба“, делењето со друг и сл.). И тука не е неопходно другото лице да започнало со уживање на дрогата. Ставањето на располагање простории е исто така дејствие на создавање услови за уживање на дрогата (давање простории во кои ќе се одржи некоја средба на која ќе се уживаат дроги и сл.). Делото е довршено со самото ставање на просториите на располагање. Овозможувањето на друг начин е секое друго дејствие на

создавање услови, помагање на друг да ужива дрога (така, на пример, давање средства за инјектирање на дрогата, пари за купување дрога и сл.). Пасивен субјект на ова кривично дело е хроничен наркоман или лице што за првпат доаѓа во средба со дрогата. Во однос на субјективниот елемент на делото, тоа е умислено, а умислата на сторителот посебно треба да ја опфати релацијата на овие дејствија со уживањето на опојни дроги (така на пример, не постои одговорност ако некој му го отстапи станот на својот пријател, без да знае дека тој таму ќе ужива опојни дроги). Потезок облик постои ако делото е сторено спрема малолетник или спрема повеќе лица или доколку предизвикало особено тешки последици, при што за сторителот во овој случај е предвидена казна затвор од 1 до 10 години.

Врз основа на статистички податоци за периодот 2010-2019 година на територијата на Република Македонија е даден табеларен приказ за регистрирани кривичните дела поврзани со злоупотреба на дрога и нивните сторители.

Табела 1. Преглед на регистрирани кривични дела поврзани со злоупотреба на дрога и нивни сторители (чл.215 и чл.216 од КЗ на РМ)⁵⁹

Кривични дела и сторители поврзани со злоупотреба на дрога										
Година	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Вкупно регистриран и кривични дела	578	596	604	555	717	611	608	552	789	896
Вкупно регистриран и сторители	713	719	736	668	872	718	708	629	905	1004

⁵⁹ Преземено од www.mvr.gov.mk, [пристапено: 25.05.2012]

Регистрирани кривични дела и сторители по чл.215 и чл.216 од КЗ на Република Македонија										
Година	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Регистриран и кривични дела по чл.215 од КЗ	494	481	468	421	577	515	488	464	673	763
Регистриран и сторители на кд по чл.215 од КЗ	616	588	586	514	714	615	572	532	782	863
Регистриран и кривични дела по чл.216 од КЗ	84	115	136	134	140	96	120	88	116	133
Регистриран и сторители на кд по чл.216 од КЗ	97	131	150	154	158	103	136	97	123	141

Од табеларниот приказ може да се забележи бројот на регистрирани кривични дела поврзани со злоупотреба на дрога и бројот на сторителите на истите за периодот 2010-2019 година, при што во 2018 и 2019 година има драстично зголемување и на кривичните дела поврзани со злоупотреба на дрога и на нивните сторители во споредба со останатите години. Бројот на регистрираните сторители е поголем од бројот на извршените кривични дела, што укажува дека кај овие кривични дела како сторител се јавуваат и повеќе лица.

1.3. Делинквентска тактика на консуматорите на дрога и нивни карактеристики

Консуматорите на дрога или популарно познати како наркомани индиректно се инволвирани во криминалитетот поврзан со злоупотреба на дрога иако не подлежат на кривична одговорност. Тие претставуваат многу значајна алка во синцирот на нарко-криминалот бидејќи се носители на побарувачката за дрога, а со тоа се диктира производството на дрога. Поголем број на консуматори значи поголема побарувачка на дрога, поголемо производство на дрога и поголема заработувачка. Значи, без консуматорите на дрога, криминалитетот поврзан со злоупотреба на дрога, вклучувајќи го и нарко-криминалот не може да егзистира, бидејќи консуматорите се крајните корисници на дрогата и исто така повторни побарувачи.

Постојат различни средини од каде се регрутираат уживателите на дрога. Најголемиот број уживатели на дрога во светот потекнуваат од редовите на најмладите и тоа од студентите, средношколците, но за жал оваа граница е многу пониска и ги опфаќа и основците. Најчесто се работи за уживатели кои потекнуваат од имотни и добро ситуирани семејства и се впуштаат во користење на дрога најпрво од љубопитство, припадност кон друштво кое веќе консумира дрога и така сето тоа преминува во навика која доведува до тешка катастрофа. Покрај љубопитноста, мотив за земање на дрога е и сопствената афирмација во друштвото. Сакајќи себе си да се докажат и да се истакнат многу млади се впуштаат во оваа „игра“, не сфаќајќи дека многу брзо ќе „потонат“. Многу мала група на зависници од дрога потекнува од редовите на здравствените работници и тешко болните лица кои на дрога се навикнати заради секојдневно манипулирање со неа или заради долготрајно лекување со употреба на наркотични средства.

Наркоманијата како социо-патолошка појава не се манифестира јавно, туку во тајност, односно скриено. Покрај скриениот начин на манифестирање на оваа појава консуматорите на дрога може да се препознаат по одредени карактеристики, иако понекогаш е тешко да се препознае консуматор на дрога.

Сепак, постојат повеќе начини на препознавање. Наједноставни начини да се препознае уживателот на дрога е промената на однесувањето, честата промена на расположението, надворешниот изглед, пронаоѓањето на наркотици, пронаоѓањето на рецепти, пронаоѓањето прибор за користење на дрога (шприцеви, игли, фолии, лажици, лулиња, остатоци од цоинт и сл.), исчезнувањето на вредни предмети и пари од дома, губењето апетит, невообичаените мириси на облеката, телото или просториите во куќата и сл.(Томовски Б., 1995,16-26).

Начините на конзумирање дрога зависат од видот на дрогата што се конзумира. Најчести начини на конзумирање на дрога се пер-орални (таблети, напитки, цваќање листови), потоа пушење, вшмркување, вбригување во кожа и инјектирање (интервенозно, интермускуларно, ректално). Инјектирањето како начин на конзумирање на дрога е најризичен, бидејќи може да предизвика многу инфекции и болести. Многу често приборот за инјектирање не е стерилен или го користат повеќе лица и може да предизвика многубројни инфекции како што се ХИВ, жолтица и др. Доколку при инјектирањето течноста наместо во вена се вбригува во артерија може да предизвика гангрена или труење на крвта. Труењето на крвта се предизвикува од инфекција на раната. Покрај споменатите инфекции може да се предизвика предозирање кое настанува по пат на инјектирање директно во крвниот систем на поголема количина на дрога или доколку јачината и количината на дрогата е непозната што најчесто води кон смрт. Кај консуматорите на дрога може да се појави апстиненцијата или апстиненцијалната криза, која се јавува како резултат на нагло прекинување на внесување на дрога кај лице кое подолго време е уживател на дрога. Апстиненцијалната криза се јавува во првите 24 часа, а вториот и третиот ден е со најголем интензитет, а во наредните денови состојбата се стабилизира. Во состојба на апстиненција настануваат голем број промени во организмот на уживателот на дрога, како што се: губење свест, намалување на крвниот притисок, грчеви во мускулатурата, силни халуцинации, а можно е и да се добијат епилептични напади. Во состојба на апстиненција на консумерот на дрога треба да му се укаже медицинска помош,

бидејќи неговиот живот е во опасност. Консумирањето на дрога предизвикува психичка и физичка дестабилизација и подолготрајното консумирање може да доведе до смрт. Во Република Македонија не постои евиденција со која може да се направи прецизна проценка бројот на консуматорите на дрога, бројката зависи од изворната информации. Според податоците кои се достапни во Република Македонија кои консумираат дрога се движи од 15.000-20.000, од кои 6.000 до 8.000 се во Скопје. Прецизна бројка на консуматори е отежната поради тоа што одреден дел од оваа популација е тешко достапна, а постои дел од популацијата кој е недостапен и поради тоа се прават бројни биобиохемикални истражувања. Бројот на лица во одредена популација е важен од два аспекта (Микиќ, В., Кузманоска, Г., Мемети, Ш., 2010, 9):

-Прво, големината на одредена популација е од особено значење при планирањето на програмите, со цел ефикасно да се искористат средствата во однос на бројот на потенцијални корисници на програмата. Додека при оценувањето на успешноста на одреден програм или сервис, важно е да се знае деноминаторот за определените индикатори на успешност.

-Второ, од епидемиолошки аспект, големината на одредена популација е важна за да се разбере динамиката на епидемијата, во смисла на бројот на зафатени лица, а за да се разбере преваленцата, неопходно е да се знае (или да се има разумна процена) деноминаторот на популацијата која е предмет на опсервација.

Нашиот законодавец уживањето на опојните дроги го инкриминирал како прекршок во Законот за прекршоците против јавниот ред и мир, при што е предвидена прекршочна одредба по член 20 која се однесува на уживање на наркотични дроги, психотропни супстанции и прекурзори за што следува глоба во износ од 200 до 500 евра во денарска противвредност.⁶⁰

⁶⁰ Закон за прекршоците против јавниот ред и мир, Сл. Весник на РМ бр. 66/07, 152/15

Табела бр.2- Преглед на прекршоци по чл.20 од ЗППЈРМ- Уживање на наркотични дроги и психотропни супстанции⁶¹

Прекршоци против ЈРМ									
Чл.20-Уживање на наркотични дроги и психотропни супстанции									
Година	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Бр.на прекршоци по чл.20 од ЗППЈРМ	547	450	399	413	328	381	219	314	492

Од дадената табела може да се констатира дека бројот на прекршоци по член 20 од Закон за прекршоци против ЈРМ почнувајќи од 2011 година е во благо опаѓање до 2017, каде има забележително намалување на бројот на прекршоци на 219 и во наредните години се бележи раст, при што во 2019 година се извршени 492 прекршоци. Во 2011 и 2012 година најголем број прекршоци се извршени на подрачјето на Охрид, а од 2013-2019 година најголем број прекршоци по член 20 се извршени на подрачјето на Штип.

ЗАКЛУЧОК

Сите учесници во криминалитетот поврзан со злоупотреба на дрога во континуитет ги осовременуваат начините на извршување на овој вид на кривични дела во насока на олеснување на транспортот, начинот на комуникација, начинот на прикривање и сл. Меѓународните криминалните организации вложуваат огромни финансиски средства за осовременување на методите и техники за извршување на овој вид на криминалитет, го следат трендот на развојот на технологијата и се во чекор со најновите достигнувања. Користат најсовремени лаборатории за производство и преработка на дрога, применуваат најсофистицирани хемиски процеси за екстракција на дрогата, при што се менува агрегатната состојба на дрогата и е невозможно да се открие, ги користат интернет алатките за комуникација и продажба на дрога, го

⁶¹Преземено од www.mvr.gov.mk, [пристапено: 25.05.2012]

осовременуваат транспортот и вложуваат финансиски средства за обуки на различни профили на човечки ресурси.

Посебен акцент треба да се стави на сторителите на кривичните дела поврзани со злоупотреба на дрога на нашата територија, бидејќи дилерите и консуматорите континуирано ги усовршуваат делинквентските тактики со што се овозможува дрогата да е лесно достапна на улица. Неопходна е поголема контрола и заострени превентивни и репресивни мерки од страна на органите на кривичниот прогон.

Библиографија

1. Богданова-Смилевска, Б., (2017), Ефикасноста на органите на кривичниот прогон во спречување, откривање, разјаснување и докажување на кривичните дела поврзани со злоупотреба на дрога, докторски труд, Скопје
2. Бошковиќ, М., (1998), Криминалистичка методика, Полицијска Академија, Београд
3. Водинелиќ, В.,(1976), Криминалистика, Савремена администрација, Београд
4. Водинелиќ В., Алексиќ Ж., (1988) Криминалистичка методика, Центар за образовање на кадри за безбедност и општествена самозаштита „Елисије Поповски-Марко“ Скопје
5. Гиновски, М., (1994), Родителски водич, дроги, опасности, знаци , Скопје
6. Dimovski, Z., Ilijevski, I., Babanoski, K., (2016), Narco-terrorism in the contemporary conditions: Financing of the terrorist activities by the illegal drug trafficking, International scientific conference Contemporary trends in social control of crime, Faculty of security – Skopje, vol. II, Ohrid
7. Закон за прекршоците против јавниот ред и мир, Сл. Весник на РМ бр. 66/07, 152/15
8. Зигел, Д., Бан де Бунт, Х., Зајик, Д., (2009), Глобален организиран криминал-трендови и случувања, Магор, Скопје
9. Кривичен законик на Република Македонија (2016)-пречистен текст
10. Лабовиќ, М., (2006), Власта корумпира на епистемолошко, глобално-политичко и национално ниво: вистината за Македонија и неспроведувањето на квалитативно новата предлог-Национална стратегија против корупцијата и организираниот криминал, Де Гама, Скопје

11. Мегваер, М., Морган, Р., Рајнер, Р., (2010) Оксфордски прирачник за криминологија, Нампрес, Скопје
12. Микиќ, В., Кузманоска, Г., Мемети, Ш.,(2010), Извештај од биобихејвиоралното истражување и процена на бројноста на популацијата кај лица кои инјектираат дроги во Македонија, Институт за јавно здравје на Република Македонија
13. Петровиќ А., (1978), Криминалистичка методика, Виша школа унутрашњих послова-Београд,
14. Report on drug seizures in Southeast Europe for 2015
15. Тодоровски, Љ., (2012), Развивање на стратегии за следење на развојот на наркокриминалот во Република Македонија и поставување на стандардизиран систем на контрола на дрога, докторска дисертација одбранета на Факултетот за безбедност, Скопје
16. www.mvr.gov.mk, [пристапено: 25.05.2012]

POLITIKAT GJEOSTRATEGJIKE TË DISA SHTETEVE NË RENDIN E RI BOTËROR

Msc.Senada LAÇKA

International University of Struga
s.lacka@eust.edu.mk

Abstract

From many international analysts on the parameters and geopolitical meaning, it has been concluded that this definition can be derived: "Geopolitics means any definition and treatment of the relationship between space (size, shape, position, climate, natural resources, etc.) and politics."¹

Since the fall of the USSR and the fall of the Berlin Wall, the new world order has begun a series of uninterrupted transformational processes through which the perfection of changes in models of international relations is occupying the main space of the 21-st century.

In a more academic objective, international relations should be understood as a study of the interaction between different actors who participate in global politics. This involvement may be of a state character, international organizations, governmental or non-governmental, state entities, etc.

Albanian nation is also a part of the geographical area, landslides, influences and geopolitical and geostrategic importance. Albanians are currently organized in two national states (Albania and Kosovo) and one in the process of demographic domination (North Macedonia). However, Albanian national remnants along the energy highway and the Silk Road between Asia, Europe, Turkey and the Russian and Chinese influence remain future challenges, especially in the Balkans.

The definition of such a strategic analysis within a state with geopolitical influence necessarily requires the recognition of diplomatic, economic, cultural, social, political and geographical circumstances through which is determined the objective of geostrategic importance in future periods of geopolitical importance.

States of geopolitical importance that have managed to resist the factors of violent change throughout international developments, especially in the cultural, ethnic and social spheres, those states again constitute strategic importance in future processes of the new order.

Keywords: *Geopolitics, Geostrategic, international relations, states.*

Abstrakt

Nga shumë analistë ndërkombëtar mbi parametrat dhe kuptimin gjeopolitik, është arritur në përfundim se mund të nxirret ky përkufizim: "*Gjeopolitika nënkupton çdo përcaktim dhe trajtim të raportit në mes të hapësirës (madhësisë, formës, pozitës, klimës, pasurive natyrore etj.) dhe politikës*".⁶²

Që nga rënia e BRSS-së si dhe rënia e Murit të Berlinit, rendi i ri botëror ka zënë një fill të proceseve të pa ndalura transformuese përmes së cilave përsosja e ndryshimeve në modele të marrëdhënieve ndërkombëtare po zë hapësirën kryesore të shekullit XXI.

Në një objektiv më akademik, marrëdhëniet ndërkombëtare duhet t'i kuptojmë si një studim i ndërveprimit mes aktorëve të ndryshëm të cilët marrin pjesë në kuadër të politikës globale. Kjo përfshirje mund të jetë e karakterit shtetëror, organizatave ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo joqeveritare, entitete shtetërore etj.⁶³

Brenda hapësirës gjeografike, rrëshqitjes, influencës e rëndësisë gjeopolitike e gjeostrategjike, bënë pjesë edhe kombi shqiptar. Shqiptarët aktualisht janë të organizuar në dy shtete kombëtare (Shqipëri e Kosovë) dhe një në proces të dominimit demografik (Maqedoni). Megjithatë mbetjet kombëtare shqiptare përgjatë autostradës energjetike dhe rrugës së mëndafshhtë mes Azisë, Evropës, Turqisë dhe ndikimit Rus e Kinez, mbeten sfidat e ardhshme veçanërisht në Ballkan.

Përkufizimi i një analize të këtillë strategjike brenda një shteti me ndikim gjeopolitik, domosdoshmërisht kërkon njohjen e rrethanave diplomatike, ekonomike, kulturore,

⁶² Dr.Sc. Haxhi Ferati, "*Gjeopolitika me Gjeostrategji*", Prishtinë, 2005. Fq. 8.

⁶³ Karen A. Mingst. "*Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*". Tiranë, 2010. Fq. 18-19.

sociale, politike dhe gjeografike përmes së cilave përcaktohet objektivi i rëndësisë gjeostrategjike në periudhat e ardhshme të rëndësisë gjeopolitike.

Shtetet me rëndësi gjeopolitik të cilat kanë arritur t'i rezistojnë faktorëve të ndryshimeve të dhunshme përgjatë zhvillimeve ndërkombëtare, veçanërisht në rrafshin kulturor, etnik e social, ato shtete përsëri përbëjnë rëndësinë strategjike në proceset e ardhshme të rendit të ri.

Fjalë Kyçe: *Gjeopolitika, Gjeostrategjia, marrëdhënie ndërkombëtare, shtetet.*

Hyrje

Historitë e bashkimit të forcave nga fuqitë lokale apo rajonale për qëllime të përbashkëta janë aq të lashta sa zanafilla e njerëzimit. Përmasat e këtyre marrëdhënieve kanë evoluuar, janë ndryshuar e transformuar përgjatë gjithë shekujve deri tek Paqja e Vestfalisë 1648, që ndryshe njihet si lindja nocionit komb.⁶⁴

Marrëdhëniet ndërkombëtare janë një proces i cili lind shumë natyrshëm dhe krijon pjesëmarrje direkt, indirekt apo vrojtuese, varësisht nga pozicioni politik, gjeografik apo i rëndësisë së këtij vrojtimi. Një ngjarje kudo në botë, një gazetë, një lajm me informacione jashtë rëndësisë kombëtare, një interesim mbi zhvillimet e samitit të G-20 -të, përbëjnë një proces fragmentues të marrëdhënieve ndërkombëtare individuale.

Zhvillimet përgjatë viteve të 90 - ta dhe gjatë fillim shekullit XXI, nxorën në pah nevojën e domosdoshme për ndryshim përmbajtjesor të rendit të ri botëror. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe rënia e Bashkimit Sovjetik, botën e gjeti fati me një fuqi unipolare.⁶⁵

Derisa kjo gjendje unipolare vazhdoi përmbi dy dekada me radhë, fuqia unipolare perëndimore në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndihmuan procesin e

⁶⁴Eqrem Zenelaj, "Historia e Diplomacisë". Prishtinë, 2013. Fq. 195

⁶⁵ Unipolare: I referohet mbizotërimit në marrëdhëniet ndërkombëtare të një fuqie të vetme kombëtare, apo siç njihet ndryshe si "Superfuqi botërore".

shumë vendeve të dala nga rënia e komunizmit drejtë integritimit brenda një vlere të unionit evropian përmes tregtisë së lirë dhe respektimin e standardeve të reja ndërkombëtare. Procesi i integritimeve evropiane për rajonin brenda një projekti të përbashkët të vlerave e integritimeve, mbetet një ndryshim shumë i madh për cilën mund të thuhet se objektivisht flitet për një rend të ri botëror në shekullin XXI.

Megjithatë, marrëdhëniet ndërkombëtare të shekullit XXI vazhdojnë rrjedhën e rritjeve dinamike të superfuqive të reja rajonale, kontinentale, me objektiva të dominimit botëror. Me ngritjen e këtyre kapaciteteve të reja ushtarake, ekonomike e politike rajonale, si Rusia, Kina, Japonia, Turqia etj., unipolariteti perëndimor vazhdon rrjedhën e transformimit të domosdoshëm, e cila në një aspekt do shënonte fundin e fuqisë perëndimore duke u kthyer me një botë bipolare të rendit të ri botëror gjatë shekullit XXI.

Ndonëse ky transformim vazhdon rrjedhën objektive, jo i gjithë procesi vazhdon natyrshëm siç do dëshironin fuqitë ekonomike e ushtarake. Megjithatë rrethanat bashkëkohore botërore flasin hapur për një nevojë të rendit të ri botëror brenda së cilës influenca dhe fuqia nuk guxon të lihet vetëm brenda një superfuqie botërore pa një kundër peshë me impakt gjeopolitik.

Marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve dhe Rendi i Ri Botëror, tashmë ka filluar. Pozicionimi objektiv, strategjik, ekonomik e ushtarak, është vënë në lëvizje dinamike nga shtetet e ndryshme me impakt ndikimit botëror. Duke u pozicionuar përkrah realizimit të interesave influencues brenda rajonit e më gjerë dhe hapësirës ndërvepruese në 100 vitet e ardhshme. Një gjë duhet të kemi parasysh, çdo ndryshim në rrafshin ndërkombëtar ekziston një kosto për shoqëritë e shtetet, veçanërisht ndaj popujve të vegjël përgjatë linjave të rrëshqitjes të cilat janë pengesa e realizimit objektiv të interesave të fuqive të mëdha ndërkombëtare.

Pozicionimi shqiptar në dekadën e artë përgjatë shekullit XXI përcakton fatin e tyre në këtë rend të ri botëror. E kaluara tek shqiptarët tashmë ka lënë gjurmët e saja përgjatë 100 viteve që lamë pas, e ardhmja gjithashtu përcakton edhe 100 vitet e tjera për kombin tonë që të rroj i bashkuar apo i asimiluar përgjithmonë.

Shtetet më të fuqishme gjeopolitike të shekullit XXI

Parametrat gjeopolitike e gjeostrategjike, mbesin përcaktuesit e variablave të ndryshimeve globale. Ato masin gamën e interesave internacionale, masin rëndësinë strategjike e politike, masin linjat e komunikimit botëror të zhvillimit ekonomik, ushtar e diplomatik. Parametrat gjeopolitik brenda një këndvështrimi të thuktë mund të themi se paraqet skanerin mbi arteriet kryesore ekonomiko - gjeografike të vendeve të fuqishme botërore.

Parametrat mbi hapësirën dhe politikën brenda konceptit të gjeopolitikës, janë përcaktuesit e ndryshimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky raport i këtyre dy elementëve (Hapësira politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare) përcakton pikëtakimin e përplasjeve të interesave ndërmjet këtyre dyjave si dhe arsyes për negociim ndërkombëtar.

Këto fërkime gjeopolitike nga fuqitë me impakt global, kanë përjetuar fërkimet e tyre përgjatë gjitha këtyre zhvillimeve të ri-pozicionimit të tyre nëpër pikat më kulmore gjeostrategjike. Me qëllim të shtjellimit të kësaj, le të ndalemi një çast tek përplasjet ekonomike mes SHBA-ve dhe Kinës në këtë fillim shekulli XXI. I gjithë ky proces mund të përkufizohet si një pozicionim i ri gjeopolitik e gjeostrategjik në vendimmarrjen e ardhshme ndërkombëtare.⁶⁶

Fërkime të ngjashme dhe ri-pozicionime karshi interesave ekonomike me impakt global, tashmë kanë kapluar gjitha superfuqitë botërore ekonomike. Përplasjet BE - SHBA, SHBA - KINË, SHBA - Turqi, përcaktojnë vetëm disa nga segmentet negociuese për tarifatat e ardhshme tregtare dhe peshën gjeopolitike të shekullit XXI. Me gjithë përpjekjet për negociim dhe superioritet nga ana e SHBA-ve përmes vënies së tarifave në tregun ndërkombëtar, superfuqitë si Rusia dhe Kina, mbesin brenda objektivit të përbashkët në hapjen e linjave të reja tregtare dhe garantimin e tyre në tregjet e ardhshme, me fokus tregun evropian dhe balancimin e fërkimeve të ardhshme brenda rrugëve të reja ndërkombëtare.

Këto linja tregtare me fokus tregun evropian, tashmë kanë gjetur hapësirën për zhvillim përmes disa nga vendet ballkanike. Kriza ekonomike evropiane që lamë pas,

⁶⁶<https://www.reuters.com/article/us-usa-trade-wto/us-and-china-clash-at-wto-over-ideology-states-role-idUSKBN1KG22G>

u shfrytëzua si një mundësi reale për investim në tregjet Ballkanike me theks tregun Evropian.⁶⁷ Varësia Evropiane ndaj këtyre furnizimeve, veçanërisht asaj të energjisë, përbënë thelbin kryesor për një raport liberal ndërmjet Ruisë e SHBA-ve në procesin e ardhshëm.

Shtetet si Turqia dhe Japonia, përsëri do të kanë peshën e balancës ndërmjet një trekëndëshi gjeostrategjik në kontinentin evropian gjatë proceseve të ardhshme ndërmjet interesave Ruse, Kineze dhe Evropiane. Japonia përbënë aleatin më të madh në Azi për SHBA-të, e cila për gjatë shekullit XX është përdorur si zëvendës i ndikimit Kinez, ndërsa Turqia gjithashtu përbënë aleatin më të madh ushtarak e gjeostrategjik ndërmjet Ruisë, Azisë dhe Evropës, por i cili gjatë shekullit XX nuk ka arritur të ketë rol të rëndësishëm në energjinë evropiane.

Shekulli XX-të ishte një arenë përplasjesh që kishte filluar me vendet ballkanike dhe kishte përfunduar me një luftë të ftohtë me qendër Evropën. Shekulli XXI, pa asnjë dyshim do të sjellë fërkimet më të mëdha përsëri në vendet e Ballkanit, e cila është një arterie kryesore ndërmjet BE-së, Kinës, Ruisë dhe Turqisë. Ndërsa SHBA do të luaj rol in arbitrit edhe për 100 vitet e ardhshme brenda kësaj arterie vendimtare ekonomike botërore njësoj sikurse në kanalin e Suezit, Panamasë, Dardaneleve dhe Ballkanit.

Arteriet e shekullit XXI ndërmjet Evropës, Ruisë dhe Kinës, kalojnë nëpër hapësirën tokësore gjeografike shqiptare dhe mbetjeve të tyre. Blloqet dhe ripozicionimet e tyre gjeostrategjike tashmë përbëjnë bazën e kësaj pikënisje e cila në dekadën e ardhshme do të formësohet edhe më shumë drejtë përmbushjes objektive strategjike në raportet ndërkombëtare.

Shtetet gjeopolitike të shekullit XXI, marrin trajtën e rëndësisë nga disa faktor. Këta faktor mund të jenë të karakterit gjeografik, ekonomik, ushtarak e politik. Rëndësia dhe pesha e tyre shënon rëndësinë e saj në bazë të fërkimit nga forcat të fuqisë ekonomike e ushtarake.

Në vazhdim, do të paraqesim një kronologji të shteteve me rëndësi gjeostrategjike me rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërveprimi i tyre, pozita gjeografike,

⁶⁷ <https://nationalinterest.org/feature/china-buying-ports-influence-across-europe-26210>

sociale, ekonomike e ushtarake, janë disa nga segmentet e peshës së tyre në procesin e ardhshëm të rendit të ri botëror.

Shtetet gjeostrategjike dhe shtetet përcaktuese në rendin e ri botëror

Shtetet të cilat përcaktojnë zhvillimet dhe përmasat e rendit të ri botëror, jo domosdoshmërisht nënkuptojmë si shtete gjeostrategjike. Ato mund të kanë përmasat e ndikimit ushtarak, ekonomik dhe rëndësisë në institucionet ndërkombëtare, por gjithashtu mund të mos janë vende gjeostrategjike të linjave ndërkombëtare, rast pozita gjeografike e Kinës. Prandaj mbi rëndësinë e shteteve me ndikim brenda rendit të ri botëror do të flasim në mënyrë të veçantë për secilin vend. Shtetet me rëndësi gjeostrategjike parimisht ndërlidhen vendet të cilat ndikohen nga faktorët gjeografik, pasi ato në një aspekt përmes hapësirës dhe pozitës gjeografike paraqesin informacionin, kufizimin apo prekin planifikimin politik e ushtarak të interesave ndërkombëtare.

Thënë ndryshe, gjeostrategjia ndërlidhet me pozitën gjeografike të shteteve dhe rëndësinë e saj përmes pozitës së saj karshi linjave të rëndësisë gjeografike ndërmjet shteteve apo kontinenteve, shembull ngushticat e kalimeve ndërkombëtare siç është Kanali i Suezit, Gjibraltari, Dardanelet etj.⁶⁸

Shtetet e rëndësisë gjeostrategjike mund t'i përkufizojmë në dy lloje të shteteve:

Shtete të cilat përcaktojnë gjeostrategjinë e interesave ndërkombëtare dhe

Shtete të cilat përdoren për gjeostrategji ndërkombëtare.

Shtetet të cilat përcaktojnë gjeostrategjinë dhe gjeopolitikën ndërkombëtare si shkak i pozitës së tyre gjeografike, nuk janë të shumta në numër. Sepse pjesa më e madhe e tyre janë transformuar përgjatë proceseve të ndryshimeve ndërkombëtare sipas interesave gjeostrategjike të superfuqive.

Mesin e shteteve me rëndësi gjeostrategjike, bënë pjesë edhe Turqia. Ajo ka një pozitë të fuqishme ndërkombëtare gjeografike. Pozita e saj është një urë lidhëse mes

⁶⁸ Vep. Ecit. "Gjeopolitika me Gjeostrategji", Prishtinë, 2005. Fq. 25.

Lindjes e Perëndimit. Ajo përbënë boshtin e linjave më jetike evropiane në sektorin e energjisë nga deti Kaspik, Rusia dhe Azia në përgjithësi.⁶⁹

Turqia gjithashtu përgjatë dy luftërave botërore i ka rezistuar një transformimi të dhunshëm karshi rëndësisë gjeostrategjike dhe vazhdon të ruaj ndikimin e saj ndaj së cilës rëndësia gjeopolitike në këtë fillim shekulli XXI është në anën e shtetit turk. Gjithashtu, shtete të rëndësisë gjeostrategjike bënë pjesë edhe Egjipti përmes kanalit të Suezit. Ajo paraqet arterien kryesore detare të transporteve ndërkombëtare kontinentale ndërmjet Azisë, Evropës e SHBA-ve.

Përkundër ndërhyrjeve të shpeshta në menaxhimin e kanalit nga fuqitë perëndimore në veçanti, gjithsesi egjiptianët përsëri kanë kthyer ndikimin e tyre brenda interesave të tyre. Egjipti përgjatë gjithë historisë së tij ka transformuar qytetërimet e ndryshme dhe nuk është transformuar asnjëherë.⁷⁰

Ndërsa sa i përket shteteve të cilat përdorën për strategji ndërkombëtare të cilat kanë target ndikimet gjeopolitike rajonale ndërkombëtare janë të shumta nëpër botë. Ato fillojnë që nga shtetet ballkanike, veçanërisht trojet shqiptare të cilat përbëjnë arterien e rëndësisë gjeostrategjike evropiane, ruse, kineze, turke dhe të shteteve të bashkuara të Amerikës. Shtetet e rëndësisë gjeopolitike që përdorën për strategji nga superfuqitë janë edhe shtetet si Tajvani, Kuvajti, Izraeli e me dhjetëra shtete të ndryshme në nivel global.

Me fjalë tjera, gjeopolitika me gjeostrategji ndërlidhë interesat gjeografike, politike, ekonomike e ushtarake të superfuqive të ndryshme ndërkombëtare për një qëllim të vetëm, atë të ndikimit përgjatë proceseve të rëndësisë së rendit të ri ndërkombëtar dhe përgjatë saj.

Shtetet të cilat menaxhojnë rëndësinë e gjeostrategjisë së tyre me impakt ndërkombëtar janë ato shtete të cilat kanë pozitën gjeografike, ekonomike, ushtarake dhe të popullsisë. Në të kundërtën, cilado që prej tyre mungon, varësia nga shtetet me ndikim gjeopolitik është e pashmangshme.

⁶⁹ <https://www.geopolitica.info/european-energy-diversification/> Kontrolluar me 16.12.2018.

⁷⁰ Ahmet Davutoglu. "Qytetet dhe qytetërimet". Shkup, 2016. Fq. 238.

Rëndësia gjeopolitike e SHBA-ve

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përbëjnë modelin më kulmor botëror të qeverisjes. SHBA është federata më e vjetër botërore e cila përbëhet nga dhjetëra shtete me një popullsi mbi 300 milion banorësh, brenda një hapësire gjeografike e katërta në nivel botëror. Pasuritë e saj nëntokësore e gjeografike janë shumë dimensionale. Ato përbëjnë bazën thelbësore të zhvillimit ekonomik dhe ndikimit të saj në rritjen si superfuqia më e madhe botërore.

SHBA, konsiderohet si vendi i shumë mekanizmave të rëndësishëm ndërkombëtar si bashkëthemelues siç janë Kombet e Bashkuara, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj.⁷¹ vend në cilin selitë botërore gjenden aty. Ajo është gjithashtu themeluesja e aleancës më të fuqishme botërore, NATO menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Politika e jashtme e SHBA-ve është mjaftë e fuqishme, ajo ka një qasje të unifikuar karshi zhvillimeve ndërkombëtare, një element që i shton rëndësinë në vendimmarrjen botërore. SHBA gjithashtu është vendi më i fuqishëm ekonomik, ushtarak e politik në nivel botëror.

Pozita gjeografike tej oqeanike mbetet një favor i rëndësisë së saj gjeopolitike e cila e bën të pa pathyeshme ndaj sulmeve të huaja. Ajo ka një flotë të fuqishme detare e cila kontrollon pjesët më të mëdha botërore të oqeanëve dhe linjave tregtare. Çdo hyrje e dalje në ujërat ndërkombëtare varet nga hapësira e flotës detare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.⁷²

Ndikimi i saj në zhvillimet ndërkombëtare është bazik për zhvillimet brenda një rendi të ri ndërkombëtar. Roli i saj në proceset e ardhshme përcakton jo vetëm peshën e influencës dhe të ardhmes së saj si superfuqi, por gjithashtu përcakton rrjedhën e

⁷¹ https://en.wikipedia.org/wiki/United_States

⁷² <http://www.aei.org/publication/5-ëays-the-us-navy-marine-corps-and-coast-guards-global-presence-matters-right-here-at-home/>

shumë proceseve të rëndësishme të karakterit ndërkombëtar brenda një rendi të ri botëror.

Shumë shtete në nivel botëror varen nga e ardhmja e SHBA-ve. Ajo mund të filloj nga shtetet e Lindjes siç është Izraeli, Kuvajti etj., deri tek vendet ballkanike siç është Kosova, Bosnja etj. Shtetet e Bashkuara gjithashtu përcaktojnë edhe ndikimin dhe fushëveprimin e superfuqive tjera botërore siç janë Kina, Rusia, BE dhe ato në proces e sipër siç është Turqia, Japonia, Meksika.

Rendi i ri botëror nuk mund të imagjinohet pa pjesëmarrjen e SHBA-ve, siç nuk mund të përlllogaritet e ardhmja e politikës ndërkombëtare pa atë. Fuqia e natyrshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e koordinuar me pozicionin gjeografik, ekonomik dhe atë ushtarak e bënë këtë të fundit aktorin kyç gjatë shekullit XXI.⁷³

Në shumë raste gjatë këtij fillim shekulli XXI, fuqia amerikane është parë si '*Agimi i epokës Amerikane*'. Shkëndijat e para të këtij ndryshimi mund të themi se paraqesin një zëvendësim të Epokës Evropiane të deritanishme, sepse linjat e pikave të interesave të shekullit XXI kalojnë mundësitë menaxheriale të ndikimit evropian si një politikë vendimmarrëse e bashkuar.

Transformimi i aleancave gjeopolitike e gjeostrategjike amerikane në këtë fillim shekull tashmë është e qartë drejtë një ri pozicionimi të ri përmes aleancave të reja strategjike edhe për 100 vitet e ardhshme.

Shembujt e fuqisë amerikane nëpër botë dëshmojnë hapur se shumë vende të pushtuara nga ajo, janë kthyer në një të ardhme të afërt në aleatët më të fuqishëm rajonal. Shembujt e saj janë Japonia, Koreja e Jugut, Kuvajti, e një të ardhme të afërt edhe Kosova.

E që gjithashtu ky formim i shteteve të fuqishme do të vazhdon përgjatë dekadave të ardhshme që nga Polonia e deri te shtetet e Kaukazit aziatik.

⁷³ George Fridma, "*100 Vitet e ardhshme*". Tiranë, 2010. Fq. 23.

Rëndësia gjeopolitike e gjeostrategjike Ruse

Pas rënies së Stalinit, reformat e thella të ndërmarra nga Mihail Gërbaçov në fund të viteve të 80- ta brenda Bashkimit Sovjetik, përfundimisht i dhanë fund sistemit multipolar ndërkombëtar brenda superfuqive botërore.⁷⁴

Deri në këtë periudhë, bota ishte e balancuar brenda dy superfuqive botërore (SHBS-BRSS) e cila kishte përjetuar gjithashtu edhe një luftë të ftohtë botërore ndërmjet blloqeve perëndimore dhe Paktit të Varshavës.

Përkundër kësaj rënie të BRSS-së, Rusia përgjatë këtyre dekadave të heshtura përsëri në fillim të shekullit XXI po rimerr vetën si një superfuqi botërore e cila ka tendencën e zëvendësimit të sistemit unipolar ndërkombëtar perëndimor.

Rusia është vendi më i madhi gjeografik në botë. Ajo përbëhet nga një popullsi qindra milionëshe dhe një ekonomi mesin e 10 ekonomive më të fuqishme botërore. Arsenalet e saj bërthamore përbëjnë fuqinë më të madhe botërore dhe mbetet si njëri nga fituesit e Luftës së Dytë Botërore kundër nazistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pozita gjeografike ruse i jep disa përparësi dominuese në gjeostrategjinë globale. Ajo ka një shtrirje nga kufiri i kontinentit amerikan, evropian dhe përfundon deri në atë aziatik. Ndonëse ka kaluar nëpër një proces të shpërbërjes së shumë shteteve nga federata ruse, ajo përsëri mban primatin e saj të ndikimit në Evropë dhe Azi.

Fuqia ushtarake dhe ekonomike ruse në fillim të shekullit XXI po merr trajtën e rëndësisë së ndikimeve gjeopolitike ndërkombëtare. Historikisht Rusët kanë luajtur rol të rëndësishëm në popullsinë sllave përmes së cilëve është synuar depërtimi në ujërat e ngrohta të vendeve ballkanike.

Ajo është eksportuesja më e madhe botërore e gazit natyror, veçanërisht drejtë vendeve evropiane e ballkanike. Rusia përgjatë dekadave të fundit ka lansuar strategjitë e reja ekonomike e gjeostrategjike ndërkombëtare. Linjat e gazit natyror janë drejtë ndryshimit të diskursit të tyre nga linjat veriore përmes Gjeorgjisë drejtë linjave 'Rrjedha Turke' e cila prek edhe një pjesë të shumë vendeve ballkanike me objektiv tregun ballkanik dhe Evropian.

⁷⁴ Paskal Ory, " *Historia e re e ideve politike*". Pejë, 2008. Fq. 364.

Ne gjeopolitikën ruse, Ballkani mbetet pika më kritike e fërkimeve gjeostrategjike në shekullin XXI për dominim dhe ndikim të drejtpërdrejtë të linjave të reja të energjisë dhe zhvillimit ekonomik e pozicionimit ushtarak. Ballkani për Rusët paraqet dy rëndësi strategjike kombëtare:

Ballkani është rajoni më i populluar në botë me ortodoks në nivelin botëror dhe paraqet boshtin kryesor të trashëgimisë ortodokse, sllave përgjatë zhvillimeve historike;

Ballkani për rusët paraqet rëndësinë e saj gjeostrategjike për depërtim në ujërat e ngrrohta të cilat janë të një rëndësie të madhe ekonomike, ushtarake dhe të sigurisë për ruajtjen e sovranitetit dhe mbrojtjen nga NATO e SHBA-të në rast një sulmi të ardhshëm.

Rëndësia gjeopolitike e BE – së, sfidat në rendin e ri botëror

Unioni Evropian, i frymëzuar nga ideja për t'i dhënë fund luftërave të shumta dhe të përgjakshme midis fqinjëve për shekuj më radhë vazhdon rrugën e saj te integrimi. Me përfundimin e Luftës së Parë e të Dytë Botërore, komuniteti evropian i industrive të rënda filloj bashkëpunimin ekonomik e politik ndërmjet vendeve në kontinentin e vjetër. Këta ishin hapat e parë drejtë frymëzimit të një unioni të përbashkët që ne sot e njohim si BE.

Bashkimi Evropian, ndonëse ende kalon nëpër procese sfiduese për të ardhmen e saj, objektivat kryesor të sigurisë përcaktojnë të ardhmen e saj. Një treg i përbashkët, një forcë e përbashkët për sigurinë dhe garancia mbi lirin e lëvizjes, janë baza substanciale mbi cilën është ndërtuar BE. Traktati i "Mastriht" për Bashkimin Evropian të vitit 1993 dhe Traktati i Amsterdimit në vitin 1999 përbënë forcimin e idesë mbi të ardhmen e BE-së dhe zgjerimin e saj.⁷⁵

Sot, BE është një gjigant ekonomik në nivel botëror, ajo ka monedhën e vet të unionit si dhe ndihmon vendet në tranzicion përmes reformave ekonomike, administrative e politike rajonale, veçanërisht ato në gadishullin ballkanik, drejtë anëtarësimit të plotë brenda familjes evropiane.

⁷⁵ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en

Pozita e saj gjeografike karakterizon një multikulturalizmi të lartë me një popullatë në plakje dhe një depërtim i lartë i refugjatëve nga vendet e Afrikës e të lindjes, si një domosdoshmëri për mbajtjen ekonomisë së saj. Varësia e saj ndaj energjisë ruse, përbënë njërën nga hendekët më të mëdha në sigurinë e kontinentit, ndërsa anën tjetër Rusia konsiderohet si armiku kryesor për zgjerimin drejtë Ballkanit perëndimor me anëtarët e rinj në BE dhe në NATO.⁷⁶

Rëndësia e BE-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rendin e ri botëror, është e një rëndësie të veçantë jo vetëm në rrafshin ekonomik por edhe në atë ushtarak e gjeostrategjik. Raportet e saja me SHBA-të mbesin të rëndësishme së madhe mbi sigurinë kombëtare, veçanërisht në mbrojtje kundër zgjerimit rus drejtë kontinentit evropian. SHBA vazhdon të mbetet aleati më i fuqishëm i BE-së, ndërsa shtetet si Turqia që janë ndër anëtarët më të rëndësishëm të NATO-së në skajin evropian, vazhdon të shihen me skepticizëm nga BE për shkak të aspektit religjion dhe epërsisë gjeostrategjike në rolin e ardhshëm mes Azisë, Evropës, Kinës dhe Rusisë.

Rëndësia gjeopolitike e gjeostrategjike e Kinës

Shteti kinez, në rrafshin ndërkombëtar përbënë njërën nga boshtet më të rëndësishme të zhvillimeve ndërkombëtare. Ajo ka një popullsi ndër më të mëdha në botë, me një territor gjithashtu gjigant në nivelin botëror. Kina gjithashtu përbënë njërën nga segmentet më të rëndësishme të tregtisë globale me një rritje enorme tregtare në eksport të mallrave kineze drejt tregjeve ndërkombëtare, veçanërisht atyre evropiane e në SHBA.

Kina është njëri nga 5 anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit dhe është një vend me fuqi nukleare ndërkombëtare. Kapacitetet ushtarake kineze përbëjnë një ushtri gjigante tokësore me një forcë ajrore mjaftë moderne dhe një gjigant i zhvillimit teknologjik në garën hapësinore dhe atë kontinentale. Përveç anëve së favorshme kineze në popullsi, territor, zhvillim ekonomik dhe atë të fuqisë ushtarake, Kina përballlet me njërin nga sfidat më të mëdha në gjitha shekujt, ajo e linjave të reja tokësore e detare për eksportim të tregtisë së saj. Ky element përbënë

⁷⁶ Samuel P. Huntington, "Përplasja e qytetërimeve". Tiranë, 2017. Fq. 144.

sfidën kryesore për shtetin kinez, e cila mbetet ndër strategjitë më kulmore gjatë këtij fillim shekulli XXI. Ajo ka një pozitë të izoluar gjeografike me një territor të pakalueshëm nga ana perëndimore dhe veriore, ndërsa anën detare të cilën e përdor si linjë të tregtisë së jashtme vazhdon të paraqet sfida konfigurimi gjeostrategjik Tajvanez dhe ai i flotës detare amerikane.⁷⁷

Kina gjatë shekullit XXI prioritet të saj ka hapjen e linjave të reja të rrugëve të mëndafshita ndërkombëtare. Njërin ndër opsionet e saj është linja përmes territorit të saj nëpër territorin e Kazakistanit dhe Turqisë që më pastaj të kalon përmes vendeve ballkanike. Gjithashtu Kina mbetet e përkushtuar në investimet e mëdha nëpër portet ndërkombëtare si në Greqi dhe hapjen e linjave të reja përmes lumenjve, siç është projekti i "Lundrimin mbi Moravë" nga porti i Selanikut, Vardarit, Moravës dhe në Danub të Serbisë.

Rëndësia e Kinës në etapat e ardhshme të marrëdhënieve të reja ndërkombëtare brenda një rendi të ri botëror përbënë rëndësinë e saj balancuese në fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit dhe një fuqi e madhe ushtarake e nukleare. Shtetet gjeopolitike të fuqishme janë ato shtete të cilat përmbushin objektivin strategjik, ekonomik, ushtarak e të popullsisë, Kina përmbush tre parametra përveç atë të hapësirës strategjike ndërkombëtare.

Rëndësia gjeopolitike e gjeostrategjike Turke

Turqia ka qenë historikisht një vend i rëndësisë së madhe gjeopolitike botërore përkundër që kjo nuk përbënë boshtin e rendit të ri botëror. Ajo zë një pozicion të rëndësisë gjeografike ndërmjet Evropës dhe Azisë, zë një hapësirë ndërmjet superfuqive botërore siç është Rusia, Kina, Evropa dhe SHBA-të. Turqia është aleati më i hershëm i NATOS. Ajo gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, përbente një aset gjeopolitik të rëndësisë për bllokun perëndimor.

Me rënien e bashkimit sovjetik, Turqia përsëri ka marrë vëmendjen ndërkombëtare të rëndësisë strategjike. Ajo ka një pozitë gjeografike midis tregjeve të mëdha të

⁷⁷ <https://worldview.stratfor.com/article/geopolitics-china-great-power-enclosed>

energjisë të cilët janë prodhuesit më të mëdhenj botëror. Rusia dhe Kaukazi përbëjnë njërin nga këta segment me rëndësi të madhe të transitit të energjisë drejtë Evropës dhe perëndimit.

Në anën tjetër, Turqia është njëra në mesin e 20 ekonomive më të fuqishme botërore. Ajo ka një popullsi kryesisht të re dhe të madhe me rreth 100 milion banor. Historikisht është dëshmuar si një superfuqi e përmasave botërore në Perandorinë Osmane të dikurshme, e cila gjithashtu vazhdon rrugëtimin drejt këtij objektivit në shekullin XXI.

Lidhjet e saj kulturore, fetare, etnike dhe të mbetjeve osmane nëpër botë përfshinë një gjeografi të madhe si në Azi, Afrikë e po ashtu edhe në Evropë e Ballkan. Ndikimi i saj përmes këtyre elementëve konsiderohet në botën Islame si vendi më me ndikim në Botë dhe vlerësohet si një shpresë e ringjalljes së qytetërimit islam gjatë dekadave në vazhdim.⁷⁸

Pavarësisht se Turqia përmbush disa nga segmentet e rëndësisë gjeopolitike siç është ana strategjike gjeografike, ekonomike e ushtarake, gjithsesi ana e popullsisë ende vazhdon të tkurrë ndikimin e saj si një lojtar i përcaktimit të rolit të saj në rendin e ri botëror. Turqia është njëri ndër aleatët më të besueshëm të SHBA-ve dhe konsiderohet si një aleancë e fuqishme e NATO-së, por që dekadën e fundit ka pësuar një diskurs të raporteve të reja gjeostrategjike, ekonomike e ushtarake me Rusinë. Pavarësisht këtyre diskurseve, interesat ballkanike turke e amerikane, janë elementët të cilët i bashkojnë drejtë një objektivit të përbashkët brenda peshës së influencës amerikane dhe interesave gjeostrategjike turke në rendin e ri botëror.

Konkluzion

3. Галев, Гале. „Слободата на договарањето и нејзината економска основа – стоковното производство“. *Годишник на Правниот Факултет во Скопје*. (1999-2001): 147- 165.

4. Д. Мариен Блер, Мерл Х. Вајнер, Меѓународно семејно право: Конвенции, статутни, регулаторни материјали, Магор, 2009.
5. Куштримовиќ – Ковачевиќ, Радмила. *Граѓанско право (Општи део)*. Друго измењено и допуњено издање. Ниш: Сириус, 1995.
6. Куштримовиќ – Ковачевиќ, Радмила, Мирослав Лажиќ. *Стварно право*, Ниш:2009.
7. Мицковиќ, Дејан, Семејството во Европа XVI-XXI век, Блесок, 2008.
8. Мицковиќ, Дејан, „Бракоразводните системи во земјите на Европската Унија“, *Евродијалог, списание за европски прашања*, 2/2002, Студентски збор, Скопје, 2002.
9. Мицковиќ, Дејан, Ристов, Ангел, „Промените во семејството и реформите во семејното право во Европските земји“, *Зборник на Правниот Факултет „Јустинијан Први“ во Скопје во чест на проф. Наум Гризо, Правен Факултет „Јустинијан Први“ во Скопје*, 2011.
10. Спировиќ - Трпеновска, Љиљана, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, *Семејно право*, Скопје: Блесок 2013.

Нормативни акти

1. Законот за облигационите односи. *Службен весник на Република Северна Македонија* 18/2001, 4/2005, 5/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009 и 78/2001.
2. Основен закон за бракот, *Службен весник на Социјалистичка Федеративна Република Југославија* бр. 28/1965.
3. Закон за семејството, *Службен весник на Република Северна Македонија* бр. 80/92, Изм. 9/96, У. бр. 149/99, У. Бр.15/01, 38/2004, 33/06, 84/08, 156/10, 44/12.

4. Законот за сопственост и други стварни права, *Службен весник на Република Северна Македонија* 18/2001, 31/2008, 92/2008, 139/2009, 35/2010.
5. Устав на Република Северна Македонија. *Службен Весник на Република Северна Македонија*, 52/1991, 1/1992, 31/1998, 91/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009, , 13/2009, 49/2011, 6/2019.

EMERGJENCA E EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT (VLERËSIME DHE ANALIZA NGA AKTUALITETI SHQIPTAR)

Dorian Leka, Ph.D. (cand.)
(Lecturer)

International University of Struga
d.leka@eust.edu.mk
Nehemiah Gateway University
dorian.leka@ng.university

Abstrakt

Punimi orientohet në drejtim të analizës dhe vlerësimeve mbi procesin e edukimit ligjor të publikut, duke synuar jo vetëm shpjegimet e kuptimit të procesit aktual, pasqyrimin e një tabloje përmbledhëse nga legjislati, deri tek reagimet institucionale, por edhe me përgjegjësitë e individëve dhe zgjidhjet e përshtatshme.

Informacionet janë siguruar nga burime zyrtare publike që korrespondojnë me statet kohore në trajtim; Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut; Botimet dhe Vendimet e Kuvendit dhe Komisionit të Posaçëm; statistikat dhe të dhënat sasiore nga INSTAT, vjetarë dhe botime periodike në nivel ministror dhe OJF-sh; botime shkencore dhe rrjete zyrtare elektronike informuese.

Ky punim shkencor, Emergjencia e Edukimit Ligjor të Publikut (Vlerësime dhe analiza nga aktualiteti shqiptar), është shkëputje e një cikli prej disa periudhash kohore që autori po hulumton aktualisht edhe në temën e doktoraturës, e cila është në proces dhe bazohet mbi funksionin e Edukimit Ligjor dhe Vullnetit Politik të Zgjidhjeve në Republikën e Shqipërisë.

Fjalët kyce: *Edukim ligjor i publikut, Strategji, Ndërgjegjësim, Çështje ligjore, Institucione vendimmarrëse, Ligj, Akte nënligjore, Raport, Vendim.*

Fjalorth:

ELP – Edukimi Ligjor i Publikut;

GENL - Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë;

EURALIUS - Projekt i Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Shqipërinë;

OPDAT - Programi i Ndhmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë;

OSBE – Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë

KUVENDI – Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

KOMISIONI I POSAÇËM - Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e

Drejtësisë

SH.C. – Shoqëria Civile

SELP – Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

TLAS – Shërbimi Ligjor Falas në Tiranë

1. Shpjegimi dhe rëndësia e Edukimit Ligjor të Publikut

Jetesa njerëzore kushtëzohet nga bashkëveprime dhe ndërveprime të ndryshme që në formalizimin e tyre janë të kushtëzuara ligjërisht, informacioni mbi përcaktimet ligjore është thelbësor, pasi ndihmon qytetarët të jetojnë në harmoni me njëri tjetrin dhe institucionet. Informacioni i munguar mund t'i privojë nga gëzimi i të drejtave të tyre dhe në raste të tjera, t'i ngarkojë me përgjegjësi dhe pasoja.

Por, edukimi ligjor i publikut shkon përtej informimit mbi të drejtat dhe proceset ligjore, duke synuar ndërtimin e kapacitetit intelektual për kuptimin e drejtë apo interpretimin e çështjeve ligjore të identifikuar nga publiku, apo që lidhen drejtpërdrejtë me ta. Pra, të aftësohen për të diferencuar kur një çështje ka karakter

ligjor; konfidencialiteti mbi procesin apo punën e njerëzve të përfshirë në të; aftësia për të komunikuar siç duhet ngjarjen konkrete; mbajtja e qëndrimit të hapur apo gatishmëria për të pranuar zgjidhjet, si në rezultat, ashtu edhe në kohë; të dinë kur dhe ku mund të drejtohen për ndihmë ligjore.

Njohuritë ligjore mbi procesin janë thelbësore, nuk mund të kërkojmë një të drejtë, nëse nuk jemi në dijeni se sa na takon ajo e drejtë, nëse jemi përfitues apo jo? Kompleksiteti i ngjarjeve që kërkojnë shpjegim ligjor mund të lidhen me një formim bazik të individit (aspirata për të përfituar nga një e drejtë me burim kushtetues), por jo pak raste vijnë në trajtim çështje që rregullohen me dispozita specifike nga ligje dhe akte nënligjore që kërkojnë interpretim të specializuar.

Kapaciteti intelektual për të kuptuar këto çështje kërkon aftësi, njohuri dhe një tërësi qëndrimesh për të menaxhuar siç duhet situatat ligjore, si vetëm, ashtu edhe në ndihmë nga juristët e specializuar, apo avokatë dhe studio ligjore, që operojnë në fushën përkatëse. Përgjithësisht, si institucionet përgjegjëse për informim, po ashtu edhe qytetarët e përfshirë në një proces që orientohet kah një problematike të caktuar ligjore, fillimisht fokusohen tek informimi, i cili jo gjithmonë është efektiv. Arsyet janë të larmishme: Keqkuptimi i Ligjit (dispozitave konkrete); keqinterpretimi i tyre apo marrja në konsideratë e një ligji, pa analizuar më tej plotësimet nga aktet nënligjore (nëse ka të tilla për rastin); mosnjohja e hierarkisë së normave ligjore dhe mundësia e fokusimit të gabuar në akte ligjore me fuqi më të ulët juridike nga akti (prioritar) që rregullon çështjen konkrete; keqkuptimi i afateve procedurale dhe zbatimi i gabuar i tyre; ngarkimi me kosto financiare procedurale të panevojshme dhe të paqartësuar.

Elementët që mund të veçohen nga ky punim në funksion të aftësisë për të kuptuar dhe identifikuar çështjet ligjore përmendim:

- a. Komunikimi sa më i drejtë i çështjes, ngjarjes apo ndodhisë;
- b. Identifikimi i problemit kryesor;
- c. Renditja e fakteve, duke përjashtuar efektin emocional;

- d. Fiksimi i materialit/eve dhe ruajtja në një dosje të personalizuar me dokumentet e siguruar të çështjes, pa bërë kategorizim të rëndësisë së tyre, të paktën në fazën fillestare, por në një rend kronologjik kohor, duke e shumëfishuar në të paktën një kopje më shumë;
- e. Formulimi i një prezantimi në formën e narrativës logjike, sa më herët të jetë e mundur (version personal i ngjarjes nga ana e personit);
- f. Informimi mbi juristët e specializuar (apo studiot ligjore) që trajtojnë problematikën e identifikuar dhe drejtimi i çështjes për opinion/këshillim ligjor.

2. ELP nën përcaktimet e legjislacionit (kronologjiksht)

Nga studimet e publikuara të deritanishme, domosdoshmëria e trajtimit të kësaj çështje (ELP) ka marrë rëndësinë e analizës dhe trajtimit të veçantë institucional fill pas publikimit të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, nga i cili u vlerësua se *“Institucionet shtetërore nuk kanë projekte dhe plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi. Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të publikut. Nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë të edukimit të vazhduar ligjor të publikut. Nuk ka një ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile, për edukimin dhe informimin vazhduar ligjor të publikut”*.¹⁷⁷

Për të siguruar mbarëvajtjen e një procesi që përfshin identifikimin dhe analizën e çdo problematike të mundshme në Shqipëri, duke pranuar edhe mungesën e strategjive konkrete apo planeve të veprimit, natyrisht që do të pasonte me një angazhim më të specializuar dhe burokraci administrative dhe organizative, por jo në pak raste edhe në dobi të procesit.

Kështu që pranë Komisionit të Posaçëm do të ngrihet edhe Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i mbështetur nga një Sekretariat Teknik, të cilët pas gjetjeve

¹⁷⁷Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë), Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Qershor 2005, fq. 223 http://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf (vizituar së fundmi në 16:00, dt. 29/05/2020)

dhe punës së përbashkët rezultuan me Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e Strategjisë për Reformimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri.¹⁷⁸ Miratimi i këtyre dokumenteve dhe përmbajtja e tyre do të ndikojë drejtpërdrejtë në hartimin e ndryshimeve kushtetuese, si dhe paketës së projektligjeve, nëpërmjet të cilave pritet zbatimi i Reformës në Drejtësi.

Në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë parashikohet “Edukimi ligjor dhe arsimi juridik”, si një nga 7 shtyllat bazë të reformës në sistemin e drejtësisë. Në datën 16 dhjetor 2016 u prezantua në Komisionin e Posaçëm paketa prej 27 projektligjesh, hartuar nga GENL së bashku me ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS, OPDAT dhe OSBE. Pjesë e paketës së akteve të reformës në drejtësi është edhe Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë.¹⁷⁹

Në mbështetje të akteve të mësipërme, Komisioni Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut do të marrë dy vendime, me të parin¹⁸⁰ do të krijojë Bordin Këshillimor me përbërje nga pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si edhe ekspertë me përvojë në fushën e edukimit ligjor; ndërsa me Vendimin nr.2¹⁸¹ do të publikojë organizatat e Sh.C. që do të jenë anëtare të rrjetit kombëtar për ELP (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Fondacioni Qendra Europiane, Organizata të ndryshëm dhe të barabartë, MEDIUS dhe LECA), ndërsa 2 organizatat anëtare të Komisionit Drejtues të Rrjetit do të jenë TLAS (shërbim ligjor falas) dhe Qendra A.L.T.R.I.

¹⁷⁸ Miratuar me Vendim Nr.14, dt.30.07.2015 "Për miratimin e Dokumentit 'Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", dhe me Vendimin nr.15, datë 30.07.2015 "Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri"

¹⁷⁹ Vendimi Nr. 47/2019 Për Miratimin Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 18/04/2019, fq. 5

¹⁸⁰ Vendimi Nr.1/2019, Për Krijimin e Bordit Këshillimor, Komisioni Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, Tiranë 10/10/2019

¹⁸¹ Vendimi Nr.2/2019, Për Pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile Rrjetin Kombëtar për Edukimin Ligjor dhe në Komisionin Drejtues, Komisioni Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, Tiranë 10/10/2019

Nga kuadri institucional dhe përgjegjësitë e institucioneve në kuadër të ofrimit të Edukimit Ligjor të Publikut, sipas Strategjisë së ELP mund të diferencojmë të ngarkuar me punë:

- Ministrinë përgjegjëse për arsimin (sot MASR)
- Institutin për Zhvillimin e Arsimit (IZHA)
- Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- Institucionet e Arsimit të Lartë
- Organizatat e Shoqërisë Civile

Ndërsa grupet e identifikuar me nevoja të veçanta janë:

- Të rinjtë
- Të miturit
- Vajzat dhe gratë
- Personat në kushte të veçanta
- Bizneset

Në tabelën në vijim reflektohen parashikimet e edukimi ligjor në legjislacionin e brendshëm dhe në aktet ndërkombëtare. Secili nga grupet e mësipërme gjen një mburojë të hekurt normative, si çdo qytetar global (të paktën si subjekt i përfitimit nga aktet ndërkombëtare), por edukimi i tyre për hapësirat që ju ofron kjo gamë ligjore kërkon një harmonizim të kuadrit institucional dhe një proces ripërtëritës, sipas kushteve dhe rrethanave, përtej përcaktimeve të ngurta të strategjisë, të cilat janë duke përjetuar pengesa të herëpashershme procedurale, ligjore dhe politike.

NR. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM

AKTET NDËRKOMBËTARE

1.	Kushtetuta	
2.	Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara
3.	Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore"	Konventa e UNESCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim

4.	Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"	Konventa e OKB-së kundër Eleminimit të të Gjitha Formave të Diskriminit Racor
5.	Ligji nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit"	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
6.	Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
7.	Ligj Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"	Konventa e OKB-së për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
8.		Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës
9.		Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Table 1

3. Kontributi i Shoqërisë Civile dhe fushata ndërgjegjësuere

Edukimi ligjor i shtetasve synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të drejtë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Grupet e synuara të veprimtarisë së edukimit ligjor janë ato të cilat kanë shfaqur nevojë më të madhe për t'u njohur me garancitë kushtetuese dhe ligjore siç janë nxënësit e shkollave të mesme dhe universiteteve, aktivistët e shoqërisë civile, personat e privuar nga liria dhe shtresat e tjera në nevojë, votuesit për herë të parë, etj.¹⁸² - shprehet Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në portalin me dritare elektronike të personalizuar për Edukimin Ligjor, i cili jo më larg se viti i kaluar ka publikuar edhe një raport mbi “njohjen dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në Shqipëri”.

Vlen të përmendet edhe studimi që ka bërë mbi Edukimin Ligjor të Publikut në rajonin e Lushnjës Qendra A.L.T.R.I, me temë “Qytetarë Aktivë të informuar dhe aksesit në drejtësi”, një studim i cili nëse shtrihet në të gjitha rajonet e Shqipërisë, atëherë do të ishte një kontribut i konsiderueshëm, që do të shërbente edhe vetë

¹⁸² <https://ahc.org.al/fushat-e-veprimtarise/edukimi-ligjor/> (vizituar së fundmi në 16:00, dt. 31/05/2020)

Rrjetin Kombëtar dhe institucionet e përfshira për zbatimin e SELP me gjetje të rëndësishme për këtë proces dhe rekomandime të individualizuara sipas zonave në studim. Kjo qendër ka përdorur edhe metoda të thjeshta informuese, si video-mesazhet e animuara, të cilat janë trend i kohës.

TLAS ka publikuar raportin mbi Vlerësimin e Nevojave Ligjore në Shqipëri dhe rezultatet janë të një alarmi që nuk duhet shpërfillur nga institucionet, edhe pse SELP dhe Reforma në Drejtësi kanë adresuar zgjidhjet duke identifikuar institucionet dhe organizatat që do të implementojnë strategjinë, sërish efektiviteti është i çalë dhe arsytet janë të shumta. Gjatë raportit përmendet se “95% e njerëzve me vështirësi ekonomike që janë përballur me një problem ligjor vitin e kaluar vlerësojnë që ky problem ka pasur pasoja negative në jetën e tyre të përditshme. Nga këta, pothuaj çereku i ka vlerësuar këto pasoja si të rënda. Sipas pyetësorit, 85% e njerëzve që kanë ndeshur një problem vitin e kaluar kanë përjetuar ndërlikime si pasojë dhe 22% e tyre janë klasifikuar si të rënda.”¹⁸³

Mund të konstatojmë lehtësisht se me Edukimin Ligjor të Publikut janë angazhuar tërësisht vetëm OJF-të e anëtarësuara në Rrjetin Kombëtar për ELP dhe kryesisht disa që e kanë në funksionin e tyre të drejtpërdrejtë operativ, ndërsa të tjerat vijojnë me projekte dhe trajnime mbi demokracinë, vendimmarrjen, qytetarinë aktive nëpërmjet trajnimeve, por jo aktiviteteve konkrete, etj. Në asnjë rast nuk tentohet që nëpërmjet këtij punimi të nënvlerësohen OJF-të që kanë qëllime të tjera strategjike, të diferencuara nga edukimi ligjor i publikut, por as ato nuk mund t’i realizojnë qëllimet dhe objektivat e tyre, nëse gjendja aktuale vijon të rëndohet. OJF-të, po ashtu si institucionet publike, duhet të ofrojnë minimalisht njohuri falas ligjore mbi fushat që mbulojnë në drejtim të qytetarëve të interesuar.

¹⁸³ <https://tlas.org.al/sq/publikimi-i-raportit-mbi-vler%C3%ABsimin-e-nevojave-ligjore-n%C3%AB-shqip%C3%ABri> (vizituar së fundmi në 18:00, dt. 31/05/2020)

Duke ju referuar statistikave të regjistrimeve në arsim 2017-2018 nga INSTAT, dhe në krahasim me vitin e kaluar akademik, vlerësohet se ka një ulje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së nxënësve dhe studentëve në studime, sipas niveleve të ndryshme të shkollimit, konkretisht¹⁸⁴:

1. Arsimi në total - ulje prej 3,8 %,
2. Arsimi Parashkollor – 1.2 %
3. Arsimi 9-vjeçar – 2.5 %
4. Arsimi Parauniversitar - ulje prej 2,9 %,
5. Arsimi i Lartë 7,3 %

Vlerësohet, gjithashtu, se gjatë vitit akademik 2016-2017, rreth 25 mijë studentë shqiptarë, studiojnë në vende të ndryshme të botës. Problematika të tjera rezultojnë: bursa e ulët e akorduar nëpërmjet grantit për nivelet vendore; fazat e shkurtra të rregjistrimit 48 orëshe; kosto të larta akreditimi për programe të reja dhe bashkëkohore, sipas kërkesës së tregut; ndalimi i këshillimit të karrierës dhe ofrimi i panairëve në zona larg lokacionit të universiteteve jashtë metropolit; mungesa e evidencave publike të studentëve që studiojnë jashtë shtetit dhe fiktiviteti i strategjisë për trajtimin e rikthimit të studentëve nga jashtë.¹⁸⁵

... ndoshta ligji mund të mos ndryshojë zemrat e njerëzve, por ai ndryshon me siguri zakonet e njerëzve. – shprehet Martin Luter King¹⁸⁶. Mungesa e fushatës ndërgjegjësuese, apo edhe e implementimit të duhur të SELP sjell aktualitetin e sotëm, me sjellje të kushtëzuara nga nevoja. Edukimi është arsyeja kryesore për stanjacionin e gjatë që po pëson ndër vite Shqipëria. Nuk jemi në kushtet për edukim gradual, konceptimi dhe aplikimi i paketës edukuese ligjore duhet të implementohet paralelisht dhe të zbatohet në parim gjithëpërfshirës dhe të personalizuar. Pra, duke

¹⁸⁴

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_ED_GRA/NewGRA02/table/tableViewLayout2/?rxid=08c34ce0-981e-4f3b-9c3e-d28b3074a32a

¹⁸⁵ Dorian Leka, Ph.D. Cand, Vertebra Arsimore me Reformime dhe Deformime Kronologji Ligjore Mbi Arsimin Shqiptar (II), International Scientific Conference New Emerging Trend on Western Balkan – NETwB 19, International University of Struga, 18 Maj 2019, fq. 319

¹⁸⁶ Karen E. Hayden, Society and Law, Merrimack College, Lanham: Rowman & Littlefield Publishing Group, Inc., London, United Kingdom 2019, fq. 199

nisur që nga përfshirja në kurrikulën mësimore të nxënësve disa prej pjesëve bazike të ligjit dhe së drejtës, deri tek takimet publike (në nivel lokal) mbi ndryshimet ligjore që ndikojnë tek funksionaliteti i biznesit, organizatat (fitimprurëse ose jo) apo qoftë edhe administrata publike.

Përfundime dhe Rekomandime

Edukimi Ligjor i Publikut është një e drejtë e pamohueshme e qytetarit, prej disa vitesh jemi ndër fazat e implementimit të SELP, por ky proces rezultoi i çalë dhe me një indiferencë si nga ana e institucioneve (kryesisht lokale dhe të linjës), po ashtu edhe e OJF-ve. Nuk mohohet as neglizhenca e qytetarëve dhe mungesa e vullnetit për të qenë pjesë e vendimmarrjes, sipas instrumentave të përfaqësimit të drejtëpërdrejtë, apo edhe prezencës fizike, por duke marrë në konsideratë situatën e brishtë financiare dhe humbjen e besueshmërisë ndaj institucioneve, kemi të bëjmë me një barrierë më shumë në padijen dhe mosedukimin ligjor.

Gjatë punimit u theksua se ka disa mënyra që mund të orientojnë individët të jenë vigjilentë për t'u kujdesur kur përballen me një çështje që kërkon trajtim të specializuar ligjor, por një përqindje e lartë e tyre kanë rezultuar konfuzë, të pasqaruar dhe me pasoja të rënda për situatën problematike konkrete.

Jetojmë në efektet e globalizimit të të drejtave dhe përveç kornizës ligjore kombëtare, një mburojë e fortë e të drejtave sigurohet edhe nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara, por edhe këto akte nuk mund të jetësohen, nëse nuk zotërohen njohuritë bazike ligjore.

Disa nga rekomandimet për tejkalimin e krizës së ELP, janë si në vijim:

- Informimi së pari i personave/institucioneve në kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarin, për të paktën të një pakete problematikash më të shpeshta.
- Rritja e monitorimit të aktorëve të përzgjedhur për implementimin e SELP dhe korrektimi i gabimeve apo përsheptimi i fazave të vonuara.

- Përshejtimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe Reformës në Administratën Publike.
- Botimi i një përmbledhje të përgjithshme legjislacioni (kryesisht të normave e rregullave që lidhen me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (arsimi dhe edukimi), të drejtën e informimit të publikut, detyrimin e institucioneve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve; Përgjegjësitë dhe roli i institucioneve të linjës dhe pushtetit vendor etj.), por të jetë i përshtatshëm për t'u kuptuar nga të gjitha grupmoshat, duke qartësuar disa nga problematikat më të shpeshta, me raste konkrete dhe këshillime ligjore.
- Shoqërimi i çdo ligji të ri, apo akti nënligjor me shpjegime të thjeshtësuara për subjektet të cilave ju drejtohet.
- Nxitja me financa apo me mbështetje projektesh të orientuar mbi Edukimin Ligjor të Publikut nga ana e OJF-ve.
- Krijimi i klimës së pranimit dhe mundësi të reja për arsimim, punësim dhe angazhim të rinjve, duke frenuar emigrimin e tyre – *le të jetë një zgjedhje, por jo zgjidhje.*

Literatura e shfrytëzuar:

Botime:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë), Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Qershor 2005
- Karen E. Hayden, Society and Law, Merrimack College, Lanham: Rowman & Littlefield Publishing Group, Inc., London, United Kingdom 2019
- Dorian Leka, Ph.D. Cand, Vertebra Arsimore me Reformime dhe Deformime Kronologji Ligjore Mbi Arsimin Shqiptar (II), International Scientific Conference New Emerging Trend on Western Balkan – NETwB 19, International University of Struga, 18 Maj 219

Vendime:

- Vendimi Nr.14, dt.30.07.2015 "Për miratimin e Dokumentit 'Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", dhe me Vendimin nr.15, datë 30.07.2015

"Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri"

- Vendimi Nr. 47/2019 Për Miratimin Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 18/04/2019
- Vendimi Nr.1/2019, Për Krijimin e Bordit Këshillimor, Komisioni Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, Tiranë 10/10/2019
- Vendimi Nr.2/2019, Për Pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile Rrjetin Kombëtar për Edukimin Ligjor dhe në Komisionin Drejtues, Komisioni Drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, Tiranë 10/10/2019

Burime elektronike:

- <https://www.parlament.al/Files/Akte/20190424122731vendim%20nr.%2047,%20dt.%2018.4.2019%20-Teksti%20i%20Strategjise.pdf>
- http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Analiza_e_sistemit_te_drejtësisë_FINAL-1.pdf
- http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_ED_GRA/Ne_wGRA02/table/tableViewLayout2/?rxid=08c34ce0-981e-4f3b-9c3e-d28b3074a32a
- <https://www.idp.al/strategjia-per-edukimin-ligjor-te-publikut/>
- https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendimi_nr_47_dt_18_4_2019.pdf
- https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendimi_nr_1.pdf
- https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendimi_nr_2.pdf
- <http://www.qendra-list.org/aktivitete/edukimi-ligjor/>
- <https://ahc.org.al/fushat-e-veprimtarise/edukimi-ligjor/>
- <https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/RAPORT%20MBI%20EDUKIMIN%20LIGJOR%20T%C3%8B%20PUBLIKUT%20Lushnje%201.pdf>
- <https://tlas.org.al/sq/publikimi-i-raportit-mpi-vler%C3%ABsimin-e-nevojave-ligjore-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

KRIMI I TË RINJËVE DHE DREJTËSIA E RINIS

Kosovare Sopi

Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”

Prishtinë, Kosovë

Kosovaresopi@gmail.com

Abstrakt

Çështjet e krimit tek moshat e reja në Republikën e Kosovës është duke u rritur në mënyrë enorme, dhe tanimë është bërë problematik shoqërore, shtrohet pyta se ku qëndron pikënisja apo më mir të themi ku qëndron faji? Tek familja, tek rrethi shoqëror, tek papunësia, apo kushtet e dobëta ekonomike, apo mos funksionimi si duhet i aparatit shtetëror, dhe këtu vihen në dilem shumë pyetje që shumë vështirë është t’iu gjejmë përgjigjrrjen. Le të marrim një vështrim më të gjerë të kësaj çështje si faza kryesore e kursit të jetës, është padyshim rinia e cila demonstron përgjithësisht disa qëndrime, sjellje dhe akte shoqërore, të cilat janë të përbashkëta, pavarësisht nga vendodhja e të rinjëve. Rinia si një periudhë ku individët nuk janë as adoleshnet dhe as pjesëmarrës të plotë në jetën e të rriturëve shoqërohet vazhdimisht me dilemme të shumta. Ajo ka gjithmonë një status të ndërmjetëm dhe një rolë që gjendet gjithnjë mes varësisë dhe pavarësisë njerëzitetit dhe medojnë rinin si moshe idiale për një jetë të gjallë, dinamike, të dhënë pas aktiviteteve krijuese, udhëtimeve, dashurisë, jetës shkollore dhe atë universitare. Duke pasur parasysh zhvillimet shumëdimensionale në Kosovë sidomos gjatë dy dekadave të fundit në Kosovën e pas luftës si një vend i tranzicionit bartja e popullësisë nga vendet rurale në ato urbane, migracioni gjatë kohës së luftës dhe kthimi , marrja e kluturave negative nga shumë vende të Evropës dhe botës , kanë ndikuar që të rinjtë të devijojnë në sjelljet e tyre dhe të bëjnë sjellje devijante dhe duke u futur në disa lloje të krimit si krim të organizuar, trafikim me qenie njerëzore, përdorimi i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope , marrja me prostitucion etj .

Andaj, duke marrur parasysh shqetësimet e gjithë shoqërisë lidhur me këtë çështje vështërsitë që hasin çdo ditë prindërit me fëmijët në mosha delikante e, përmes këtij

punimi jam munduar të bëj sqarimin se si vijnë deri tekë sjelljet devianjte të të rinjëve në moshë të re të cilët bien ndesh me ligjin!.

Fjalët kyçe: Krimi tek të rinjët; sjelljet devijante ; sanksionimi i të rinjëve ;

1. Hyrje /Vështrime të përgjithshme

Ky studim është një përpjekje për të realizuar një prezantim të përgjithshëm të situatës së kriminalitetit mes moshave të reja, duke u ndalur kryesisht tek faktorët e riskut dhe profilin e individëve që rrezikohen të përshihen në sjellje penale. Në këtë kuadër është e domosdoshme të qartësohet kufiri i moshës së individëve që janë objekt i këtij studimi.

Sipas tekstit të Kodit i Drejtësis për të Mitur në shtetin e Kosovës Fëmijë-konsiderohet personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetmbëdhjetë 18 vjeç , ndërsa i mitur konsiderohet personi ndërmjet moshës katëmbëdhjetë 14 vjeç dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç 16 ndërsa I mitur i rritur –personi ndërmjet moshës 18 tetëmbëdhjetë vite . Në disa dispozita të tjera përdoret edhe termi “fëmijë”. Në nenin 1 të Konventës për të drejtat e fëmijës theksohet se “fëmijë konsiderohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur ligji i brendshëm vendos një kufi më të ulët”.

Legjislacioni në shtetin e Koosvës si kufirin maksimal të miturisë ka vendosur moshën 18 vjeç’. Në disa vende të Europës Perëndimore, kur studiohet kriminaliteti i të miturve, studjuesit bëjnë dallim ndërmjet të miturve dhe një kategorie të veçantë që po njih shtrirje të madhe, të të ashtuquajturve “të rritur të rinj”. Fjala është për persona të grupmoshës 18 deri në 21 vjeç por sipas rasteve edhe deri në 23 apo 25 vjeç. Në kontekstin kulturor shqiptar, termat fëmijë dhe i ri përdoren rëndom me diferenca disa vjeçare nga përkufizimet e cituara në paragrafin e mësipërm. Kështu, përgjithësisht, trajtohen dhe konsiderohen si fëmijë individët deri më 16 vjeç, më pas, nga 16 deri më 18 – 20 vjeç, ata konsiderohen si të rinj. Ky dallim në vlerësimet moshore të individëve të përfshirë në sjellje penale, nuk ka kaluar pa ndikuar edhe

studimin tonë. Është kjo arësyeja që gjatë gjithë studimit ne do të përdorim në mënyrë të vazhdueshme termat të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin duke synuar prezantimin sa më të mirë të moshave të reja në konflikt me ligjin duke ja përshtatur kufirin moshor të këtij grupi edhe kulturës dhe mentalitetit të mjedisit kosovar.

Sidoqoftë, sqarimi i kufinjve moshorë për individët e përfshirë në aktivitete kriminale do të na ndihmojë për të studjuar dhe identifikuar më mirë dhe më saktë faktorët që ndikojnë tek ata, karakteristikat e personalitetit të tyre, por edhe masat parandaluese e trajtuese që duhen realizuar për të ulur efektin e sjelljeve dhe aktiviteteve të tyre. Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete kriminale është kthyer në një shqetësim për shqiptarët, veçanërisht në dhjetë vjeçarin e fundit.

2.Faktorët që ndikojnë në sjelljet devijante tek të rinjtë

2.1. Faktorë të hershëm

Në moshat e reja periudha parashkollore dhe mosha e re shkollore faktorët e riskut kanë natyrë inividuale dhe familjare. Tregues të veçantë sigjanë agresiviteti ose niveli I lartë I impulsivitetit ose të kërkuarit e vëmndjes,janë produkte të shumë influencave që fillojnë nga geni deri tek mjedisi ku rritet fëmija. Agrisitiviteti provohet të jetë treguesi më I mirë I sjlljes së ardhëshme kriminale. Nga të gjitha studimet e bëra në botë rezulton se fëmijët me sjellje agresive që në moshat fare të reja madje që në kopësht , kanë rezultuar të jenë adoloshentë dhe të rinjë të përfshirë në vepra penale. Sjelljet asni-sociale të takuara në moshat e reja janë gjithashtu një tregues I kriminalitetit në moshat e rritura . Ky fakt është më shumë I lidhur me sjelljen penale të takuar djemtë. Loeber një nga studujuesit e sjlljes penale në moshat e reja , pohon se të miturit dhe të rinjët që përfshihen në dhunime të pronës spo në sjellje të dhunshme shfaqin disa nga sjlljet : kanë problem të sjlljes që në moshën parashkollore , kanë sjellje agresive dhe problematike si tendenca për të gënjyer dhe vjedhur , kanë sjellje hiperatkive dhe impulsive qe në moshat e reja.

Arësimi dhe shkollat

Shumë studjues të krimit në moshat e reja e vënë theksin tek roli I shkollës . sistemi arsimorë vlerësohet si factor kryesor për të luftuar varfërinë dhe mungesën e stabilitetit në familje.

Shkolla është vendi ku fëmijët edukohen, formohen dhe rriten . Të miturit dhe të rinjtë e sotëm nuk e kanë mundësinë në 100 përqind të tyre të arrijnë nivelin e dëshiruar arsimor. Varfëria , mungëgesa e transportit mungesa e shkollave me konvikte , mungesa e sigurisë etj e bëjnë të pamundur një gjë të tillë . Nga ana tjetër kurikula e sotme shkollore , nuk është ngritur mbi parime të praktikitetit të vlefshmërisë jetike. Nxënësit nuk arrijnë të marrin njohuri të vlefshme për t’I përdoror për të përmisuar jetën e tyre. Në këto kushte, për disa prej tyre është më e lehtë të largohen prej shkollës dhe të merren me aktivitete që ndikojnë në përmirësimin e situatës familjare siç mund të jenë angazhimi me tokën , kujdesi për bagatinë , shitja në tregun e zonës apo aktivitete të tjera larg zonës së banimit deri në përfshirje në aktivitete criminale si vjedhje , grabitje, shpërndarje dhe transport të bimëve narkotike etj.

Vetëm kështu mund të shpjegohet rritja e vazhdueshme e numërit të të miturëve që largohen nga shkolla pa mbaruar arësimin e detyruar . mësueit dhe edukatorët ndjehen ende të pamotivuar për të indentifikuar dhe zgjidhur shumë nga problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit e tyre .

Studimet e bëra lidhur me ndikimin e shkollës ndaj sjelljeve anti-sociale kanë treguar në vazhdimësi se rezultatet e dobëta në mësimet janë direct të lidhura me sjelljen e fëmijëve me prvalecën dhe shfaqjen e kriminalitetit që në moshën të herëshme. Lidhjet e dobëta me shkollën , dëshira e pakët për shkollim , aspiratat e ulëta për arësimim dhe niveli I uët I motivimit e vendosin fëmijën në kushte tejet të rrezikuara për t’u përfshirë në sjellje penale. Organizimi dhe procesi Brenda shkollës mund të luajnë rolin e faktorëve të rrishtit në momentë të caktuara .

Shkollat me numër të kufizuar mësuesish përkundrajt numërit të lartë të nxënësve mbartin gjithnjë rrezikun e mungesës së rregullit dhe disiplinës që nga ana e tyre

ndikojnë në rritjen e mundësis për sjellje anti-sociale dhe përfshirjes në sjellje problematike.

Përkatësia etnike dhe gjinore

Ndërthurja përkatësis etnike dhe gjinore me përfshirëjen e herëshme në sjellje problematike është një terren pothuaj i paekspolruar dhe i pastudjuar . Shpeshherë, harutesit e politikave , profesionistët e ligjit por edhe ata të shërbimeve sociale, në aktivitetin e tyre mbështet në stereotype dhe supozime lidhur me përkatësinë etnike dhe gjinore.

Të miturit me ngjyrë janë shpesh më të takuarit në pozita e të akuzrëve apo të dënuarëve për sjellje penale. Numri I tyre është shumë I lartë në raport me popullësinë që ata përfaqësojnë përkundrejtë pjesës tjetër të popullsisë. Nga ana tjetër, numrin e popullëssë që ato prezantojnë, por shpesh janë të taukeshme në pozicionin e viktimës së sjelljeve penale të meshkujëve. Në këto kushte është e domosdoshme që në të gjitha studmiet që do të vijonë duhet mbajtur mirë parasysh dhe duhet eksploruar marrëdhënia përkatëse etnike dhe gjinore në raport me sjlljen penale.

Bashkëmohatarët

Në të vërtet, për të vërtetuar rolin dhe ndikin e bashkëmohatarëve në sjlljet penale nevojiten studime dhe kërkime të mëtejme. Migjithatë, të dhënat e deritanishme tregojnë se përfshirja e të miturëve dhe të rinjëve në sjllje penale është rezultat i kombinimit të faktorëve të mëpoashtëm:

-tendecat anti-sociale të fëmijëve me sjllje të çrregulluar në moshë të hershme dhe në vazhdimësi¹⁸⁷

-shoqëri me bashkëmohatrët që kanë shfaqur sjellje problematike

-pasoja negative e përjashtimit nga grupet e bashkëmohatarëve

Ndërsa fëmijët rriten, ndjekin shkolën dhe përfshihen në komunitetin ku ata banojnë ,spektri I faktorëve të riskut rritet . Shumë studime provojnë lidhjen që ekziston midis

¹⁸⁷ Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri Prof. Asoc. Dr. Edlira Haxhiymer qeshor 2007 fq 20;

grupit problematic me të cilin lidht fëmija dhe sjllje së tij penale . Pytja që kërkon përgjighe në këtë rast është se cili nga variantet është I vërtet ‘‘shoqëria e keqe të prish’’ apo ‘‘të qinjët mblidhen bashkë’’ . Shumë hipoteza sugjerojnë se grupet problematike e tërheqin dhe e nxisin inivididin pa histori kriminale të mëparshe , drejt sjlljes penale ose rrisin ndjeshëm kriminalitetin atje ku ai ka ekzistuar edhe më parë. Të rinjët e përfshirë në sjllje penale që shoqërohen me grupe problematike janë më të prirur të përfundojnë me shpejtë në burg se sa ata q nuk janë pjesë e grupeve problematike. Për më tepër ,studimet tregojnë së vëllai apo motra më e madhe e përfishrë në sjllje penale mund të shërbejë si një nsitës I fuqishëm për fëmijën për t’u përfishrë në të tilla sjllje . Kjo bëhet edhe më evidente kur fëmijët janë shumë të lidhur me njërin-tjetërin dhe janë afër me moshë.

3. Dispozitat ligjore në zbatim sanksionimit të të rëniëve në shtetin e Kosovës

3.1 Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturëve

Masat që mund të shqiptohen të miturëve janë : masat e diversitetit dhe masat edukativeMasat e diversitetit qëllimi i kësaj mase është që të parandalojë , kur është e mundur fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur , të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësin e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste . Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim me përjashtim të atyre të cilat sjellin pasojë vdekjen. Kushtet për shqiptimin e kësaj mase: Pranimi i përgjegjës për veprën penale nga i mituri. Shprehja e gashtishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar Pëlqimi i të miturit ose prindërit ,prindit adoptues apo kujdesatarit në emër të miturit për të zbatuar masën e duhur.

3.2Llojet e masave të diversitetit

- Masat e diversitetit që mund të shqiptohen të miturit janë :

- pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar , duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri nda palës së dëmtuar
- Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij
- Kompensimi i dëmit të palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërjellë ndërmjet të dëmtuarit të miturit dhe përfaqësuesit ligjor në përputhje me situatën financiare
- Vijimi i rregullt në shkollë
- Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me adtësi dhe shkathtësi e tij
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësin e kryerësit të mitur pëe kryerjen e punës së tillë .Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë dite në gjashtëdhjetë orë
- Edukimi ne rregullat e trafikut dhe
- Këshillimi pskilogjik

4.Masat edukative

Qëllimi i masave edukative është që të kontribojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur duke ofruar mbrojtje , ndihmë dhe mbikëqyrje duke siguruar edukim dhe aftësim profesional duke zhvilluar përgjegjësin e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjljen recidiviste.¹⁸⁸

4.1 Llojet dhe kohëzgjatje e masave edukative

-masat disiplinore

-masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat inititucionale

4.2 Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor shqiptohet ndaj të miturit, interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.

¹⁸⁸Po aty fq 10

4.3 Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.

4.1894. Masat institucionale edukative janë, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. 5. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale

5. Ekzekutimi i dënimeve

Edhe ndaj të miturëve gjykata mund të shqiptoj ndonjërin nga llojet e dënimeve ashtu sic ka paraparë Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ndaj të miturit mund të shqipëtohen këto llojë të dënimeve;

-Ekzekutimi i gjobës

-Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme

-Ekzekutimi i burgut për të mitur

5.1 -Ekzekutimi i gjobës

Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale lidhur me ekzekutimin e gjobës zbatohen përshtatshëm për ekzekutimin e gjobës të shqiptuara për të mitur.

¹⁸⁹Kodi Nr. 06/L-006 14 shtator 2018

¹⁹⁰ Shih: Komentarin e Kodit Penal të Kosovës. Prishtinë, 2012. Fq11

Gjoha e shqiptuar ndaj të miturit e cila nuk është paguar nuk mund të zëvendësohet me burgim.

5.2-Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme

Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për ekzekutimin e dënimit me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme zbatohen përshtatshëmrisht për ekzekutimin e urdhrave për punë në dobi të përgjithshme të shqiptuara ndaj të miturve. Nëse është në interes të të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë apo bashkëpunim me organin e kujdestarisë apo përfaqësuesin ligjor të të miturit. Kujdes i veçantë duhet kushtuar që puna në dobi të përgjithshme të mos pengojë vijimin e rregullt në shkollë ose aktivitetet tjera të rëndësishme. Gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin për punë në dobi të përgjithshme, zyrtarët e shërbimit sprovues i dorëzojnë raport me shkrim dhe e njoftojnë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e kësaj mase. Nëse i mituri nuk mund të kryejë punën në dobi të përgjithshme për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të rrethanave për të cilat ai nuk është përgjegjës, shërbimi sprovues nga gjykata kërkon rishqyrtimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Varësisht nga rezultatet e arritura, gjykata mund ta ndryshojë urdhrin apo ta pushojë ekzekutimin e masës.

5.3-Ekzekutimi i burgut për të mitur

Dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë dërgimin, pranimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit, caktimin e grupeve arsimore, të drejtat në vizitë dhe angazhimin në ushtrime fizike, përcaktimin e punës dhe edukimin, mundësinë e shkollimit të rregullt, dënimet disiplinore të të miturve në institucionet edukative dhe procedurat për ankesa dhe lutje, gjithashtu vlejnë edhe për ekzekutimin e dënimeve me burg

¹⁹¹ Hajdari Azem E drejta e procedurës penale e të miturëve Prishtinë 2005

për të miturit. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e dënimit me burgim zbatohen përshtatshëm për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me këtë Kod. I mituri i cili është dënuar me burgim për të mitur, krahas të drejtave të parapara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta si personi madhor i dënuar me burgim. Tani do të kemi një shembull të një shkresë të propozimit për shqiptimin e masës edukative

Republika e Kosovës Prokuroria Themelore në Prishtinë

PPM.nr.xx/19
Dt.xx.xx.xx
Prishtinë

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË
-Departamenti për të Mitur-

Prishtinë

Konform nenit 63 dhe nenit 25 të KDM-s parashtrojë këtë:

PROPOZIM

PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKATIVE
Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë

A.A. I biri i XX dhe i XX e gjinisë XX I lindur më dt. xx.xx.xx në fashtain Llapashticë e Epërme K.Podujevë , ku dhe tani banon , me shkollë fillore , me gjendje të dobët ekonomike , shqiptar shtetas i R.së Kosovës

Për shkak se :

Më dt.xx.xx.xx rreth orës 03.:00 në fashtin Llapashticë e Epërme K.Podujevë me anë të zjarrit kan shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzëve dhe pasurisë në atë mënyrë që I mituri XX së bashku me të miturin XX (djalin e motrës së tij) shkojnë në shtëpin e XX hyjn në oborr dhe I mituri XX me një shkrepse ia venë flakën ushqimit për bahgati duke ja djegur 2000copë duaj të sanës me ë'rast të dëmtuarit i shkakton dëm në vlerë prej 3000euro e më pas ikin nga vendi I ngjarjes .

-Me çka ka kryer veprën penale Shkaktimi I rrezikut të përgjithshëm nga neni 365par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj.

PROPOZOJ

I.Që pranë kësaj Gjykate-Trupit Gjykues për të mitur që të mbahet shqyrtimi gjyqësor jopublik në të cilin të ftohen:

1.Prokurori I shtetit të prokurorisë Themelore-Departamenti për të mitur në Prishtinë

2.të miturin A.A. , me përfaqësues ligjor në adresë të lartë cekur

3.të dëmtuarin –dëshmitarin XX nga fsh.LLapashticë e Epërme K.Podujevë

4.Av.sipas detyrës zyrtare për të miturin A.A. –X.X.

5. përfaqësuesin e shërbimit sprovoes

6. Përfaqësuesin e Qendrës për punë sociale Podujevë

II. Që gjatë shqyrtimit gjyqësor të bëhet shikimi dhe leximi I këtyre provave vërtetimi mbi marrjen e përkohsme të gjësendve I dt 08.12.2019 forma e zingjirit të ruajtjes së dëshimeve I dt 07.12.2019 nga raporti I vendit të ngjarjes I dt 07.12.02019 fotoalbumi si dhe shkresat tjera në lënd

III. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor propozoj që të miturit ti shqiptohet Masa Edukative e shtuar nga organi i kujdestaris .

Arysetim

Ndaj të miturit A.A dhe B.B satcioni policer njësia e hetimeve në Podujevë me nr 2019-AF-0000 të datës 10.12.2017 ka parashtruar Kallëzim oenal me dyshim të arsyeshëm se kishin për të kryer veprën penale Zjarrëvënie nga neni 322 të KPRK-së .

Duke u mbështetur në këtë kallzim penal prokurori I çështjes nën PPMnr.xx/19 me datën 19.12.2019 ka marrë aktevdim për fillimin e procedurës përgaditore ndaj të miturit A.A dhe B.B me dyshim të bazuar se në bashkëryerje kanë kryher veprën penale Shkaktimi I rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Prokurori i çështjes gjatë procedurës përgaditore në këtë penale ka marrë këto veprime hetimore, ashtu që ka proceduar të miturit a.a dhe B.B të cilët në prezencën e mbrojtësëve të tyre e pranoj veprën penale e cila ju vihet në barrë. Konkludimin se I mutiri ka kryer veprën penale të përshkruar si më lartë e mbeshtesim në provat sin ë vijim;

Nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarr X.X I cili në deklartën e dhën në polici deklaron me datën xx.xx.xx reth orës 03:00në shtëpin time në fshatin Llapashticë K.Podjeë mu ka djegur ushqimi I batëisë dhe atë 2000 duajë sanë duke ju shkaktiar dëm prej 3000mijë euro dhe pas shaktimit të dëmit I njëjti pasi që është inetresuar se nga kush I është shaktuar ky dëm ka hulumtuar dhe ka verjetur se bëpëe mesa rave të tij kanë ardhur disa gjurmë të qizmevve ku këto gjurmë I ka përcjellur me kujdes dhe të njëtat e kanë dërguar në shtëpin e fqit X.X dhe I njëjti dyshon në të pasi që më parë kishin pasur mosmarrëveshje por gjithqka ka përfunudar mirë.

Për të miturin prokuroria ka siguruar anketën sociale nga shëribimi sporovues nr.xxx/xxx/2019 të dt. xx.xx.xx për të miturin A.A nga e cila jemi njofute se i mituri jeton në kushte të dobëta ekonomike , kjo familje jeton nga ndihma sociale prej 80 euro I mituri jeton me nën I ka tri motra të martuara dhe një vëlla që jeton jashtë vendit babi I ka vdekur dhe ka mbetur nënpërkujdesjën e nëns , raportet si Brenda edhe në rrethin ku jetojnë janë të mira dhe me respect , lidhur me rastin ndihen keq dhe shpresojnë most ë përsiriten I mituri nuk punon nuk merret me ndonjë aktivitet është pa angazhim , duhanin nuk e konsumon në të ardhmen planifikon të merret me automekanikë për këtë të mitur është hera e parë që pëepilohet ankete sociale.

Për te miturin B.B kemi marrë aktvendim mbi masën e diveristetit pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar duke përfshirë edhe kërkim faljen nga I mituri ndaj palës së dëmtuar.

Andaj duke vlerësuar të gjitha prova e nxjerrura dhe të siguruara gjatë procedurës pergaditore, deklartën e të dëmtuarit , ashtu që duke I vlerësuar ato në lidhshmëri logjike dhe faktike me njera tjetrën e të gjitha së bashku kam ardhur në përfundim se në veprimet e të miturit B.B ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale Shkaktimi I reikut të përgjithshëm nga neni 356par11 të KPRK-ës .

I propozoj trupit Gjykes për të mitur që duke marrë parasysh natyrën e veprës penale mmoshën e të miturit rrethanat në të cilat është kryer vepra penale intersin më të mirë të tij andaj mendoj që propozimi për shqiptimin e maës edukuese Mbikqërja e shtuar nga oragni i kujlëstarisë conform nenin 25 të KDM-ës do të arrihet të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryesit të mitur dhe së fundi të parandalohet që i njëjti most ë përsërisë vepë të tillë penale apo ndonjë vepër tjetër. Nga të cekurat më lart, propzimi për aplikin e mases educes Mbikqërja e shtuar nga organi I kujdestarisë është I provuar dhe I bazuar me ligj .

PROKURORI I SHTETIT
XXXXXXXXXXXX XXXXXXXX

PËRFUNDIMI

Janë dy gjëra, perëndimorët përdorin një term, një lloj “demokratizimi” të krimit, një zgjerim, një përhapja. E dyta, prirja për t’u ulur moshë e atyre që kanë aktivitet kriminal. Edhe në shoqërit perëndimore 90 përqind të krimeve i kryejnë të rinjtë. Kjo tregon tendencën e sotme të shoqërisë, ku krimi minor ka rritje. Nën diktaturë krimi ishte i izoluar dhe fëmijët ishin nën strukturat e forta të familjes dhe numri i krimeve ishte i ulët. Tani, për shkak edhe të liberalizimit të jetës, këto i fusin dhe në rrugë kriminale. Është një grup social me të cilin duhet të merremi seriozisht. Por këto janë dukuri globale dhe nuk janë vetëm tek ne.

Si perfundim I këtij punimi duhet patjetër që të fokusohemi më shumë si shtet si shoqëri tek rinia jonë që në një mënyrë ti preventivojmë dhe të arrijmë që ti shmangim sjelljet devijante tek të rinjtë , sepse në punim elaboruam që nëse një I ri bie ndesh me ligjin dhe bënë sjellje anti ligjore e kjo sjellje dënohet duke u përshtatur dispozitave të Kodit të drejtësisë për të mitur , në punim elaboruam që sipas këtij kodi të rinjëve u shqiptohen masa siq ishte masat educative dhe masat e diversitetit , mirëpo në punim elaboruam që përpos këtyre masave të miturëve mund ti shqiptohen poashtu edhe dënime siq ishtë ekzekutimi i dënimit me gjobë , ekzekutimi i urdhrat për punë në dobi të përgjithshme dhe ekzekutimi i burgut për të mitur pra nuk do të thotë që jë I rinjë apo I mitur që të parjashtohesh nga dënimi në rast se bënë sjellje devijante të miturit duhet që të jenë të kujdeshëm që të bëjnë jetë të përkushtuar arsimimit aktiviteteve kulturore-sportive ë të arrijnë ti polotësojnë ëndrrat e tyre jetësore në rrugë të duhur , e jo të mirren me aktivitete kriminale që efekti negative do ti përcjell për shumë vite sepse do të jenë persona të njohur për sistemin e drejtësisë dhe organet hetimore vazhdiisht do ti përcjellin sikurse me llup në rast se bëjnë prap sjellje devijante e më e keqja do ishte edhe dërgimi në mbajtje në entet korrektuese përmisuese pra në burg e që për një të rinjë do të linte pasoja shumë të mëdha në psikikën e tyre mbyllja e tij në dhomat e ktyre enteve pra burgjeve për të mitur.

REKOMANDIME

Për legjislativin dhe situatën vendore:

- *Korniza normative lidhur me dispozitat e Kodit të drejtësisë për të mitur e duhet të kanalizohet dhe harmonizohet me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e rinjëve dhe të miturëve .*
- *Kodi I drejtësisë për të mitur duhet të jetë I qartë I kuptueshëm edhe nga vetë të miturit nuk duhet që të përdoren terminologji juridike që do të jenë të paktueshme nga shtresa e të miturëve.*
- *Në arsimin e të rinjëve duhet tu kushtohet më shumë rëndësi të drejtat e të miturëve dhe duhet që patjetër të futet landë mësimore pasojat në rastë se të miturit bien ndesh*

me ligjin që edhe të miturit dënonohen edhe të miturit dërgohen në mbajtje të dënimit etj.

- Legjislacioni duhet të adresojë drejtpërsëdrejti çështjen se si gjykatat duhet të merren me situatat ku pale në procedurë kemi të mitur*
- Duhet të ketë më shumë gjyqëtar në Republikën e Kosovës që janë të specializuar që ti gjykojnë rastet për të mitur ngase është në pyetje mosha delikate duhet pasur kujdes se si trajtohen këta persona ne seanca gjyqësore*
- Poashtu duhet pasur edhe prokuror më shumë të specializuar që do ti trajtonin vetëm qështjet për të mitur në Kosovë*
- Gjykata Supreme e Kosovës duhet t'i përcjellë me përkushtim të madh lëndët për të miturit dhe duhet që ti udhëzojë gjykatat e shkallës më të ulët se si t'i adresojnë rastet e tilla.*

Literatura:

- *Kodi drejtëisi për të mitur Nr. 06/L-006 14 shtator 2018*
- *Kodi drejtëisi për të mitur Nr. 03/L-003 8 korrik 2010*
- *Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri Prof. Asoc.*
- * Dr. Edlira Haxhiymer qeshor 2007.*
- * Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr.19/13 korrik 2012 Prishtinë*
- * Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr 06/L-074 14 janar 2019 Prishtinë*
- *Kodi i Procedurën Penale Nr.04/L-123 13 dhjetor 2012*
- *Hajdari Azem E drejta e procedurës penale e të miturëve Prishtinë 2005*
- *Halili Ragip Kriminologjia Prishtinë 2002***
- * Halil Ragip Penologjia***
- *Salihu Isamet'' E drejta penale ''Prishtinë 2010***
- *Salihu Isamet ''E drejta penale ''Prishtinë 2015***
- *Gashi Rexhep ''Ekezuktimi i dënimeve alternative ''***

REGJISTRIMI I TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME SIPAS LEGJISLACIONIT NË KOSOVË

Kastriote Vlahna PhD.Cand.

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” rruga e shkronjave, nr.1, 20000,

Republika e Kosovës.

Email: kastriote.vlahna@uni-prizren.com

Abstrakt

Çështjet e pronësisë vazhdojnë të konsiderohen edhe sot, një shqetësim madhor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës dhe regjionit. Tregu i pasurive të patundshme përballet në mënyrë konstante me sfida të shumta, që në një numër të konsiderueshëm të rasteve, origjinojnë nga mungesa e një sistemi të qartë e funksionues të administrimit të të drejtave të pronësisë. Mirëspecifikimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i mirëdokumentuar i pronave të paluajtshme kanë një rëndësi primare në projektimin afatgjatë dhe përmirësimin e planifikimit urban, si dhe të zhvillimit të infrastrukturës, duke lejuar hapësirat e nevojshme për implementimin e reformave shtetërore. Me qëllim që të jetë eficient, sistemi i administrimit të pronave duhet të garantojë pronësinë dhe zotërimin e pronës nga pronarët, e ligjshëm, duke i shërbyer përforcimit të qendrueshmërisë së sektorit të pronave të paluatshme, reduktimit të mosmarrëveshjeve për tokën, lehtësimit të transaksioneve në lidhje me pronat dhe mbështetjes së mirëqeverisjes. Realiteti kaotik i pronave të paluajtshme në vend dhe shqetësimet e grupeve të interesit për të drejtat e pronësisë kanë rritur vëmendjen mbi rëndësinë e efektivitetit të reformave dhe efikasitetit të agjensive shtetërore përgjegjëse për këto çështje. Andaj, duke marrur parasysh shqetësimet e subjekteve të së drejtës lidhur me vështërsitë që hasin çdo ditë me mos informimin e duhur për kushtet e nevojshme që një subjekt të quhet titullar i një paluajtshmërie, përmes këtij punimi jam munduar të bëj sqarimin se si vijmë deri tekë fitimi i një prone të paluajtshme, pra se cilat kushte duhet ti plotësojmë që në të ardhmën të mos jemi ndesh me ligjin, respektivisht se si fitohet e drejta e pronësisë në Republikën e Kosovës, në të cilin legjislacion përcaktohet

qartazi se kjo e drejtë fitohet përveq një pune juridike të vlefshme kusht esencial është dhe regjistrimi i të drejtës në librat kadastral. Andaj në përgjithësi punimi përmban kushtin e regjistrimit të drejtave në librat kadastral!.

Fjalët e kyçe: E Drejta e Pronësisë; Fitimi i pronësis në paluajtshmëri; Kushtet thelbësore të fitimit të drejtës së pronësis; Regjistrimi i të drejtave; Librat kadastral;

Hyrje

Të drejtat e pronësisë të mirëpërcaktuara e të detyrueshme për t'u zbatuar janë parakusht për funksionimin e ekonomisë së tregut. Për sa kohë këto të drejta janë të dobëta, një ekonomi tregu nuk mund të shërbejë me efikasitet dhe progresi ekonomik është thellësisht i penguar. Eksperienca shqiptare nuk është unike në këtë fushë. Pas rënies së komunizmit, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore u përballën me sfida të ngjashme, duke përfshirë edhe ish-Republikën Demokratike Gjermane. Eksperienca gjermane ka treguar disa elementë: Nga këndvështrimi ligjor, dukej logjike që t'i ktheheshin ish-pronarëve pronat e konfiskuara, dhe një maxhorancë e gjerë votoi në favour të kthimit të tyre. Në atë kohë, mundësia e kompensimit ishte e asociuar me një barrë të rëndë financiare. *Në praktikë, vendimi për pronarin ligjitim të një prone u provua të ishte ekstremisht i vështirë në shumë raste.* Struktura industriale e Gjermanisë Lindore kishte ndryshuar krejtësisht. Ishte e vështirë të dallohej mes pronësisë të një kompanie dhe të një pasurie të paluajtshme. Regjistrat e tokës neglizhoheshin nga autoritetet e RDGJ dhe ishin të paplotë, e në më të shumtën e rasteve ish-pronarët nuk jetonin më, për këtë arsye çështjet e pronësisë ishin gjithashtu subjekt i çështjeve të pazgjidhura të trashëgimisë. Si pasojë, kishte shumë pretendues për një numër të madh pronash. Për sa kohë të drejtat e pronësisë nuk ishin të përcaktuara qartësisht, ishte e vështirë të tërhiqeshin investitorët potencialë, sipërmarrjet humbën shumë mundësi investimi dhe kishin vështirësi në financimin e biznesit të tyre.

REGJISTRIMI I TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME SIPAS LEGJISLACIONIT NË KOSOVË

Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme (në tekstin e mëtejme: Regjistri), themelohet si mekanizem që njeh dhe zbaton vlefshmërinë e të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë sipas ligjeve në fuqi.¹⁹² Autorizohet Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejme: "AKK") që të bëjë administrimin e gjithmbarshëm të Regjistrimit në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi. Zyrat Kadastrale të Komunave (në tekstin e mëtejme: "ZKK") do të regjistrojnë të drejtat e pronave të paluajtshme në Regjistrim sipas autorizimit të AKK-së dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga AKK-ja.¹⁹³

Për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme duhet të bëhet kërkesë me shkrim në ZKK-në në të cilën gjendet prona e paluajtshme. ZKK-ja do ta konfirmojë orën dhe datën e pranimit të kërkesës për regjistrim.

Aplikacioni i regjistrimit mund të parashtrohet nga:

- *pronari i pronës apo nga personi i autorizuar nga pronari;*
- *personi i cili ka të drejtë të kërkojë pronësinë mbi pronën përmes transaksionit për*
- *pronën e paluajtshme dhe duke marrë paraprakisht pëlqimin e pronarit me shkrim.*

Aplikanti që kërkon të regjistrojë të drejtën e pronës së paluajtshme duhet t'i bashkëngjisë kërkesës dokumentacionin për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme. ZKK-ja do të regjistrojë të drejtat e pronës të paluajtshme vetëm në bazëtë dokumenteve ligjore të radhiturane

Kërkesat për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme i parashtrohen me shkrim ZKK-së në territorin ku ndodhet prona e paluajtshme. ZKK-ja do të konfirmojë datën dhe kohën e pranimit të kërkesës për regjistrim.¹⁹⁴ Parashtruesi që

¹⁹² Ligji Nr. 2002/ 5, Për Themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronësisë në paluajtshmëri, Neni 1, paragrafi 1.1.

¹⁹³ Po aty. Neni 1. paragrafi 1.2.

¹⁹⁴ Ligji Nr. 2002/ 5, Për Themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronësisë në paluajtshmëri, Neni 3. Paragrafi 1.

kërkon regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, kërkesës duhet t'ja bashkangjes dokumentacionin përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi.¹⁹⁵ ZKK-ja do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe nëse ky dokumentacion nuk është i mjaftueshëm sipas ligjit në fuqi, ZKK-ja cakton afatin për parashtruesin për ta kompletuar dokumentacionin.¹⁹⁶ ZKK-ja e refuzon regjistrimin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm të provojë se parashtruesi i kërkesës është bartës i:

- (i) të drejtës së pronës së paluajtshme, të kërkuar për regjistrim;*
- (ii) nëse kërkesa dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë parregullsi të dukshme;*
- (iii) nëse validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetës është në pyetje; dhe*
- (iv) nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar dhe nuk paraqet bazë për regjistrim.¹⁹⁷*

Pas shqyrtimit dhe vlersimit ZKK-ja do të marrë vendim me shkrim¹⁹⁸ dhe kështu bën regjistrimin e të drejtës mbi pronën e paluajtshme, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, prej ditës së pranimit të kërkesës për regjistrim dhe lidhur me të do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës. Regjistrimi hyn në fuqi kur vendimi për regjistrim i ZKK-së futet në Regjistër.¹⁹⁹

Aplikimi përmes kompanis së licencuar apo gjeodetit:

¹⁹⁵ Po aty. Neni 3, paragrafi 2;

¹⁹⁶ Po aty. Neni 3, paragrafi 3;

¹⁹⁷ Po aty. Neni 3, paragrafi 4;

¹⁹⁸ Po aty. Neni 3, paragrafi 5;

¹⁹⁹ Po aty. Neni 3, paragrafi 5;




Figura1. Hapat kryesor për regjistrimin e një paluajtshmërie.

I.1. Përshkrimi i Përgjithshëm i Procesit

Kadastru i tokave përmban të dhënat tekstuale dhe grafike për parcelat kadastrale, sipërfaqen, kulturën, bonitetin e klasën e tyre dhe të dhënat për ndërtesat, të pjesëve të ndërtesave, përçuesëve dhe objekteve nëntokësore në Kosovë.²⁰¹

Regjistrimi në kadastrë apo rirregullimi i kufirit kadastral kërkon matje kadastrale nga një personel i certifikuar nga ZKK²⁰², kompani e licencuar apo nga një gjeodet.²⁰³ Në rastin e parë, i tërë regjistrimi dhe matja bëhet nga ZKK-ja në të cilën gjendet zona kadastrale. Në rastin e dytë, kompania vepron si një agjent i aplikuesit që bën të gjitha matjet dhe grumbullon të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrim. Kompania i dorëzon të dhënat në ZKK-në e cila kryen punë kadastrale edhe bën regjistrimin.

I.2. Kërkesa për matje kadastrale

Në rastin kur kërkesa parashtrohet përmes një kompanie të licencuar apo përmes gjeodetit, aplikuesi duhet të dorëzojë atyre:

- autorizim nga avokati i cili autorizon kompaninë apo gjeodetin për të përfaqësuar apo
- për të vepruar në emër tij/saj gjatë procesit të regjistrimit; të gjitha dokumentet e nevojshme për transferimin e pronës dhe regjistrimit.

Kërkesa e parashtruar në ZKK duhet të përmbajë edhe një kërkesë për regjistrim në kadastrë.

²⁰⁰ Ligji Nr. 2002/ 5, Për Themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronësisë në paluajtshmëri, Neni 3.

²⁰¹ Shih: Ligjin Nr 2003/25 për Katastrë të Kosovës; Neni 6, paragrafi 1;

²⁰² Zyra Kadastrale Komunale. Organ komunal përgjegjës për regjistrimin e të dhënave në Kadastrë. ZKK-të gjithashtu mund të jenë përgjegjëse për procedurat dhe matjet kadastrale. ZKK-të kryejnë aktivitetet e tyre kadastrale nën mbikqyrjen e AKK-së.

²⁰³ Këtëj e tutje "stafi i licencuar i ZKK-së, kompania e licencuar apo gjeodeti" quhet "gjeodet".

Procedura zyrtare që zbatohet nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Dosjet me dokumentet që duhen për secilën kategori pronash. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme bëhet me përgatitjen e kartelave të pasurive të paluajtshme dhe dokumentimin e kufijve të këtyre pasurive në Harten Treguese të Regjistrimit. Të drejtat e pronësive si dhe kufijet e çdo pasurie të paluajtshme vërtetohen me paraqitjen në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të dokumenteve të mëposhtme. Për secilin rast është dhënë dhe legjislacioni ku duhet të bazohen për procedurën të metejshme të gjithë ata qytetarë që duan të kryejnë një regjistrim fillestar të pasurive të paluajtshme që posedojnë. Për të gjithë ata që duan të regjistrojnë pasuritë e paluajtshme që e kanë marrë këtë pronë falë *Ligjit nr. 7501* u duhet si dokument akti i marrjes së tokës në përdorim ose në pronësi.²⁰⁴

I.3. Përgatitjet nga Gjeodeti

Për çdo aplikacion të parashtruar nga qytetarët për regjistrim në kadastrë, rregullim të kufijve kadastral, piktimit etj., gjeodeti është i obliguar të²⁰⁵:

- kontrollojë dallimet e sipërfaqes në mes të bazës së të dhënave grafike dhe tekstuale;
- kontrollojë të dhënat e vektorit kundrejt planeve të vjetra kadastrale (raster);
- analizojë planet kadastrale duke futur pikat e kontrollit të rendit të parë, të dytë dhe të
- tretë dhe të pikave të tjera me koordinata të njohura precize;
- krahasojë hartën kadastrale me matjet origjinale të terrenit
- kontrollojë hartën kadastrale kundrejt hartave tjera relevante.

²⁰⁴ Shih: <https://www.shqiperia.com/Hipoteka-dokumentet-qe-duhen-per-regjistrimin-fillestar-te-prones.7431>;

²⁰⁵ UA 01/2013 për Korrigjimin e sipërfaqeve. (Fushata për Sensibilizimin të Publikut gjatë Rindërtimit të Kadastrit dhe Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme);

Pas përfundimit të analizave të mësipërme dhe pas konkludimit se ekzistojnë mospërputhje, ZKK-ja duhet të informojë AKK-në me shkrim dhe të paraqesë të gjitha dokumentet e prodhuaranga ky studim.

I.4 Përgatitja e të dhënave për gjeodetin

Në emër të aplikuesit, gjeodeti kërkon nga ZKK të gjitha të dhënat grafike dhe tekstuale në dispozicion për njësinë/njësitë kadastrale.

Të dhënat tekstuale janë marrë dhe eksportuar nga SIKTK-T. Për këtë qëllim, zyrtari për përpunim regjistron një Rast të ri në sistem, dhe zgjedh "Shërbimi i të Dhënave i Njësisë Kadastrale të Selektuar për Gjeodet" nga menyuja rënëse - Lloji i Rastit.²⁰⁶ Pastaj ai/ajo hyn në faqen për Vendosjen e Rastit,²⁰⁷ ku rasti është vendosur në atë listë për përpunim dhe eksporton dosjen CSV me të dhënat tekstuale.

Të dhënat grafike eksportohen nga SIKTK-HK. Për këtë arsye, zyrtari i procesimit hyn në paraqitjen e Gjendjes Aktuale dhe gjeneron Raportin e Njësisë Kadastrale, nëse është e nevojshme Hartën e Parcelave Fqinje në formatin PDF.²⁰⁸ Gjithashtu në paraqitjen e gjendjes aktuale, ai/ajo përdor zgjedhjen e poligonit për të eksportuar pikat dhe vijat e pikave të kufijve (ose karakteristikat e tjera të nevojshme) në CSV, GML, shapefile, DWG ose në formatin ITF.²⁰⁹

I.5 Matjet kadastrale

Matjet dhe grumbullimi i të dhënave në terren me qëllim të regjistrimit në kadastër, apo ri-rregullimin e kufijve kadastral bazuar në të dhënat në kadastër dhe rindërtimin kadastral e quajm matje kadastrale.²¹⁰ Matjet kadastrale quajm matjen dhe paraqitja

²⁰⁶ AAK/2011 Udhëzues për Përdorues nëpërmjet Proceseve Biznesore duke përdorur SIKTK –T, Moduli i Shërbimeve, Pjesa 2;

²⁰⁷ AAK/2011 Udhëzues për Përdorues nëpërmjet Proceseve Biznesore duke përdorur SIKTK –T, Moduli i Shërbimeve, Pjesa 6;

²⁰⁸ AAK/ 2014SIKTK Sistemet e Hartës Kadastrale, Udhëzues dhe Komandë Referenca, Pjesa 2.

²⁰⁹ AAK/ 2014SIKTK Sistemet e Hartës Kadastrale, Udhëzues dhe Komandë Referenca, Pjesa 3.3.2.

²¹⁰Shih:http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_04_ALA2003_25.pdf.

në hartë e vijave kufitare të parcelës që përdoret për mbështetje e sistemit zyrtar të administrimit dhe regjistrimit të tokës.²¹¹ Të gjitha matjet e paluajtshmërive shënohen në harta katastrale e cila tregon kufinj të parcelave të tokës, referimet ndaj shenjave të këndeve kufitare, ndërtesat mbi parcela, si dhe identifikuesit e parcelave dhe ndërtesave.²¹² Hartat e vjetra kadastrale mund të mos tregojnë këto karakteristika

Harta kadastrale digjitale bazohet në sistemin unik shtetëror të koordinatave dhe në kornizën referente. Harta kadastrale digjitale është dëshmi publike e pronës së paluajtshme të çdokujt. Në formën e saj përfundimtare (të përkryer) ajo mund të paraqes pozitën e saktë të parcelave, ndërtesave dhe pronave të tjera të paluajtshme deri në disa centimetra. Por sot, cilësia gjeometrike e objekteve të paraqitura, e cila bazohet vetëm në “koordinatat e paraqitjes”, është shumë më ndryshe. Që hartat kadastrale digjitale të përdoren në mënyrë profesionale, koordinatat e të gjitha pikave të objekteve duhet të plotësohen me vlera të besueshme për tri atributet e propozuara të cilësisë: origjinën (burimin), saktësinë dhe besueshmërinë. Kjo është e domosdoshme për të siguruar cilësinë e këtyre të dhënave, por edhe për opsionin e përmirësimit gradual të cilësisë së dëshmimeve gjeometrike për pronat e paluajtshme që paraqiten në hartën kadastrale digjitale. Me shtimin e këtyre të dhënave cilësore, harta kadastrale digjitale përfshinë edhe mundësinë që të jetë dëshmia e vetme e bazuar në koordinata për të gjitha objektet e përcaktuara gjeometrike kadastrale. Kjo është mënyra më moderne dhe më ekonomike për të mbajtur dhe mirëmbajtur pjesën gjeometrike të pronës së paluajtshme pa teprica. Koordinatat përfundimtare të përcaktuara me matjet kadastrale paraqesin pozicionet e vërteta të pikave të objekteve kadastrale në realitet. Të njëjtat koordinata përdoren si koordinata për paraqitje përfundimtare në hartën kadastrale digjitale. Matjet e bazuara në GNSS gjithmonë rezultojnë në koordinata tre-dimensionale (hapësinore). Kjo është arsyeja pse komponenti i lartësisë duhet të merret parasysh edhe në kontekstin e matjeve kadastrale. Megjithatë, me matjet e

²¹¹ Shih: Ligjin Nr 2003/25 për Katastër të Kosovës; Neni 2, paragrafi 2.3;

²¹² Shih: Ligjin Nr 2003/25 për Katastër të Kosovës; Neni 2, paragrafi 2.4;

bazuara vetëm në GNSS do të përcaktohet lartësia e definuar elipsoide geometrike mbi elipsoiden e referencës GRS80.

I.5.1. Pregaditja e Projektit

Pas marrjes së të dhënave tekstuale dhe grafike për situatën e vjetër (ekzistuese), gjeodeti duhet të përgatisë projektin për krijimin ose ndryshimin e njësisë/njësive kadastrale. Kjo është e domosdoshme, përshembull për nënndarje ku gjeodeti duhet hartuar planin për nënndarje. Për këtë qëllim, ai/ajo duhet të përdorë një program të jashtëm. Nëse zona kadastrale është rindërtuar, projekti është përgatitur me të dhënat e siguruara nga ZKK. Nëse zona nuk është rindërtuar, gjeodeti së pari duhet matur kufijtë e jashtëm të njësisë/njësive. Matjet duhet të përfshijnë vetëm pjesën e pa rindërtuar. Kufijtë e rindërtuar nuk duhet të ndryshohen. Matja e situatës së vjetër është e detyrueshme për të gjitha punët kadastrale duke përfshirë nënndarjen, bashkimin, piketimin etj.,²¹³ Pastaj, këto të dhëna duhet të përdoren për përgatitjen e projektit.

I.5.2. Procesimi i të dhënave

Të dhënat e fituara nga matjet duhet të përpunohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kapitujt 18-20 të këtij publikimi dhe procedurat e rekomanduara të prodhuesit.

Gjeodeti importon koordinatat përfundimtare me kodet e tyre në programin e jashtëm që përdoret për përgatitjen e projektit. Pastaj ai/ajo modifikon karakteristikat e nevojshme grafike dhe përditëson dosjet e pranuar nga ZKK për të përgatitur të dhëna përsëri në SIKTK²¹⁴-HK.²¹⁵

I.5.3. Të dhënat e dorëzuara nga gjeodeti

Gjeodeti duhet të dorëzojë:

²¹³ UA 01/2013për Korrigjimin e Sipërfaqeve.

²¹⁴ **Sistemi Informativ Kadastral dhe Tokësor i Kosovës (SIKTK)**: SIKTK është sistem për mbledhjen, përpunimin dhe distribuimin e informacioneve mbi tokën në baza tekstuale dhe grafike të të dhënave

²¹⁵Shih:http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_04_ALA2003_25.pdf;

- aplikacionin e pronarit.
- kopjen e numrit identifikues të pronarit.
- përshkrimin e punës së kryer nga gjeodeti.
- të dhënat grafike dhe tekstuale të marra nga ZKK.
- raportin për përgatitjen e studimit.
- projektin për krijimin apo modifikimin e njësisë/njësive kadastrale.
- raportin e përpunimit të të dhënave.
- matjet origjinale në format të përshtatshëm për të treguar: datën dhe kohën e matjes, saktësinë e matjes dhe kodin e pikës.
- koordinatat përfundimtare të pikave të reja në formatin XLSX.
- hartën digjitale- një dokument që përmban një skicë të situatës së re dhe koordinatat.
- të dhënat tekstuale për situatën e vjetër dhe të re.
- certifikatën e pronarit për situatën e vjetër.
- faturën për pagesën e bërë ZKK-së.
- certifikatën për taksat e paguara nga pronari.
- licencën e gjeodetit.
- kopjen e numrit identifikues të gjeodetit.
- dosjet e hyrjeve për SIKTK-HK.
-

I.5.4. Kontrolli i Kualitetit nga gjeodeti

Gjeodeti i cili bën KK të dorëzimeve duhet të:

- kontrollojë plotësinë e dorëzimeve kundrejt;
- rishikojë matjet origjinale kundrejt kërkesave duke përdorur listën kontrolluese;
- realizoj kontrollë gjeometrike të dosjes së të dhënave për SIKTK-HK përfshirë edhe vlefshmërinë e gjeometrisë dhe lidhjes sipas procedurave specifike softuerike.

Gjithashtu bëhet dhe kontrollë vizuale të:

- koordinatave përfundimtare të pikave të matura kundrejt raportit të përpunimit të të dhënave.
- koordinatave përfundimtare dhe kodeve të pikave të reja në formatin XLSX.
- hartës digjitale kundrejt projektit për krijimin ose ndryshimin e njësisë/njësive kadastrale dhe koordinatave të fundit të pikave të reja.
- të dhënat tekstuale për situatën e re dhe të vjetër.
- përshkriminë punës së bërë nga ana e operatorit ekonomik.

Vetëm të dhënat të cilat e kanë kaluar KK nga gjeodeti do të dorëzohen në AKK.

I.6. Kërkesa për regjistrim

Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet me shkrim në ZKK-në në të cilën gjendet njësia kadastrale. ZKK-ja duhet të konfirmojë kohën dhe datën e regjistrimit të pranimit të kërkesës.

Aplikanti duhet t'i bashkëngjisë kërkesës matjet kadastrale për regjistrim në kadastër, si dhe dokumente të tjera relevante për të mbështetur kërkesën, sipas dispozitave të ligjit në fuqi të përfshira në kapiutill 3 të këtij publikimi. Kërkesa duhet të parashtrohet brenda 60 ditësh të matjeve kadastrale.²¹⁶

I.6.1. Shqyrtimi i kërkesës

ZKK duhet të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara. Nëse kërkesa apo matjet kadastrale nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Ligjit dhe këtij udhëzimi administrativ, ZKK-ja do t'i caktojë parashtruesit të kërkesës një afat kohor për të rregulluar këtë çështje.²¹⁷ ZKK-ja ka për detyrë ta njoftojë me shkrim parashtruesin e kërkesës rreth mangësive të konstatuara. Nëse brenda afatit parashtruesi i kërkesës nuk e plotëson dokumentacionin e kërkuar, ZKK-ja do të refuzojë të regjistrojë njësinë e pronës.

²¹⁶Shih: Ligji Nr. 04/-L-013 për Kadastër, Neni 13, Paragrafi 3.

²¹⁷ Shih: Ligji Nr. 04/-L-013 për Kadastër, Neni 13, Paragrafi 4.

ZKK do ta refuzojë regjistrimin nëse:

- *dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar se parashtruesi i*
- *kërkesës është mbajtës i të drejtës së asaj prone të paluajtshme.*
- Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse përmbajnë parregullsi të dukshme.
- Vlefshmëria e kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetëse është diskutabile.
- Nëse dokumentacioni është i mangët dhe nuk mund të ketë bazë për regjistrim.

ZKK-ja duhet të marrë vendim dhe të bëjë regjistrimin brenda 3 ditëve nga data e kërkesës.²¹⁸ Parashtruesi i kërkesës duhet njoftuar menjëherë pas përfundimit. Regjistrimi është efektiv me hyrjen e vendimit të ZKK-së në regjistër.

I.6.2. Rishqyrtimi

Brenda 30 ditëve, nga marrja e njoftimit me shkrim nga ZKK-ja mbi refuzimin për regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme, parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë nga ZKK-ja të rishqyrtojë vendimin.²¹⁹ ZKK-ja do të konfirmojë kohën dhe datën e pranimit të kërkesës për rishqyrtim. ZKK-ja do të marrë vendim lidhur me regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.²²⁰

Kur ZKK-ja konsideron se parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriteret për regjistrim, do të mbajë shënim për një vendim të tillë dhe do të regjistrojë të drejtën e pronës së paluajtshme në përputhje me rrethanat. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit me shkrim të ZKK-së mbi refuzimin e regjistrimit të së drejtës

²¹⁸ Shih: Ligji Nr.04/-L-013 për Kadastër, Neni 13, Paragrafi 5.

²¹⁹ Shih: Po aty. Neni 27, Paragrafi 1.

²²⁰ Shih: Po aty. Neni 27, Paragrafi 2.

së pronës së paluajtshme, parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë nga AKK të shqyrtojë vendimin e ZKK-së.²²¹

AKK-ja duhet të shqyrtojë vendimin e ZKK-së brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.²²² ZKK-ja duhet të zbatojë vendimin e AKK-së. Nëse ZKK-ja nuk e zbaton vendimin, atëherë AKK-ja do ta zbatojë atë vendim. Vendimi i lartpërmendur i AKK-së do t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësorë në pajtim me ligjin në fuqi.

I.7. Procesimi dhe regjistrimi

Me rastin e pranimit, kërkesa regjistrohet në SIKTK-T përmes faqes për Regjistrimin e Rastit.²²³ Rasti merr një numër automatik nga sistemi si dhe regjistrohet data e saktë. Lloji i Rastit të zgjedhur varet nga kërkesa (për shembull: "Bashkim", "Nënndarje", "Matje sporadike", etj.).

Mbikëqyrësi ia cakton rastin zyrtarit të procesimit i cili do ta bëjë procesimin si dhe do ta dërgojë tek verifikuesi për të verifikuar rezultatet e procesit.

Zyrtari i procesimit e vendos Rastin në SIKTK-T duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara drejtpërdrejtë nga parashtruesi i kërkesës apo nga gjeodeti. Pas vendosjes, rasti konsiderohet i vlefshëm dhe duhet të dërgohet për verifikim.

Para verifikimit, Rastet të cilat kërkojnë procedurë për njoftimin e publikut duhet të përfshihen në listën e njoftimit publik përmes faqes së verifikimit të SIKTK-T.²²⁴

Këto raste përfshijnë:

- transaksionin e pronësisë dhe posedimit;
- kontratën e qirambajtjes mbi 3 vite, kontratën e qirambajtjes mbi 10 vite dhe kontratën e qirambajtjes mbi 99 vite.

²²¹ Shih: Po aty. Neni 27, Paragrafi 1.

²²² Shih: Po aty. Neni 28, Paragrafi 3.

²²³ AKK/2011Udhëzues për Përdorues nëpërmjet Proceseve Biznesore duke përdorur SIKTK –T, Modul për Menaxhimin e Rastit, Pjesa 2.

²²⁴ AKK/2011Udhëzues për Përdorues nëpërmjet Proceseve Biznesore duke përdorur SIKTK –T, Modul për Menaxhimin e Rastit, Pjesa 2.

Lista për njoftimin e publikut duhet të gjenerohet, shtypet (duke përdorur SIKTK-T), dhe pastaj të ekspozohet në komunë në tabelën e shpalljeve për 5 ditë pune. Pas skadimit të afatit të njoftimit verifikuesi njoftohet se Rasti është gati për vendim përmes faqes së Verifikimit.²²⁵

Të drejtat tjera, p.sh. hipoteka, servitute, barra tatimore, etj. Nuk janë temë e njoftimit publik dhe SIKTK-T-ja nuk kërkon dërgimin e listës për njoftim publik.

SIKTK-T e lejon verifikuesin të pranojë apo të refuzojë Rastet e proceduara. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, apo nëse rasti nuk mund të procesohet për arsye të ndryshme, verifikuesi gjithashtu mund të refuzojë Rastin.

Verifikuesi i cakton parashtruesit të kërkesës një afat kohor prej 15 ditësh që ta dorëzojë dokumentacionin e plotë (shih 14.6). Nëse nuk i dorëzon brenda këtij afati, atëherë Rasti refuzohet. Pasi të pranohet, Rasti do të mbyllet dhe të dhënat kadastrale të modifikuara gjatë procesimit të Rastit do të ruhen përgjithmonë në bazën e të dhënave SIKTK-T.

I.8. Regjistrimi i paluajtshmërive

Gjatë procesit të rindërtimit të Kadastrit duhet të kërkohet dhe shqyrtohet dokumentacioni për zyrtarizimin e transaksioneve jo zyrtare që për ndonjë arsye, deri atëherë kanë mbetur jashtë sistemi kadastral. Regjistrimi apo ndryshimet në SIKTK mund të bazohen vetëm në dokumentet që i kanë ofruar subjektet që dojnë të bëjnë regjistrimin. Së pari, operatori ekonomik duhet të kërkojë nga pronari/përdoruesit të dorëzojnë dokumentet ligjore për regjistrimin e të drejtave pronësore. Këto dokumente duhet të pranohen nga fillimi i punës të OE e deri para perfundimit të Shikimit Publik.²²⁶ Regjistri i paluajtshmërive është mekanizëm, i cili administrohet nga organet shtetërore në të cilin mbahen të gjitha të dhënat për paluajtshmëritë. Regjistrimi është akti (veprimi) me anë të të cilit shënohen në këto regjistra të posaçëm, disa veprime juridike që lidhen me pasuritë e paluajtshme dhe që synojnë

²²⁵ Po aty.

²²⁶ Shih: <http://www.qbz.gov.al/botime/PasuritePaluajtshme.pdf>;

transferimin e ndonjë të drejte reale që lidhet me këto pasuri.²²⁷ Regjistrimi fillestar i çdo pasurie të paluajtshme bëhet me përgatitjen e një karteles dhe të një harte treguese të regjistrimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe në përputhje me dispozitat e çdo akti që përcakton pronësinë ose marrëveshjet apo detyrimet që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme.²²⁸ Dështimi për të regjistruar marrëveshjen e blerjes së një prone, mund t'ju bëjë një rrezik të madh. Çdo dokument që detyrohet të regjistrohet, por nuk është i regjistruar, nuk mund të pranohet si provë në asnjë gjykatë.²²⁹

Për pasojat që duhet të sjellë regjistrimi ekzistojnë dy sisteme kryesore:

1- Sistemi që regjistrimin e kërkon për efekt të fitimit të pronësisë ose të drejtës tjetër reale. Ky quhet sistemi kadastral.

2-Sistemi që regjistrimin nuk e kërkon për efekt të fitimit të së drejtës, si shkak preferimi. Ky sistem quhet sistemi i transkriptimit;²³⁰

Një shembull i këtij të fundit, i cili mbështetet në sistemin e transkriptimit është sistemi francez. Sistemi kadastral është pranuar dhe nga sistemi kosovar këtë e dallojmë fare mirë tek forma e veprimit juridik, ku kërkohet regjistrimi si element për vlefshmërinë e veprimit juridik dhe fitimit të pronësisë.²³¹ Kadastrën mund ta përkufizojmë si një regjistër, një inventar të përgjithshëm të pasurive të paluajtshme në një territor të dhënë, si një tërësi dokumentesh që shoqërojnë pasuritë e paluajtshme, qoftë sipërfaqen tokësore apo ndërtesat që ekzistojnë brenda një shteti. Kadastrë si koncept ka ardhur duke evoluar e përsosur deri në formën që ka në ditët e sotme si një regjistër i paluajtshmërive. Në të kaluarën ai nuk ka qenë i specifikuar vetëm për paluajtshmëritë, por në mënyrë të përgjithshme ka qenë formë e regjistrimit si për sendet e luajtshme dhe ato të paluajtshme, për mbajtjen e një pasqyre me qëllim pagimin e tatimit. Qëllimi tatimor ka qenë bazë e kadastrit,

²²⁷ Shehu. Avni. Pronësia, Tiranë, 2000. fq.100;

²²⁸ Shih: Ligjin. Nr.7843, datë 13.7.1994, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Neni 13, paragrafi 1;

²²⁹ Shih: <https://housing.com/news/laws-related-registration-property-transactions-india/>

²³⁰ Shih: <https://housing.com/news/laws-related-registration-property-transactions-india/>;

²³¹ Një gjë e tillë parashikohet dhe në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Kosovës.

pikërisht nevoja për të përcaktuar të ardhurat e tatueshme.²³² Qëllimi juridik sot konsiston në mundësinë për të siguruar dokumente kadastrale me vlerë juridike, që me anën e dokumenteve kadastrale të provohen të drejtat e regjistruara në kadastrë. Administrimi i kadastrit në Republikën e Kosovës bëhet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi. Ajo është autoriteti më i lartë për Kadastrë, Gjeodezi dhe Hartografi në Kosovë që merret me mirëmbajtjen e të gjitha evidencave zyrtare për pronat e paluajtshme të bazuara në të dhënat e matjes dhe kadastrit të tokave. Duke ditur vështirësitë që kanë ekzistuar në Kosovë para vitit 1999, regjistrimi i pasurisë sot është një sfidë si rezultat i vështirësive që vijnë nga e kaluara. Mos regjistrimi i paluajtshmërive ka ndodhur për shumë arsye ndër to më kryesore: mungesa e një infrastrukture të kompletuar ligjore, mungesa e planeve urbanistike dhe i parcelave ndërtimore. Gjithashtu në komuna vihet re mungesa e regjistrave të cilët janë marrë gjatë periudhës së luftës. Përsa i përket realizimit të qëllimit civil të kadastrit, në këtë periudhë informacioni vihet në dispozicion me anën e dokumenteve kadastral dhe veçanërisht planimetrisë së detajuar në shkallë të madhe të të gjithë territorit kombëtar, dhe analizës të çdo parcele tokës bujqësore dhe asaj urbane. Si njësi themelore e kadastrit është ngastra tokësore, ndërtesat, pjesët e ndërtesës ose përçojat.²³³ Secila komunë është e ndarë në Zona Kadastrale. Me Zonë Kadastrale kuptohet një pjesë e sipërfaqes së tokës e përcaktuar gjeografikisht, zakonisht një fshat në zonat rurale apo një qytet ose pjesë e tij në zonat urbane.²³⁴ Kadastrin përbëhet nga dy pjesë kryesore, nga regjistri i të dhënave mbi paluajtshmërinë dhe të dhënat teknike, të cilat kanë të bëjnë me hartat grafike të njësisë themelore të kadastrit qoftë ajo ngastër tokësore apo ndërtesë si pjesë e paluajtshmërisë. Për të regjistruar pasurinë e paluajtshme në regjistrin kadastral dokumentet kryesore që duhet të paraqiten janë:

²³² Shih: <http://geomatica.como.polimi.it/corsi/catasto/storia.pdf> vizituar për herë të fundit më datë 01.06.2017;

²³³ Shih: http://www.delhi.gov.in/wps/wcm/connect/doi_revenue/Revenue/Home/Services/Property+Registration

²³⁴ Shih: Ligji Për Kadastrin, Neni 7 Njësitë në Kadastrë;

- *dokument i vlefshëm nga një organ kompetent qoftë ai gjyqësor apo administrativ.*
- *vendimi i gjykatës kompetente.*
- *transaksioni ligjor, evidentuar nga dokumentet në përputhje me ligjet e aplikueshme në fuqi.*²³⁵

Karakteristikë e sistemit kadastral sot në Kosovë është digjitalizimi i të dhënave dhe përdorimi i databazës krahas librave manualë të përdorur në sistemin e mëparshëm. Gjatë një hulumtimi të bërë në dy komuna të Republikës së Kosovës për qëllime verifikimi të të dhënave kadastrale manuale dhe atyre digjitale u vu re se pati mospërputhje midis të dhënave të kaluara nga librat manual në databazën elektronike. Në rastin e Kadastrit vlen parimi i publicitetit çka do të thotë se të gjithë kanë të drejtë për të marrë informacion - të dhëna nga Kadastrit - përveç rasteve të rregulluara në paragrafin 2 të Nenit 22 të Ligjit për Kadastrin.²³⁶

I.8.1.Mënyra e Regjistrimit:

Regjistruesi, një person ose çdo grup i ngarkuar nga kryere-gjistruesi kërkon që pronësia si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- *Pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë,*²³⁷
- *Individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, sipas shkronjës “a”, por nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme, kanë të drejtë t’i paraqesin regjistruesit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me dokumentin e pronësisë, me një planvendosje apo genplanin e pasurisë, deklaratën noteriale të pronarëve fqinjë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për pronësinë dhe kufijtë e pasurisë që pretendohet, si dhe kopje të vërtetuara nga noteri të*

²³⁵ Murat Meha, Analysis of Cadastral Data in the Perspective of Land Administration in Kosovo.

²³⁶ Shih: <http://www.qbz.gov.al/botime/PasuritePaluajtshme.pdf>

²³⁷ Shih: Kodin Civil të Shqipëris. Neni 193;

dokumenteve të ndryshme, që mbështesin kërkesën për regjistrim. Regjistruesi, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuetit pas pagesës së shpenzimeve, të cilat parapaguhet nga kërkueti. Kundër vendimit të regjistruetit ose në mungesë të përgjigjes, me kalimin e këtij afati, kërkueti mund të ankohet në gjykatë. Në procesin gjyqësor gjykata thërret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë ngjitur njëra-tjetrës e të cilët kanë interes të ligjshëm në gjykim.²³⁸

Pra kërkesa për regjistrimin e pronësisë duhet të përmbaj:

- dokumentin e pronësisë;
- një plan rievimi të pasurisë, të përgatitur nga një subjekt i licencuar për punime topografike, sipas kërkesës së të interesuarit apo nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet. Regjistruesi, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuetit, pas pagesës së shpenzimeve, të cilat parapaguhet nga kërkueti. Kundër vendimit të regjistruetit ose në mungesë të përgjigjes, me kalimin e këtij afati, kërkueti mund të ankohet në gjykatë. Në procesin gjyqësor gjykata thërret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë kufitare me njëra-tjetrën, e të cilët kanë interes të ligjshëm për gjykim.²³⁹

c) *Për kalimin në pronësi të sipërfaqes, kur në dokumentin e pronësisë është bërë shënimi “oborr në përdorim”, kërkuetit duhet t'u drejtohen organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave. Për rastet, të cilat nuk janë subjekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, kërkuetit i drejtohen institucionit të autorizuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e kalimit të kësaj sipërfaqeje në pronësi, në këto raste, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.²⁴⁰*

I.8.2.Njoftimi publik

²³⁸ Shih: LIGJ Nr. 33/2012. Ligji për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Neni 25;

²³⁹ Shih: <http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/alb112532.pdf>;

²⁴⁰ Shih: <http://www.qbz.gov.al/botime/PasuritePaluajtshme.pdf>

Regjistrimi i përkohshëm duhet të afishohet për 45 ditë në një vend të përshtatshëm për konsultim publik brenda zonës gjeografike ku këto pasuri janë të lokalizuara. Gjithashtu do të bëhet edhe një njoftim për këtë periudhë 45 ditëshe sipas një mënyre publike për të lajmëruar individët që mund të bëjnë ndonjë pretendim për pasuritë e paluajtshme. Gjatë kohës së afishimit të gjitha gabimet apo pretendimet duhet t'i bëhen të ditura regjistruarit. Asnjë pretendim i paraqitur pas kësaj periudhe 45 ditëshe, nuk do të pranohet për shqyrtim.²⁴¹ Informacioni për regjistrimin e kryer, sipas nenit 25 të këtij ligji, duhet të afishohet për 45 ditë në një vend të përshtatshëm për konsultim publik, brenda zonës kadastrale ku këto pasuri janë të lokalizuara.²⁴² Ky afishim duhet të shoqërohet edhe me kryerjen e një njoftimi publik, për të lajmëruar individët që mund të kenë ndonjë pretendim për pasuritë e paluajtshme të regjistruara. Të gjitha gabimet e konstatuara apo pretendimet e paraqitura gjatë kohës së afishimit duhet t'i bëhen të ditura regjistruarit. Çdo pretendim i paraqitur pas kësaj periudhe 45-ditore të afishimit nuk do të pranohet për shqyrtim nga regjistruari. Me kërkesë të pronarit të një pasurie të paluajtshme ose të qiramarrësit, të cilëve nuk u është lëshuar asnjë certifikatë pronësie ose qiraje, regjistruari i lëshon pronarit një certifikatë pronësie ose qiraje, sipas rastit, në formë të shkruar duke pasqyruar të gjithë informacionet që ndodhen në kartelën e kësaj pasurie dhe që kanë efekt mbi pasurinë e paluajtshme apo mbi kontratën e qirasë.²⁴³ Për çdo pasuri të paluajtshme, të regjistruar në kartelën përkatëse, për pronësi, hipotekim apo për kontrata të ndryshme që janë realizuar mbi këtë pasuri, lëshohet vetëm një certifikatë. Certifikata e pronësisë, e qirasë apo e hipotekës është dëshmi e vlefshme për çështjet që tregohen në të, ndërsa pasuria e paluajtshme kontrata e qirasë apo hipotekës u nënshtrohen të gjitha atyre që janë shkruar në kartelë si në rastin kur këto shënohen

²⁴¹ Shih: <http://www.ikub.al/Ligje/1204200123/Article-Per-REGJISTRIMIN-E-PASURIVE-Te-PALUAJTSHME.aspx>;

²⁴² Shih: <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:33/2012:21.03.2012;>

²⁴³ Shih: Ligjin Nr. **33/2012.**// Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme i Shqipërisë. Neni 32, paragrafi 1.

në certifikatë ashtu edhe kur nuk shënohen. Data e lëshimit të certifikatës së pronësisë, së qirasë apo hipotekës shënohet në kartelë.²⁴⁴

PËRFUNDIMI

12. Konrad-Adenauer-Stiftung, (2018), *The influence of external actors in the Western Balkans, A map of geopolitical players*
13. Kurtoglu Eskisar, Gul M. *A Facilitator or A Hindrance: the Role of Religion on Balkan Peace*, Department of International Relations
14. Lucius, C., (2012), *Religion and the National Security Strategy*
15. Mijalkovic, S., (2009), Nacionalna bezbednost - od vestfalskog koncepta do posthladnoratvoskog,
16. Oran, B., (1994), *Religious and national identity among the Balkan muslims : A comparative study on Greece, Bulgaria, Macedonia and Kosovo*
17. Shala, Xh., (2018), *Inter-Religious Communication, Religious Radicalization and Security Issues*, European Journal of Social Sciences
18. Terziev, V., Levski, V., Koleci, R., Koleci, B., (October 2018), *Security Dilemmas and Defense Challenges in Kosovo and Western Balkans*, University Hadzi Zeka, Peja, Kosovo
19. THE INTER-UNIVERSITY CENTER FOR TERRORISM STUDIES, (August 2018), *Security Challenges in the Balkans*, 2018
20. Vjekoslav, P., (October 2014), *Religion in the Balkan Wars*
21. Котовчевски, М., Котовчевска, Б., (2018), *Од интегрална кон национална безбедност*
22. НАЦИОНАЛНА КОНЦЕПЦИЈА ЗА БЕЗБЕДНОСТ И ОДБРАНА

23. Фондација Фридрих Еберт (2008), *Партнери во мир и превенција, Регионална стабилност преку човекова безбедност*, одбрани текстови од Конференции за Превенција и човекова безбедност 2005-2007

VICTIM OF THE CRIMINAL OFFENSE

DR. Av. Firdusi AJAZI

Member of Local Chamber of Attorney Durres

Msc. Av. Elton Kanapari

Member of Local Chamber of Attorney Durres

Abstract

In this topic, we will address the place where the victim of the criminal offense is involved in the criminal trial in the Republic of Albania, as well as her participation in criminal trials.

In criminal trials in Albania before the 2017 amendments to the Code of Criminal Procedure and the Criminal Code, the victim of the criminal offense was not a direct participant in the trial. The court was not obliged to summon the victim of the criminal offense to take an active part in the criminal proceedings.

Following the changes in 2017, summoning a victim of a criminal offense to court is now an obligation for the court. The participation of the victim of the criminal offense or its heirs is now a positive step towards better guaranteeing their rights.

Although we have legal changes in favor of the victim of the crime or their heirs, we still have shortcomings in their effective protection. This comes as a result of the negligence of the victims of the criminal offense in their active participation in the trial. In most cases, victims follow the trial only as participants or by intervening very little in the process to protect their rights. This fact has to do with the concept that has existed so far for criminal trials where only the prosecutor and the defense of the defendant have been at the center of the criminal trial.

This fact also comes from the negligence that the victims of criminal offenses treat the criminal process by not choosing a lawyer to protect their rights in the criminal process but by following the process itself and not recognizing all its rights in process then and effective victim protection is not complete.

Abstrakt

Në këtë temë do të trajtojmë vendin të cilën zë viktimat e veprës penale në procesin gjyqësor Penal në Republikën e Shqipërisë si dhe pjesëmarrjen e saj në proceset gjyqësore penale.

Në proceset gjyqësore penale në Shqipëri përpara ndryshimeve të vitit 2017 të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal, viktimat e veprës penale nuk ka qenë pjesëmarrëse e drejtëpërdrejtë në gjykim. Gjykata nuk e kishte detyrim thirrjen e viktimës së veprës penale për të marrë pjesë aktive në procesin gjyqësor penal.

Pas ndryshimeve të vitit 2017, thirrja në procesin gjyqësor të viktimës së veprës penale është tani detyrim për gjykatën. Pjesëmarrja e viktimës së veprës penale apo e trashëgimtarëve të saj është tani më një hap pozitiv drejtë garantimit sa më mirë të të drejtave të tyre.

Megjithëse kemi ndryshime ligjore në favor të viktimës së veprës penale apo të trashëgimtarëve të tyre, sërisht kemi mangësi në mbrojtjen efektive të tyre. Kjo vjen si shkak i vetë neglizhencës nga ana e viktimave të veprës penale në pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin gjyqësor. Në të shumtën e rasteve viktimat e ndjekin procesin gjyqësor vetëm si pjesëmarrës ose duke ndërhyrë shumë pak në proces për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ky fakt ka të bëjë edhe me konceptin që deri më tani ka ekzistuar për proceset gjyqësore penale ku në qendër të procesit gjyqësor penal ka qenë vetëm prokurori dhe mbrojtja e të pandehurit.

Ky fakt vjen edhe nga vetë neglizhenca që viktimat e veprës penale e trajtojnë procesin gjyqësor penal duke mos zgjedhur një mbrojtës për të mbrojtur të drejtat e tyre në procesin penal por duke e ndjekur vetë procesin dhe duke mos i njohur të gjitha të drejtat e saj në proces atëherë dhe mbrojtja efektive e viktimës nuk është e plotë.

Viktima e veprës penale

Me viktimë të veprës penale do të kuptojmë ata persona të cilët në mënyrë individuale apo kolektive kanë pësuar dëmtime fizike të cilat kanë sjellë si pasojë jo domosdoshmërisht humbjen e jetës por mund të kenë pësuar edhe lëndime qofshin këta të lehta ose të rënda. Në grupin e viktimave nuk futen vetëm personat të cilët kanë pësuar dëmtime trupore me pasoja për jetën ose jo por edhe personat të cilëve u është shkaktuar dëm psikologjik apo ekonomik duke prekur në këtë mënyrë të drejtat e tyre themelore.

Viktima e veprës penale, pikësëpari ka nevojë për një mbrojtje funksionale. Sot në proceset penale në gjykim, rëndësi i kushtohet plotësisht në mënyrë të plotë të drejtave të autorit të veprës penale. Të drejtat e viktimës në të shumtën e rasteve janë sekondare, dhe plotësisht të këtyre të drejtave duhet që ti kushtohet një rëndësi më e madhe. Për promovimin e të drejtave të viktimës deri më tani janë miratuar dhe ratifikuar konventa të nxjerra nga OKB në nivel të përgjithshëm apo edhe nga Këshilli i Europës. Një dokument me rëndësi në lidhje me të drejtat e viktimave të veprave penale është Rezoluta e OKB-s, “Mbi principet e funksionimit të drejtësisë në lidhje me viktimat e kriminalitetit dhe keqpërdorimin e pushtetit” e vitit 1985. Kjo rezolutë është ratifikuar edhe nga Shqipëria si përpjekje për të realizuar më mirë të drejtat e viktimave.²⁵⁵ Sigurisht që këto akte ndërkombëtare nuk i japin një zgjidhje të plotë problemeve që hasen me respektimin e të drejtave të viktimës. Të drejtat e viktimës të veprës penale në Shqipëri janë parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, i cili rregullon pozitën e viktimës së veprës penale, në vecanti të drejtat e tyre kur kemi të bëjmë me vepra penale të krimeve seksuale, veprat penale kundër fëmijëve, të moshuarve apo të personave të tjerë, të cilët nuk kanë mundësi që të mbrohen. Viktima e veprës penale ka të drejtë që të paraqesë prova, fakte, të kërkojë dëmshpërblim etj.

Një problem më vete për viktimën e veprës penale është riviktimizimi i tyre. Viktima e veprës penale mund të ndiejnë riviktimizim përsëri në rastet kur ato ndërmarrin

²⁵⁵http://www.ajls.org/doc/2_APuka_Mbrojtja_Viktimes_se_Krimit.pdf

hapa për denoncimin e çështjes. Ata mund të përballen me paragjykimet e shoqërisë apo edhe të autoriteteve shtetërore të cilat duhet të jenë garantuese të këtyre të drejtave. Shpesh viktimat duhet që të përballen me autorin e veprës penale dhe të rikujtojnë momentet e ngjarjes duke ndikuar dhe në gjendjen emocionale të saj. Shmangia e riviktimizimit mund të bëhet nëpërmjet trajtimit intensiv dhe rritjes së profesionalizimit të punonjësve të autoriteteve shtetërore.

Për arritjen e këtij qëllimi, nevojitet që dhe nga Shqipëria të hartohen plane për mbrojtjen e viktimave, mbështetur në dispozita të qarta ligjore që ju garanton atyre realizimin efikas të të drejtave dhe trajtimin përkatës prej kontaktit të parë me organet përkatëse e deri në zgjidhjen e çështjes në tërësi.

Në funksion të kësaj, rëndësi të vecantë duhet që t'u kushtohet të drejtave të viktimës në castin e parë që bëjnë denoncimin e veprës penale në polici. Gjatë kontaktit të parë të viktimës me policinë dhe marrjen në pyetje të saj në lidhje me ngjarjen ajo paraprakisht duhet ta informojë viktimën për të drejtat e saj dhe ofrimin e mbrojtjes juridiko-profesionale në rast të pamundësisë financiare.

Rol të rëndësishëm në realizimin e të drejtave të tyre luan edhe vetë viktimat duke kërkuar vete në mënyrë aktive që t'i realizohen disa të drejta, që vetëm me inicim e saj mund që të realizohen nga policia, prokuroria apo dhe vete gjykata. Për tu realizuar këto të drejta duhet që viktimat të marrë ekskluzivitetin e aktivizimit të tyre.

Disa forma të vetërealizimit të të drejtave nga ana e viktimave janë:

- Të kërkojë ndjekjen penale të autorit. Në shumë raste është viktimat ajo e cila duhet që të iniciojë një proces penal, pasi në rast të mosvënies në dënim të institucioneve përkatëse për një krim të caktuar është e pamundur që këto institucione të veprojnë kryesisht.
- Të kërkojë marrjen e provave, të parashtrojë kërkesa për marrjen e provave të reja që viktimat mendon se do të ndikojnë në përfundimin e hetimeve dhe gjatë procesit gjyqësor.
- Të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat por pa çënuar sekretin hetimor.
- Të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal.

- Të përjashtohet në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i cdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë padisë që lidhet me statusin e viktimës së veprës penale.

Të drejtat e sipërpërmendura janë ekskluzivitet i viktimës së veprës penale dhe pa iniciimin e saj nuk mund që të realizohen.

Përkundër këtyre të drejtave të cilat duhet që të iniciohen nga vetë viktima, kemi edhe disa të drejta të cilat duhet që të ushtrohen dhe realizohen nga organet e drejtësisë. Në këtë rast, këto të drejta duhet të jenë në vëmendje të vecantë të Prokurorit, Gjykatës, si dhe oficerit të policisë gjyqësore, pasi këto të drejta janë ekskluzivitet i organeve të drejtësisë, pavarësisht nëse viktima ose përfaqësuesi i saj kanë kërkuar realizimin e tyre ose jo. Në këtë rast, avokati i viktimës ose i përfaqësuesi i saj ligjor kanë detyrë të jenë të vëmëndshëm për të identifikuar nëse janë përmbushur këto të drejta, si dhe për të kërkuar në vijim respektimin e tyre nga organet përgjegjëse, deri në ankim për shkelje procedurale. Këtu përfshihen vecanërisht të drejtat si më poshtë:

- Të zgjedhë mbrojtës dhe kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas në rast të pamundësisë financiare
- Të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimimin e tij, në bazë të parashikimeve të K.Pr.P
- Të informohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit.
- Të thirret nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar
- Të përfitojë kujdes shëndetësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tera të ofruara nga autoritetet, organizatat dhe institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale
- Të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar.

- Në rast të mosplotësimit të këtyre të drejtave të viktimës së veprës penale nga ana e organeve të drejtësisë mund të dërgojë në pavlefshmëri aktesh dhe si të tilla mund të dërgojë në prishjen e procesit gjyqësor për shkak të mosrespektimit të të drejtave të viktimës.²⁵⁶

Viktimat e dhunës në familje.

Shoqëria shqiptare një nga plagët më të mëdha që ka është dhe dhuna në familje. Format e shfaqjes së saj janë të ndryshme si dhunë fizike, ekonomike, apopsikologjike. Megjithatë në vitet e fundit kemi dhe një sensibilizim më të madh të shoqërisë në denoncimin e dhunës në familje, sërish duhet që të bëhet më shumë pasi numri i rasteve të denoncuara të dhunës në familje është më i vogël se numri real i rasteve të ndodhura. Ndër shkaqet kryesore të dhunës në familje janë, papunësia, alkoolizimi i dhunuesve, marrja e lëndëve narkotike, xhelozia por edhe shkalla e ulët arsimore e autorëve të veprës penale. Në përjashtim të këtyre faktorëve, kemi edhe faktorë të tjerë të cilët lidhen edhe me mentalitetin patriarkal të shoqërisë shqiptare.

Ndëshkimi i autorëve të veprave penale të dhunës në familje kanë qenë prioritet i legjislatorit shqiptar. Si masë mbrojtëse kundër dhunës në familje, K.Penal i Republikës së Shqipërisë me ndryshimet e bëra në vitet 2012-2013 e parashikon dhunën në familje si një vepër të vecantë penale dhe ndëshkimet e parashikuara për autorët e veprave janë rënduar me qëllim që të ndikojë në uljen e veprave penale të dhunës në familje.²⁵⁷

Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të anëtarëve të familjes, lidhjes së afërt pët shkak të gjinisë apo krushqisë në nenin 130/a të K.P parashikohet se;

“Rrahja si dhe cdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt

²⁵⁶ <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/373351?download=true>.

²⁵⁷ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/linert-lireza/?lang=en>.

me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në 2 vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkoshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

*Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet”.*²⁵⁸

Nga interpretimi që mund ti bëjmë dispozitës së mësipërme, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posacme juridike njëkohësisht dy objekteve:, familjes dhe shëndetit nga veprimet ose mosveprimet kriminale të autorit të veprës penale. Paragrafi i fundit i nenit 130/a e cilëson si rrethanë cilësuese praninë e fëmijës në momentin e konsumimit të veprës penale. Kjo gjë bëhet për të mbrojtur integritetin psikologjik të fëmijës dhe shmangien që në një të ardhme të afërt ky fëmijë dëshmitar i dhunës në familje të bëhet një autor potencial i dhunës. Tërësia e këtyre ndërhyrjeve ligjore duke ashpërsuar dënimet në lidhje me dhunën në familje bëhet me qëllim uljen e veprave penale të dhunës në familje.²⁵⁹

Format më të shpeshta të shfaqjes së dhunës në familje janë:

- Dhuna fizike. Është forma më e dukshme e dhunës në familje. Kjo formë dhune në të shumtën e rasteve përfshin goditjet, thyerjen e gjymtyrëve, plagosjen, djegien apo edhe mbytjen e viktimës së veprës penale.
- Dhuna psikologjike dhe emocionale. Kjo formë dhune ka si qëllim uljen e vetëvlerësimit ose vetëbesimit të viktimës së veprës penale. Pjesë e saj mund të jenë kritikata e vazhdueshme dhe të pajustificuara, fyerjet, shpifjet apo

²⁵⁸ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë, Neni 130/a, Dhuna në familje.

²⁵⁹ Ismet Elezi, E Drejta Penale, Pjesa e Posacme, fq179-180, “KUMI” Tiranë 2014

edhe poshtërimi në publik. Kjo formë e dhunës mund që të sjellë si pasojë edhe mbylljen e viktimës në vetvete duke mos u shoqëruar më me persona të tjerë apo edhe duke transmetuar modelin e dhunshëm tek fëmijët e tij/saj.

- Dhuna ekonomike. Në të shumtën e rasteve autor i kësaj forme dhune janë pjesëtarët e familjes të cilët janë në marrëdhënie pune dhe të cilët kanë kontrollin financiar të familjes. Duke patur këtë kontroll në familje, autori i ndalon pjesëtarëve të tjerë që të marrin vendime sesi mund që të menaxhohen këto të ardhura apo i ndalon që të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme apo edhe refuzimit të dhënies së parave për plotësimin e nevojave bazike në familje. Viktima të dhunës ekonomike nuk janë vetëm anëtarë të familjeve me të ardhura të ulëta por edhe anëtarë të familjeve me të ardhura mesatare apo të larta.²⁶⁰
- Dhuna seksuale. Kjo formë e dhunës përfshin imponimin, detyrimin e viktimës për të kryer marrëdhënie seksuale ose sjellje seksuale pa pëlqimin e viktimës. Viktima të dhunës seksuale nuk mund të konsiderojmë vetëm femrat por ka edhe raste në të cilat viktima të dhunës seksuale janë meshkujt. Megjithatë, pabarazitë gjinore midis meshkujve dhe femrave bëjnë që këto të fundit të jenë më të predispozura që të jenë viktima të dhunës në familje.
- Dhuna shoqërore. Autori i veprës penale të dhunës shoqërore tenton që të manipulojë apo izolojë viktimën. Me qëllim rritjen e varësisë së viktimës, abuzuesi mundohet që ti shkëpusë marrëdhëniet e viktimës me shoqërinë. Abuzuesi për ta bërë sa më të madhe varësinë e viktimës ndaj tij, e privon atë nga përdorimi i mjeteve të zakonshme të përditshmërisë si: celulari, makina apo ndalimi për të takuar familjarët e tyre. Viktimës së dhunës shoqërore i duhet që për cdo veprim të sajën duhet që të marrë leje tek dhunuesi i saj.

²⁶⁰ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/linert-lireza/?lang=en>

- Dhuna e asistuar. Viktimat e dhunës së asistuar nuk janë viktimat të drejtëpërdrejta të dhunës. ato kanë qenë të detyruar të asistojnë në një skenë dhune pa dëshirën e tyre.²⁶¹

Për të ulur sa më shumë numrin e rasteve të dhunës familjare është miratur dhe Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ky ligj në nenin 10 të tij parashikon masat mbrojtëse që duhet të marrin organet ligjzbatuese në rast se përballen me rastet e dhunës në familje. Neni 10 i ligjit parashikon se në rastet kur rrezikshmëria është e evidente dhe e pashmangshme, agresori duhet që të largohet menjëherë nga banesa për një afat të pacaktuar me urdhër të gjykatës duke mos e lejuar atë të hyjë në banesë pa marrë më parë një leje nga gjykata. Me qëllim parandalimin e dhunës në ambjentet jashtë shtëpisë gjykata vendos edhe disa limite në lidhje me distancën që duhet të mbajë agresori ndaj viktimës, familjarëve të tjerë, vendit të punës së viktimës. Në rastet kur largimi i dhunuesit nga banesa është i pamundur, atëherë, është gjykata ajo që investohet në gjetjen e një banese të përkohshme për viktimat me qëllim që të shmanget ngjarje më të rënda.²⁶²

Një tjetër masë por që është me karakter ekonomik është edhe detyrimi i dhunuesit që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme ose të përhershme të viktimës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim. Gjykata mund që të vendosë edhe masa mbrojtëse shtesë nga ato të kërkuara në kërkesë padi. Këto masa gjykata i jep në rast se i konsideron të nevojshme dhe që do të ndihmonin në mos rëndimin e situatës.

Pavarësisht këtyre masave të dhëna nga gjykata, problem në Shqipëri mbetet ekzekutimi i këtyre vendimeve. Sigurisht që faji në ekzekutimin e këtyre masave nuk i mbetet vetëm gjykatave por edhe institucioneve të tjera shtetërore të cilat janë të ngarkuara me ekzekutimin e këtyre vendimeve. Gjykata e ka për detyrë që pas dhënies së urdhërit të mbrojtjes apo cdo lloj mase tjetër mbrojtëse duhet që të tregohet e vëmendshme për të kontrolluar zbatimin e këtyre masave. Funkcion të

²⁶¹ Ismet Elezi, E Drejta Penale, Pjesa e Posacme, fq179-180, “KUMI” Tiranë 2014

²⁶² Ligji Nr.9669 dt.18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Neni 10.

drejtëpërdrejtë në zbatimin e urdhrave të mbrojtjes luan përmbaruesi gjyqësor. Përmbaruesit duhet që ti trajtojnë si çështje prioritare urdhrat e mbrojtjes të dhëna nga gjykata pasi moszbatimi i tyre mund që të sjellë pasoja të rënda. Në Shqipëri ekzekutimi i urdhrave të mbrojtjes është një problem pasi në shumë raste nuk janë ekzekutuar në kohë. Mosekzekutimi i urdhrave të mbrojtjes nga ana e përmbaruesit në disa raste ka sjellë edhe pasoja fatale për viktimën. Autori i dhunës i ndjerë i “fyer” nga viktima ka ndërmarrë veprime edhe më të rënda duke sjellë si pasojë plagosjen ose vrasjen e asaj.²⁶³

Veprat penale kundër të miturve.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve përbën një ndër drejtimet kryesore të sistemit tonë penal. Të drejtat e të miturve janë parashikuar në Kushtetutën e vendit, janë ratifikuar nmarrëveshje ndërkombëtare si Konventa të ndryshme të OKB-së dhe instrumentave të tjera të ndërkombëtare, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të vecantë nga familja dhe shteti. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut parashikon se, fëmijët kanë të drejtë për ndihmë dhe përkrahje të vecantë, për një zhvillim sa më harmonik të personalitetit të tij. Në vitin 1992 Shqipëria ratifikoi Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijëve. Konventa parashikon detyrimin e qartë të shtetit, për të mbrojtur fëmijët nga çfarëdo lloji dhune. Megjithatë për të patur një arritje sa më të plotë të të drejtave të fëmijëve shteti duhet që të bashkëpunojë me prindërit e fëmijëve të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët. E drejta e trajtimit të diferencuar të të miturve është parashikuar edhe nga Kushtetuta Shqiptare në nenin 54 të saj, ku theksohet se:

- 1) Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të vëçantë nga shteti.
- 2) Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.

²⁶³ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/linert-lireza/?lang=en>

- 3) Cdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, vecanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.²⁶⁴

Me kalimin e viteve dhe marrjen e eksperiencës nga vendet europiane në vitin 2017 në Shqipëri hyri në fuqi Kodi Penal i të Miturve. Me hyrjen në fuqi të këtij kodi, bëhet e mundur që i mituri të trajtohet në mënyrë të diferencuar, si në rastet kur është viktimë i veprës penale ashtu dhe në rastet kur është autor i veprës penale. Qëllimi i miratimit të Kodit penal për të Miturit është mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit, integritetin social të tij, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të mitur që janë dëshmitarë ose viktima. Kodi Penal për të Miturit parashikon në mënyrë të specifikuar në Kreun V të saj të drejtat e të miturit të mitur, i cili është dëshmitar i veprës penale ose viktimë e saj. Në nenin 33 të Kodit Penal për të Mitur parashikohen parime të përgjithshme të cilat duhet që të respektohen për të mbrojtur privatësinë e të miturit dhe mbi të arrihet që i mituri të ketë një ndikim sa më të vogël nga vepra penale. Për të miturin dëshmitar ose viktimë duhet që të mbrohet jeta private e tij dhe të ruhet konfidencialiteti i të miturit. Në rast se për zbardhejn e çështjes duhet që të ndërhyhet dhe në të dhëna private të miturit, duhet që këto ndërhyrje të jenë sa më të paktë dhe të mos ndikojnë tek vijueshmëria e jetës normale të tij.²⁶⁵ Gjatë kësaj periudhe i mituri viktimë ose dëshmitar i një veprës penale duhet që të asistohet në cdo veprim nga përfaqësuesi i tij ligjor dhe nga një psikolog. Pavarësisht pranisë së psikologut gjatë të gjithë procesit penal, prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore duhet që të marrin një trajnim të specializuar në organet përkatëse. Prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, gjatë marrjes në pyetje të personave të mitur duhet që t'i bëjnë në ambiente të përshtatshme, duke patur parashysh moshën, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit, dhe vështirësitë në komunikim në rast se kanë. Një hap tjetër për mbrojtjen e të mituri viktimë ose dëshmitar i veprës penale është dhe ngritja e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës i cili funksionon si një institucion mbështetës. Gjatë

²⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 54

²⁶⁵ Kodi Penal I të Miturve. Neni 33

dhënies së vendimeve të saj Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut shprehet se, pyetjet e të miturit dëshmitar ose viktimë nuk duhet të bëhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë pasi mund ta rëndojë atë psikologjikisht. Gjykata, gjithashtu, shprehet se pyetjet e prokurorit mund të formulohen dhe t'i jepen një psikologu për një vlerësim, në mënyrë që, formulimi i saj të mos krijojë konfuzion tek viktima e mitur. K.Pr.Penale por edhe Kodi Penal i të Miturve siguron dhe detyron institucionet që të miturit t'i sigurojnë një mbrojtës. Mbrojtësi mund të jetë i zgjedhur vetë nga përfaqësuesit e të miturit, ose në rast pamundësie, mbrojtësi duhet që të sigurohet nga ana e shtetit. Në përjashtim nga personat e rritur të miturit nuk kanë të drejtë që të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes vetë. Kjo pasi formimi i të miturit nuk është i plotë dhe vlerësimi i tij për situatën në të cilën ndodhet mund të jetë i gabuar.

Mbrojtësi i të miturit duhet që të njohë mirë legjislacionin përfshirë dhe aktet ndërkombëtare që referojnë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, njëkohsisht duhet që të jetë sa më aktiv në sigurimin e një mbrojtjeje efektive që në fazën e hetimit, ai duhet që të ndihmojë në mënyrë aktive prokurorin në sigurimin e provave që dërgojnë në verifikimin e plotë të ngjarjes. Në rastet kur mbrojtësi është në dijeni të fakteve të tjera të cilat, i mituri nuk i ka deklaruar gjatë marrjes së dëshmisë së tij, ai duhet që të vërë në dijeni menjëherë prokurorin, pasi kjo gjë mund të ndikojë drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen e hetimeve por edhe të gjyqimit.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal I të Miturve.
- Ligji Nr.9669 dt.18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.
- Ismet Elezi, E Drejta Penale, Pjesa e Posacme, “KUMI” Tiranë 2014

- [http:// www.ajls.org/doc/2 APuka Mbrojtja Viktimes se Krimet.pdf](http://www.ajls.org/doc/2_APuka_Mbrojtja_Viktimes_se_Krimit.pdf)
- [https:// www.osce.org/sq/presence-in-albania/373351?download=true.](https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/373351?download=true)
- [http:// www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/linert-lireza/?lang=en.](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/tag/linert-lireza/?lang=en)

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E TATIMEVË

DR. Av. Firdusi AJAZI

Member of Local Chamber of Attorney Durres

Msc. Av. Elton Kanapari

Member of Local Chamber of Attorney Durres

Abstract

In this topic we will address the criminal offenses in the field of taxation, analyzing at least the impact of criminal offenses on economic and social development in Albania.

Criminal offenses in the field of taxation are one of the main problems in the Republic of Albania in the steps towards its economic development.

Taxes are the main source of income that directly affects a country's budget. Avoiding the declaration of income directly affects the opportunities that the state has to invest in economic areas that need more support.

The tax purposes are now not only fiscal, but also non-fiscal goals through which the numerous goals of financial (economic) policy are realized. So taxes are now used as a very effective financial instrument for achieving the many economic and social goals of the state.

Fiscal evasion has serious side effects, as it creates other criminal phenomena, with very serious consequences such as: excessive money to be used for the purpose of illegal financing, or corruption, inequality in the business world, serious social consequences, etc. . But on the other hand, tax evasion should be seen in connection with possible corruption in the ranks of the tax administration, as an offer made by the tax to dishonest payers (who hide and do not report income) to employees of the tax administration.

In the continuation of the paper we will analyze the provisions of the Criminal Code of the Republic of Albania which address criminal offenses related to the field of taxation.

Abstrakt

Në këtë temë do të trajtojmë veprat penale në fushën e tatimeve, duke analizuar sadopak ndikimin e veprave penale në zhvillimin ekonomik e shoqëror në Shqipëri.

Veprat penale në fushën e tatimeve përbëjnë një nga problematikat kryesore në Republikën e Shqipërisë në hapat drejt zhvillimit ekonomik të saj.

Tatimet jaë burimi kryesor I të ardhurave që ndikojnë drejtëpërdrejtë në buxhetin e një shteti. Shmangia e deklarimit të të ardhurave ndikon drejtëpërdrejtë në mundësi që ka shteti për të investuar në fusha ekonomike të cilat kanë më shumë nevojë për mbështetje.

Qëllimet e tatimit tani nuk janë vetëm fiskalë, por dhe qëllime jofiskale përmes të cilave realizohen qëllimet e shumta të politikës financiare (ekonomike). Pra tatimet tani përdoren dhe si instrument financiar shumë efikas për realizimin e qëllimeve të shumta ekonomike dhe sociale të shtetit.

Evazioni fiskal ka efekte anësore me peshë, pasi krijon dukuri të tjera kriminale, me pasoja shumë të rënda si: para të tepërta për t'u përdorur me qëllim financimet e paligjshme, apo korrupsionin, pabarazi në botën e biznesit, pasoja të rënda sociale etj. Por nga ana tjetër, evazioni fiskal duhet parë I ndërlidhur edhe me korrupsionin e mundshëm në rradhët e administratës tatimore, si një ofertë që bëhet nga tatim paguesit e pandershëm (të cilët fshehin dhe nuk raportojnë të ardhurat) ndaj punonjësve të administratës tatimore.

Në vijim të punimit do të analizojmë dhe dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të cilat trajtojnë veprat penale të lidhura me fushën e tatimeve.

Kuptimi, definicioni dhe karakteristikat e tatimit²⁶⁶

Tatimet paraqesin burimin kryesor të të hyrave publike me të cilat shteti i plotëson shpenzimet publike. Sot tatimet janë bërë të hyra të përherëshme të rregullta dhe të hyra më me rëndësi të cilat mbliidhen prej personave fizik dhe juridik dhe shërbejnë për financimin e shpenzimeve publike (shtetërore).

Tatimi është ajo pjesë e pasurisë të cilin çdo qytetar ja jep shtetit

– (nje definicion tjetër thotë) –

Tatimi është dhënie në para të cilat shteti i mbledh prej individëve në bazë të sovranitetit të vet, pa kundërshpërblim të drejtpërdrejt me qëllim të financimit të shpenzimeve publike

Karakteristikat kryesore të tatimeve janë:

Tatimet janë të hyra derivate – Pra shteti duke i tatuar subjektet ekonomike (fizike dhe juridike) i siguron të hyrat e veta dhe u'a zvogëlon fuqinë ekonomike personave fizik dhe juridik me qëllim që vetvetes t'i krijojë fuqi ekonomike për financimin e shpenzimeve publike.

Tatimet janë të hyra të detyrueshme të shtetit – Pagesa e tatimit është obligimi i përgjithshëm i cili nuk varet prej dëshirës se personave fizik dhe juridik, por bazohet në sovranitetin financiar të shtetit. Detyrimi pra si karakteristikë e tatimeve do të thotë se detyruesit tatimor janë të obligueshëm të paguajnë tatimin, sepse në të kundërtën bëhet arketimi i dhunshëm i tij.

Tatimet mbliidhen për financimin e shpenzimeve publike – nëpërmjet mjeteve të mbledhura me anë të tatimit, plotëson shpenzimet shtetërore (publike), pra tatimi si element kryesor i të hyrave publike shërben për plotësimin e interesave publike apo shoqërore.

Tatimet paraqesin dhënie pa kundërshpërblim të drejtpërdrejt – pra kur tatim paguesit i'a paguajnëtatimin shtetit ata nuk përfitojnë kundërshpërblim të drejtpërdrejt, mirëpo shteti i ofron tatim paguesit dobi indirekte. Pra kundërshpërblim i shtetit ndaj tatim paguesve është indirect, sepse nëpërmjet mjeteve të mbedhura shteti financon shpenzimet e arsimit, shkencës, kulturës,

²⁶⁶ Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

shëndetësisë, sportit, mirëmbajtjen e rrugëve, hekurudhave, ujësjellësit, kanalizimit, mbrojtje popullore, administratës etj.

Tatimet nuk e kanë karakterin e qëllimit të caktuar – qëllimi i tatimit sipas rregullave nuk caktohet përpara, pra të hyrat nga tatimet derdhen në buxhetin e shtetit dhe shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve të përbashkëta. Kjo do të thotë se tatimi nuk paguhet për një qëllim të caktuar përpara, për këtë arsye shteti nuk i jep shpjegime tatim paguesit se për çfare qëllimi do të përdoren të hyrat publike që rrjedhin nga tatimet.

Tatimet mbliidhen në para – tatimet në shtete modern caktohen në para dhe paguhen me mjete monetare, mirëpo vetëm në rastet e jashtëzakondëshme dhe rrallë paguhen në formë natyrale ose me punë. Gjithashtu pagimi i tatimit është definitive, pra dhënie pa kthim, që e bën të dallohet prej të hyrave të tjera p.sh huaja shtetërore e cila duhet të kthehet.

Tatimet nuk janë në lidhje me shtetësinë – karakteristikë e tatimeve është se ato nuk lidhen me atë se secilit shtet i përket detyruesi tatimor, pra tatim duhet të paguajnë të gjithë personat në territorin e shtetit të cilët realizojnë të ardhura ose kanë pasuri ose kanë trashëguar pasuri të patundëshme në shtetin përkatës pa marrë parasysh se a janë shtëtas të atij shteti apo jo. Përjashtim bëjnë personat e huaj diplomatik dhe konsullarë në bazë të reciprocitetit

Qëllimet e tatimit

Në shtetet skllavopronare dhe në shtetet feudeale qëllimi kryesor i tatimit ishte mbledhja e mjeteve financiare për plotësimin e nevojave shtetërore, kryesisht të nevojave mbretërore dhe të njerëzce të oborrit mbretëror. Ndërsa në shtete kapitalistezgjerohet roli i shtetit dhe në këtë ndryshojnë dhe qëllimet e tatimit. Qëllimet e tatimit tani nuk janë vetëm fiskalë, por dhe qëllime jofiskale përmes të cilave realizohen qëllimet e shumta të politikës financiare (ekonomike). Pra tatimet tani përdoren dhe si instrument financiar shumë efikas për realizimin e qëllimeve të shumta ekonomike dhe sociale të shtetit. Në këtë mënyrë tatimet janë bërë instrument i politikës ekonomike dhe ato ndikojnë:

Në politikën e cmimeve;

Në vëllimin dhe drejtimin e investimeve

Në barazimin e ofertës dhe të kërkesës

Në kufizimin e shkallës së inflacionit, etj.

*Në praktikë mund të hasim politikën tatimore **restriktive** dhe **ekspansive**.*

p.sh nëse kërkesa e përgjithshme në treg është më e madhe se oferta e përgjithshme, atëherë në këto raste me anë të politikës tatimore restrictive ndikohet në zvogëlimin e fuqisë blerëse të detyruesit tatimor dhe në këtë mënyrë edhe zvogëlohet kërkesa e përgjithshme. Pra politika tatimore restrictive quhet ajo politikë e cila është e drejtuar kah zvogëlimi i fuqisë blerëse të obliguesit tatimor dhe me atë ndikon në zvogëlimin e kërkesës së përgjithshme në treg.

Anasjelltas, nëse oferta e përgjithshme në treg është më e madhe se kërkesa e përgjithshme, atëherë duhet të ndërmerren masat për tu vendosur ekuilibri i prishur dhe stabiliteti ekonomik. Në këto raste me masat e politikës tatimore ekspansive ndikohet në rritjen e fuqisë blerëse të gjithmbarshme, e me atë të rritjes së kërkesës së përgjithshme. Pra politika tatimore e cila është e drejtuar kah rritja e kërkesës së përgjithshme në treg, quhet politikë tatimore ekspansive.

Me anë të politikës tatimore mund të realizohen qëllimet ekonomike të shtetit si p.sh të stimulohen ose destimulohen zhvillimi i ndonjë dege ekonomike, tregtia e jashtme etj.

Me anë të politikës tatimore mund të realizohen edhe qëllimet sociale të shtetit. P.sh me anë të aplikimit të normave progressive tatimore, përjashtimeve, lirimeve nga tatimi etj. P.sh me anë të politikës tatimore mund të nxitet ndërtimi i banesave duke i liruar nga pagimi i tatimit, të ndihmohet veprimtaria kulturore, arsimore, shkencore, shëndetsore pastaj caktimi i tatimit të lartë për pijet alkoolike me qëllim të zvogëlimit të konsumit të tij.

Mënyrat e kryerjes së evazionit fiskal – (sipas legjislacionit shqiptar)

Tatimi është një pagesë në buxhetin e shtetit me natyrë të detyrueshme dhe të pakthyeshme, i cili përfshin edhe dënimet administrative si dhe interes për pagesa të vonuara të përcaktuara në ligj.

Taksa është një kontribut i detyrueshëm për tu paguar nga cdo person i cili drejtpërdrejt përfiton një shërbim publik.

Diferenca ndërmjet detyrimeve tatimore ligjore që duhet të paguajë tatim paguesi dhe asaj që ai deklaron dhe paguan, përben evasion tatimor ose fiskal.

Ky evazion, pra ky boshllëk përfshin tre elementë:

Mosdeklarimin e të ardhurave dhe detyrimeve tatimore;

Nën deklarimin (deklarim më pak) të të ardhurave dhe detyrimeve tatimor;

Mospagimi në masë të plotë të detyrimeve tatimore të deklaruara

Subjektet e tatueshëm, synojnë sa herë që u paraqitet rasti, duke përdorur forma të ndryshme, që t'i shmangen pagimit të detyrimeve fiskale, që ata kanë kundrejt shtetit. Këtë ata e realizojnë në cdo formë, të sofistikuar apo në mënyrë edhe më të dukshme, mjafton thjesht të realizojë qëllimin.

Evazioni fiskal ka efekte anësore me peshë, pasi krijon dukuri të tjera kriminale, me pasoja shumë të rënda si: para të tepërta për t'u përdorur me qëllim financimet e paligjshme, apo korrupsionin, pabarazi në botën e biznesit, pasoja të rënda sociale etj. Por nga ana tjetër, evazioni fiskal duhet parë i ndërlidhur edhe me korrupsionin e mundshëm në rradhët e administratës tatimore, si një ofertë që bëhet nga tatim paguesit e pandershëm (të cilët fshehin dhe nuk raportojnë të ardhurat) ndaj punonjësve të administratës tatimore.

Ekzistojnë forma dhe mënyra të ndryshme, që zgjidhen nga subjekte të ndryshëm, me qëllim kryerjen e evazionit fiskal. Disa prej formave, në të cilat shfaqet evazioni fiskal po i përmëdim më poshtë:

Mosrregjistrimi në organet tatimore:

Personat fizikë apo juridikë, janë të detyruar me ligj, që paraprakisht të rregjistrojnë aktivitetin që mendojnë të realizojnë në organet tatimore. Në pjesën e subjekteve, kryesisht ato që kryejnë aktivitet në biznesin e vogël, nuk rregjistrohen në organet tatimore, duke mos deklaruar të ardhurat e përfituara nga aktiviteti, duke i mohuar shtetit marrjen e asaj pjese të detyrimit, që i takon me ligj. Subjekte të tjera të cilat kanë aktivitet të madh dhe të ardhura të tilla, që duhet t'i përkasin biznesit të madh, në fakt rregjistrohen dhe taten si subjekte që i përkasin biznesit të vogël. Në këto kushte detyrimi tatimor, krahasuar me atë që duhej të ishte më të vërtetë disa herë më i vogël. Subjekte të tilla janë si p.sh > bare, restorante, butikë, me xhiro mjaft të madhe, madje ka pasur raste edhe rrjete marketesh, që arrijnë të fshehin te ardhurat

e tyre reale e rregjistrohen si subjekte të biznesit të vogël duke paguar detyrime tatimore, aq sa paguan një nënpunës i shtetit.

Kjo është një nga format që mund të shmanget më lehtë, duke kontrolluar xhiron ditore të tyre, për të kontrolluar rreth të ardhurave realë që ata përfitojnë.

Mosdeklarimi në doganë:

Mosdeklarimi në doganë është një ndër mekanizmat e fshehjes së të ardhurave të subjekteve që duhet të tathohen, për faktin se ai con në mosgjatjen e mallit duke e “zhdukur” Brenda territorit të shtetit.

Mosdeklarimi i të ardhurave personale:

Punëdhënësit në Shqipëri, në mjaft raste nuk i deklarojnë pagat dhe as tatimet, që duhet t’u paguajnë organeve tatimore për të punësuarit e tyre. Kjo përbën një nga format e shmangies nga detyrimet tatimore. Në raste të tjera individët nuk i deklarojnë të ardhurat personale, kur ato duhet të mbahen në burim, pra tek punëdhënësi. Kjo quhet ndryshe – puna e zezë – ku individët, shpërblehen me para në dorë, dhe nuk deklarojnë pagat e tyre, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.

Mosdeklarimi i nënkontraktorëve:

Subjektet që ushtrojnë biznese të mëdha, sic mund të jenë p.sh – ato në fushën e ndërtimit, për realizimin e disa prej punëve të tyre, hyjnë në mardhënie më nënkontraktorë dhe nërmjet tyre realizojnë një pjesë të punës. Kompanitë e mëdha raportojnë një numër të vogël personash të punësuar prej tyre, për të cilët edhe paguajnë detyrime tatimore në shtet, ndërkohë që pjesën më të madhe të punës e kryejnë pikërisht më nënkontraktorët, të cilët më së shumti nuk figurojnë në organet tatimore. Duke vepruar kështu, nënkontraktorët i shpëtojnë pagimit të detyrimeve, si rezultat i punës së kryer prej tyre.

Shitjet dhe blerjet e parregjistruara në Cash:

Lloj tjetër i evazionit është dhe rasti i shitjeve apo blerjeve me lekë në dorë. Meqënëse transaksioni financiar i kryer në cash, nuk mund të kontrollohet në cdo rast nga ana e organeve tatimore, shitësit dhe blerësit, përfitojnë nga rasti për të mos pasqyruar këtë shit-blerje në librat e llogarisë. Kështu, deklarohen më pak shitje, dhe të ardhurat që duhet t’i nënshtrohen tatimit deklarohen pjesërisht. Blerësi në rastin e

blerjes me para në dorë, mund t'i shesë mallrat pa llogaritur vlerën e tvsh-se, pasi mardhënia e blerjes dhe më pas shitjes së mallit prej tij, nuk është pasqyruar në asnjë vënd. Rastet e blerjes së lëndës së parë më para në dorë, prodhimit të mallit dhe shitjes së tij, përsëri me para në dorë, janë rast tipik i evazionit fiskal.

Në përgjithësi transaksionet me para në dorë, pëlqehen së tepërmi nga personat që kërkojnë të bëjnë *pastrim parash*, pasi kështu i shmangen kontrollit banker, deklarimit të burimeve të të ardhurave dhe nxjerrin fitime të mëdha. Kryerja e kësaj veprimtarie nëpërmjet bankave, do të ishte tepët efektive jo vetëm për të kontrolluar të ardhurat, por njëkohësisht do të krijonte lehtësi edhe për efekt të hetimeve, në rastet kur do të nevojitet.

Nxjerrja me humbje e aktivitetit të biznesit:

Kjo formë e fshehjes së të ardhurave, që synohet të arrihet nëpërmjet ritjes fictive të shpenzimeve. Shpenzimet e dryshme, si ato për konsulenca, për qeranë e objekteve, për lëndën e parë etj., në bilanc jo me vlerën e shpenzimeve reale, por disa herë më të larta, duke bërë që bilanci i firmës të ketë një rezultat negative. Nxjerrja me humbje e aktivitetit/biznesit, në raste të tjera kryhet nëpërmjet mosfaturimit të të gjitha shitjeve.

Në rastet kur personat fizik apo juridikë, paraqesin përpara balance me rezultate negative, administrate tatimore ka të drejtë për fillimin e procedurave të falimentimit, kundrejt subjektit dhe pasurisë së tij, duke e konsideruar atë debitor²⁶⁷. Mirëpo humbja e mundshme e subjektit lejohet të mbartet në tre vitet pasardhës tatimorë dhe kur borxhi nuk do të shlyhet dhe pas kalimit të tre viteve, atëherë administrate tatimore duhet të kërkojë fillimin e procedurave të falimentimit²⁶⁸.

Këmbimet mall me mall:

Ky është një lloj mekanizmi për të shmangur pagimin e taksave që përdoret zakonisht nga tregtarët e vegjël, që kanë njohje mes tyre dhe shkëmbejnë vazhdimisht mall me njëri-tjetrin. Mardhënia midis tyre për të shkëmbyer mall me njëri-tjetrin, pa përdorur fatura tatimore, pa i pasqyruar në libra apo balance këto shit-blerje – kryhet

²⁶⁷ Kjo e drejte e administrates tatimore eshte e pasqyruar ne Ligjin Nr. 8901 Dt. 23.05.2002 - Per falimentimin -

²⁶⁸ Ligji Nr. 8438 Dt. 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" 27/1

për interes ë përfitimit të dyanshëm, me qëllim për ti shpëtuar pagimit të detyrimeve, që rrjedhin si rezultat i të ardhurave të përfituara prej tyre.

Shitjet e nënraportuara:

Tregtarët e mëdhenj përdorin si mekanizëm për t'iu shmangur detyrimeve tatimore, deklarimin e shitjeve poshtë vlerës reale të tyre. Kjo sjell në fakt, pakësimin e tvsh-së që duhet të paguajë subjekti. Ky fenomen në praktikë quhet zakonisht manipulimi i cmimeve të shitjes, i cili mund të ndodhë edhe me sasinë e mallit, kryesisht në rastet e prodhuesve vëndas.

Por, kjo ka edhe raste të vecanta të evazionit, p.sh kur kemi të bëjmë furnizime të tatueshme me tvsh. Në këto raste, subjekti i jep blerësit një faturë të rregullt në dukje, e cila në fakt nuk ka të shënuar të gjithë shumën që ka paguar klienti, për mallin apo shërbimin e përfituar, por një vlerë më të ulët. Kjo bëhet me qëllim minimizimin e qarkullimi të deklaruar, duke minimizuar në këtë mënyrë dhe detyrimet tatimore të pagueshme. Edhe në vetë, rolin e klientit, duke mos u treguar të kujdesshëm ndaj faturave që na serviren prej subjekteve tregtare, favorizojnë pa dashje evazionin fiskal.

“Tregtarët” provizorë:

Sikurse ka persona fizikë, që për arsye të caktuara ndërrojnë identitet, ekzistojnë edhe kompani, të cilat për t'iu fshehur kontrollit të administratës tatimore, veprojnë në të njëjtën mënyrë. Ato formohen dhe futen një emër të caktuar në tregun vëndas, duke përdorur pikërisht këtë mekanizëm mashtrues, dhe në këtë mënyrë, për një kohë të shkurtër, sa është jetgjatësia e tyre, ato prodhojnë dhe fatura false, që pasqyrojnë veprime që nuk janë kryer asnjëherë, si p.sh eksporte të kryera prej tyre duke kërkuar dhe zbritjen e tvsh-së për këto “eksporte” që kryejnë. Ata, në fakt i shesin mallrat e tyre brënda vëndit, por në fatura i pasqyrojnë si mallrat ë eksportuara.

Kërkesat për rimbursime:

Metodë tjetër e evazionit fiskal është ajo që realizohet nëpërmjet kërkesës që subjekti i paraqet organeve tatimore, në lidhje me masën e rimbursimit, që kërkon të përftojë prej tyre. Ai kërkon që të kreditohet për tvsh-në e paguar në blerjet fictive, që nuk janë bërë realisht prej tij. Kjo realizohet nëpërmjet paraqitjes së një numri faturash të rreme blerjeje, që rrjedhin nga mardhëniet e biznesit të tij, me persona të tretë, ku

Regarding the statement on *creativity as an innate talent*, teachers' responses were distributed across the spectrum of the agreement. While almost half of them don't think creativity is an innate talent (46.3% disagree or disagree with this statement), about a fifth of them (19.5%) think it is. Within those who strongly disagree that creativity is an innate talent, about 66% also think that everyone can be creative. This means that these respondents see creativity as a skill that can be developed and promoted in any person. It is not a gift of nature, but it depends on the food. These results show that these respondents perceive creativity as a talent that every child is endowed with from birth, supporting the broad view of children's natural creativity. A rather polarized distribution of opinions can be seen in the fourth statement: almost a little more than half of teachers (66%) claim that creativity varies by age group and over a quarter that does not. It can be noticed that even in the field research there are contradictory opinions on this statement. Sawyer (2006b) argues that the concepts of creativity are changing over time and space, and that in Europe in particular the idea that children are more creative than adults came into the romantic period. For him, this notion is a myth that contrasts with reality. In contrast to this position there is the assertion that schools (Robinson, 2006) and educators (Malaguzzi, 1987) kill and limit the natural creative attitude of young children. Many other researchers, especially educators, support it Being creative has different meanings for adults and children and that the definition of creativity should change according to age

groups. Studies with Meador and Runco (Meador, 1992, Runco, 1990) show that there has been a decline in the uniqueness and originality of young people since pre-adolescence, due to increased awareness and the need to be consistent with the Review Group.

Nearly twenty-seven out of forty-one teachers in this study supported a democratic view of creativity, arguing that everyone can be creative (65.9%). At the same time, one-fifth of respondents still believed that creativity was an innate talent (19.5%).


The results achieved differ from the findings of surveys conducted in various European Union countries. With about 21% difference, school teachers in Europe believe that anyone can be creative and 88% of respondents belong. At the same level, teachers' statements on the perception that creativity is an innate talent are presented, where in Albania 19.5% affirm this and 21% of European school teachers affirm it.

4.1.3 Creativity as the ability to produce something original

Creativity has been defined by researchers as 'the ability to produce work that is both new in type and appropriate' (Sternberg & Lubart, 1999). For a product or process to be creative, it must be both new and valuable. The balance between the two concepts is important: something original that has no value can also have negative characteristics (Beghetto, 2005). In the field of education, and in particular with the change in the meaning of applied creativity (for young people) the concept of value is difficult to structure. Children and young people are creative, but their creative processes are less likely to be innovative advances that have value for society as a whole. When we talk about creativity for young people, it is important to understand that judges of the value of the creative or production process must be the young people themselves, and that the creative process or product is valuable to them (Crafts, 2005, Runco, 1990). This adaptation of the definition of creativity in the educational context and at a young age of students is reflected in the opinions of teachers who participated in our study, as most of them are convinced of the originality behind creativity, but not so much on value.

Teachers were confronted with three statements regarding the definition of creativity:

1. Creativity is the ability to produce something original;
2. Creativity is about finding connections between things that were not previously connected;
3. Creativity is the ability to produce something valuable



Grafik.4. Teachers' perception on the definition of creativity

The first statement traverses the highest percentage of respondents, with about 71% agreeing or strongly agreeing that creativity is the ability to produce something original. About half of teachers surveyed are convinced (51.2%) that creativity is about finding connections between things that have not been linked before. It can be noticed that while only 9.8% do not agree with this statement, while 2.4% do not support the view of creativity as the ability to produce something original. Respondents are less convinced about the definition of creativity as the ability to produce something of value: 68.3% strongly agreed or disagreed, and 14.6% disagreed and 2.4% strongly disagreed. This may be due to the lack of definition of the term "value", how will one judge the value of students' creative output? Society as a whole, teachers or students themselves? (Crafts, 2005). It can be noticed that the importance of understanding creativity as the ability to produce something of value can be related to the sense of initiative and entrepreneurship. The ability to judge the value of new and original ideas and products is a central feature

of entrepreneurs, as is the ability to convince others of the value of their ideas (Sternberg & Lubart, 1993).

Teachers perceive at higher levels (70%) that creativity is the ability to produce something new original. 68.3% of them perceive creativity as the ability to produce something valuable. While almost half of the respondents perceive what is related to the connection of things that were not previously connected (51.2%)


Our findings are the same in the third statement with the finding of studies conducted in different countries of the European Union. With about 22% difference, school teachers in Europe believe that creativity is about finding connections between things that have not been linked before (73%). And 9% more European teachers believe that creativity is the ability to produce something original (79%)

2.1.4. Creativity is an important skill that can be developed in schools.

Some researchers (Crafts, 2005, Ferrari, etc., 2009; Runco, 1990), argue that creativity is an essential skill for personal development and enhances the learning process. Teachers faced three statements regarding creativity in education and respectively:

1. Creativity can be learned;
2. Creativity can be appreciated;
3. Creativity is an important skill that needs to be developed in school.

As described in Graph 5, 80.5% of teachers believe that creation is a basic skill that can be assessed. 73.2% of teachers believe that creativity is a basic skill that needs to be developed in school. They are much more convinced that creativity is the ability to produce something original and that creativity is a skill that can be applied to any subject (68.3%).



Grafik.5. Teachers' perception of creativity in education

What is worth noting is that about 1/3 of the surveyed teachers, and more precisely 36.6% of them, strongly agree or agree that creativity can be learned. Half of the respondents agree somewhat, while about 10% do not agree with this statement, of which 2.4% do not agree at all. The latter also disagrees that creativity is a basic skill that needs to be developed in school, or it is a skill that can be applied to any subject, the ability to produce something original or the ability to produce something valuable.

As a generalization we can say that teachers perceive evaluative creativity (80.5%) and as a basic skill that should be developed in school (73.2%), but only 36.6% of them believe that it can be taught.

This statement is very different from the findings of European school teachers, first at the percentage level, where European school teachers (70%) believe that creativity can be learned. There is even a positive correlation between the statement 'Creativity can be learned' and 'Anyone can be creative' or 'Creativity is innate talent'. The more respondents believe that everyone can be creative, the more they agree Creativity can be learned. Those who support the view of creativity as an innate ability are less convinced of the possibility of teaching creativity.

Necessary support for teachers, in encouraging the creativity of their students

A large number of respondents (82.9%) underwent creative creativity training in school curricula. And an even higher number (87.8%) want to undertake continuous

professional development in relation to creativity. More than half of the teachers (68.3%) claimed to have received training in pedagogy and innovative methods and the use of ICT in the classroom.

Over half of teachers complain of a lack of resources (51.2%) and state that the school where they work needed more financial support (79%). Only 17.1% of teachers believe that the quality of ICT in their school was excellent, but about respondents (70.7%) stated that it was not.

5. CONCLUSIONS AND RECOMMENDATIONS

5.1. CONCLUSIONS

The findings of this study present data on how primary school teachers in the city of Durrës perceive and understand creativity, encourage it through their teaching; use ICT to encourage creativity; and what institutional support they need to cultivate creativity in their students. The analysis aims to provide an understanding of how innovation and creativity are applied in teaching practices at the primary level in education in our schools.

This study shows that teachers **have a comprehensive idea of creativity** unlike previous studies that have been done (Satka, 2012) where most of the surveyed teachers did not know what creativity is. Almost all teachers believe that creativity can be applied in any field of knowledge and that creativity can be applied to any subject, and few teachers are convinced that creation is important only for the visual arts, music, drama and artistic performance. A good majority of teachers do not believe that creativity has an elitist appearance, as few surveyed teachers, about 1/5 still believe that creativity is an innate talent. Most support - everyone can be creative.

Teachers are almost equally convinced of the connection between **creativity with originality** and **creativity with value**. Although it is true that the value of a process or outcome in the education concourse should be tailored to the age group and skills of the students, it has been argued *that value* is the basis of **entrepreneurship** and

that students become aware of the value and output of their thoughts. In order to be able to judge and develop entrepreneurial skills.

5.2. RECOMMENDATIONS

The recommendations that emerge from this study focus mainly on creative classroom practices, ICT perception and use, and institutional support.

In relation to creative practices in primary education classes by teachers such activities as workshops, multi-disciplinary work or research of students on a certain topic, were considered less important. Since creative practices require time and space, which do not fit curriculum programs, *review of curricula or curricula* should be done by the teacher, school or even at higher levels.

Ways to evaluate creativity need to be reviewed and teachers need to be introduced to them. In relation to assessment, teachers should be encouraged to *combine different assessment methods*, including students who can reflect on learning and personal progress. If we want to improve creativity in schools, students should be given considerable time and space to investigate, test and review their work and that of their colleagues.

Bibliography

- Ala-Mutka, K., Bacigalupo, M., Kluzer, S., Pascu, C., Punie, Y., & Redecker, C. (2008). Learning2.0: The Impact of Web2.0 Innovation on Education and Training in Europe: Report on a validation and policy options workshop organized by IPTS. Seville, 29-30 October 2008, <http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC50704.pdf>
- Ala-Mutka, K., Punie, Y., & Redecker, C. (2008a). Digital Competence for Lifelong Learning <http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC48708.TN.pdf>
- Ala-Mutka, K., Punie, Y., & Redecker, C. (2008b). ICT for Learning, Innovation and Creativity, <http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC48707.TN.pdf>
- Al-Khateeb, AA (1995). Innovative Education. *Education Journal, Qatar National Commission for Education, Science and Culture* , (111), pp. 133-137 March.

- Boden, M. (2001). Creativity and Knowledge. In A. Craft, B. Jeffrey & M. Leibling (Eds.), *Creativity in education* (pp. 95-102). London: Continuum.
- Bottino, RM (2003). ICT, national policies, and impact on schools and teachers' development. Paper presented at the ICT and the Teacher of the Future.
- Burke, C. (2007). Inspiring spaces: creating creative classrooms. *Curriculum Briefing*, 5 (2), 35-39.
- Chacia, R. & Ferrari, A. (2010). Creativity in Schools: A survey of Teachers in Europe. <http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC59232.pdf>
- Cachia, R., Compañó, R., & Da Costa, O. (2007). Grasping the potential of online social networks for foresight. *Technological Forecasting and Social Change*, 74 (8), 1179- 1203.
- Beghetto, RA (2005). Does Assessment Kill Student Creativity? *The Educational Forum*, 69, 254–263.
- Black, P., Harrison, C., Lee, C., Marshall, B., & Wiliam, D. (2004). *Working Inside the Black Box: Assessment for Learning in the Classroom*. *Phi Delta Kappan*, 86 (1), 9-21.

PËRGATITJA E MËSUESIT SI EDUKATOR I NXËNËSIT. SYNIMET E EDUKIMIT

Rita Hasanaj

Mësuese e ciklit të ulët, shkolla 9 vjeçare “Nikolla Xhuveli”, Nartë, Vlorë

Abstrakt

Me këtë kumtesë mbi procesin e edukimit kulturor në shkollat tona, do të përqëndrohem në ecurinë e zhvillimit të arsimit të fëmijëve tanë, që natyrshëm kalojnë me botën e librave në vend të parë dhe me botën e lodrave në vend të dytë. Nxënësi ynë përparon kur funksionon si duhet edukimi në familje dhe në shkollë, nëpërmjet raportit të drejtë të trekëndëshit: prind - nxënës - mësues, sa klasik aq dhe bashkëkohor, për nga dobia e rezultateve që ka sjellur, kur ka funksionuar sipas standardeve të kërkuara. Synimet e edukimit arrihen me ndershëmëri profesionale, me kulturë qytetare, me dashuri ndaj nxënësit, si ndaj fëmijës tënd dhe me vlerësimin e punës në grup, duke e konsideruar veten si pjesë e së tërës. Që udhëtimi i edukimit të vijojë përditshmërisht normalisht, ndër tre hallkat e zinxhirit të artë, gjykojmë se parësore del përgatitja e mësuesit si edukator, jo thjesht si teknikien, ekspert mësues, por sidomos zotërues i metodologjisë në procesin mësues dhe edukativ të klasës e shkollës sonë. Nuk mund ta quajmë të drejtë që përgatitja e mësuesit si edukator të shikohet si ishull më vehte, e shkëputur nga dy hallkat e tjera të rëndësishme të sistemit: prindi dhe nxënësi. Secili ka vendin dhe rolin e tij në këtë proces, ku mësuesi jep dije e kulturë, nxënësi merr dije dhe edukohet, ndërsa prindi vijon me format e tij etiko-morale edukimin në familje, duke qenë hallka e ndërmjetme midis dhënësit - mësues dhe marrësit - nxënës.

Fjalët çelës/ kyçe: *edukimi, shkolla, përgatitja, raporti mësues - nxënës - prind*

1. Hyrje

Në rrafshin e pedagogjisë, kur flasim për edukimin, kuptojmë procesin e gjerë të formimit tërësor të personalitetit të njeriut, zhvillimin e tij gjatë gjithë jetës. Edukimi është një veprimtari e organizuar, e vetëdijshme, për të ndikuar mbi njerëzit, sidomos mbi brezat e rinj, për t'i formuar ata sipas një synimi të caktuar. Hapësirat e edukatës, ose përmasat e saj janë shumë të gjera. Ato shtrihen në tërë jetën tonë. Ndër fushat më kryesore, kryesisht në kuptimin, brendinë, rrugët kryesore të edukimit, prof. Musa Kraja ndërton këtë pemë pedagogjike të hapësirave të edukatës: “1. Edukata mendore, 2. Edukata morale, 2.1 Rrugët kryesore të edukimit moral, 2.2. Dy fushat konkrete të edukimit moral, 3. Edukata e punës, 4. Edukata teknike, 5. Edukata fizike, 6. Edukata shëndetësore, 7. Edukata estetike”²⁸⁴. Çdo mësues e ka të qartë se ato zhvillohen në harmoni me njëra-tjetrën dhe jo të shkëputura, pra, edukata mendore zhvillohet në harmoni me edukatën fizike, edukatën e punës, morale, estetike, teknike, nëpërmjet veprimtarisë arsimore, edukative të shkollës, të institucioneve të tjera, të medias, familjes etj. Nxënësi formohet në dy hapësira të tilla që cilësohen si makromjedis dhe mikromjedis. Mikromjedisi përfaqëson ato rrethana dhe kushte konkretet në të cilat nxënësit tanë sillen ditë për ditë, kalojnë sidomos një pjesë të kohës së lirë. Këto mjedise i ndeshim kudo, si në krye të ndonjë rrugice, në sheshe, në oborrin e shkollës, në rrugë, në varësi të lagjeve të vjetra dhe tradicionale të qytetit, në një shesh fshati, tek furra, klubi, fusha e lojës etj. Ndërsa makromjedisi përfshin gjerësisht mjedisin e qytetit, të zonës, lagjes apo fshatit. Ka efekt shumë të madh në edukim. Makromjedisi i Nartës apo Kaninës nuk mund të jetë si në një zonë në Dibër, Elbasan apo Korçë. Shkolla është institucioni i mësimit dhe edukimit, shtëpia e dritës së dijes, vatër e edukimit kulturor. Edukimi i nxënësve kërkon marrëdhënie të shëndosha të trekëndëshit mësues - nxënës - prind. Po bëjmë një paralelizëm jo thjeshtë për ilustrim figurativ. Nuk mjafton që pema të mbillet për t'u rritur e shëndetshme, duhet të ujitet, të krasitet, të punohet toka rrotull pemës (të prashitet, të plehërohet) etj. Agronomët, fermerët, bahçevanët i njohin mirë këto procese jetike për pemën dhe ia bëjnë me përpikmëri dhe në kohën e duhur. Kështu

²⁸⁴) Kraja, Musa, “Pedagogjia”, Tiranë, Migreeralb, 2009, f. 147.

funksionon edhe puna me fëmijën, me nxënësit tanë. Falë përvojës shumëvjeçare në arsimin e cilkit të ulët, kemi vënë re që ka prindër që thonë: “Unë të dorëzoj fëmijën, ti, zotni mësues apo zonja mësuese je përgjegjës/ e për gjithçka ndaj tij”. Nuk mendojmë se është i drejtë një qëndrim i tillë i papërgjegjshëm, sepse fëmija vërtet në shkollë merr bazat e arsimimit dhe edukimit qytetar, por fëmija, që na është besuar, ka prindërit e tij, babën e nënën, që janë të pazëvendësueshëm, jo vetëm se është krijesa e tyre, por është edhe vijimi i jetës së tyre, kopja e tyre në kohë të re. Nga ana tjetër, në jo pak raste, mësuesi shfajsohet: “Është fëmijë me problem filan nxënës, s’merrem me të”. Edhe në këtë rast kemi mungesë përgjegjësie dhe aq më keq pandershëmi profesional. Në qoftë se prindi, vërtet është babai apo nëna e nxënësit, ai në jetë mund të ketë profesion tjetër që ushtron, (jo detyrimisht mësues); mësuesi është në profesion **mësues** dhe detyrimisht duhet ta bëjë shumë mirë, sepse paguhet për ta ushtruar këtë profesion të nderuar me fëmijët, me brezat. Fëmijët vijnë në shkollë që të mësojnë lëndët sipas programit mësimor orë pas ore, ditë pas dite, semestër pas semestri e vit pas viti. Ata vijnë po aq të edukohen sipas normave qytetare dhe këto mesazhe edukimi t’i mishërojnë në jetë, të formësojnë shprehitë e kulturës qytetare dhe të rriten të shëndetshëm fizikisht, shkollarisht dhe qytetarisht. Në qendër të vëmendjes është nxënësi/ nxënësja. Që ai/ ajo të rritet dhe të bëhet i denjë për shkollën, familjen e shoqërinë, prindi dhe mësuesi duhet të bashkëpunojnë papushim, pa u lodhur, pa lozur “hidh e prit” “kungulleshkën” në kurriz të edukimit të nxënësit, por, në kuptimin më të mirë të fjalës, duhet të jenë shokë të ngushtë, sepse kanë një qëllim: edukimin e fëmijës/ nxënës. Nuk është objekt i kësaj kumtese puna e prindit me fëmijën e tij, por objekt kemi punën tonë si mësues me nxënësit tanë. Me kohë ka fituar qytetari shprehja “Mësuesi është prind i dytë për nxënësin” dhe popullariti i saj është mbushmëndës, i motivuar. Kyçi për suksesin në punën me nxënësit është: mësimdhënia. Nuk është fjala vetëm tek spjegimi i duhur për dhënien e dijeve të mjaftueshme nxënësit hap pas hapi, por së pari komunikimi me ta, mënyra e të sjellurit, se, siç na kujton fjala e urtë e popullit: “Ç’ të mbjellësh, do të korrësh”. Komunikimi është art më vete, art i bukur i fjalës së shprehur, ndëraq më i vështiri, po sa fisnik. Me fjalën e ngrohtë e bën për vete nxënësin e ai të do si prind; me fjalën

e ftohtë, e largon, e humbet respektin e mundshëm të tij. Nxënësi vjen në shkollë të mësojë, të nxëjë, se ka nevojë të mbushet me dije. Ai vjen në shkollë të formohet, të edukohet, të zbatojë normat, rregullat, rregulloret, ligjet, kodet etike dhe estetike të jetesës. Nuk janë të gjithë nxënësit të mirësjellshëm në shkollë, se, po themi, ashtu janë mësuar në jetën parashkollore. Mësuesi prandaj është mësues, që t'i mësojë dhe edukojë, me qetësi e dashuri, pa i fyer, pa i prekur në personalitet, sepse temperamentet e tyre përbëjnë variante mozaikore, që nuk mund t'i imagjinojmë. Këtu ne na vjen në ndihmë pedagogjia dhe psikologjia. Prapë urtësia popullore na sjell në kujtesë fjalën e rrallë: “Gjuha hekur s’ka e hekur thyen”. Mësimdhënia nuk është abstrakte: nuk do të thotë të përvetësosh veç disa rregulla, ndërtime fjalish, pra nuk bëhet fjalë vetëm për lëndën në vetvete në lidhje me nxënësin. “Gjuha dhe kultura ndikojnë pareshtur mbi njëra-tjetrën”²⁸⁵. Misioni ynë realizohet përditshëm në punën tonë me nxënësit e vështirë, të zgjuarit dhe nxënësit me kufizime të lehta. Thuhet se nxënësit me dhunti, një dorë të ngrohtë mësuesi duan dhe ecin. Vullneti, dëshira dhe ndershmëria profesionale shfaqem më dukshëm në punën e diferencuar me nxënësit me probleme, apo të vështirë si quhen ndryshe.

2. Procesi i të nxënit, një proces i motivuar

Procesi i të mësuarit, në të cilin marrin pjesë mësuesit dhe nxënësit, përbëhet nga mësimdhënia, që realizohet kryesisht nga mësuesi si organizator dhe drejtues i procesit mësimor, si dhe nga të nxënëtit, proces që e realizon nxënësi, fillimisht nën drejtimin e mësuesit dhe, gradualisht, drejt një të nxëni të pavarur. Ndodh që konceptet “të nxënit” dhe “të mësuarit përdoren në vend të njëri-tjetrit. Në fakt, ekzistojnë edhe kuptime të tjera.

Të nxënëtit është një proces, nëpërmjet të cilit çdo nxënës dhe çdokush tjetër fiton njohuri, shkathtësi dhe shprehje. Njeriu gjatë gjithë jetës është nxënës. Edhe mësuesi mëson për vete, freskon njohuritë e fituara dhe aftësohet më tej, që të jetë mbushmëndës, i plotë dhe jo i cinguar në dijet që u jep nxënësve, në përputhje me grupmoshën, programin mësimor-edukativ etj. Pra, kur themi që njeriu mëson gjatë

²⁸⁵) Buletini shkencor, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, nr. 3/ vol.2, 2015, f. 186.

gjithë jetës, kemi parasysh gjithë periudhën jetësore të tij, që sa lind, gjatë foshnjërisë, fëmijërisë e deri në pleqëri; mëson në shtëpi, në shumë fusha; mëson në shkollë, madje me synime të caktuara, sipas planeve dhe programeve të përcaktuara nga organizmat kompetente, për një vëllim të caktuar informacioni, njohurish, dhe arrin në përvetësimin e mënyrave të reja të zgjidhjeve, të kuptuarit, zbatimit të tyre në praktikë. Në këtë rrafsh, duke bërë dhe lidhjen e mikromjedisit me makromjedisin, njeriu mëson në shkollë, por mëson edhe në shoqëri, në libra, nëpërmjet burimeve të tjera të informacionit, duke mbetur të nxëniet një proces i pandalshëm; mëson edhe në mënyrë të organizuar (në shkollë dhe në institucione të tjera që punojnë me plane dhe programe të caktuara), por ky proces, jashtë shkolle është edhe i rastësishëm. Në përpikëmi që ky organizim të bëhet edhe në shtëpi. Në të nxëniet nuk mund të kërkojmë receta absolute, pasi tek çdo nxënës ka edhe diçka origjinale në të nxëniet e tij. Kjo nuk do të thotë që nxënësi të mos marrë në konsideratë përvojën e të tjerëve, kur ajo jep rezultate të mira. Ne mund të ndihmojmë nxënësin që të zgjedhë metodën më të mirë të të nxëniet. Ky proces realizohet në mënyrë individuale. Prindi i cakton fëmijës një kënd të nxënies, por mbajtjen, shfrytëzimin e bën vetë nxënësi. Ai zgjedh mjetet shumë të domosdoshme, të cilat i përdor jo vetëm njëherë, por i ka mjete pune të përhershme, si fjalorë, atlasë, libra ushtrimesh, veç teksteve bazë të lëndëve. Të nxëniet, si proces, nuk ndalet vetëm në kapjen e informacionit, edhe pse shfaqja e një modeli mund të thjeshtësojë përpunimin e përgjigjes. Përvetësim të vërtetë të informacionit do të vëmë re vetëm nëse kjo do të ketë një përgjigje të subjektit ndaj situatës dhe sipas konstruktivizmit (frytshmërisë, dobishmërisë; shën. im - R. H), nëse do të ketë kuptim apo ndërgjegjësim të kësaj sjelljeje të re, gjë që çon në një konceptim nga ana e nxënësit.

Si rrjedhojë e re e të nxëniet, nga faktorë objektivë dhe subjektivë, nga familja, shkolla, shkolla, shoqëria, media, nga studimi individual, vetëedukimi, vetëveprimi, vetëarsimimi, këmbëngulja, ambicja nga nxitja dhe stimulimi i përdorur prej mësuesve, shkollës, institucioneve të specializuara, etj., sigurohet një përvetësim aktiv, nxitet më tej mendimi dhe veprimi i nxënësve. Ky është edhe synimi i punës sonë si mësues. “Shkolla nuk është as vend i “pavarësisë së nxënësit” nga mësuesit, por as fushë beteje, për të treguar “Unin” apo egocentrizmin pedagogjik të

mësuesit”²⁸⁶. Një vëmendje e veçantë ndaj teknikave të informacionit, teknikave të të nxënët shkollor ka dhënë rezultat, si një veprimtari me karakter të thelluar individual, prej nga rrjedh edhe domosdoshmëria e njohjes dhe e zotërimit të teknikave për ta realizuar atë si një rrugë që lehtëson shumë përqëndrimin e forcave dhe energjive tek nxënësi. Në aparatën pedagogjike të tekstit mund të formulohen pyetje nga vetë nxënësi. Pas pyetjeve shtrohet problemi i vetëkontrollit, leximit aktiv me theksime të veçanta në pauzat domethënëse dhe në të menduarit gjatë asaj kohe, në shënimet gjatë të lexuarit, në nxjerrjen e çështjeve kryesore, në formulimin e një skeleti etj., aty zënë vendin edhe riprodhimi i informacionit, zbatimi i tij si efektshmëri e të nxënët. Niveli më i lartë i veprimtarisë është zgjidhja e problemeve me ndihmën e njohurive të reja të përvetësuar. Provimi është metodë e të nxënët intensive. Kur flasim për teknikat e të nxënët, kujtojmë skemën e thjeshtë që përfshin:

- Të dëgjuarit
- Të lexuarit
- Të shënuarit
- Riprodhimi i pavarur
- Diskutimi
- Zgjidhja e problemeve.

Është thënë që të nxënët është një proces i motivuar. Nxënësi mund të mësojë nga që i pëlqen të nxënët. Është e nevojshme të theksohet se në organizimin e mësimit, nëse duam të kemi pjesëmarrjen e nxënësit duhet të fillojmë të sigurohemi që rezultati i pritur të integrohet midis projekteve të subjektit, domethënë të merret nga ai si një kontribut për realizimin e objektivave të tij. Mësuesi mund të ruajë procedurën e tij vetëm pasi të jetë informuar mbi gjuhën, konceptet, aftësinë e funksioneve mendore dhe stilet e njohjes së nxënësit. Në praktikë, njohja e nxënësve duhet të jetë objekt i vazhdueshëm i kërkimit nga ana e tij. Në këtë kuadër, është me interes të shihet se ç’vend i lihet motivimit, nevojave dhe interesave të nxënësit, cilët janë funksionet

²⁸⁶) Tushi, Gëzim: “Edukimi në familje dhe në shkollë: kontekste të reja të marrëdhënieve prind-mësues-nxënës”, Tiranë, Toena, 2017, f. 276.

mendore të nxitura, cilat janë modelet e propozuara dhe cili është qëllimi për të cilin i vendosim nxënësit:

- Sepse do të marrë fillimisht nota të mira dhe më tej një dëftesë, diplomë a certifikatë;
- Sepse nuk do të përsërisë vitin shkollor;
- Sepse ngulmojnë prindërit dhe nxënësi nuk do t'ua prishë atyre. Në këtë pikëpamje, ndeshim dhe alternativë të kundërt. Ajo që është themelore për ta kuptuar është se fëmijët mësojnë në mënyrë të pavarur, jo në grupe (siç ndosh me konviktorët - nxënës të shkollave të mesme apo studentët e universiteteve); ata mësojnë nga interesi dhe kureshtja që kanë, jo nga tendenca për të kënaqur të rriturit.
- Sepse dëshirojnë të përmbushin një ego personale;
- Sepse kërkojnë të arrijnë synime personale në gjuhë të huaj, në matematikë etj., nëpërmjet të cilave të arrijnë objektiva të domosdoshme për vetveten.

Të nxënit mund të udhëhiqet nga qëllime të çastit ose nga një gjerësi e qëllimit të tij në të mësuar. Gjithashtu, të nxënëtit është rezultat i aftësive të shumta: lidhet me aftësinë për të planifikuar kohën, për të mos pranuar ndikimin e elementëve irelevantë (të panevojshëm, të tepërt, të pavend; shën. im - R. H) të nxënit, për të shmangur tërheqësit e vëmendjes, për të zotëruar veten, për t'u mbështetur në forcat e tij, për të bashkëpunuar në grup.

3. Përgatitja e mësuesit si mësues, si edukator i nxënësit

Në punën e përditshme me nxënësit, me klasat, mësuesi nuk mund të shfaqet thjesht si një profesionist i aftë dhe aq. Për profesionin mësuesi ka marrë diplomën. Siç u shprehëm edhe më lart, mësuesi punën e ka me nxënësit dhe me librat, me tekstet mësimorë dhe ato ndihmëse të edukimit të nxënësve të tij. Si frymën që merr, mësuesi duhet të përditësojë njohuritë bashkëkohore. Aq më tepër rritet përgjegjësia e tij për thithjen e materialit të nevojshëm nga bota e informacionit, sidomos sot kur fëmija është më i zgjuar dhe, të paktën, ka njohuri më të shumta se bashkëmoshatarët e tij para 10 vjetësh. Përse mos të shtrojmë pyetjen: a është i aftë mësuesi të ndjekë

prurjet e reja nga bota digjitale? A është zoti t'ua transmetojë në mënyrën e duhur dhe në masën e caktuar fëmijve që prindërit i kanë dërguar në shkollë për të nxënë? Mos vallë ka edhe raste kur mësuesi sfidohet nga nxënësi për mikrobotën e dijeve të marra nga libri dhe interneti? Si përballohet kjo gjendje? Së pari, një gjendje e tillë as që nuk duhet të mendohet nga askush prej armatës së mësuesve, sepse nuk jemi thjeshtë mësimdhënës, por misionarë të dritës diturore. Një mësues i paplotësuar me dije të përditësuara ndoshta do të ishte më mirë të bënte diçka tjetër më të dobishme për vete e për familjen e tij se sa të futej në klasë, në auditorët e shkollës dhe të ndjenjte skuqje në ndërgjegjen profesionale, kur intuita, memoria e mbushur nga të dhënat që na “bombardojnë” nëpërmjet celularit, laptopit, kompjuterit e mjeteve të tjera të “qelqit digjital” apo freskia informative e ndonjë nxënësi me prirje apo kushdo qoftë tjetër ta zinte “gafil”..., domethënë të papërgatitur!...

Mësuesi, qoftë tek nxënësi, qoftë tek prindi, është imazhi i edukimit të fëmijës që vjen në shkollë të pajiset me dije e kulturë qytetare. Kujtojmë dijetarët e periudhës së lashtësisë, që nga Sokrati, Platoni, Aristoteli, Demokriti e Kuintiliani, të cilët që ndikuan fuqishëm në edukimin e brezave, i mësuan ata dhe i pajisën me dituritë e duhura, hodhën themelet e veprimtarisë mësimore, edukative, duke i pasuruar proceset e teknikat deri tek përcaktimi i tri shkallëve të të mësuarit: intuitën, mësimin teorik, ushtrimet. Mësuesit e sotëm nuk kanë se si mos të kujtojnë me nderim personalitetet pedagogjike në nivel botëror për Mesjetën, të cilët i dhanë një frymë të re pedagogjike dhe të virtytshme arsimit, që nga pedagogu i shquar italian Vitorino de Feltre (1378-1446), që themeloi shkollën e tij “Shtëpia e gëzuar” ku krijoi mjedis tërheqës. Veç letërsisë, në atë shkollë mësohej algjebra, astronomia, dituri natyre etj. Kujtojmë humanistin anglez Tomas Mor (1478-1535), pedagogun dhe reformatorin çek Jan Amos Komenski (1592-1670), mendimtari tjetër anglez Xhon Lok (1632-1704) si dhe pedagogun dhe filozofin e madh zvicerian Zhan Zhak Ruso (1712-1778), i cili gabimisht ka hyrë në një pjesë të mirë të literaturës shqipe si autor francez. Pa u futur në rrjedhën e figurave të shumëfuqishme të arsimit dhe edukimit, do të kishte më shumë dobi për formimin tonë si mësues njohja dhe homazhi për personalitetet që u shquan në mendimin pedagogjik të Kohës së Re, si Johan H. Pestalocin, Johan F. Herbartin, Fridrih Frebel, Adolf Disterveg, K. D. Ushinski,

Xhon Djuj, Georg Kershtajner, A. S. Makarenko dhe William Killpatirrk. Po ndalojmë pakëz tek personaliteti i Johann Heinrich Pestalocit (1746-1827), mësues i shquar zvicerian, studiues, filozof e shkrimtar i përmasave botërore, i cili vuri bazat didaktikën e arsimit fillor. Tek ai spikatën idetë e mëdha për personalitetin e mësuesit, për rolin e tij në të gjithë veprimtarinë mësimore - edukative, për rolin e jashtëzakonshëm të nënës, si edukatore natyrore e fëmijës, për lidhjen e mësimin me praktikën, me prodhimin e jetën, si dhe në fusha të rëndësishme të edukimit moral, të edukatës së punës, etj. Idetë e Pestalocit ushtruan ndikim të madh mbi arsimin amerikan të shek. XIX. Pa e quajtur të nevojshme përmendjen nderuesve ndaj rilindasve tanë, që luftuar për liri dhe arsim kombëtar, duke u përlulur para tyre, para pishtarëve të arsimit shqip në shekullin XX dhe dritanëve të dijes në periudhat historike vijuese, mendojmë të përmendim një përkufizim klasifikues të historianit të arsimit, profesor, akademik, Mësues i Popullit Hamit Beqja (1929-2011): “Në pedagogji ka dhe dy ndarje të mëdha-didaktikë dhe edukatë, më konkretisht teori dhe metodologji e të mësuarit (pra didaktikë). Didaktika është shumë konkrete, është shumë aplikative, shumë eksperimentale. Por edhe shumë normative. Dhe kur ka normativitet nuk mund të mos ketë edhe doza pedantizmi dhe pak formalizmi, qoftë edhe “sui generis”²⁸⁷ (i llojit të vet, lloj më vete, i veçantë; shën. im - R. H). Jemi ndërgjegjësuar për misionin e gjerë socio-edukativ që ka marrë shkolla jonë në ditët e sotme dhe që me sa duket ka për të qenë një konstante që do ta theksojë këtë fizionomi edhe për të ardhmen. Roli i ri i shkollës në formimin qytetar dhe intelektual të nxënësit (brenda hapësirave diturore të grupmohës) në shoqërinë tonë moderne kërkon një këndvështrim konkret të trekëndëshit mësues, nxënës, “fryma e shkollës” (nga mjediset familjare dhe sociale, gjeografia prej nga vjen kontingjenti nxënësve). Në procesin mësimor edukativ, motivimi i mësimnxënies ka dhënë rezultat kur është parë i pashkëputur pa motivimin optimal në rritjen e efektivitetit të mësimnxënies. Forma më elementare e mësimnxënies konsiston në krijimin e staveve të nevojës, ku bashkëveprojnë situata “presion - barrierë” dhe situata “shtrirje - tendencë”. Është i përhapur në shumë vende koncepti i një dinamike si një faktor motivues i shkollarit.

²⁸⁷) Beqja, Hamit: “Gjurmë jete. Vepra 7”. Tiranë, Neraida, 2016, f. 146.

Më 1970 Arnold përpunoi modelin teorik të motivimit të mësimit, duke vënë në raport vertikal faktorët: “tension emocionues” - E, “intensiteti i impulsit shtytës” - I dhe Frenimi” - R, pra $I=E/R$. Është pikërisht mësuesi që duhet të jetë mjeshtër i motivimit të mësimit, që mësimit e trajton si harmoni e shëndetshme të dy këndvështrimve: mësimit si art dhe mësimit si shkencë. Në arsim roli kryesor është i mësuesit, vështruar në shërbim të bashkëpunëtorit të tij të pandarë dhe të përjetshëm: nxënësit. Kur diskutohet për tekstin është fjala e mësuesit ajo që i jep forcë e jetë. Kur flitet për metodat mësimore, është mësuesi që zgjedh; për edukimin, është mësuesi edukator; për marrëdhëniet mësues-nxënës është pikërisht ai që u jep tonin pozitiv ose dhe për shqetësime të këtyre marrëdhënieve; pra është mësuesi një figurë e pazëvendësueshme, personaliteti i të cilit është i lidhur me tërë problemet mësimore-edukative në shkollë.

Përfundime

Përvoja e punës dhe sidomos ballafaqimi me tekstet e fushës, që e trajtojnë pedagogjinë si shkencë mbi edukimin, edhe ne mund të shprehemi se mësuesi është hallka kryesore e veprimtarisë në shkollë. Ai është drejtues, organizues i procesit mësimor, interpretues i dokumentacionit shkollor, nga puna e të cilit varet veprimtaria e të tërë hallkave që veprojnë në shkollë ose në lidhje dhe bashkëpunim me të. Vetë natyra e punës së mësuesit kërkon që personaliteti i tij të përfshijë:

- Paralelisht vijmë tek idea e parë “lind”. Normalisht pamja e tij të jetë normale. Kjo është e dëshirueshme, kur është e bukur është edhe më mirë.
- Një përgatitje të përgjithshme shkencore dhe kulturore.
- Mësuesi duhet të jetë i thelluar në lëndën e tij, në profilin e ngushtë, duke ndjekur dijet bashkëkohore, informacionin e ri që sjellin shndërrimet e vullshme në disiplinën e tij, përvojat e reja, duke zgjeruar dhe aktualizuar në mënyrë të pandërprerë dijet në disiplinën e tij shkencore.
- Mësuesi duhet të ketë përgatitje pedagogjike, didaktike dhe metodike.

- Mësuesi duhet të dallohet nga pasioni për punën me fëmijët, dashuria dhe respekti për personalitetin e nxënësit.

-Është e domosdoshme që mësuesi të ketë një figurë shoqërore dhe morale të rregullt.

Vetëm kështu, i veshur me këto cilësi e virtyte, mësuesi realizon 5 rolet e tij në shërbim të nxënësve në shkollë si ekspert mësimor, drejtues dhe udhëheqës i klasës së tij, si këshilltar, si model dhe si motivues i nxënësve për një të mësuar aktiv, për të pasur interesim dhe logjikë nga nxënësit e tij.

Bibliografia:

1. Beqja, Hamit: “*Gjurmë jete. Vepra 7*”. Tiranë, Neraida, 2016.
2. Buletini shkencor, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, nr. 3/ vol.2, 2015.
3. Kraja, Musa, “*Pedagogjia*”, Tiranë, Migreeralb, 2009.
4. Tushi, Gëzim: “*Edukimi në familje dhe në shkollë: kontekste të reja të marrëdhënieve prind-mësues-nxënës*”, Tiranë, Toena, 2017.

TEACHER'S PREPARATION AS AN EDUCATOR. (GOALS OF EDUCATION.)

Rita Hasanaj

Elementary school teacher, Secondary Education School "Nikolla Xhuveli", Nartë, Vlorë, Albania

Abstract

This paper on the process of cultural education in our schools concentrates on the ongoing development of our children's education which passes naturally firstly into the book's world and secondly into the toys' world. Our students make progress when family and school education works properly, through the right relationships in the triangle parents-students-teachers, which seems both classical and contemporary in regard to the benefits of the results it has produced, when it has operated according to the required standards. The goals of education are achieved with professional honesty, with a civic culture, with love for the learner, as if they were your children and appreciation of teamwork, by considering yourself part of the whole. In order that our education journey can continue its progress normally every day, in the three links of the golden chain, we consider primarily the teacher's preparation as an educator, not just as a technician or educational expert, but mostly as an owner of methodology in the educational process of our class and school. It is not a fair approach to consider teacher's education as an isolated island from the other two important links of the system: parents and students. Each one of them has its place and plays its role in this process; the teacher gives knowledge and culture, the student receives knowledge and education, while the parents follows his / her ethical and moral forms of family education, being the intermediary link between the giver that is the teacher and the receiver who is the student..

Key words: *education, school, preparation, ratio teachers - students - parents*

1. Introduction

In the field of pedagogy, when we talk about education, we understand the vast process of the complete formation of the human personality and its lifelong development. Education is an organized, conscious activity to influence people, especially younger generations, to shape them according to a specific goal. The spaces of education, or its dimensions, are really wide. They extend throughout our lives. Among the most important areas, mainly in terms of meaning, when it comes to the main educational pathways, Prof. Musa Kraja creates this pedagogical tree of educational spaces: “1. Mental education, 2. Moral education, 2.1 Main ways of moral education, 2.2. Two specific areas of moral education, 3. Work education, 4. Technical education, 5. Physical education, 6. Health education, 7. Aesthetic education. Every teacher is aware that they develop in harmony with each other and they not disconnected, that is, mental education develops in harmony with physical, work, moral, aesthetic and technical education, through the educational activity of the school, other institutions, media, family etc. The student is formed in two spaces called macro environment and micro environment. The micro environment represents those specific circumstances and conditions in which our students behave day by day, and in which they spend part of their free time. We encounter these environments everywhere, such as at the top of any alley, in the squares, in the schoolyard, on the street, depending on the old and traditional neighborhoods of the city, in a village square, in the bakery, club, playground, etc. While the macro environment extensively encompasses the environment of the city, area, neighborhood or village. It has a great influence on education. The macro environment of Narta or Kanina cannot be considered the same as that of Dibër, Elbasan or Korça. The school is the institution of learning and education, the home of the light of knowledge, the home of cultural education. Student education requires a healthy relationship among teachers-students-parents. We're making a parallelism not just for figurative illustration. It is not enough for the tree to be planted to grow healthy, it must be watered and pruned; the soil around the tree needs to be plowed, and fertilized. Agronomists, farmers, gardeners are familiar with these vital

processes for the tree and do it precisely in the respective time and manner. This is how it works with our students. Thanks to many years of experience in the elementary education, we have noticed parents who say, "I am bringing my child to school and you as a teacher are responsible for everything happening to him/her from now on". We do not think that such an irresponsible attitude is right, because it is true that the child really gets to the basics of civic education in the school, but on the other hand the student who frequents the school has a family, his parents, who are irreplaceable, not just that he/she is their creature, but it is also the continuation of their life, their copy in the new age. Yet, in several cases, the teacher justifies: "That student is really problematic, and it's not my business to deal with him/her!". Even in this case, we lack responsibility and I could say, even worse, we have to do with professional dishonesty. If the parent is the father or mother of the student, he may have another occupation in life and he might not necessarily be a teacher. The teacher is a teacher in profession and should do this job very well because he is paid to practice this honorable profession with children, for many generations. Children come to school to learn subjects according to the curriculum hour after hour, day after day, term after term and year after year. They also come to get educated according to civic norms and embody these educational messages in their lives, create civic culture habits, and grow physically, literally, and civically healthy. The student is on the focus of attention. In order for him / her to grow up and become worthy of school, family and society, his parents and teachers must closely cooperate together and should not try to avoid responsibility at the expense of the student's education, but in the best sense of the word, they must try to be close friends because they have one purpose: the education of the student. The aim of this paper is not the work parents should do with their children, but the work teachers should do with their students. The term "Teacher is the second parent for the student" and its popularity is convincing and motivating. The key to success in working with students is teaching. It does not necessarily refer to just explaining to the students step-by-step knowledge, but the most important thing is the way of communicating with them, the way they behave, as the people's famous saying reminds us: "What goes around, comes around!" Communication is an art in itself, a beautiful art of

